LIBRI I KUQ I FAUNËS



SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Halil Ibrahimi, Agim Gashi, Daut Rexhepaj, Ferdije Zhushi Etemi, Linda Grapci Kotori, Zoltán Fehér, Taulant Bino, Lucija Šerić Jelaska, Gabor Mesaroš, Philippe Théou

Prishtinë, 2018

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
AGJENCIA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT TË KOSOVËS
INSTITUTI I KOSOVËS PËR MBROJTJEN E NATYRËS

Libri i Kuq i Faunës së Republikës së Kosovës

Botues:
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Redaktor përgjegjës:
Halil Ibrahimi

Recensentë:
Dr. sc. Valentina Slavevska Stamenković, Universiteti i Shkupit
Dr. sc. Hakan Bozdoğan, Ahi Evran University

Lektor:
Sheremet Krasniqi

Autorë:
Dr. sc. Halil Ibrahimi, Universiteti i Prishtinës
Dr. sc. Agim Gashi, Universiteti i Prishtinës
Dr. sc. Daut Rexhepaj, Universiteti i Prishtinës
Dr. sc. Ferdije Zhushi Etemi, Universiteti i Prishtinës
Dr. sc. Linda Grapci Kotori, Universiteti i Prishtinës
Dr. sc. Zoltán Fehér, Muzeu Hungarez i Natyrës
Dr. sc. Taulant Bino, Universiteti POLIS
Dr. sc. Lucija Šerić Jelaska, Universiteti i Zagrebit
Dr. sc. Gabor Mesaroš, Suboticë, Vojvodinë
Dr. sc. Philippe Théou, Universiteti i Tiranës

Dizajni grafik:

Hartat:
Florian Isufi

Shtypi:

Tirazhi:

ISBN:

Prishtinë, 2018

® Ndalohet shumëzimi dhe ribotimi i paautorizuar pa
lejen e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

TABELA E PËRMBAJTJES

PARATHËNIE 1

1 HYRJE 2

1.1 Libri i Kuq i Faunës së Republikës së Kosovës dhe mbrojtja e biodiversitetit 3
1.2 Metodologjia e punës 4

1.2.1 Klasifikimi i faunës në bazë të kategorive të IUCN-së 5
1.2.2 Definimi i termave të përdorur në Librin e Kuq të Faunës 6
1.2.3 Klasifikimi i habitateve 7
1.2.4 Klasifikimi i kërcënimeve 8
1.2.5 Klasifikimi i masave për konservim dhe hulumtimeve të nevojshme 9
1.2.6 Përdorimi i softuerit Ramas Red List 10
1.2.7 Përdorimi i fotografive të llojeve 11
1.2.8 Të gjeturat e Librit të Kuq të Faunës 12
1.2.9 Përfundime 13

A1 Shtojcat e Hyrjes 14

A1.1 Kategoritë e IUCN-së (sipas Kategorive dhe Kritereve të Listës së Kuqe të IUCN-së: Versioni 3.1-2012) 15
A1.2 Përmbledhje e pesë kritereve (A-E) të përdorura për të vlerësuar nëse taksoni i takon kategorisë së kërcënueshërisë sipas IUCN-së (Skajshmërisht i Rrezikuar, I Rrezikuar ose I Cenuar) 16
A1.3 Definimi i termave lidhur me kriteret e përdorura për vlerësimin e llojeve (sipas Kategoritë dhe Kriteret e Listës së Kuqe të IUCN-së: Versioni 3.1-2012) 90
A1.4 Skema e Klasifikimi të Habitateve (Versioni 3.1) 100
A1.5 Skema e Klasifikimit të Kërcënimeve (Versioni 3.2) 230
A1.6 Skema e Klasifikimit të Veprimeve për Konservim (Versioni 2.0) 345
A1.7 Skema e Klasifikimit të Hulumtimeve të Nevojshme (Versioni 2.0) 343

2 LLOJET SKAJSHMËRISHT TË RREZIKUARA (CR) 423

2.1 Insecta 223
2.2 Actinopterygii 233
2.3 Aves 123
2.4 Mammalia 100

3 LLOJET E RREZIKUARA (EN) 230

3.1 Bivalvia 345
3.2 Oligochaeta 343
3.3 Insecta 423
3.4 Actinopterygii 223
3.5 Amphibia 233
3.6 Aves 123
3.7 Mammalia 100

4 LLOJET E CENUARA (VU) 230

4.1 Gastropoda 345
4.2 Malacostraca 343
4.3 Diplopoda 423
4.4 Insecta 223
4.5 Actinopterygii 233
4.6 Amphibia 123
4.7 Reptilia 100
4.8 Aves 230
4.9 Mammalia 345

5 LLOJET GATI TË KËRCËNUARA (NT) 343

5.1 Gastropoda 423
5.2 Oligochaeta 223
5.3 Insecta 233
5.4 Cyclostomata 123
5.5 Actinopterygii 100
5.6 Reptilia 230
5.7 Aves 345
5.8 Mammalia 343

6 LLOJET ME SHQETËSIMIN MË TË VOGËL (LC) 423

6.1 Oligochaeta 223
6.2 Arachnida 233
6.3 Insecta 123
6.4 Actinopterygii 100
6.5 Amphibia 230
6.6 Reptila 345
6.7 Mammalia 343

7 LLOJET ME TË DHËNA TË PAMJAFTUESHME (DD) 423

7.1 Oligochaeta 223
7.2 Clitellata 233
7.3 Arachnida 123
7.4 Malacostraca 100
7.5 Diplopoda 230
7.6 Insecta 345
7.7 Actinopterygii 343
7.8 Amphibia 423
7.9 Reptilia 223
7.10 Aves 233
7.11 Mammalia 123

REFERENCAT 100

Libri i Kuq i Faunes se Kosoves | 1

ANKRONIMET	KUPTIMI
AK	Autoriteti Kontraktues
AKMM	Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit
AS	Ambasada e Suedisë
AT	Asistenca Teknike
BB	Banka Boterore
BE	Bashkimi Europian
BNRN	Bashkimi Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN)
CR	Skajshmërisht i Rrezikuar (kategoria IUCN)
DD	Të Dhëna të Pamjaftushme (kategoria IUCN)
DI	Departamenti i Inspektoratit
DMMU	Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit dhe i Ujërave
DP	Drejtor i Projektit
EA	Ekspert Afatshkurtë
EK	Ekipi Kryesor
EN	I Rrezikuar (Kategoria IUCN)
EP	Eksperti i Prokurimit
EP	Ekipi i Projektit
EUR	Euro (monedha Europiane)
EW	I Zhdukur në Natyrë (Kategoria IUCN)
EX	I Zhdukur (Kategoria IUCN)
IHMK	Instituti Hidro-Meteorologjik i Kosovës
IKMN	Instituti Kosovar për Mbrojtjen e Natyrës
IP	Institucioni Përfitues
IPA	Instrumenti i Ndihmës Para-Anëtarësimit
IPH	Instituti i Planifikimit Hapësinor
IShMK	Inspektorati Shtetëror i Mjedisit të Kosovës
KB	Kombet e Bashkuara
KD	Komitet Drejtues
KE	Komisioni Europian
KE	Kryeshefi Ekzekutiv
KK	Kuvendi i Kosovës
KNU	Këshilli Ndërministror i Ujërave
KZSh	Koordinatori i Zyrës Shtëpi
LC	Shqetësim më i Vogël (Kategoria IUCN)
LKF	Libri i Kuq i Faunës
MBR	Menaxhimi i Bazuar në Rezultate
MEL	Menaxheri i Ekipit Lokal
MEZh	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
MIE	Ministria e Integrimit Europian
MK	Marrëveshja Kornizë
MKRS	Ministria e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MP	Menaxhimi i Projektit/Programit/Menaxheri i Programit
MPA	Monitorimi i Projektit dhe Auditimi
MPBZhR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

KUPTIMI	ANKRONIMET
I Paaplikueshëm (kategoria IUCN)	**NA**
I Pavlerësuar (kategoria IUCN)	**NE**
Njësia e Lehtësimit të Programit	**NjLP**
Njësia e Zbatimit	**NjZ**
Gati i Kërcënuar (Kategoria IUCN)	**NT**
Ofruesi i Shërbimeve Kornizë	**OShK**
Parku Kombëtar	**PK**
Parkun Kombëtar Qendra e Informimit	**PKQI**
Programi Mjedisor i Kosovës	**PMK**
Plani i Menaxhimit të Parkut Kombëtar	**PMPK**
Plani i Punës	**PP**
Pjesëmarrja në Sektorin Privat	**PSP**
Qeveria e Kosovës	**QeK**
I Zhdukur në Rajon (Kategoria IUCN)	**RE**
Sigurimi i Cilësisë	**SC**
Krona Suedeze (monedha Suedeze)	**SEK**
Shteti Përfitues	**ShP**
Shtrirja e përhapjes	**SHP**
Seti Kryesor i Treguesve	**SKT**
Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar	**Sida**
Shërbimet e Sigurimit të Cilësisë	**ShCS**
Strategjia e Mjedisit në Kosovë	**SMK**
Sekretar i Përgjithshëm	**SP**
Udhëheqësi i Ekipit të Programit	**UEP**
Udhëzimet e Prokurimit	**UP**
Udhëzimet e Prokurimit të Sida-s	**UPS**
Udhëheqësi i Ekipit të Komponentit	**UEK**
Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis	**VNM**
I Cenuar (Kategoria IUCN)	**VU**
Zona e Pranisë	**ZP**
Zyra e Bashkimit Europian në Kosovë	**ZBEK**

Të nderuar lexues dhe dashamirës të natyrës



Dr. Sc. Ilir Morina,
Kryeshef i AMMK-së

Në shumë vende të botës, duke përfshirë edhe Kosovën, si pasojë e moszbatimit të konventave ndërkombëtare për ruajtjen e biodiversitetit, ka ardhur deri te humbje të konsiderueshme, përfshirë ndryshimin e habitateve, shfrytëzimin e skajshëm të tyre, ndotjen, si dhe ndryshimet klimatike.

Sot, në botë ekzistojnë shumë organizata mjedisore të cilat kanë rol të rëndësishëm në nivel kombëtar ose ndërkombëtar në ruajtjen e llojeve të rralla dhe të rrezikuara. Këto organizata në bashkëpunim me qeveritë e vendeve të tyre, po ndikojnë që sado pak të ndalojnë ose të paktën të ngadalësojnë zhdukjen e llojeve të rralla dhe të rrezikuara.

Për ruajtjen e biodiversitetit të një vendi rëndësi të madhe ka edhe edukimi i popullatës në përgjithësi e në veçanti i popullatës rurale që jeton në afërsi të lokaliteteve të pasura me vlera të mëdha të biodiversitetit. Është shumë e rëndësishme që të merren masa në mbrojtjen e llojeve, të cilat kanë rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare dhe të caktohet statusi i kërcënueshmërisë së këtyre llojeve. Kjo do të kishte ndikim të madh në caktimin e prioriteteve për mbrojtjen e llojeve të caktuara.

Në bazë të të dhënave nga terreni është konstatuar se në Kosovë faktori kryesor që ndikon në zvogëlimin e arealit të shumë llojeve të faunës është njeriu. Në botë, por edhe në Kosovë janë shkatërruar habitate të ndryshme me ç'rast janë zhdukur edhe lloje shtazore dhe bimore që janë panjohura për shkencën. Ekzistojnë mjaft të dhëna shkencore që na mësojnë si duhet ruajtur ekosistemet, habitatet dhe biodiversiteti në përgjithësi. Me ruajtjen e këtyre resurseve krijohen kushtet për ruajtjen e llojeve bimore dhe shtazore.

Libri i Kuq i Faunës së Republikës së Kosovës është i rëndësishme sepse e përqendron vëmendjen e të gjithëve që merren me mbrojtjen e natyrës.

Ky libër ka rëndësi të madhe, sepse siguron informacionet të cilat ndihmojnë në hartimin e politikave mbrojtëse në nivel kombëtar dhe mundëson një bashkëpunim më të mirëfilltë me organizata ndërkombëtare që merren me mbrojtjen e biodiversitetit.

Republika e Kosovës, edhe pse është një shtet me sipërfaqe të vogël (10.908 km²), është mjaft e pasur në aspektin e shumëllojshmërisë shtazore.

Pasi që ky është Libri i Kuq i parë i punuar në Republikën e Kosovës, ai do t'i shërbej studiuesve, studentëve dhe politikbërësve në hartimin e politikave dhe strategjive në mbrojtjen e faunës dhe orientimin e projekteve në të ardhshmen.

Me këtë raste në emër të AMMK-së, shprehi falënderimin dhe mirënjohjen për mbështetjen financiare të SIDA-s, si dhe për të gjithë ekspertet e angazhuar në finalizimin e këtij projekti.

PARATHËNIE

Më 16 qershor 2016 Ambasada e Suedisë (AS) nënshkroi një Marrëveshje Kornizë me ORGUT Consulting AB, e blerë më pas nga FCG Suedi, më tutje e quajtur thjesht "FCG", si Ofrues i Shërbimive Kornizë (OShK) në partneritet me EPTISA Servicios de Ingeniería (Spanjë), quajtur thjesht "EPTISA", për zbatimin e "Programit Mjedisor të Kosovës", gjithashtu i quajtur "Programi" ose "PMK" (dokumenti i propozuar për AS në Qershor 2015), referenca nr. 2016/07076, financuar nga Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim (Sida) dhe është pajtuar me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së Kosovës (MMPH). Marrëveshja Kornizë filloi formalisht me 4 korrik 2016 me një kohëzgjatje të përgjithshme prej 4 vitesh deri më 3 korrik 2020. Qëllimi i Programit është mbështetja e zhvillimit të kapaciteteve të MMPH-së, Këshillit Ndërministror të Ujërave (KNU), komunave dhe akterëve të tjerë në monitorimin dhe menaxhimin e mjedisit. Më konkretisht, PMK-ja synon të zhvillojë kapacitetin e zbatimit të legjislacionit mjedisor në përputhje me direktivat e BE-së dhe të mbështesë Agjencinë Kosovare të Mbrojtjes së Mjedisit (AKMM) për të rritur njohuritë, për të mbrojtur biodiversitetin dhe për të përmirësuar menaxhimin e zonave të mbrojtura ndërkufitare mbi prioritetet kombëtare që rrjedhin nga dokumentet e politikave të MMPH-së, duke përfshirë Strategjinë e Kosovës për Mjedisin (SKM) dhe Planin Kombëtar të Veprimit për Mjedisin (PKVM). Programi gjithashtu synon të forcojë njohuritë mbi burimet ujore të Kosovës duke përmirësuar menaxhimin e tyre dhe duke rritur elasticitetin ndaj ndryshimeve mjedisore dhe klimaterike. Për të arritur këto objektiva, PMK-ja është ndarë në Komponentët e mëposhtëm:

Komponentët e PMK-së

1. Forcimi i kapacitetit të AKMM-së për monitorimin, vlerësimin dhe raportimin mjedisor
2. Ruajtja e biodiversitetit nëpërmjet Librit të Kuq të llojeve të kafshëve në Kosovë
3. Forcimi i menaxhimit të zonave natyrore ndërkufitare
4. Ngritja e rrjetit të monitorimit të ujërave nëntokësore në Kosovë
5. Forcimi i kapaciteteve për zbatimin e legjislacionit mjedisor në nivel qendror dhe lokal
6. Hulumtimet e ujërave nëntokësore në Pellgun e Lumit Drin
7. Plani i menaxhimit të pellgut lumor për Pellgun e Lumit Drin
8. Mbështetje për Këshillin Ndërministror të Ujërave
9. Ofrimi i Shërbimeve të Asistencës Teknike për Njësinë Lehtësuese të Programit (ndërthurur)

Komponenti 2 i Programit është kryesisht i fokusuar në finalizimin e Librit të Kuq të Faunës që jetojnë ose kalojnë territorin e Republikës së Kosovës përmes zbatimit të detyrave dhe aktiviteteve kryesore si në vijim:

A2 Ruajtja e biodiversitetit nëpërmjet Librit të Kuq të llojeve të kafshëve në Kosovë

A2.01 Ofrimi i mjeteve të matshme dhe të vlerësueshme për mbrojtjen dhe ruajtjen e biodiversitetit për Institucionet kryesore

A2.01.01 Përgatitja e një dokumenti bazë për një punëtori për përgatitjen e Librit të Kuq të Llojeve të Kafshëve
A2.01.02 Planifikimi, nxitja dhe shpërndarja e rezultateve të punëtorisë midis pjesëmarrësve
A2.01.03 Përgatitja e një raporti bazë dhe baza e të dhënave mbi statusin e ruajtjes dhe shpërndarjes së llojeve të kafshëve
A2.01.04 Verifikimi i të dhënave bazë dhe mbledhja e informatave të tjera relevante përmes inventarit në terren
A2.01.05 Përgatitja e një metodologjie për klasifikimin në lidhje me statusin e kafshëve bazuar në standardet rajonale dhe globale të ruajtjes
A2.01.06 Ofrimi i udhëzimeve për përditësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të bazës së të dhënave
A2.01.07 Lehtësimi i aktiviteteve të planifikimit pjesëmarrës dhe analizës për gjenerimin e të dhënave/statistikat mbi biodiversitetin/ruajtjen e monitorimit
A2.01.08 Lehtësimi i planifikimit pjesëmarrës për përfshirjen e të dhënave të Librit të Kuq të të Dhënave tëLlojeve të Kafshëve mbi strategjitë e biodiversitetit/mjedisit
A2.01.09 Përgatitja dhe botimi i versionit të parë të Librit të Kuq të të Dhënave të Llojeve të Kafshëve në Kosovë

A2.02 Trajnimi i personelit nga Institucionet e monitorimit të natyrës mbi teknikat e monitorimit dhe konservimit të grupeve të kafshëve

A2.02.01 Kryerja e trajnimeve në vendin e punës për monitorimin e ekosistemeve të ujërave të ëmbla, mishngrënësve të mëdhenj dhe eko sistemeve tokësore
A2.02.02 Përgatitja e metodologjive standarde dhe identifikimi i udhëzimeve të monitorimit dhe manualeve për llojet e kafshëve
A2.02.03 Ofrimi i objekteve themelore logjistike për monitorimin e llojeve të kafshëve
A2.02.04 Ofrimi i trajnimeve për perspektivat ligjore për monitorimin, konzervimin dhe ruajtjen e llojeve të kafshëve
A2.02.05 Sinkronizimi dhe organizimi i shkëmbimit të njohurive kërkimore kolektive dhe ekspertizës në ruajtjen e biodiversitetit

A2.03 Rritja e ndërgjegjësimit të OJQ-ve, komuniteteve/institucioneve kyçe mbi rëndësinë/metodat e mbrojtjes së biodiversitetit

A2.03.01 Organizimi i 2 punëtorive për mbrojtjen, monitorimin dhe zbatimin e ligjit lidhur me biodiversitetin e kafshëve në Kosovë
A2.03.02 Organizimi i 2 punëtorive mbi prioritetet e aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes dhe mbrojtjen e natyrës në lidhje me biodiversitetin e kafshëve
A2.03.03 Prodhimi i një versioni përmbledhës të Librit të Kuq të Llojeve të Kafshëve, duke synuar mësuesit, nxënësit dhe studentët, OJQ-të dhe komunitetet
A2.03.04 Organizimi i një punëtorie për shpërndarjen e Librit të Kuq të Llojeve të Kafshëve në Kosovë
A2.03.05 Organizimi i një punëtorie trajnimi për trajnuesit për mbrojtjen, konzervimin, ruajtjen dhe monitorimin e llojeve të kafshëve

Detyra dhe aktivitete të tilla u zbatuan nga 3 Janari 2017 deri më 31 Dhjetor 2018 dhe drafti i parë i Librit të Kuq të Llojeve të Kafshëve në Kosovë (ky dokument) është finalizuar më 31 Dhjetor 2018.

Gjatë kësaj periudhe është angazhuar një grup multidisiplinar i ekspertëve ndërkombëtarë, rajonalë dhe kosovarë për të mbështetur stafin e AKMM-së dhe IKMN-së në finalizimin e Komponentit 2 dhe në shtypjen e Librit të Kuq të Llojeve të Kafshëve (ky studim). Këta 11 ekspertë ishin:

- Z. Halil IBRAHIMI (ekspert kosovar dhe rajonal i Librit të Kuq të Faunës, I faunës së Trichoptera-ve dhe Plecoptera-ve):
- Z. Daut REXHEPAJ (ekspert kosovar për amfibe dhe zvarranikë, si dhe për faunën e gjitarëve);
- Z. Agim GASHI (ekspert kosovar për faunën e Ephemeroptera-ve dhe Diptera-ve);
- Znj. Linda GRAPCI KOTORI (eksperte kosovare për faunën e peshqve);
- Znj. Ferdije ZHUSHI ETEMI (eksperte kosovare për faunën e Lepidoptera-ve dhe faunën e Odonata-ve);
- Z. Zóltan FEHÉR (ekspert nderkombëtar për faunën e molluskave);
- Znj. Lucija ŠERIĆ JELASKA (eksperte ndërkombëtare për faunën e dheut);
- Z. Taulant BINO (ekspert rajonal për faunën e shpendëve)
- Z. Philippe THÉOU (ekspert rajonal për faunën e Chrioptera-ve);
- Z, Gabor MESAROŠ (ekspert rajonal për faunën e Coleoptera-ve);
- Znj. Valentina SLAVEVSKA STAMENKOVIĆ (eksperte rajonale për redaktimin e Librit të Kuq)

Puna e të gjithë këtyre ekspertëve me angazhim afat-shkurtër (EA) ishte nën koordinimin e drejtpërdrejtë dhe mbikëqyrjen e Z. Fadil BAJRAKTARI, Drejtor i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (IKNM) i cili ka punuar nën drejtimin e Z. Ilir MORINA, Kryeshefi Ekzekutiv i Agjensionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AKMM) për të zbatuar Komponentin 2 të përgjithshëm të PMK-së, me ndihmën e 2 Ekspertëve Kryesorë: Z. Giuseppe RAZZA, Udhëheqësi i Ekipit të Programit dhe Udhëheqësi i Ekipit të Komponentëve 1÷4 të PMK-së dhe Z. Tush MARKAJ, Menaxheri i Ekipit Lokal të Komponentëve të njëjtë.
Përveç ekspertëve të mësipërm, përpilimi i Librit të Kuq të Faunës është mundësuar edhe nga kontributi i vlefshëm i ekspertëve në vijim të cilët kanë siguruar të dhëna për llojet, mostra të llojeve të rëndësishme e të rralla, vlerësime për llojet e tilla dhe përpunim të të dhënave ekologjike: Profesor Esat DAUTI, Z. Qenan MAXHUNI, Z. Astrit BILALLI dhe Z. Donard GECI.
Universiteti i Prishtinës duhet të falënderohet veçanërisht pasi që nëpërmjet bashkëpunimit akademik të tij ka mundësuar bashkëpunimin e shumë njerëzve që ndihmuan në përpilimin e Librit të Kuq të Faunës të Republikës së Kosovës, gjatë të gjitha fazave të realizimit të tij, duke siguruar të dhëna dhe mostrat, duke asistuar në marrjen e mostrave dhe/ose vëzhgimin e llojeve të kafshëve të ndryshme, duke lehtësuar dhe duke mundësuar punën në terren, duke identifikuar disa nga materialet e mbledhura faunistike etj.
Veçanërisht falënderohen personat e mëposhtëm të cilët ofruan mostra ose të dhëna për lloje të ndryshme të kafshëve të përfshira në Librin e Kuq: Z. Bardh XËRXA, Z. Milaim MUSLIU, Znj. Eike NEUBERT, Z. Joseph GREGO, Z. Miklósv SZEKERES, Z. Marko WANKE, Z. Miklós SZEKERES, Z. Gregor WOLF, Z. Nexhmedin RAMADANI dhe Z. Liridon HOXHA.

Përveç kësaj, profesionistët e tjerë të mëposhtëm ishin të rëndësishëm për ndihmën e tyre të vlefshme gjatë punës në terren dhe hulumtimeve të kryera gjatë zbatimit të projektit: Z. Zoltán ERŐSS, Z. Tamás DELI, Z. Dejan KULIJER, Z. Damjan VINKO, Z. Sami BEHRAMI, Znj. Nexhmije KAMBERI, Z. Pajtim BYTYQI, Znj. Valentina PEJA, Z. Edison KASUMAJ, Znj. Delvina HOTI, Z. Valmir BYTYQI, Z. Arian MAVRIQI, Z. Xhavit MALA, Z. Besim ZOGU, Z. Jeton MUHAXHIRI, Z. Myzafer ARIFI, Z. Bekim BYTYQI, Z. Raim KURTAJ, Z. Bujar KRASNIQI, Z. Granit HYSENI, Z. Besnik JAKUPI, Z. Fatos LAJÇI, Z. Sefer ALICKAJ, Z. Besim DEMIRI dhe Z. Liridon SHALA. Falenderohen ekspertët e mëposhtëm për kontributin e tyre në ofrimin e fotografive të disa llojeve të përfshira në Librin e Kuq të Faunës të Republikës së Kosovës: Z. Jan-Joost MEKKES, Z. Deajn KULJIER, Z. Peter GLŐER, Z. Vladimir PEŠIĆ, Z. Dávid MURÁNYI, Z. Liridon HOXHA, Znj. Nataša STEFANOVSKA, Z. Tomi TRILAR, Znj. Nesrine AKKARI, Z. Jenő KONTSCHÁN, Z. Mišel JELIĆ, Znj. Marijana VUKOVIĆ, Znj. Darija ČALETA, Z. Roman OZIMEC, Z. Barna PÁLL-GERGELY dhe Z. Besnik FETIU. Personat në vijim dhanë ndihmën e tyre të çmuar në përcaktimin e disa prej mostrave të mbledhura: Z. Jean-Luc GATTOLLIAT, Z. Michael SARTORI dhe Z. Ignac SIVEC. Dhe së fundmi, personat e mëposhtëm falënderohen për ofrimin e aksesit në koleksionet e ruajtura: Z. Sigrid HOF, Znj. Anita ESCHNER dhe Z. Reshat ZEQIRI.
Përveç kësaj, stafi i Parqeve Kombëtare të Bjeshkëve të Nemunadhe Sharri falënderohen për ndihmën e tyre gjatë realizimit të disa udhëtimeve në këto zona të mbrojtura.

1 HYRJE

1.1 Libri i Kuq i Faunës së Republikës së Kosovës dhe mbrojtja e biodiversitetit

Me gjithë rëndësinë që e ka biodiversiteti i të gjitha niveleve (i ekosistemit, llojor dhe gjenetik), sot jemi dëshmitarë të njërës ndër epokat më dramatike të zhdukjes dhe rrezikimit të llojeve të organizmave të gjallë, të cilët, në të vërtetë, shërbejnë si shtylla të mbarëvajtjes dhe qëndrueshmërisë së jetës në Tokë. Aktivitetet njerëzore gjatë dekadave të fundit kanë shkaktuar rritjen rapide për qindra herë të nivelit të humbjes së llojeve.

Në qoftë se në kushte natyrore gjatë një viti do të zhdukej një lloj, në kohët e sotme, ky nivel i humbjes së llojeve është ngritur deri në qindra herë për disa grupe, si rezultat i ndryshimit të mënyrës së jetesës së njerëzimit gjatë shekujve të fundit (Chivian & Bernstein 2008). Sipas Indeksit të Planetit të Gjallë (Living Planet Index LPI) midis viteve 1970 dhe 2018 kemi pasur një rënie të popullatave të disa prej grupeve kryesore të kurrizorëve deri në 60% (WWF 2018). Krahas kësaj, ekosistemet e ujërave të ëmbla dhe ato përreth, të njohura si qendra të biodiversitetit për shumë grupe të pakurrizorëve dhe kurrizorëve, kanë pësuar degradim drastik gjatë këtyre dekadave, duke çuar mijëra lloje drejt zhdukjes. Gjatë periudhës së njëjtë, 1970 – 2018, popullatat e ujërave të ëmbla kanë rënë me mbi 80% (WWF 2018).

Krahas këtij trendi të humbjes së llojeve dhe habitateve gjatë dekadave të fundit, në të njëjtën kohë janë bërë përpjekje të shumta që të ngritet vetëdija për parandalimin e veprimtarive që shkaktojnë përkeqësimin e jetës së organizmave të gjallë. Njëri nga konkluzionet e OKB-së nga Konferenca e Rio-s për Mjedisin dhe Zhvillimin e vitit 1992 ishte se mungesa e informatave cilësore rreth gjendjes së biodiversitetit në nivel lokal, shtetëror, rajonal dhe global, është një ndër pengesat kryesore në mbrojtjen dhe konservimin e natyrës. Në këtë kontekst, listat e kuqe dhe librat e kuq të përgatitur në shtete të ndryshme gjatë viteve gjashtëdhjetë të shekullit XX, ishin përpjekje për parandalimin e humbjes së llojeve dhe krijimin e politikave për mbrojtjen efektive të tyre.

Ndërkombëtarizimi i kësaj ideje u kurorëzua në vitin 1980, kur IUCN krijoi Njësitin e Librit të Kuq, i cili e konceptoi këtë dokument si udhëzues për formulimin, mbrojtjen dhe menaxhimin e llojeve të listuara (Collar 1996). Që nga atëherë, një mori librash të kuq të grupeve të ndryshme të organizmave janë krijuar në përmasa globale, rajonale, nacionale e lokale, duke u bërë edhe obligim ligjor në shumë vende në botë. Qëllimet e librave të kuq janë përmbledhur në disa pika, si:

1. Vendosja e prioriteteve,
2. Gjithëpërfshirja,
3. Objektiviteti,
4. Motivimi, dhe
5. Monitorimi.

Rrjedhimisht, qëllimet specifike të tyre janë: ruajtja e llojeve nga zhdukja, formësimi i politikave publike, identifikimi i habitateve kyçe, çështjeve kyçe dhe vendeve kyçe, synimi i fondeve dhe reduktimi i kostos për menaxhimin e llojeve, mbulesa e tërësishme e grupeve kryesore të organizmave dhe burimeve kryesore, që ndërlidhen me taksonet, krijimi i bazave të të dhënave për biodiversitetin, vendosja e standardeve globale neutrale dhe të pavarura në kontekstin lokal, transferimi i dëshmive shkencore në domenin publik, nxitja dhe pjesëmarrja e publikut në mbrojtje e menaxhim, krijimi i politikave publike dhe ndërlidhja midis tyre, si dhe krijimi i bazës për monitorimin e llojeve dhe bazës për matjen e progresit në konservim (Collar 1996).
Në nivel rajonal, Shqipëria ka prodhuar deri më tani dy versione të Librit të Kuq të Faunës (Misja 2006; REC 1997), në Serbi është punuar Libri i Kuq i Amfibeve (Kalezić *et al.* 2015), Libri i Kuq i Reptileve (Tomović *et al.* 2015) dhe Libri i Kuq i Fluturave të Ditës (Jakšić 2003), në Bosnjë-Hercegovinë, Lista e Kuqe e Zgjeruar e Faunës së Federatës së Bosnjës (Škrijelj *et al.* 2013), kurse Maqedonia dhe Mali i Zi ende nuk kanë libra të kuq të faunës. Në këtë kontekst, Libri i Kuq i Faunës së Republikës së Kosovës punohet për herë të parë. Paraprakisht, në vitin 2013 është publikuar Libri i Kuq i Florës Vaskulare të Kosovës (Millaku *et al.* 2013).

Kosova karakterizohet si një pjesë e rëndësishme e Gadishullit Ballkanik në aspektin e biodiversitetit, për shkak të një numri të madh të llojeve bimore e shtazore stenoendemike, endemike, të rralla, të rëndësishme, por edhe të kërcënuara dhe të rrezikuara. Megjithëkëtë, vendi akoma ballafaqohet me mungesë të investimeve të rëndësishme në ruajtjen e biodiversitetit, hulumtime gjithëpërfshirëse dhe vendosje të një baze të informatave themelore për biodiversitetin.
Mbrojtja e zonave natyrore në Kosovë është iniciuar gjatë viteve pesëdhjetë të shekullit të kaluar, me përcaktimin e disa rezervateve natyrore, si në Kozhnjer, Rusenicë, Gubavc etj., me më shumë zhvillime në këtë drejtim gjatë viteve tetëdhjetë, kur është shpallur parku i parë kombëtar, ai i Bjeshkëve të Sharrit. Kjo zonë e mbrojtur është zgjeruar tutje në vitin 2012. Një park tjetër kombëtar është shpallur në vitin 2014, ai i Bjeshkëve të Nemuna. Aktualisht, rreth 10.9% e territorit të Kosovës e ka statusin e zonës së mbrojtur ligjërisht. Megjithatë, mbrojtja e këtyre zonave dhe pasurisë llojore të organizmave të gjallë që jetojnë aty, mbetet ende sfiduese.

Krahasuar me vendet përreth, hulumtimet e organizmave të gjallë në Kosovë janë relativisht të vonshme dhe, rrjedhimisht, akoma nuk ka ndonjë inventar sistematik të biodiversitetit në përgjithësi. Sidomos janë të mangëta njohuritë e pasurisë llojore të shtazëve. Shumica e hulumtimeve faunistike në të kaluarën janë sporadike për grupe të caktuara, janë josistematike dhe të kryera në zona të ngushta në Kosovë (p.sh., Apfelbeck 1907; Csiki 1940; Dauti 1980, 1987; Djorović 1974, 1975, 1992; Gradojević 1930-31; Jakšić 1987, 1988, 1998, 2003, 2006, 2007; Karaman 1968; Koçak 1989; Pasuljević 1968; Pongrácz 1923; Rebel 1913, 1917; Rebel dhe Zerny 1931; Šapkarev 1972, 1975, 1980; Weiss 1975). Shumicës së këtyre hulumtimeve u ka munguar aspekti ekologjik që do të mundësonte ndërmarrjen e veprimeve konkrete për mbrojtjen apo konservimin e llojeve. Vetëm viteve të fundit, disa nga grupet e shtazëve janë hulumtuar më intensivisht (Gashi *et al.* 2015; Gashi & Ibrahimi 2008; Ibrahimi *et al.* 2012a, 2012b, 2013, 2014a, 2014b, 2015a, 2015b, 2016a, 2016b; Grapci Kotori *et al.* 2010; Zhushi Etemi *et al.* 2017a, 2017b; Zhushi *et al.* 2017), e kjo ka prodhuar edhe lloje të reja, e bile edhe gjini të reja për shkencën (p.sh., Glöer & Pešić 2014; Grosser *et al.* 2016; Ibrahimi *et al.* 2015, 2016; Olah *et al.* 2013; Perreau 2008).

Të gjitha këto hulumtime, të kryera gjatë disa dekadave në Kosovë, e sidomos bashkë me ato të realizuara në kuadër të projektit të Librit të Kuq të Faunës së Republikës së Kosovës, tregojnë se Kosova, edhe pse me një territor të vogël, përmban një numër të madh të llojeve, të cilat shpeshherë janë të kufizuara në zona të ngushta dhe të cilat janë të rëndësishme në pikëpamje të konservimit në kontekstin më të gjerë europian dhe global.

Prandaj, rëndësia e Librit të Kuq të Faunës së Kosovës është se i nxjerr shumë nga këto lloje nga anonimiteti dhe, duke i vënë në prioritet konservimi, ndihmon edhe në inicimin e hulumtimeve të tjera në vend, duke pasur parasysh se akoma ngelen shumë zona të pahulumtuara ose të hulumtuara dobët.

1.2 Metodologjia e punës

Libri i Kuq i Faunës së Republikës së Kosovës është punuar sipas Kategorive dhe Kritereve të Listës së Kuqe të Bashkimit Ndërkombëtar për Konservimin e Natyrës (IUCN), versioni 3.1 (IUCN 2012). Bashkë me këtë dokument është përdorur edhe Udhëzuesi për Përdorimin e Kategorive dhe Kritereve të Listës së Kuqe të IUCN-së (versioni i 13-të, Mars 2017: Nënkomiteti i Standardeve dhe Peticioneve të IUCN-së 2017). Është përdorur gjithashtu edhe Udhëzuesi për Aplikimin e Kritereve të IUCN-së për Listat e Kuqe në Nivel Rajonal dhe Kombëtar, versioni 4.0 (IUCN 2012a). Këto dokumente, bashkë me të tjerat përcjellëse, janë përdorur kështu për të siguruar një kornizë të saktë objektive për klasifikimin e llojeve, bazuar në statusin e tyre të kërcënueshmërisë.

Emrat shkencorë të taksoneve, sikundër edhe veçoritë e tjera sistematike, janë dhënë sipas bazës së të dhënave për faunën në nivel europian (Fauna Europaea) (deJong *et al.* 2014), kurse për llojet që nuk gjenden në këtë bazë, siç janë ato të përshkruara rishtas, ose lloje të tjera, janë përdorur referencat përkatëse shkencore të tyre (p.sh., Glöer & Pešić 2014; Grosser *et al.* 2016; Ibrahimi *et al.* 2015, 2016; Olah *et al.* 2013).

Emërtimi i llojeve në gjuhën shqipe dhe angleze është përdorur në ato raste kur ka ekzistuar, edhe pse është vërejtur një mangësi e madhe në emërtimin e një numri të madh të llojeve në gjuhën shqipe.

Pjesa më e madhe e të dhënave të përfshira në Librin e Kuq të Faunës së Kosovës vijnë nga hulumtimet e organizuara gjatë viteve 2017 dhe 2018 në kaudër të aktiviteteve të Programit Mjedisor të Kosovës (KEP) të financuar nga Agjencioni Suedez për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SIDA). Gjithashtu janë përfshirë edhe hulumtime të shumta nga vitet paraprake, përfshirë dhe të dhënat nga literatura, aty ku kanë ekzistuar. Përpunimi i mëtejmë i të dhënave për taksonet e analizuara është bërë nëpërmjet programit kompjuterik të dedikuar për formulimin e Listave të Kuqe, Ramas Red List Software.

1.2.1 Klasifikimi i faunës në bazë të kategorive të IUCN-së

Llojet e kërcënuara janë të gjitha ato lloje, të cilat janë të ndjeshme ndaj zhdukjes ose kandidate për zhdukje në një të ardhme të afërt, në qoftë se faktorët kërcënues rriten apo nuk trajtohen me kohë. IUCN (Bashkimi Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës) i trajton llojet e kërcënuara jo si një kategori të vetme, por si një grup prej tre kategorish: të cenuara, të rrezikuara dhe skajshmërisht të rrezikuara, në varshmëri prej shkallës së kërcënimit dhe intensitetit të tij. Kategoritë e tjera të përdorura nga IUCN e përcaktojnë, ose shkallën e përafrimit të llojeve me këto kategori, ose kualifikimin e llojeve për t'u vlerësuar kundrejt kritereve të IUCN-së, ose vetë zhdukjen e llojit.

Këto kategori apo klasë, sipas IUCN-së, janë: I Zhdukur EX, I Zhdukur në Natyrë EW, I Zhdukur në Natyrë në Rajon RE, Skajshmërisht i Rrezikuar (CR), I Rrezikuar (EN), I Cenuar VU, Gati i Kërcënuar NT, Shqetësim më i Vogël LC, Të Dhëna të Pamjaftueshme DD, I Paaplikueshëm NA dhe I Pavlerësuar NE. Në Shtojcën A1.1 në këtë §1 HYRJE është dhënë shpjegimi i këtyre termave sipas manualit të IUCN-së "Kategoritë dhe Kriteret e Listës së Kuqe të IUCN-së (Versioni 3.1)" (marrë nga IUCN 2012).

Të gjitha llojet i nënshtrohen vlerësimit kundrejt kritereve të IUCN-së, me përjashtim të llojeve që konsiderohen se i përkasin kategorisë: I Paaplikueshëm (NA). Disa lloje mund të mos vlerësohen aktualisht dhe këto grupohen në kategorinë: I Pavlerësuar NE. Llojet që janë në këtë kategori nuk do të thotë se nuk janë të kërcënuara, por thjeshtë vetëm se nuk janë të vlerësuara aktualisht.

Të gjitha llojet e tjera vlerësohen tutje për njërën nga kategoritë e ngelura përkatëse. Në qoftë se të dhënat aktuale nuk janë të mjaftueshme për të bërë një vlerësim për kategoritë: Shqetësim më i Vogël (LC), Gati i Kërcënuar (NT), I Cenuar (VU), I Rrezikuar (EN), Skajshmërisht i Rrezikuar (CR), I Zhdukur në Natyrë në Rajon (RE), I Zhdukur në Natyrë (EW) dhe I Zhdukur (EX), atëherë llojet e tilla vlerësohen në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme (DD). Për llojet e tilla duhet mbledhur më shumë të dhëna, në mënyrë që ato të kategorizohen më vonë në njërën nga kategoritë e përmendura. Llojet të cilat nuk kanë ndonjë kërcënim serioz që i çon drejt zhdukjes, vlerësohen në kategorinë: Shqetësim më i Vogël (LC), kurse llojet e tjera të cilat janë të kërcënuara për zhdukje, në varshmëri nga shkalla e kërcënimit, vendosen në kategoritë: I Cenuar (VU), I Rrezikuar (EN) dhe Skajshmërisht i Rrezikuar (CR). Llojet të cilat janë nën kërcënime të tilla, që shumë shpejt mund të kualifikohen për këto kategori, vendosen në kategorinë: Gati i Kërcënuar (NT). Llojet për të cilat është dëshmuar se janë zhdukur, vendosen në kategoritë: I Zhdukur në Natyrë (EW), I Zhdukur (EX) dhe/ose I Zhdukur në Natyrë në Rajon (RE).

Në Shtojcën A1.2 në këtë §1 HYRJE, është dhënë përmbledhja e pesë kritereve (A-E) të përdorura për të vlerësuar nëse taksoni i takon kategorisë së kërcënueshërisë sipas IUCN-së (Skajshmërisht i Rrezikuar, I Rrezikuar ose I Cenuar).

Vlerësimi i tillë është i vlefshëm për një periudhë të caktuar. Një rivlerësim i mëvonshëm mund të rezultojë në ndryshimin e statusit të llojeve, dhe arsyet për një lëvizje të tillë brenda kategorive mund të lidhen me ndryshimin e gjendjes së llojit në natyrë apo me shtimin e të dhënave për llojin. Ndryshimi i gjendjes së llojit në natyrë do të thotë se, që nga vlerësimi i kaluar kërcënimet janë shtuar ose zvogëluar dhe se, gjendja e popullatës është përkeqësuar apo përmirësuar. Ndryshimi i kategorisë për shkak të shtimit të të dhënave nënkupton se që nga vlerësimi i kaluar janë mbledhur të dhëna të reja më të besueshme, ose ka ndryshuar statusi taksonomik i llojit (për shembull, popullatat që i takonin një lloji të vetëm janë ndarë në disa nënlloje apo lloje, e kjo e ndryshon arealin e tyre të përhapjes dhe rrjedhimisht e ndryshon edhe gjendjen në kërcënimet që i kanosen secilës nënpopullatë të mëhershme të llojit, që tash janë popullata të llojeve të reja), ose është gjetur ndonjë gabim në të dhënat në vlerësimin e mëhershëm. Në cilindo rast, në mënyrë që të monitorohet gjendja dhe ndryshimi i statusit të biodiversitetit, është thelbësore që llojet të rivlerësohen në mënyrë periodike, në mënyrë që masat e ndërmarra për mbrojtjen e llojeve të jenë adekuate dhe të bazuara në gjendjen reale të llojeve, si dhe me qëllim të përfshirjes në mbrojtje edhe të llojeve që paraprakisht, për arsye të ndryshme, nuk u janë nënshtruar kritereve të kërcënueshmërisë sipas IUCN-së.

1.2.2 Definimi i termave të përdorur në Librin e Kuq të Faunës

Në Librin e Kuq të Faunës të Republikës së Kosovës janë përdorur terma në kontekstin e vlerësimit të llojeve dhe ekologjisë së llojeve, të cilat në disa raste ndryshojnë nga ato të përdorura në biologji, ekologji apo në fjalorin e përditshëm. Përcaktimi i qartë i këtyre termave është i rëndësishëm në vlerësimin e llojeve, duke qenë se kriteret e IUCN-së për kategorizimin e llojeve marrin parasysh pikërisht të kuptuarit prapa termeve të tilla gjatë këtij kategorizimi.

Këta terma, midis të tjerash, janë: popullata, madhësia e popullatës, nënpopullata, individët e rritur (adultët), gjenerata e taksonit, reduktimi i (nën)popullatës, rënia e vazhdueshme e nën(popullatës), luhatjet ekstreme të nën(popullatës), fragmentimi i habitatit, shtrirja e përhapjes, zona e pranisë, lokacioni, lokaliteti, analiza sasiore e vlerësimit të zhdukjes së një taksoni, etj.

Në Shtojcën A1.3 në këtë §1 HYRJE, është dhënë shpjegimi i këtyre termave sipas manualit të IUCN-së "Kategoritë dhe Kriteret e Listës së Kuqe të IUCN-së (Versioni 3.1)" (marrë nga IUCN 2012).

1.2.3 Klasifikimi i habitateve

Në Librin e Kuq të Faunës së Republikës së Kosovës është përdorur klasifikimi i kërcënimeve sipas Skemës së Klasifikimit të Kërcënimeve (versioni 3.2.). Kërcënimet e drejtpërdrejta janë aktivitete njerëzore ose procese që kanë ndikuar, janë duke ndikuar ose mund të ndikojnë në statusin e taksonit që vlerësohet (p.sh., peshkimi i paqëndrueshëm, prerja e pyjeve, zhvillimi komercial etj.). Kjo skemë e klasifikimit të kërcënimeve është dhënë në Shtojcën A1.5 në këtë §1 HYRJE.

Përveç kësaj, në shumicën e rasteve janë ofruar të dhëna më të detajuara për karakteristikat e kërcënimeve për llojet përkatëse.

Duke qenë se në shumë raste kanë munguar të dhënat për ndikimin kohor të kërcënimeve, atëherë ka qenë e pamundur që kërcënimet të ndërlidhen me madhësinë e ndikimit të tyre apo me aspektin kohor të ushtrimit të ndikimit të tyre. Në këtë kontekst, në Librin e Kuq të Faunës së Republikës së Kosovës kërcënimet janë përdorur më tepër në aspektin e faktorëve që kanë ndikuar ose mund të ndikojnë në gjendjen e popullatave të llojit, pa ndonjë kuantifikim direkt eventual.

1.2.5 Klasifikimi i masave për konservim dhe hulumtimeve të nevojshme

Në Librin e Kuq të Faunës së Republikës së Kosovës është përdorur klasifikimi i veprimeve të nevojshme për konservim sipas Skemës së Klasifikimit të Veprimeve për Konservim (Versioni 2.0). Këtu janë përfshirë veprimet që janë më urgjente, të rëndësishme dhe të cilat realisht mund të mbërrihen në një periudhë të caktuar të ardhshme kohore. Në pjesën më të madhe të rasteve nuk ka pasur veprime momentale për konservim për llojet përkatëse.

Gjithashtu, është përdorur struktura hierarkike për hulumtime të nevojshme sipas Skemës së Klasifikimit të Hulumtimeve të Nevojshme (Versioni 2.0). Këtu janë potencuar hulumtimet që janë të domosdoshme në funksion të përmirësimit të statusit të llojit që vlerësohet dhe të cilat në mënyrë reale mund të mbërrihen brenda një periudhe të caktuar afatshkurtër. Skema e Klasifikimit të Veprimeve për Konservim dhe Skema e Klasifikimit të Hulumtimeve të Nevojshme janë dhënë në Shtojcat A1.6 dhe A1.7 në këtë 1 HYRJE.

1.2.6 Përdorimi i softuerit Ramas Red List

Të dhënat e mbledhura për Librin e Kuq të Faunës së Republikës së Kosovës janë përpunuar me softuerin Ramas Red List (Akçakaya dhe Ferson 2001) në rastet kur sasia dhe cilësia e të dhënave e ka mundësuar këtë. Ky program kompjuterik i përmbush kriteret e kërcënueshmërisë sipas IUCN-së dhe operon sipas tri moduleve: Ramas Red List 3.0, Moduli i Analizës Kohore dhe Moduli i Analizës Hapësinore. Ramas Red List 3.0 është moduli bazë, i cili e kryen vlerësimin e llojeve. Moduli i Analizimit Kohor operon sipas këtyre parametrave: gjatësia e gjeneratës në vite, reduktimi i popullatës, rënia e vazhdueshme e popullatës dhe luhatjet e popullatës. Moduli i Analizës Kohore operon sipas këtyre parametrave:

shtrirja e përhapjes, zona e pranisë, trendet në shtrirjen e përhapjes (% për vit), trendet në zonën e pranisë, rënia e vazhdueshme e shtrirjes së përhapjes, rënia e vazhdueshme e zonës së pranisë, lëvizjet ekstreme në shtrirjen e përhapjes si dhe lëvizjet ekstreme në zonën e pranisë.

Ky softuer, po ashtu merr parasysh numrin e popullatave/nënpopullatave, numrin e lokacioneve ku janë prezente taksonet, rreziqet kryesore, numrin e individëve të rritur, madhësinë e popullatës/nënpopullatës më të madhe (shprehur në numër të individëve të rritur), gjasat e zhdukjes së taksonit në natyrë brenda periudhave të caktuara kohore etj.

1.2.7 Përdorimi i fotografive të llojeve

Për një numër të madh të llojeve të shtazëve të përfshira në Librin e Kuq të Faunës së Republikës së Kosovës janë dhënë edhe fotografitë, por jo për të gjitha, duke pasur parasysh vështirësitë në dokumentimin e kafshëve me anë të fotografive, siç është edhe rasti me librat e tjerë të faunës në rajon dhe në botë. Fotografitë e përdorura janë bërë ose direkt në teren ose në bazë të mostrave të konservuara.

Fotodokumentimi i kafshëve ngelet si një nga detyrat më të vështira duke pasur parasysh natyrën e jetesës së këtyre organizmave, vështirësitë në vëzhgim të tyre, si edhe vetë sfidat në të fotografuarit e tyre. Kështu që kurdo që këto rrethana kanë mundësuar, janë ofruar fotografi kurse për llojet e tjera nevojitet kohë më e madhe për t'i shoqëruar edhe ato me fotografitë përkatëse.

1.2.8 Të gjeturat e Librit të Kuq të Faunës

Në Librin e Kuq të Faunës të Republikës së Kosovës janë përfshirë gjithsejtë 306 lloje, të cilat u takojnë këtyre grupeve të shtazëve: Gastropoda, Bivalvia, Oligochaeta, Hirudinea, Arachnida (Araneae, Mesostigmata), Malacostraca, Diplopoda, Insecta (Ephemeroptera, Plecoptera, Odonata, Coleoptera, Mecoptera, Diptera, Trichoptera, Lepidoptera), Cyclostomata, Actinopterygii, Amphibia, Reptilia, Aves dhe Mammalia. Numri i llojeve të vëzhguara është shumë më i madh, por për shkak të hapësirës së kufizuar, është vendosur vetëm për këto lloje.

Një pjesë e konsiderueshme e materialit faunistik të mbledhur gjatë këtij projekti mbetet akoma e paidentifikuar për shkak të problemeve taksonomike dhe nevojës më të gjatë kohore për të finalizuar përcaktimin e tyre.
Një numër i madh i llojeve të Ephemeroptera-ve, Coleoptera-ve, Mollusca-ve, Araneae-ve dhe të tjera bëjnë pjesë në këtë grup të materialit të paidentifikuar ende, dhe përfundimi i përcaktimit të tyre mund të krijojë rezultate të rëndësishme për faunën e Republikës së Kosovës.

Numri më i madh i llojeve të përfshira në Librin e Kuq të Faunës të Republikës së Kosovës i takon grupeve: Insecta (140 lloje), Mammalia (39), Aves (24), Reptilia (20) dhe Gastropoda (20), kurse grupet e tjera janë të përfaqësuara me numër më të vogël të llojeve (Tabela 1.2.1)

Gjatë implementimit të Programit Mjedisor të Kosovës në aktivitetet e hulumtimit të kafshëve, është gjetur një lloj i ri për shkencën, i cili i takon grupit Insecta, rendit Trichoptera dhe gjinisë Potamophylax, grupit juliani, që është grup endemik i Ballkanit me përhapje të ngushtë. Ky lloj është gjetur në Bjeshkët e Lloqanit, në Komunën e Deçanit, dhe është në procedurë publikimi, e cila deri në këtë kohë nuk ka përfunduar ende, prandaj nuk ka mundur të përfshihet në Librin e Kuq (Figura 1.2.1).



Figura 1.2.1: Lloji i ri për shkencën *Potamophylax* sp. nov., i gjetur gjatë projektit të Librit të Kuq të Faunës

Tabela 1.2.1: Shpërndarja e llojeve të përfshira në Librin e Kuq të Faunës së Republikës së Kosovës në gjashtë kategoritë sipas IUCN

Grupet/Kategoritë	Skajshmërisht i Rrezikuar (CR)	I Rrezikuar (EN)	I Cenuar (VU)	Gati i Kërcënuar (NT)	Shqetësim më të Vogël (LC)	Të Dhëna të Pamjaftueshme (DD)	Totali
Gastropoda			10	10			20
Bivalvia		1					1
Oligochaeta		1		2	2	7	12
Hirudinea						2	2
Arachnida					1	8	9
Araneae					1	7	8
Mesostigmata						1	1
Malacostraca			1			1	2
Diplopoda			3			6	9
Insecta	20	11	19	42	13	35	140
Ephemeroptera		4		4	2	2	12
Plecoptera	5	1					6
Odonata				4	1	7	12
Coleoptera			3	2	4	17	26
Mecoptera						1	1
Diptera						2	2
Trichoptera	15	1	7	20	1	2	46
Lepidoptera		5	9	12	5	4	35
Cyclostomata				1			1
Actinopterygii	1	1	1	4	2	5	14
Amphibia		2	1		3	7	13
Reptilia			1	8	8	3	20
Aves	3	6	4	4		7	24
Mammalia	1	2	1	9	17	9	39
Totali	25	24	41	80	46	90	306

Numri më i madh i llojeve të përfshira në Librin e Kuq të Faunës së Republikës së Kosovës i takon kategorive: Të Dhëna të Pamjaftueshme (gjithsej 90) dhe Gati i Kërcënuar (gjithsej 80), kurse numri më i vogël i llojeve i takon kategorive: I Rrezikuar (24) dhe Skajshmërisht i Rrezikuar (25). Këto të dhëna reflektojnë gjendjen faktike në hulumtimet e diversitetit shtazor në Kosovë, ku akoma ka mungesa thelbësore për një numër të madh të llojeve sa i përket të dhënave rreth popullatave, numrit të individëve, trendit të tyre dhe faktorëve që i kërcënojnë. Ky është një paralajmërim emergjent që të fillohet monitorimi i llojeve të tilla, në mënyrë që llojet të cilat nuk kanë mundur të vlerësohen për kategoritë e kërcënueshmërisë për shkak të mungesës së të dhënave, të vlerësohen drejt, para se ato të rrezikohen në mënyrë të pakthyeshme prej rreziqeve antropogjene dhe të tjera.

Numri më i madh i kërcënimeve për llojet e vlerësuara i takon këtyre grupeve të kërcënimeve: përdorimi i burimeve biologjike, modifikime të sistemeve natyrore, ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër, Ndërhyrje dhe shqetësime njerëzore, ndotja dhe zhvillimi rezidencial dhe komercial. Prerja dhe vjelja e pyjeve, aktivitetet rekreative të pamenaxhuara mirë, eksploatimi i ujërave sipërfaqësore (veçanërisht për qëllime bujqësore), ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane, zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit dhe zonat e turizmit dhe rekreacionit janë rreziqet specifike më të shpeshta, që i kërcënojnë llojet e vlerësuara.



Figura 1.2.2: Numri i llojeve në kuadër të grupeve të ndryshme të kafshëve të përfshira në Librin e Kuq të Faunës së Republikës së Kosovës



Figura 1.2.3: Kategoritë kryesore të rreziqeve që i kërcënojnë llojet e vlerësuara të kafshëve



Figura 1.2.4: Rreziqet kryesore specifike të cilat i kërcënojnë llojet e vlerësuara të kafshëve

1.2.9 Përfundime

Libri i Kuq i Faunës së Republikës së Kosovës është dokumenti më i rëndësishëm zyrtar i prodhuar deri më tani në Kosovë sa i përket diversitetit të faunës, sepse jep për herë të parë të dhëna cilësore dhe të matshme rreth llojeve të shtazëve të pranishme në Kosovë, shtrirjes së tyre, aspekteve të endemizmit dhe masave për mbrojtjen e tyre. Duke i identifikuar në të njëjtën kohë edhe kërcënimet, që u kanosen këtyre llojeve, ky dokument do të shërbejë si udhërrëfyes për mbrojtjen e llojeve, evitimin e kërcënueshmërisë ndaj tyre dhe krijimin e politikave për konservim.

Hapi tjetër është krijimi i programeve për monitorim të llojeve të vlerësuara dhe habitateve përcjellëse, në pajtim me masat e sugjeruara për konservim, duke i kontribuar kështu mbrojtjes së llojllojshmërisë së botës së gjallë në Kosovë. Ky dokument dëshmon për pasurinë e madhe llojore që ka Kosova, dhe në të njëjtën kohë kjo e shton përgjegjësinë e institucioneve shtetërore dhe atyre akademike për mbrojtjen e këtyre llojeve.

Libri i Kuq i Faunës së Republikës së Kosovës e nxjerr biodiversitetin nga kufizimi akademik, duke i vënë llojet e përfshira në përgjegjësi të organeve vendimmarrëse, OJQ-ve, institucioneve edukative dhe arsimore, sikur edhe të shoqërisë në përgjithësi. Në anën tjetër, përgjegjësia e institucioneve akademike nuk pushon me kaq, por ajo bëhet edhe më e rëndësishme, sidomos në përcjelljen e vazhdueshme të gjendjes së popullatave të llojeve të përfshira, sidomos në vlerësimin e llojeve të tjera të kafshëve me sistemin e njëjtë të kritereve, duke pasur parasysh se llojet e përfshira në këtë Libër të Kuq përbëjnë vetëm një përqindje të vogël të llojllojshmërisë së shtazëve të pranishme në Republikën e Kosovës.

A1 Shtojcat e Hyrjes

A1.1 Kategoritë e IUCN-së (sipas Kategorive dhe Kritereve të Listës së Kuqe të IUCN-së: Versioni 3.1-2012)

· I ZHDUKUR (EX): Taksoni është: I Zhdukur, kur nuk ka asnjë dyshim të arsyeshëm se individi i fundit ka vdekur. Taksoni konsiderohet: I Zhdukur, kur hulumtimet e detajuara në habitatin e njohur dhe/ose të pritshëm, në kohë të përshtatshme (ditore, stinore, vjetore), përgjatë rangut të tij historik nuk kanë arritur të regjistrojnë një individ. Hulumtimet duhet të jenë realizuar në një kornizë kohore të përshtatshme për ciklin jetësor të taksonit dhe formën e tij të jetës.

· I ZHDUKUR NË NATYRË (EW): Një takson është: I Zhdukur në Natyrë, kur dihet se mbijeton vetëm në kultivim, në robëri ose si një popullatë (ose popullata) e natyralizuar jashtë rangut të kaluar të taksonit. Një takson konsiderohet: I Zhdukur në Natyrë, kur hulumtimet e detajuara në habitatin e njohur dhe/ose të pritshëm, në kohë të përshtatshme (ditore, stinore, vjetore), përgjatë rangut të tij historik, nuk kanë arritur të regjistrojnë një individ. Hulumtimet duhet të jenë realizuar në një kornizë kohore të përshtatshme për ciklin jetësor të taksonit dhe formën e jetës.

· I ZHDUKUR NË RAJON (RE): Kjo është kategori rajonale për një takson kur nuk ka asnjë dyshim të arsyeshëm se individi i fundit i aftë për riprodhim brenda rajonit ka vdekur ose është zhdukur nga natyra në rajon ose kur, nëse është një ish-takson vizitues, individi i fundit ka vdekur ose është zhdukur në natyrë nga rajoni. Përcaktimi i çdo afati kohor për listim në kategorinë: I Zhdukur në Rajon, është lënë në diskrecionin e autoritetit rajonal të Listës së Kuqe, por normalisht nuk duhet të paraprijë datën 1500 pas erës së re.

· SKAJSHMËRISHT I RREZIKUAR (CR): Një takson është: Skajshmërisht i Rrezikuar kur dëshmitë më të mira të disponueshme tregojnë se ai plotëson ndonjë nga kriteret A deri në E për kategorinë: Skajshmërisht i Rrezikuar dhe për këtë arsye konsiderohet se përballet me një rrezik jashtëzakonisht të lartë të zhdukjes në natyrë.

· I RREZIKUAR (EN): Një takson është: I Rrezikuar, kur dëshmitë më të mira të disponueshme tregojnë se ai plotëson ndonjë nga kriteret A deri në E për kategorinë: I Rrezikuar dhe për këtë arsye konsiderohet se po përballet me një rrezik shumë të lartë të zhdukjes në natyrë.

· I CENUAR (VU): Një takson është: I Cenuar, kur dëshmitë më të mira të disponueshme tregojnë se ai plotëson ndonjë nga kriteret A deri në E për: I Cenuar dhe për këtë arsye konsiderohet se po përballet me një rrezik të lartë të zhdukjes në natyrë.

· GATI I KËRCËNUAR (NT) Një takson është: Gati i Kërcënuar, kur është vlerësuar kundrejt kritereve, por nuk kualifikohet tani për tani për kategoritë: Skajshmërisht i Rrezikuar, I Rrezikuar ose I Cenuar, por është afër kualifikimit ose ka të ngjarë të kualifikohet për një kategori të kërcënueshmërisë në një të ardhme të afërt.

· SHQETËSIM MË I VOGËL (LC): Një takson është në kategorinë: Shqetësim më i Vogël, kur është vlerësuar kundrejt kritereve, por nuk kualifikohet për kategoritë: Skajshmërisht i Rrezikuar, I Rrezikuar, I Cenuar ose Gati i Kërcënuar. Llojet gjithandej të përhapura dhe me dendësi të madhe janë të përfshira në këtë kategori.

· TË DHËNA TË PAMJAFTUESHME (DD): Një takson është në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme, kur informacionet janë joadekuate për të bërë një vlerësim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të rrezikut të zhdukjes, bazuar në përhapjen dhe/ose statusin e popullatës. Një takson në këtë kategori mund të jetë i studiuar mirë dhe biologjia e tij të jetë e njohur mirë, por mungojnë të dhëna të përshtatshme për dendësinë dhe/ose përhapjen. Prandaj, Të Dhëna të Pamjaftueshme nuk është kategori kërcënimi. Listimi i taksoneve në këtë kategori tregon se kërkohet më shumë informacion dhe pranohet mundësia që hulumtimet e ardhshme do të tregojnë se klasifikimi në kategoritë e kërcënueshmërisë është i përshtatshëm. Është e rëndësishme të përdorim mirë çfarëdo të dhënash të disponueshme. Në shumë raste kujdes i madh duhet të ushtrohet në zgjedhjen midis: Të Dhëna të Pamjaftueshme dhe një statusi të kërcënueshëmërisë. Nëse rangu i një taksoni dyshohet të jetë relativisht i kufizuar dhe një periudhë e konsiderueshme kohore ka kaluar që nga regjistrimi i fundit i taksonit, atëherë statusi i kërcënueshmërisë mund të arsyetohet.

· I PAVLERËSUAR (NE): Një takson është: I Pavlerësuar, kur nuk është vlerësuar ende sipas kritereve.

· I PAAPLIKUESHËM (NA): Kjo është kategoria për një takson, që konsiderohet i papërshtatshëm për vlerësim në nivel rajonal. Një takson mund të jetë: I Paaplikueshëm, sepse nuk është një popullatë natyrore ose nuk është brenda vargut të tij natyror në rajon, ose është një kalimtar në rajon. Lloji gjithashtu mund të jetë: I Paaplikueshëm, sepse gjendet në numër shumë të ulët në rajon (p.sh., kur autoriteti i Listës së Kuqe rajonale ka vendosur të përdorë një "filtër" për të përjashtuar taksone para procedurës së vlerësimit) ose taksoni mund të klasifikohet në një nivel më të ulët taksonik (p.sh., nën nivelin e llojit apo nënllojit) sesa konsiderohet e pranueshme nga autoriteti rajonal i Listës së Kuqe. Për dallim nga kategoritë tjera të Listës së Kuqe, nuk është e detyrueshme të përdoret kjo kategori për të gjitha llojet për të cilat vlen, por rekomandohet të përdoret për llojet ku përdorimi i tij është informativ.

A1.2 Përmbledhje e pesë kritereve (A-E) të përdorura për të vlerësuar nëse taksoni i takon kategorisë së kërcënueshërisë sipas IUCN-së (Skajshmërisht i Rrezikuar, I Rrezikuar ose I Cenuar)

A. Population size reduction. Population reduction [observed over the longer of 10 years or 3 generations] based on any of A1 to A4:			
	Critically Endangered	Endangered	Vulnerable
A1	≥ 90%	≥ 70%	≥ 50%
A2, A3 & A4	≥ 80%	≥ 50%	≥ 30%
A1	Population reduction observed, estimated, inferred, or suspected in the past where the causes of the reduction are clearly reversible AND understood AND have ceased.	Immediate cause of the reduction:	(a) direct observation [except A3] (b) an index of abundance appropriate to the taxon (c) a decline in area of occupancy (AOO), extent of occurrence (EOO), and/or habitat quality
A2	Population reduction observed, estimated, inferred, or suspected in the past where the causes of the reduction may not have ceased OR may not be understood OR may not be reversible.		
A3	Population reduction projected, inferred or suspected to be met in the future (up to a maximum of 100 years) [(a) cannot be used for A3].		(d) actual or potential levels of exploitation
A4	An observed, estimated, inferred, projected or suspected population reduction where the time period must include both the past and the future (up to a maximum of 100 years in the future), and where the reduction may not have ceased OR may not be understood OR may not be reversible.		(e) effects of introduced taxa, hybridization, pathogens, pollutants, competitors or parasites.

B. Geographic range in the form of either B1 (extent of occurrence) AND/OR B2 (area of occupancy)			
	Critically Endangered	Endangered	Vulnerable
B1. Extent of occurrence (EOO)	< 100 km²	< 5,000 km²	< 20,000 km²
B2. Area of occupancy (AOO)	< 10 km²	< 500 km²	< 2,000 km²
AND at least 2 of the following 3 conditions:			
(a)	Severely fragmented OR Number of locations	= 1	≤ 5
(b)	Continuing decline observed, inferred or projected in any of: (i) extent of occurrence; (ii) area of occupancy; (iii) area, extent and/or quality of habitat; (iv) number of locations or subpopulations; (v) number of mature individuals		
(c)	Extreme fluctuations in any of: (i) extent of occurrence; (ii) area of occupancy; (iii) number of locations or subpopulations; (iv) number of mature individuals		

C. Small population size and decline				
		Critically Endangered	Endangered	Vulnerable
Number of mature individuals		< 250	< 2,500	< 10,000
AND at least one of C1 or C2:				
C1	An observed, estimated, inferred or projected continuing decline of at least [25% in 3 years or 1 generation (whichever is longer)] (up to a maximum of 100 years in the future).	[20% in 5 years or 2 generations (whichever is longer)]	[10% in 10 years or 3 generations (whichever is longer)]	(Not used for this category)
C2	An observed, estimated, projected or inferred continuing decline AND at least 1 of the following 3 conditions:			
(a)	(i) Number of mature individuals in each subpopulation:	≤ 50	≤ 250	≤ 1,000
	(ii) % of mature individuals in one subpopulation =	90–100%	95–100%	100%
(b)	Extreme fluctuations in the number of mature individuals			

D. Very small or restricted population				
		Critically Endangered	Endangered	Vulnerable
D1.	Number of mature individuals	< 50	< 250	< 1,000
or:	Only applicable for vulnerable category: Restricted area of occupancy (typically AOO < 20 km²) such that the species is prone to the effects of human activities or stochastic events within a possible future threat period [one of these]			(typically) AOO < 20 km² or number of locations ≤ 5

E. Quantitative Analysis			
	Critically Endangered	Endangered	Vulnerable
Indicating the probability of extinction in the wild to be:	≥ 50% in 10 years or 3 generations, whichever is longer (100 years max.)	≥ 20% in 20 years or 5 generations, whichever is longer (100 years max.)	≥ 10% in 100 years

A1.3 Definimi i termave lidhur me kriteret e përdorura për vlerësimin e llojeve (sipas Kategoritë dhe Kriteret e Listës së Kuqe të IUCN-së: Versioni 3.1-2012)

Popullata dhe madhësia e popullatës (Kriteret A, C dhe D)

Termi 'popullatë' përdoret në një kuptim të veçantë në Kriteret e Listës së Kuqe, që ndryshon nga përdorimi i saj i zakonshëm biologjik. Popullata këtu përkufizohet si numër i përgjithshëm i individëve të taksonit. Për arsye funksionale, kryesisht për shkak të dallimeve në mes të formave të jetës, madhësia e popullatës matet vetëm me numrat e individëve të rritur. Në rastin e taksoneve që varen detyrimisht nga taksone të tjera, për tërë ose një pjesë të cikleve të tyre të jetës, duhet të përdoren vlerat biologjikisht të përshtatshme për taksonin pritës.

2. Nënpopullatat (Kriteret B dhe C)

Nënpopullatat përcaktohen si grupe gjeografikisht ose tjetërqysh të ndryshme në popullatë, midis të cilave ka pak shkëmbim demografik ose gjenetik (zakonisht një individ migrues i suksesshëm ose gamet në vit, ose më pak).

3. Individët e rritur (Kriteret A, B, C dhe D)

Numri i individëve të rritur është numri i individëve të njohur, të vlerësuar ose të konkluduar, që janë në gjendje të riprodhohen. Kur të vlerësohet ky aspekt duhet të mbahen parasysh pikat e mëposhtme:

- Individët e rritur, të cilët kurrë nuk do të prodhojnë pasardhës të rinj, nuk duhet të numërohen (p.sh., dendësitë janë tepër të ulëta për fekondim).
- Në rastin e popullatave me numër të panjohur mirë të të rriturve apo të raportit gjinor, është e përshtatshme që të përdoren vlerësime më të ulëta për numrin e individëve të rritur.
- Kur ka luhatje në madhësinë e popullatës, duhet të përdoret një vlerësim më i ulët. Në shumicën e rasteve kjo vlerë do të jetë shumë më e vogël sesa mesatarja.
- Njësitë e riprodhimit brenda një dege duhet të numërohen si individë, me përjashtim të rasteve kur njësitë e tilla nuk janë në gjendje të mbijetojnë vetëm (p.sh., koralet).
- Në rastin e taksoneve që natyrisht humbin të gjithë ose një pjesë të individëve të rritur në një pikë në ciklin e tyre të jetës, vlerësimi duhet të bëhet në kohën e duhur, kur individët e rritur janë në dispozicion për riprodhim.
- Individët e reintroduktuar duhet të kenë prodhuar pasardhës të qëndrueshëm para se të numërohen si individë të rritur.

4. Gjenerata (Kriteret A, C dhe E)

Gjatësia e gjeneratës është mosha mesatare e prindërve të kohortit aktual (p.sh., e individëve të posalindur). Gjatësia e gjeneratës pasqyron kështu shkallën e qarkullimit të individëve riprodhues në një popullatë. Gjatësia e gjeneratës është më e gjatë se sa mosha, në të cilën riprodhimi i parë ka ndodhur dhe më e shkurtër se sa mosha e individit më të vjetër që akoma riprodhohet, me përjashtim të taksoneve të cilat riprodhohen vetëm një herë. Aty ku gjatësia e gjeneratës ndryshon nën kërcënim, duhet të përdoret gjatësia më e natyrshme, për shembull, ajo para se të ndodhte kërcënimi.

5. Reduktimi (Kriteri A)

Reduktimi është një rënie në numrin e individëve të rritur të së paku një përqindjeje të caktuar sipas kriterit për periudhën (vitet) e specifikuar, megjithëse rënia nuk është e domosdoshme që të vazhdojë. Një reduktim nuk duhet të interpretohet si pjesë e luhatjes së popullatës nëse nuk ka dëshmi të mirë për këtë. Rënia e numrit të individëve si rezultat i luhatjeve natyrore në madhësinë e popullatës, në parim nuk duhet të konsiderohet si reduktim.

6. Rënia e vazhdueshme (Kriteret B dhe C)

Rënia e vazhdueshme është një rënie që ka ndodhur rishtas, e tanishme ose e parashikuar e ardhshme (e cila mund të jetë graduale, e parregullt ose sporadike), e cila mund të vazhdojë nëse nuk merren masa përmirësuese. Luhatjet, normalisht, nuk do të llogariten si rënie të vazhdueshme, por gjithashtu një rënie e vëzhguar nuk duhet të konsiderohet si luhatje, nëse nuk ka dëshmi për këtë.

7. Luhatjet ekstreme (Kriteret B dhe C)

Mund të thuhet se luhatjet ekstreme mund të ndodhin në një numër të taksoneve, kur madhësia e popullatës ose zona e përhapjes ndryshon gjerësisht, shpejt dhe shpesh, zakonisht një rritje apo ulje dhjetëfish, për shembull

8. Fragmentim i skajshëm (Kriteri B)

Fraza "i fragmentuar skajshmërisht" i referohet situatës në të cilën rritja e rrezikut të zhdukjes së taksonit rezulton nga fakti se shumica e individëve të tij gjenden në nënpopullata të vogla dhe relativisht të izoluara (në rrethana të caktuara kjo mund të jetë nxjerrë nga informacioni i habitatit). Këto nënpopullata të vogla mund të zhduken, me një probabilitet të zvogëluar të rikolonizimit.

9. Shtrirja e përhapjes (Kriteret A dhe B)

Shtrirja e përhapjes përcaktohet si zona që gjendet brenda kufirit më të shkurtër të imagjinuar të vazhdueshëm, që mund të tërhiqet për të përfshirë të gjitha lokalitetet e njohura, të nxjerra ose të parashikuara të ndodhjes aktuale të një taksoni, përjashtuar rastet e ndodhjes së rastësishme të ndonjë individi. Kjo masë mund të përjashtojë shkëputjet ose disjunksionet brenda përhapjeve të përgjithshme të taksoneve (p.sh., zonat e mëdha të habitatit dukshëm të papërshtatshëm) (shih 'zonën e pranisë'). Shtrirja e përhapjes shpesh mund të matet nga një poligon minimal konveks (poligoni më i vogël në të cilin asnjë kënd i brendshëm nuk kalon 180 gradë dhe që përmban të gjitha lokalitetet e ndodhjes).

10. Zona e pranisë (Kriteret A, B dhe D)

Zona e pranisë përkufizohet si zonë brenda "shtrirjes së përhapjes" (shih 'shtrirjen e përhapjes' më lart), e cila është e okupuar nga një takson, duke përjashtuar rastet e gjendjes së rastësishme. Kjo masë reflekton me faktin se një takson zakonisht nuk do të ndodhë në të gjithë shtrirjen e tij të përhapjes, ku mund të ekzistojnë habitate të papërshtatshme ose të pabanuara. Në disa raste (p.sh., lokalitete të pazëvendësueshme të vendosjes së kolonive, vende të rëndësishme të ushqyerjes për taksone shtegtuese), zona e pranisë është zona më e vogël e rëndësishme për mbijetesën e popullatave ekzistuese të një taksoni në çfarëdo faze të saj. Madhësia e zonës së pranisë do të jetë në funksion të shkallës, në të cilën matet dhe duhet të jetë në një shkallë të përshtatshme me aspektet përkatëse biologjike të taksonit, natyrën e kërcënimeve dhe të dhënat në dispozicion. Për të shmangur mospërputhjet dhe paragjykimet në vlerësimet e shkaktuara nga përkufizimi i zonës së pranisë në shkallë të ndryshme, mund të jetë e nevojshme të standardizohen vlerësimet duke aplikuar një faktor të korrigjimit të shkallës. Është vështirë të japësh udhëzime strikte se si duhet të bëhet standardizimi, sepse llojet e ndryshme të taksoneve kanë marrëdhënie të ndryshme të raporteve shkallë-zonë.

11. Lokacioni (Kriteret B dhe D)

Termi 'lokacion' përcakton një zonë gjeografikisht ose ekologjikisht të dallueshme, në të cilën një ngjarje e vetme kërcënuese mund të prekë me shpejtësi të gjithë individët e taksonit të pranishëm. Madhësia e lokacionit varet nga zona e mbuluar nga ngjarja kërcënuese dhe mund të përfshijë një pjesë të një nënpopullimi ose disa sosh. Kur një takson është prekur nga më shumë se një ngjarje kërcënuese, lokacioni duhet të përcaktohet duke marrë parasysh kërcënimin më të rëndë të besueshëm.

12. Analiza sasiore (Kriteri E)

Një analizë sasiore përcaktohet këtu si çfarëdo forme e analizës, që vlerëson mundësinë e zhdukjes së një taksoni të bazuar në historinë e njohur të jetës, kërkesat e habitatit, kërcënimet dhe opsionet e specifikuara të menaxhimit. Analiza e qëndrueshmërisë së popullatës (PVA) është një teknikë e tillë. Analizat sasiore duhet të përdorin plotësisht të gjitha të dhënat relevante në dispozicion. Në një situatë, në të cilën ka informacion të kufizuar, të dhëna të tilla që janë në dispozicion mund të përdoren për të siguruar një vlerësim të rrezikut të zhdukjes (për shembull, duke vlerësuar ndikimin e ngjarjeve stokastike në vendbanim). Në paraqitjen e rezultateve të analizave sasiore, supozimet (të cilat duhet të jenë të përshtatshme dhe të mbrojtura), të dhënat e përdorura dhe pasiguria në të dhënat ose në modelin sasior, duhet të dokumentohen.

A1.4 Skema e Klasifikimi të Habitateve (Versioni 3.1)

1 Pyje
- 1.1 Pyje boreale
- 1.2 Pyje subarktike
- 1.3 Pyje subantarktike
- 1.4 Pyje të klimës mesatare
- 1.5 Pyje të thata subtropike/tropike
- 1.6 Pyje të lagështa subtropike/tropike të ultësirave
- 1.7 Vegjetacion pyjor mangrovë subtropik/tropik mbi nivelin e lartë të baticës
- 1.8 Pyje subtropike/tropike moçalishte
- 1.9 Pyje të lagështa malore subtropike/tropike

2 Savana
- 2.1 Savana të thata
- 2.2 Savana të lagështa

3 Shkurre
- 3.1 Shkurre subarktike
- 3.2 Shkurre subantarktike
- 3.3 Shkurre të klimës mesatare
- 3.5 Shkurre subtropike/tropike të vendeve të thata
- 3.6 Shkurre subtropike/tropike të vendeve të lagështa
- 3.7 Shkurre subtropike/tropike të lartësive të mëdha mbidetare
- 3.8 Vegjetacion shkurror i tipit mesdhetar

4 Kullosa
- 4.1 Tundra
- 4.2 Kullosa subarktike
- 4.3 Kullosa subantarktike
- 4.4 Kullosa të klimës mesatare
- 4.5 Kullosa subtropike/tropike të thata të ultësirave
- 4.6 Kullosa stinore subtropike/tropike të ultësirave të lagështa/të përmbytura
- 4.7 Kullosa subtropike/tropike të lartësive të mëdha mbidetare

5 Vende ujore (kontinentale)
- 5.1 Lumenj, përrenj, përroska të përhershme [përfshirë ujëvarat]
- 5.2 Lumenj, përrenj, përroska stinore/të përkohshme/të parregullta
- 5.3 Vende me ujë të dominuara nga shkurret
- 5.4 Këneta, moçale, moçalishte [mbi 8 ha]
- 5.5 Liqene të përhershme të ujërave të ëmbla [mbi 8 ha]
- 5.6 Liqene të përkohshme/stinore të ujërave të ëmbla [nën 4 ha]
- 5.7 Këneta/basene të përhershme të ujërave të ëmbla [nën 8 ha]
- 5.8 Këneta/basene stinore/të përkohshme të ujërave të ëmbla [nën 8 ha]
- 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza
- 5.10 Vende ujore në tundra [përfshirë basenet dhe ujërat e përkohshme nga shkrirja e borës]
- 5.11 Vende ujore alpine [përfshirë ujëra të përkohshme nga shkrirja e borës]
- 5.12 Vende ujore gjeotermale
- 5.13 Delta të brendshme të përhershme
- 5.14 Liqene të njelmëta ose bazike të përhershme
- 5.15 Liqene dhe rrafshina të njelmëta ose bazike stinore/të përkohshme
- 5.16 Këneta/basene të njelmëta ose bazike të përhershme
- 5.17 Këneta/basene të njelmëta ose bazike stinore/të përkohshme
- 5.18 Sisteme kontinentale ujore karstike ose të tjera nëntokësore

6 Zona shkëmbore [p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore]

7 Shpella dhe habitate nëntokësore [jo-ujore]
- 7.1 Shpella
- 7.2 Habitate të tjera nëntokësore

8 Shkretëtira
- 8.1 Të nxehta
- 8.2 Mesatare
- 8.3 Të ftohta

9 Detare neritike [xhepa submergjentë pranëbregorë kontinentalë ose ishuj oqeanikë]
- 9.1 Pellagjike
- 9.2 Shkëmbinj nënbaticor dhe guna shkëmbore
- 9.3 Shkëmbinj/gurë/zhavorr i lirë nënbaticor
- 9.4 Zallë nënbaticor
- 9.5 Zallë/baltë nënbaticore

- 9.6 Baltë nënbaticore
- 9.7 Leshterikë/makroalga
- 9.8 Korale në shkëmbinj nënujorë
- 9.8.1 Kanale të jashtme shkëmbinjsh nënujorë
- 9.8.2 Shpate të pasme
- 9.8.3 Shpate të përparme (shpate të jashtme të shkëmbinjve nënujorë)
- 9.8.4 Lagunë
- 9.8.5 Substrat i butë i ndërmjetëm i shkëmbinjve nënujorë
- 9.8.6 Substrat guror i ndërmjetëm i shkëmbinjve nënujorë
- 9.9 Barishte detare (submergje)

9.10 Estuare

- 10 Detare oqeanike
- 10.1 Epipellagjike (0–200 m)
- 10.2 Mezopellagjike (200–1,000 m)
- 10.3 Batipellagjike (1,000–4,000 m)
- 10.4 Abisopellagjike (4,000–6,000 m)
- 11 Shtresa detare e thellë oqeanike (bentike dhe demersale)
  - 11.1 Shpat kontinental/zonë batile (200-4,000 m)
  - 11.1.1 Substrat i fortë
  - 11.1.2 Substrat i butë
  - 11.2 Rrafshinë abisale (4,000–6,000 m)
  - 11.3 Mal/kodër abisale (4,000–6,000 m)
  - 11.4 Llogor i thellë/hadal detar (>6,000 m)
  - 11.5 Pyje nënujore
  - 11.6 Hapje të thella detare (çarje)

12 Detare ndërbaticore

- 12.1 Zonë gurore bregdetare
- 12.2 Zonë ranore bregdetare dhe/ose plazh, shtylla, rëre etj.
- 12.3 Zonë bregdetare dhe/ose plazh me zall ose rërë
- 12.4 Zonë bregdetare me baltë dhe rrafshina ndërbaticore me baltë
- 12.5 Moçale të njelmëta (barishte emergjente)
- 12.6 Basene baticash
- 12.7 Rrënjë nënujore të mangrovës

13 Detare bregore/suprabaticore

- 13.1 Shkëmbinj detarë dhe ishuj shkëmborë jashtëbregorë
- 13.2 Shpella/karste bregore
- 13.3 Duna ranore bregore
- 13.4 Laguna/liqene detare të njelmëta bregore
- 13.5 Liqene bregore të ujërave të ëmbla

14 Artificiale - tokësore

- 14.1 Toka të punueshme
- 14.2 Kullosa
- 14.3 Plantacione
- 14.4 Kopshte rurale
- 14.5 Zona urbane
- 14.6 Zona ish-pyjore subtropikale/tropikale skajshmërisht të degraduara

15 Artificiale - ujore

- 15.1 Zona të deponimit të ujit [mbi 8 ha]
- 15.2 Basene [nën 8 ha]
- 15.3 Basene të akuakulturës
- 15.4 Zona të eksploatimit të rërës
- 15.5 Ekskavime (të hapura)
- 15.6 Zona të trajtimit të ujërave të zeza
- 15.7 Toka të ujitura [përfshirë kanalet e ujitjes]
- 15.8 Toka bujqësore të përmbytura gjatë stinëve
- 15.9 Kanale dhe kanale drenazhimi, gropa
- 15.10 Karste dhe sisteme të tjera hidrologjike nëntokësore [të ndërtuara nga njeriu]
- 15.11 Struktura detare antropogjene
- 15.12 Kafazë të marikulturës
- 15.13 Basene të marikulturës

16 Vegjetacion i introduktuar

17 Tjetër

18 I panjohur

A1.5 Skema e Klasifikimit të Kërcënimeve (Versioni 3.2)

1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial

- 1.1 Banimi dhe zonat urbane
- 1.2 Hapësirat komerciale dhe industriale
- 1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit

2 Bujqësia dhe akuakultura

- 2.1 Kulturat vjetore dhe shumëvjeçare jodrusore
  - 2.1.1 Zhvendosja e bujqësisë
  - 2.1.2 Blegtori/bujqësi e shkallës së vogël
  - 2.1.3 Blegtori/bujqësi agroindustriale
  - 2.1.4 Shkalla e panjohur/e paregjistruar
- 2.2 Plantacione druri dhe pulpë
  - 2.2.1 Plantacione të vogla
  - 2.2.2 Plantacionet e agroindustrisë
  - 2.2.3 Shkalla e panjohur/e paregjistruar
- 2.3 Blegtoria dhe fermat
  - 2.3.1 Kullotja nomade
  - 2.3.2 Kullotja e vogël, fermat apo bujqësia
  - 2.3.3 Kullotja agroindustriale, ose fermat
  - 2.3.4 Shkalla e panjohur/e paregjistruar
- 2.4 Akuakultura detare dhe e ujërave të ëmbla
  - 2.4.1 Akuakultura për jetesë/artizanale
  - 2.4.2 Akuakultura industriale
  - 2.4.3 Shkalla e panjohur/e paregjistruar

3 Prodhimi i energjisë dhe minierat

- 3.1 Shpimi i naftës dhe gasit
- 3.2 Miniera dhe gurore
- 3.3 Energjia e rinovueshme

4 Korridoret e transportit dhe shërbimit

- 4.1 Rrugët dhe hekurudhat
- 4.2 Linjat e shërbimeve
- 4.3 Linjat e transportit
- 4.4 Rrugët e fluturimit

5 Përdorimi i burimeve biologjike

- 5.1 Gjuetia dhe mbledhja e kafshëve tokësore
  - 5.1.1 Përdorimi i qëllimshëm (lloji që vlerësohet është i synuar)
  - 5.1.2 Efektet e padëshiruara (llojet që vlerësohen nuk janë të synuara)
  - 5.1.3 Përndjekja/kontrolli
  - 5.1.4 Motivimi i panjohur/i paregjistruar

5.2 Mbledhja e bimëve tokësore

- 5.2.1 Përdorimi i qëllimshëm (lloji që vlerësohet është i synuar)
- 5.2.2 Efektet e padëshiruara (llojet që vlerësohen nuk janë të synuara)
- 5.2.3 Përndjekja/kontrolli
- 5.2.4 Motivimi i panjohur/i paregjistruar

5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve

- 5.3.1 Përdorimi i qëllimshëm: vjelje për jetesë/në shkallë të vogël (lloji që vlerësohet është i synuar) [vjelja]
- 5.3.2 Përdorimi i qëllimshëm: shkalla e madhe (lloji që vlerësohet është i synuar) [vjelja]
- 5.3.3 Efektet e paqëllimshme: vjelje për jetesë/në shkallë të vogël (llojet që vlerësohen nuk janë të synuara) [vjelja]
- 5.3.4 Efektet e paqëllimshme: në shkallë të madhe (llojet që vlerësohen nuk janë të synuara) [vjelja]
- 5.3.5 Motivimi i panjohur/i paregjistruar

5.4 Peshkimi dhe vjelja e burimeve ujore

- 5.4.1 Përdorimi i qëllimshëm: vjelje për jetesë/në shkallë të vogël (lloji që vlerësohet është i synuar) [vjelja]
- 5.4.2 Përdorimi i qëllimshëm: në shkallë të madhe (lloji që vlerësohet është i synuar) [vjelja]
- 5.4.3 Efektet e paqëllimshme: jetesa/në shkallë të vogël (llojet që vlerësohen nuk janë të synuara) [vjelja]
- 5.4.4 Efektet e paqëllimshme: në shkallë të madhe (llojet që vlerësohen nuk janë të synuara) [vjelja]
- 5.4.5 Përndjekja/kontrolli
- 5.4.6 Motivimi i panjohur/i paregjistruar

6 Ndërhyrje dhe shqetësime njerëzore

- 6.1 Aktivitete rekreative
- 6.2 Luftëra, trazira civile dhe ushtrime ushtarake
- 6.3 Punë dhe aktivitete të tjera

7 Modifikimet e sistemeve natyrore
- 7.1 Zjarret dhe luftimi i tyre
  - 7.1.1 Rritja e frekuencës/intensitetit të zjarrit
  - 7.1.2 Shtrëngimi në frekuencën/intensitetin e zjarrit
  - 7.1.3 Trendi i panjohur/i paregjistruar
- 7.2 Digat dhe menaxhimi/përdorimi i ujit
  - 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri)
  - 7.2.2 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi komercial)
  - 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)
  - 7.2.4 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi i panjohur)
  - 7.2.5 Eksploatimi i ujit nëntokësor (përdorimi në amvisëri)
  - 7.2.6 Eksploatimi i ujit nëntokësor (përdorimi komercial)
  - 7.2.7 Eksploatimi i ujit nëntokësor (përdorimi në bujqësi)
  - 7.2.8 Eksploatimi i ujit nëntokësor (përdorimi i panjohur)
  - 7.2.9 Diga të vogla
  - 7.2.10 Diga të mëdha
  - 7.2.11 Digat (madhësia e panjohur)
- 7.3 Modifikime të tjera të ekosistemit

8 Lloje invazive dhe të tjera problematike, gjenet dhe sëmundjet
- 8.1 Llojet jonative invazive/të huaja/sëmundjet
  - 8.1.1 Lloje të papërcaktuara
  - 8.1.2 Llojet e emërtuara
- 8.2 Llojet/sëmundjet origjinale të lindura
  - 8.2.1 Lloje të papërcaktuara
  - 8.2.2 Llojet e emërtuara
- 8.3 Materiali gjenetik i introduktuar
- 8.4 Llojet problematike/sëmundjet me origjinë të panjohur
  - 8.4.1 Lloje të papërcaktuara
  - 8.4.2 Llojet e emërtuara
- 8.5 Sëmundjet e shkaktuara nga viruset
  - 8.5.1 "Lloje" të paspecifikuara (sëmundje)
  - 8.5.2 "Lloje" të emërtuara (sëmundje)
- 8.6 Sëmundjet me shkaktarë të panjohur

9 Ndotja
- 9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane
  - 9.1.1 Ujërat e zeza
  - 9.1.2 Shkarkimet
  - 9.1.3 Lloji i panjohur/i paregjistruar
- 9.2 Shkarkimet industriale dhe ushtarake
  - 9.2.1 Derdhjet e naftës
  - 9.2.2 Kullimi nga minierat
  - 9.2.3 Lloji i panjohur/i paregjistruar
- 9.3 Efluentet bujqësore dhe pyjore
  - 9.3.1 Ngarkesat me nutrientë
  - 9.3.2 Erozioni i tokës, sedimentimi
  - 9.3.3 Herbicidet dhe pesticidet
  - 9.3.4 Lloji i panjohur/i paregjistruar
- 9.4 Mbetjet dhe mbeturinat e ngurta
- 9.5 Ndotësit e ajrit
  - 9.5.1 Shiu acidik
  - 9.5.2 Smogu
  - 9.5.3 Ozoni
  - 9.5.4 Lloji i panjohur/i paregjistruar
- 9.6 Energjia e tepërt
  - 9.6.1 Ndotja e dritës
  - 9.6.2 Ndotja termike
  - 9.6.3 Ndotja e zhurmës
  - 9.6.4 Lloji i panjohur/i paregjistruar

10 Ngjarjet gjeologjike
- 10.1 Vullkanet
- 10.2 Tërmetet/tsunamet
- 10.3 Ortekët/rrëshqitjet e tokës

11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër
- 11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit
- 11.2 Thatësirat
- 11.3 Ekstremet e temperaturës
- 11.4 Stuhitë dhe përmbytjet
- 11.5 Ndikime të tjera

12 Opsione të tjera
- 12.1 Kërcënim tjetër

A1.6 Skema e Klasifikimit të Veprimeve për Konservim (Versioni 2.0)

1 Mbrojtja e tokës/ujit
- 1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës
- 1.2 Mbrojtja e burimeve dhe habitateve

2 Menaxhimi i tokës/ujit
- 2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës
- 2.2 Kontrolli i llojeve invazive/problematike
- 2.3 Restaurimi i habitatit dhe procesit natyror

3 Menaxhimi i llojeve
- 3.1 Menaxhimi i llojeve
  - 3.1.1 Menaxhimi i vjeljes
  - 3.1.2 Menaxhimi i tregtisë
  - 3.1.3 Kufizimi i rritjes së popullatës
- 3.2 Ripërtëritja e llojeve
- 3.3 Reintroduktimi i llojeve
  - 3.3.1 Reintroduktimi
  - 3.3.2 Introduktimi beninj
  - 3.4 Konservimi ex-situ
  - 3.4.1 Shumimi në robëri/përhapja artificiale
  - 3.4.2 Banka e resurseve gjenomike

4 Edukimi dhe ndërgjegjësimi
- 4.1 Edukimi formal
- 4.2 Trajnimi
- 4.3 Ndërgjegjësimi dhe komunikimi

5 Ligji dhe politikat
- 5.1 Legjislacioni
  - 5.1.1 Niveli ndërkombëtar
  - 5.1.2 Niveli kombëtar
  - 5.1.3 Niveli nënkombëtar
  - 5.1.4 Shkalla e paspecifikuar
- 5.2 Politikat dhe rregulloret
- 5.3 Standardet dhe kodet e sektorit privat
- 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit
  - 5.4.1 Niveli ndërkombëtar
  - 5.4.2 Niveli kombëtar
  - 5.4.3 Niveli nënkombëtar
  - 5.4.4 Shkalla e paspecifikuar

6 Stimulime rreth mjeteve të jetesës, ekonomike dhe të tjera
- 6.1 Ndërmarrjet e lidhura dhe alternativat e jetesës
- 6.2 Zëvendësimi
- 6.3 Forcat e tregut
- 6.4 Pagesat e konservimit
- 6.5 Vlerat jomonetare

NE FAQE TE RE - SHTOJCAT

A1.7 Skema e Klasifikimit të Hulumtimeve të Nevojshme (Versioni 2.0)

1 Hulumtimi
- 1.1 Taksonomia
- 1.2 Madhësia, përhapja dhe trendi i popullatës
- 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia
- 1.4 Vjelja, përdorimi dhe mjetet e jetesës
- 1.5 Kërcënimet
- 1.6 Veprimet

2 Planfikimi i konservimit
- 2.1 Plani i veprimit/restaurimit të llojit
- 2.2 Plani i menaxhimit i bazuar në areal
- 2.3 Plani i menaxhimit të tregtisë dhe vjeljes

3 Monitorimi
- 3.1 Trendet e popullatës
- 3.2 Trendet e nivelit të vjeljes
- 3.3 Trendet e tregtisë
- 3.4 Trendet e habitatit

4 Të tjera

2.1.

LLOJET SKAJSHMERISHT TE RREZIKUARA

INSECTA

Brachyptera macedonica Ikonomov, 1983

Insecta: Plecoptera: Taeniopterygidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Skajshmërisht i Rrezikuar, CR B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Esat Dauti, Astrit Bilalli

Të dhëna të përgjithshme

Në fazën larvore jeton në ujë përgjatë një viti. Faza adulte paraqitet në periudhën e pranverës. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit, ku ka jetuar si larvë. Faza larvore është treguese e ujërave të pastra dhe mesatarisht të pastra (Ikonomov 1983).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat), 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Gjendet kryesisht në përroska të vogla malore. Haset në lartësi të mëdha mbidetare.

Përhapja e përgjithshme

Lloj endemik i Ballkanit. Deri më tani është i njohur vetëm nga Kosova dhe Maqedonia.

Përhapja në Kosovë

Përroskë në Lugun e Kopilaqës.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Në Kosovë është konstatuar në vetëm 1 lokalitet, me numër të vogël të individëve.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Skajshmërisht i Rrezikuar, për shkak të zonës së pranisë ZP të kufizuar (4 km2), numrit të lokacioneve, që është 1 dhe reduktimit të projektuar të popullatës, bazuar në rënien e kualitetit të habitatit të përshtatshëm për llojin dhe numrin e lokacioneve. Lokacioni, ku është gjetur ky lloj, është nën presion të vazhdueshëm nga ndotja dhe degradimi.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)); 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).
Faktorët kryesorë, që e kërcënojnë këtë lloj, në Kosovë janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë të njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Ikonomov 1983



Nemoura anas Murányi, 2007

Insecta: Plecoptera: Nemouridae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Skajshmërisht i Rrezikuar, CR B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Esat Dauti, Astrit Bilalli, Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Në fazën larvore jeton në ujë përgjatë një viti. Faza adulte paraqitet në periudhën e pranverës. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit, ku ka jetuar si larvë. Faza larvore është treguese e ujërave të pastra. Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për mënyrën e të ushqyerit dhe jetesës së fazës larvore. Ky lloj i takon gjinisë *Nemoura Latreille*, 1796, e cila posedon një potencial të lartë endemizmi, me disa lloje të reja të përshkruara viteve të fundit nga Ballkani (Murányi 2007).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) [5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Gjendet kryesisht në përroska të vogla malore. Haset në lartësi të ndryshme mbidetare, kryesisht mbi 800 m.

Përhapja e përgjithshme

Lloj endemik i Ballkanit. Deri më tani është konstatuar vetëm në Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni dhe Shqipëri.

Përhapja në Kosovë

Përroskë në malet e Berishës.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Skajshmërisht i Rrezikuar, për shkak të zonës së pranisë ZP të kufizuar (4 km2), numrit të lokacioneve që është 1 dhe reduktimit të projektuar të popullatës, bazuar në rënien e kualitetit të habitatit të përshtatshëm për llojin dhe numrin e lokacioneve. Lokacioni, ku është gjetur ky lloj, është nën presion të vazhdueshëm nga prerja e pyjeve dhe degradimi i mjediseve ujore.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)]; 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).
Faktorët kryesorë, që e kërcënojnë këtë lloj, në Kosovë janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë të njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet. Të kontrollohet, dhe eventualisht ndalohet, aktiviteti i prerjes së pyjeve përreth zonës ku është gjetur ky lloj.

Referencat

Murányi 2007



Nemoura asceta Murányi, 2007

Insecta: Plecoptera: Nemouridae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Skajshmërisht i Rrezikuar, CR B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Astrit Bilalli, Esat Dauti, Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Në fazën larvore jeton në ujë përgjatë një viti. Faza adulte paraqitet në periudhën e pranverës. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit, ku ka jetuar si larvë. Faza larvore është treguese e ujërave të pastra dhe mesatarisht të pastra. Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për mënyrën e të ushqyerit dhe jetesës së fazës larvore. Ky lloj i takon gjinisë *Nemoura*, e cila posedon një potencial të lartë endemizmi, me disa lloje të reja të përshkruara viteve të fundit nga Ballkani (Murányi 2007).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) [5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Gjendet kryesisht në përroska të vogla malore. Haset në lartësi të ndryshme mbidetare, kryesisht mbi 800 m.

Përhapja e përgjithshme

Lloj endemik i Ballkanit. Deri më tani është konstatuar vetëm në Kosovë dhe Shqipëri.

Përhapja në Kosovë

Përroskë në malet e Berishës.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Skajshmërisht i Rrezikuar, për shkak të zonës së pranisë ZP të kufizuar (4 km2), numrit të lokacioneve që është 1 dhe reduktimit të projektuar të popullatës, bazuar në rënien e kualitetit të habitatit të përshtatshëm për llojin dhe numrin e lokacioneve. Lokacioni, ku është gjetur ky lloj, është nën presion të vazhdueshëm nga prerja e pyjeve dhe degradimi i mjediseve ujore.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)]; 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).
Faktorët kryesorë, që e kërcënojnë këtë lloj, janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë të njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet. Të kontrollohet, dhe eventualisht ndalohet, aktiviteti i prerjes së pyjeve përreth zonës ku është gjetur ky lloj.

Referencat

Murányi 2007





Nemoura vinconi Murányi, 2007

Insecta: Plecoptera: Nemouridae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Skajshmërisht i Rrezikuar, CR B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Astrit Bilalli, Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Në fazën larvore jeton në ujë përgjatë një viti. Faza adulte paraqitet në periudhën e pranverës. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit, ku ka jetuar si larvë. Faza larvore është treguese e ujërave të pastra. Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për mënyrën e të ushqyerit dhe jetesës së fazës larvore. Ky lloj i takon gjinisë Nemoura, e cila posedon një potencial të lartë endemizmi, me disa lloje të reja të përshkruara viteve t ë fundit nga Ballkani (Murányi 2007).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) [5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Gjendet kryesisht në përroska të vogla malore. Haset në lartësi të ndryshme mbidetare, kryesisht mbi 800 m.

Përhapja e përgjithshme

Lloj endemik i Ballkanit. Deri më tani është konstatuar vetëm në Kosovë dhe Shqipëri.

Përhapja në Kosovë

Përroskë në malet e Berishës.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Skajshmërisht i Rrezikuar, për shkak të zonës së pranisë ZP të kufizuar (4 km2), numrit të lokacioneve që është 1 dhe reduktimit të projektuar të popullatës, bazuar në rënien e kualitetit të habitatit të përshtatshëm për llojin dhe numrin e lokacioneve. Lokacioni, ku është gjetur ky lloj, është nën presion të vazhdueshëm nga prerja e pyjeve dhe degradimi i mjediseve ujore.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)]; 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).
Faktorët kryesorë, që e kërcënojnë këtë lloj, në Kosovë janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë të njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet. Të kontrollohen dhe menaxhohen qëndrueshëm aktivitetet turistike dhe rekreative përreth lokacionit ku është gjetur ky lloj.

Referencat

Murányi 2007



Nemoura zwicki Sivec, 1980

Insecta: Plecoptera: Nemouridae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Skajshmërisht i Rrezikuar, CR B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Esat Dauti, Halil Ibrahimi, Astrit Bilalli

Të dhëna të përgjithshme

Në fazën larvore jeton në ujë përgjatë një viti. Faza adulte paraqitet në periudhën e pranverës. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit, ku ka jetuar si larvë. Faza larvore është indikatore e ujërave të pastra. Është përshkruar si lloj i ri nga Bjeshkët e Sharrit në afërsi të Brezovicës, në Kosovë (Sivec 1980).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. . Vende ujore (kontinentale) [5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Gjendet kryesisht në përroska të vogla malore. Haset në lartësi të mëdha mbidetare mbi 1000 m.

Përhapja e përgjithshme

Lloj endemik i Ballkanit. Deri më tani është konstatuar vetëm në Kosovë dhe Maqedoni.

Përhapja në Kosovë

Përroskë në Brezovicë.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Në Kosovë është konstatuar në vetëm 1 lokalitet, që është lokaliteti nga është përshkruar

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Skajshmërisht i Rrezikuar, për shkak të zonës së pranisë ZP të kufizuar (4 km2), numrit të lokacioneve, që është 1 dhe reduktimit të projektuar të popullatës, bazuar në rënien e kualitetit të habitatit të përshtatshëm për llojin dhe numrin e lokacioneve. Lokacioni, ku është gjetur ky lloj, është nën presion të vazhdueshëm nga ndërtimet turistike dhe aktivitetet rekreative.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)]; 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).
Faktorët kryesorë, që e kërcënojnë këtë lloj, në Kosovë janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë të njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet. Të kontrollohen dhe menaxhohen qëndrueshëm aktivitetet turistike dhe rekreative përreth lokacionit ku është gjetur ky lloj.

Referencat

Sivec 1980



Adicella altandroconia Botosaneanu & Novak, 1965

Insecta: Trichoptera: Leptoceridae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Skajshmërisht i Rrezikuar, CR B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 5.5 deri në 7.5 mm. Në fazën larvore jeton në një përgjatë një viti. Faza adulte paraqitet në periudhën maj - gusht. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit, ku ka jetuar si larvë. Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për mënyrën e të ushqyerit dhe jetesës së fazës larvore të këtij lloji (Graf *et al.* 2008; Kumanski 1988).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. . Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat]).
Gjendet kryesisht në përroska të vogla. Substrat i parapëlqyer i larvave të këtij lloji janë: makrofitet, myshqet, pjesët e gjalla të bimëve tokësore, si dhe degët e gjethet e rëna të drunjve. Ky lloj haset kryesisht në lartësi të vogla mbidetare, më së shumti deri në 600 m (Graf *et al.* 2008).

Përhapja e përgjithshme

Bullgari, Greqi, Kosovë, Rumani, Turqi.

Përhapja në Kosovë

Përroskë në afërsi të Liqenit të Badovcit.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Në Kosovë është konstatuar në vetëm 1 lokalitet me numër të vogël të individëve.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Skajshmërisht i Rrezikuar, për shkak të zonës së pranisë ZP të kufizuar (4 km2), numrit të lokacioneve që është 1 dhe reduktimit të projektuar të popullatës, bazuar në cilësinë e habitatit të përshtatshëm për llojin dhe numrin e lokacioneve. Lokacioni, ku është gjetur ky lloj, është duke u shkatërruar në mënyrë të shpejtë, duke qenë se gjendet brenda një zone të banuar, me shumë ndërtime të vazhdueshme përreth përroskës.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)); 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).
Faktorët kryesorë, që e kërcënojnë këtë lloj, janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët. Lokaliteti ku është gjetur ky lloj ka degraduar skajshmërisht viteve të fundit.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Graf *et al.* 2008; Kumanski 1988





Chaetopteroides kosovarorum Ibrahimi & Oláh, 2013

Insecta: Trichoptera: Limnephilidae

Flutura kosovare

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Skajshmërisht i Rrezikuar, CR A2ac; B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 12 deri në 16 mm. Në fazën larvore jeton në një përgjatë një viti. Faza larvore është indikatore e ujërave të pastra. Faza adulte paraqitet në periudhën gusht – nëntor. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit, ku ka jetuar si larvë. Ky lloj i takon gjinisë *Chaetopteroides Kumanski*, 1968, që është gjini endemike e Ballkanit dhe deri më tani është konstatuar vetëm në një numër të kufizuar të lokaliteteve në Bullgari, Kosovë, Serbi dhe Maqedoni (Oláh *et al.* 2013). Njohuritë për mënyrën e të ushqyerit, por edhe jetesës së fazës larvore akoma janë të mangëta, ashtu siç janë edhe njohuritë për fazën adulte.

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Gjendet kryesisht në zonat burimore dhe në rrjedhat e epërme të përroskave e lumenjve malorë, por mund të haset edhe në zonat më poshtë se këto. Substrati i parapëlqyer i larvave të këtij lloji përbëhet nga: zhavorri i madhësive të ndryshme, gurët e madhësive të ndryshme, si dhe mjediset e pasura me material bimor. Ky lloj mund të gjendet në lartësi mbidetare mbi 1000 m.

Përhapja e përgjithshme

Kosovë.

Përhapja në Kosovë

Përroskë në Bajgorë.

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie
Në Kosovë është konstatuar në vetëm 1 lokalitet, me një numër të vogël të individëve.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Skajshmërisht i Rrezikuar, për shkak të reduktimit të vëzhguar të popullatës në të kaluarën, ku shkaktarët e rënies mund të mos kenë pushuar ende, bazuar në vëzhgimin direkt dhe rënien e cilësisë së habitateve të përshtatshme për llojin. Ky lloj është i njohur nga vetëm 1 lokalitet me zonën e pranisë ZP të kufizuar (4 km2). Mbi 50% të vegjetacionit të lartë përreth zonës ku është hasur ky lloj është prerë.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)); 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).
Faktorët kryesorë, që e kërcënojnë këtë lloj, në Kosovë janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lokalitetin ku gjendet. Të ndalohet prerja e mëtejme e pyjeve përreth zonës ku është gjetur lloji.

Referencat

Oláh *et al.* 2013





Adicella altandroconia Botosaneanu & Novak, 1965

Insecta: Trichoptera: Leptoceridae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Skajshmërisht i Rrezikuar, CR B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 5.5 deri në 7.5 mm. Në fazën larvore jeton në një përgjatë një viti. Faza adulte paraqitet në periudhën maj - gusht. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit, ku ka jetuar si larvë. Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për mënyrën e të ushqyerit dhe jetesës së fazës larvore të këtij lloji (Graf *et al.* 2008; Kumanski 1988).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. . Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat]).
Gjendet kryesisht në përroska të vogla. Substrat i parapëlqyer i larvave të këtij lloji janë: makrofitet, myshqet, pjesët e gjalla të bimëve tokësore, si dhe degët e gjethet e rëna të drunjve. Ky lloj haset kryesisht në lartësi të vogla mbidetare, më së shumti deri në 600 m (Graf *et al.* 2008).

Përhapja e përgjithshme

Bullgari, Greqi, Kosovë, Rumani, Turqi.

Përhapja në Kosovë

Përroskë në afërsi të Liqenit të Badovcit.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Në Kosovë është konstatuar në vetëm 1 lokalitet me numër të vogël të individëve.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Skajshmërisht i Rrezikuar, për shkak të zonës së pranisë ZP të kufizuar (4 km2), numrit të lokacioneve që është 1 dhe reduktimit të projektuar të popullatës, bazuar në cilësinë e habitatit të përshtatshëm për llojin dhe numrin e lokacioneve. Lokacioni, ku është gjetur ky lloj, është duke u shkatërruar në mënyrë të shpejtë, duke qenë se gjendet brenda një zone të banuar, me shumë ndërtime të vazhdueshme përreth përroskës.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)); 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).
Faktorët kryesorë, që e kërcënojnë këtë lloj, janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët. Lokaliteti ku është gjetur ky lloj ka degraduar skajshmërisht viteve të fundit.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Graf *et al.* 2008; Kumanski 1988





Drusus dardanicus Ibrahimi, Kučinić & Vitecek, 2015

Insecta: Trichoptera: Limnephilidae

Flutura dardane

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Skajshmërisht i Rrezikuar, CR A2ac; B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 7 deri në 9 mm. Në fazën larvore jeton në një përgjatë një viti. Faza larvore është treguese e ujërave të pastra. Faza adulte paraqitet në periudhën maj - gusht. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit, ku ka jetuar si larvë. Njohuritë për mënyrën e të ushqyerit, por edhe jetesës së fazës larvore akoma janë të mangëta, ashtu siç janë edhe njohuritë për fazën adulte. Ky lloj bën pjesë në nënfamiljen Drusinae, e cila karakterizohet me potencial të lartë të endemizmit në Ballkan, me një numër të madh të llojeve të reja të përshkruara viteve të fundit nga Bosnjë-Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia, Serbia dhe Shqipëria (Ibrahimi *et al.* 2015).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Gjendet kryesisht në zonat burimore dhe në rrjedhat e epërme të përroskave malore. Substrati i parapëlqyer i larvave të këtij lloji përbëhet nga zhavorri i madhësive të ndryshme, gurët e madhësive të ndryshme, si dhe mjediset e pasura me material bimor. Mund të haset prej 1300 deri në mbi 1700 m lartësi mbidetare.

Përhapja e përgjithshme

Kosovë.

Përhapja në Kosovë

Përroskë në fshatin Bollosicë.

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie
Në Kosovë është konstatuar në vetëm 1 lokalitet, me numër të vogël të individëve.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Skajshmërisht i Rrezikuar, për shkak të reduktimit të vëzhguar të popullatës në të kaluarën, ku shkaktarët e rënies mund të mos kenë pushuar ende, bazuar në vëzhgimin direkt dhe rënien e cilësisë së habitateve të përshtatshme për llojin. Ky lloj është i njohur nga vetëm 1 lokalitet me zonën e pranisë ZP të kufizuar (4 km2).

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).
Faktorët kryesorë, që e kërcënojnë këtë lloj, janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, menaxhimi i paqëndrueshëm i ujërave, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet. Të ndalohet prerja e mëtejme e pyjeve përreth zonës ku është gjetur lloji.

Referencat

Ibrahimi *et al.* 2015





Drusus schmidi Botosaneanu, 1960

Flutura e Shmidit

Insecta: Trichoptera: Limnephilidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Skajshmërisht i Rrezikuar, CR B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 7 deri në 9 mm. Në fazën larvore jeton në një përgjatë një viti. Faza larvore është treguese e ujërave të pastra. Faza adulte paraqitet në periudhën e pranverës dhe fillimit të verës. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit, ku ka jetuar si larvë. Ky lloj bën pjesë në nënfamiljen Drusinae, e cila karakterizohet me potencial të lartë të endemizmit në Ballkan (Ibrahimi *et al.* 2015). Popullata e këtij lloji nga Kosova ka dallime morfologjike në ndërtimin e organeve gjenitale mashkullore, por mbetet të shihet nga analiza më të detajuara gjenetike dhe morfologjike, nëse është fjala për llojin në fjalë apo për ndonjë lloj ose nënlloj të ri.

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat), 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Gjendet kryesisht në zonat burimore dhe në rrjedhat e epërme të përroskave e lumenjve malorë. Substrati i parapëlqyer i larvave të këtij lloji përbëhet nga: zhavorri i madhësive të ndryshme, gurët e madhësive të ndryshme si dhe mjediset e pasura me material bimor. Ky lloj parapëlqen lartësitë e mëdha mbidetare.

Përhapja e përgjithshme

Lloj endemik i Europës Juglindore. Gjendet në numër të kufizuar të lokaliteteve në Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë, Kroaci dhe Mal të Zi.

Përhapja në Kosovë

Përroskë në fshatin Haxhaj.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Në Kosovë është konstatuar në vetëm 1 lokalitet, me numër të vogël të individëve

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Skajshmërisht i Rrezikuar, për shkak të reduktimit të vëzhguar të popullatës në të kaluarën, ku shkaktarët e rënies mund të mos kenë pushuar ende, bazuar në vëzhgimin direkt dhe rënien e cilësisë së habitateve të përshtatshme për llojin. Ky lloj është i njohur nga vetëm 1 lokacion me zonën e pranisë ZP të kufizuar (4 km2).

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)); 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).
Faktorët kryesorë, që e kërcënojnë këtë lloj, janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse, edhe pse lokaliteti ku është gjetur lloji është në kuadër të zonës së mbrojtur.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Ibrahimi *et al.* 2015





Drusus sharrensis Ibrahimi, Previšić & Vitecek, 2016

Insecta: Trichoptera: Limnephilidae

Flutura e Sharrit

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Skajshmërisht i Rrezikuar, CR A2ac; B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 7 deri në 9 mm. Në fazën larvore jeton në një përgjatë një viti. Faza larvore është treguese e ujërave të pastra. Faza adulte paraqitet në periudhën maj - gusht. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë në afërsi të brigjeve të përroskës ku ka jetuar si larvë. Të dhënat rreth mënyrës së të ushqyerit dhe jetesës së fazës larvore janë akoma të panjohura mirë, ashtu siç janë edhe të dhënat për fazën aduulte. Ky lloj bën pjesë në nënfamiljen Drusinae, e cila karakterizohet me potencial të lartë të endemizmit në Ballkan, me një numër të madh të llojeve të reja të përshkruara viteve të fundit (Ibrahimi *et al.* 2016).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat), 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Gjendet kryesisht në zonat burimore dhe në rrjedhat e epërme të përroskave malore. Substrati i parapëlqyer i larvave të këtij lloji përbëhet nga: zhavorri i madhësive të ndryshme, gurët e madhësive të ndryshme, si dhe mjediset e pasura me material bimor. Mund të haset në lartësi të mëdha mbidetare.

Përhapja e përgjithshme

Kosovë.

Përhapja në Kosovë

Bjeshkët e Sharrit.

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Skajshmërisht i Rrezikuar, për shkak të reduktimit të vëzhguar të popullatës në të kaluarën, ku shkaktarët e rënies mund të mos kenë pushuar ende, bazuar në vëzhgimin direkt dhe rënien e cilësisë së habitateve të përshtatshme për llojin. Ky lloj është i njohur nga vetëm 1 lokacion me zonën e pranisë ZP të kufizuar (4 km2).

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)); 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).
Faktorët kryesorë, që e kërcënojnë këtë lloj, janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse, edhe pse lokaliteti ku është gjetur lloji është në kuadër të zonës së mbrojtur.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet. Të monitorohet dhe kontrollohet prerja e pyjeve përreth zonës ku është gjetur lloji.

Referencat

Ibrahimi *et al.* 2016





Drusus siveci Malicky, 1981

Flutra e Sivecit

Insecta: Trichoptera: Limnephilidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Skajshmërisht i Rrezikuar, CR B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 7 deri në 9 mm. Në fazën larvore jeton në ujë përgjatë një viti. Faza larvore është treguese e ujërave të pastra. Faza adulte paraqitet në periudhën e pranverës dhe fillimit të verës. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit, ku ka jetuar si larvë. Ky lloj bën pjesë në nënfamiljen Drusinae, e cila karakterizohet me potencial të lartë të endemizmit në Ballkan, me një numër të madh të llojeve të reja të përshkruara viteve të fundit (Ibrahimi *et al.* 2016). Popullata e këtij lloji nga Kosova ka ndryshime të konsiderueshme morfologjike në ndërtimin e organeve gjenitale mashkullore dhe, me gjasë, pas përfundimit të analizave të detajuara morfologjike, do të cilësohet si lloj i ri.

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Gjendet kryesisht në zonat burimore dhe në rrjedhat e epërme të përroskave e lumenjve malorë. Substrati i parapëlqyer i larvave të këtij lloji përbëhet nga: zhavorri i madhësive të ndryshme, gurët e madhësive të ndryshme, si dhe nga habitatet me material të origjinës bimore. Ky lloj parapëlqen kryesisht lartësitë e mëdha mbidetare.

Përhapja e përgjithshme

Lloj endemik i Ballkanit. Deri më tani është gjetur në numër të kufizuar të lokaliteteve në Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë dhe Mal të Zi.

Përhapja në Kosovë

Përroskë në fshatin Haxhaj, Përroskë në Bjeshkën e Lloqanit.

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Skajshmërisht i Rrezikuar, për shkak të reduktimit të vëzhguar të popullatës në të kaluarën, ku shkaktarët e rënies mund të mos kenë pushuar ende, bazuar në vëzhgimin direkt dhe rënien e cilësisë së habitateve të përshtatshme për llojin. Ky lloj është i njohur vetëm nga 2 lokacione, me zonën e pranisë ZP të kufizuar = 8 km2.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)]; 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet]; 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit). Faktorët kryesorë, që e kërcënojnë këtë lloj, janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse. Megjithatë, që të dy lokalitetet ku është gjetur lloji janë në kuadër të zonës së mbrojtur.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet. Të monitorohet dhe kontrollohet eksploatimi i ujërave sipërfaqësore nga lokaliteti ku është gjetur ky lloj në Bjeshkët e Lloqanit.

Referencat

Ibrahimi *et al.* 2016





Drusus tenellus Klapálek, 1898

Insecta: Trichoptera: Limnephilidae

Flutura e Sharrit

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Skajshmërisht i Rrezikuar, CR A2ac; B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 7 deri në 8 mm. Në fazën larvore jeton në ujë përgjatë një viti. Faza larvore është treguese e ujërave të pastra. Faza adulte paraqitet në periudhën e pranverës dhe fillimit të verës. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit, ku ka jetuar si larvë (Graf *et al.* 2008; Kumanski 1988). Ky lloj bën pjesë në nënfamiljen Drusinae, e cila karakterizohet me potencial të lartë të endemizmit në Ballkan, me një numër të madh të llojeve të reja të përshkruara viteve të fundit nga Shqipëria, Kosova, Serbia, Bosnjë-Hercegovina, Maqedonia dhe Mali i Zi.

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Gjendet kryesisht në zonat burimore dhe në rrjedhat e epërme të përroskave e lumenjve malorë. Substrat i parapëlqyer i larvave të këtij lloji është zhavorri i madhësive të ndryshme, gurët e madhësive të ndryshme, si dhe mjediset e pasura me material bimor. Mund të haset prej 1300 deri në mbi 1900 m lartësi mbidetare.

Përhapja e përgjithshme

Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë, Mali i Zi, Maqedoni, Rumani, Shqipëri.

Përhapja në Kosovë

Përroskë në fshatin Haxhaj.

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Skajshmërisht i Rrezikuar, për shkak të reduktimit të vëzhguar të popullatës në të kaluarën, ku shkaktarët e rënies mund të mos kenë pushuar ende, bazuar në vëzhgimin direkt dhe rënien e cilësisë së habitateve të përshtatshme për llojin. Ky lloj është i njohur nga vetëm 1 lokacion me zonën e pranisë ZP të kufizuar (4 km2).

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)]; 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet]; 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).
Faktorët kryesorë, që e kërcënojnë këtë lloj, në Kosovë janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse edhe pse lokaliteti ku është gjetur lloji është në kuadër të zonës së mbrojtur.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Graf *et al.* 2008; Kumanski 1988





Ecclisopteryx keroveci Previšić, Graf & Vitecek, 2014

Flutra e Kerovecit

Insecta: Trichoptera: Limnephilidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Skajshmërisht i Rrezikuar, CR B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 7 deri në 10 mm. Në fazën larvore jeton në ujë përgjatë një viti. Faza larvore është treguese e ujërave të pastra. Faza adulte paraqitet në periudhën maj – gusht (Ibrahimi *et al.* 2014b). Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit, ku ka jetuar si larvë.

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) [5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Gjendet kryesisht në zonat burimore dhe në rrjedhat e epërme të përroskave e lumenjve malorë. Substrati i parapëlqyer i larvave të këtij lloji përbëhet nga: zhavorri i madhësive të ndryshme, gurët e madhësive të ndryshme, si dhe nga mjediset e pasura me material bimor. Mund të haset prej 800 deri në mbi 1700 m lartësi mbidetare.

Përhapja e përgjithshme

Bosnjë-Hercegovinë, Kroaci, Kosovë, Mali i Zi.

Përhapja në Kosovë

Lumbardhi i Pejës në Kuqishtë.

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Skajshmërisht i Rrezikuar, për shkak të reduktimit të vëzhguar të popullatës në të kaluarën, ku shkaktarët e rënies mund të mos kenë pushuar ende, bazuar në vëzhgimin direkt dhe rënien e cilësisë së habitateve të përshtatshme për llojin. Ky lloj është i njohur nga vetëm 1 lokacion me zonën e pranisë ZP të kufizuar (4 km²).

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike [5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve]; 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore [6.1 Aktivitetet rekreative]; 7 Modifikimet e sistemeve natyrore [7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)]; 9 Ndotja [9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet]; 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).
Faktorët kryesorë, që e kërcënojnë këtë lloj, në Kosovë janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit [1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës]; 5. Ligji dhe politikat [5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit].
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi [1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia]; 3. Monitorimi [3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit].
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Ibrahimi *et al.* 2014b





Ernodes skipetarum Malicky, 1986

Insecta: Trichoptera: Beraeidae

Ernodes shqiptar

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Skajshmërisht i Rrezikuar, CR A2ac; B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 4 deri në 6 mm. Në fazën larvore jeton në ujë përgjatë një viti. Faza larvore është treguese e ujërave të pastra dhe mesatarisht të pastra. Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për mënyrën e të ushqyerit apo jetesës së fazës larvore. Faza adulte paraqitet në periudhën e pranverës dhe verës. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit, ku ka jetuar si larvë. Është përshkruar si lloj nga Çakorri në Kosovë (Ibrahimi *et al.* 2014b).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) [5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Gjendet kryesisht në përroska të vogla malore. Haset në lartësi të mëdha mbidetare.

Përhapja e përgjithshme

Lloj endemik i Ballkanit. Deri më tani është konstatuar vetëm në Kosovë dhe Shqipëri.

Përhapja në Kosovë

Përroskë në Lloqan.

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Skajshmërisht i Rrezikuar, për shkak të reduktimit të vëzhguar të popullatës në të kaluarën, ku shkaktarët e rënies mund të mos kenë pushuar ende, bazuar në vëzhgimin direkt dhe rënien e cilësisë së habitateve të përshtatshme për llojin. Ky lloj është i njohur nga vetëm 1 lokacion, me zonën e pranisë ZP të kufizuar = 4 km2. Në lokalitetin tipor nuk është gjetur gjatë hulumtimeve të vitit 2017, e kjo nuk do të thotë medoemos se kjo nënpopullatë është zhdukur. Nevojiten hulumtime më të detajuara për ta vërtetuar këtë.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike [5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve]; 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore [6.1 Aktivitetet rekreative]; 7 Modifikimet e sistemeve natyrore [7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)]; 9 Ndotja [9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet]; 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).
Faktorët kryesorë, që e kërcënojnë këtë lloj, në Kosovë janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse, edhe pse lokaliteti ku është gjetur lloji është në kuadër të zonës së mbrojtur.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. . Mbrojtja e tokës/ujit [1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës]; 5. Ligji dhe politikat [5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit].
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi [1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia]; 3. Monitorimi [3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit].
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Ibrahimi *et al.* 2014b



Limnephilus petri Marinkovic-Gospodnetic, 1966

Flutra e Petrit

Insecta: Trichoptera: Limnephilidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Skajshmërisht i Rrezikuar, CR B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 8 deri në 10 mm. Në fazën larvore jeton në ujë përgjatë një viti. Faza larvore është treguese e ujërave të pastra. Faza adulte paraqitet gjatë periudhës majgusht. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit, ku ka jetuar si larvë. Ky lloj është endemik i Bjeshkëve të Sharrit. Të dhënat për praninë e tij nga Serbia dhe Bullgaria janë akoma të paverifikuara (Kumanski 1988).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Gjendet kryesisht në zonat burimore dhe në rrjedhat e epërme të përroskave malore, por edhe të lumenjve më të mëdhenj. Substrati i parapëlqyer i larvave të këtij lloji përbëhet nga zhavorri i madhësive të ndryshme, gurët e madhësive të ndryshme si dhe nga mjediset e pasura me material bimor. Mund të haset prej 1300 deri në mbi 1700 m lartësi mbidetare.

Përhapja e përgjithshme

Kosovë.

Përhapja në Kosovë

Lumi Brod në Komunën e Dragashit.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Skajshmërisht i Rrezikuar, për shkak të zonës së pranisë të kufizuar ZP = 4 km2, numrit të lokacioneve, që është 1 dhe reduktimit të projektuar të popullatës bazuar në cilësinë e habitatit të përshtatshëm për llojin dhe numrin e lokacioneve. Zona prej nga njihet ky lloj, ka degraduar dukshëm viteve të fundit për shkak të aktivitetve turistike dhe rekreative.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)]; 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet]; 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).
Faktorët kryesorë, që e kërcënojnë këtë lloj, janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse. Lokaliteti ku është gjetur ky lloj është në kuadër të zonës së mbrojtur.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Kumanski 1988



Notidobia melanoptera Stein, 1963

Insecta: Trichoptera: Sericostomatidae

Notidobia melanopterë

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Skajshmërisht i Rrezikuar, CR A2ac; B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 15 deri në 18 mm. Adultët karakterizohen me ngjyrën e errët të krahëve. Në fazën larvore jeton në ujë përgjatë një viti. Faza adulte paraqitet në periudhën e pranverës. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit, ku ka jetuar si larvë (Graf *et al.* 2008; Kumanski 1988).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat]).
Gjendet kryesisht në pjesët e epërme dhe të mesme të lumenjve me rrjedhje të shpejtë. Kryesisht preferon habitatet në lartësi të mëdha mbidetare.

Përhapja e përgjithshme

Lloj endemik i Ballkanit. Deri më tani është konstatuar vetëm në Greqi dhe Kosovë.

Përhapja në Kosovë

Rrjedha e mesme e lumit Lepenc.

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie
Në Kosovë është konstatuar në vetëm 1 lokalitet, me numër të vogël të individëve.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Skajshmërisht i Rrezikuar, për shkak të reduktimit të vëzhguar të popullatës në të kaluarën, ku shkaktarët e rënies mund të mos kenë pushuar ende, bazuar në vëzhgimin direkt dhe rënien e cilësisë së habitateve të përshtatshme për llojin. Ky lloj është i njohur nga vetëm 1 lokacion, me zonën e pranisë ZP të kufizuar = 4 km2.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)]; 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet]; 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).
Faktorët kryesorë, që e kërcënojnë këtë lloj, janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. . Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Graf *et al.* 2008; Kumanski 1988





Odontocerum hellenicum Malicky, 1972

Insecta: Trichoptera: Odontoceridae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Skajshmërisht i Rrezikuar, CR B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 16 deri në 18 mm. Në fazën larvore jeton në ujë përgjatë një viti. Faza adulte paraqitet në periudhën maj - gusht. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit, ku ka jetuar si larvë (Graf *et al.* 2008; Kumanski 1988). Shpeshherë haset në simpatri me llojin tjetër të gjinisë së njëjtë, *Odontocerum albicorne* (Scopoli, 1763), nga i cili është më i rrallë. Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për mënyrën e jetesës së fazës larvore.

Habitati

Lloji i habitatit: 5.Vende ujore [kontinentale] (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Gjendet kryesisht në përroska të vogla malore me rrjedhje të shpejtë. Ky lloj parapëlqen lartësitë mbidetare prej 600 deri në mbi 2000 metra.

Përhapja e përgjithshme

Bosnjë-Hercegovinë, Bullgari, Greqi, Kosovë, Kroaci, Maqedoni, Rumani, Serbi, Shqipëri.

Përhapja në Kosovë

Përroskë në Bajgorë.

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie
Në Kosovë është konstatuar në vetëm 1 lokalitet, me numër të vogël të individëve.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Skajshmërisht i Rrezikuar, për shkak të reduktimit të vëzhguar të popullatës në të kaluarën, ku shkaktarët e rënies mund të mos kenë pushuar ende, bazuar në vëzhgimin direkt dhe rënien e cilësisë së habitateve të përshtatshme për llojin. Ky lloj është i njohur nga vetëm 1 lokacion me zonën e pranisë ZP të kufizuar = 4 km2.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)); 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).
Faktorët kryesorë, që e kërcënojnë këtë lloj, janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Graf *et al.* 2008; Kumanski 1988





Polycentropus ierapetra Malicky, 1972

Insecta: Trichoptera: Polycentropodidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Skajshmërisht i Rrezikuar, CR A2ac; B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 4.5 deri në 5 mm. Në fazën larvore jeton në ujë përgjatë një viti. Faza adulte paraqitet në periudhën e pranverës. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit, ku ka jetuar si larvë. Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për vlerat indikative të tolerancës së këtij lloji, meqenëse faza larvore është e papërshkruar. Lloji P. ierapetra i ka disa nënlloje, kryesisht të përhapura në zona të ngushta në Ballkan dhe Turqi. Në Kosovë është i pranishëm nënlloji *Polycentropus ierapetra slovenica* Malicky, 1998 (Graf *et al.* 2008; Kumanski 1985).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat]).
Gjendet kryesisht në zona të caktuara të rrjedhave të epërme të përroskave malore.

Përhapja e përgjithshme

Bosnjë-Hercegovinë, Bullgari, Greqi, Itali, Kosovë, Rumani, Sllloveni, Turqi. Nënlloji P. ierapetra slovenica deri më tani është gjetur vetëm në Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë dhe Sllloveni.

Përhapja në Kosovë

Bjeshkët e Nemuna.

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie
Në Kosovë është konstatuar në vetëm 1 lokalitet, me numër të vogël të individëve.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Skajshmërisht i Rrezikuar, për shkak të reduktimit të vëzhguar të popullatës në të kaluarën ku shkaktarët e rënies mund të mos kenë pushuar, bazuar në vëzhgimin direkt dhe rënien e cilësisë së habitateve të përshtatshme për llojin. Ky lloj është i njohur nga vetëm 1 lokacion, me zonën e pranisë ZP të kufizuar (4 km2).

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)); 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).
Faktorët kryesorë, që e kërcënojnë këtë lloj, janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Graf *et al.* 2008; Kumanski 1985





Rhyacophila trescavicensis Botosaneanu, 1960

Insecta: Trichoptera: Rhyachophilidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Skajshmërisht i Rrezikuar, CR B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 7 deri në 9 mm. Ngjyra e krahëve është kafe e mbyllët. Në fazën larvore jeton në ujë përgjatë një viti. Faza larvore është treguese e ujërave të pastra. Faza adulte paraqitet prej marsit deri në maj. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit, ku ka jetuar si larvë.

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore [kontinentale] [5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza].
Gjendet kryesisht në zonat burimore dhe në rrjedhat e epërme të përroskave malore. Zakonisht haset në ujërat me rrjedhje të shpejtë. Ky lloj mund të haset në lartësi të ndryshme mbidetare, nga 500 deri në afër 2000 m. Substrati i parapëlqyer i larvave të këtij lloji përbëhet nga: zhavorri i trashë, gurët e madhësive të ndryshme dhe shtrati guror i lumit (Graf *et al.* 2008).

Përhapja e përgjithshme

Lloj endemik i Ballkanit. Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë, Shqipëri.

Përhapja në Kosovë

Vrellë e Istogut.

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie
Ky lloj deri më tani është hasur në vetëm 1 lokalitet në Kosovë dhe aty karakterizohet me numër të vogël të individëve. Në këtë lokalitet është vërejtur në vazhdimësi degradimi i mjedisit nëpërmjet zvogëlimit të habitatit të përshtatshëm dhe ndotjes së tij.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Skajshmërisht i Rrezikuar, për shkak të reduktimit të vëzhguar të popullatës në të kaluarën, ku shkaktarët e rënies mund të mos kenë pushuar ende, bazuar në vëzhgimin direkt dhe rënien e cilësisë së habitateve të përshtatshme për llojin. Ky lloj është i njohur nga vetëm 1 lokacion, me zonën e pranisë ZP = 4 km2. Gjatë disa viteve të fundit, gati gjysma e habitatit të përshtatshëm për këtë lloj ka degraduar. Ndryshimi i reggimit ujor gjatë verës, i shkaktuar nga njeriu, mund t'a rrezikojë fazën larvore.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 7 Modifikimet e sistemeve natyrore [7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor [përdorimi në amvisëri], 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor [përdorimi në bujqësi]]; 9 Ndotja [9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet]; 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër [11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit]. Faktorët kryesorë, që e kërcënojnë këtë lloj, janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit [1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës]; 5. Ligji dhe politikat [5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit].
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi [1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia]; 3. Monitorimi [3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit].
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Graf *et al.* 2008





Synagapetus moselyi Ulmer, 1938

Insecta: Trichoptera: Glossosomatidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Skajshmërisht i Rrezikuar, CR A2ac; B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 5 deri në 6 mm. Në fazën larvore jeton në ujë përgjatë një viti. Faza larvore është treguese e ujërave mesatarisht të pastra. Faza larvore për nga aspekti i të ushqyerit bën pjesë në grupin e gërryesve dhe mbledhësve/kolektorëve. Faza adulte paraqitet kryesisht gjatë qershorit. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit, ku ka jetuar si larvë (Graf *et al.* 2008; Kumanski 1985).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore [kontinentale] [5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza].
Gjendet kryesisht në zona të caktuara të rrjedhave të epërme dhe zonave burimore të përroskave malore. Substrati i parapëlqyer i larvave të këtij lloji përbëhet nga zhavorri dhe gurët e madhësive të ndryshme. Mund të gjendet deri në 1000 m lartësi mbidetare (Graf *et al.* 2008; Kumanski 1985).

Përhapja e përgjithshme

Austri, Bullgari, Çeki, Gjermani, Hungari, Kosovë, Rumani, Sllovaki.

Përhapja në Kosovë

Përroskë në rrethinën e Lipjanit.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Ky lloj deri më tani është gjetur në vetëm 1 lokalitet në Kosovë me vetëm 1 individ.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Skajshmërisht i Rrezikuar, për shkak të reduktimit të dyshuar të popullatës në të ardhmen, bazuar në rënien e cilësisë së habitateve të përshtatshme për llojin. Ky lloj është i njohur nga vetëm 1 lokacion, me zonën e pranisë ZP të kufizuar [4 km2). Ky lloj është shumë i rrallë edhe në rajon.

Gurëthyesi që operon në afërsinë direkte të lokacionit ku është gjetur ky lloj, me gjasë, do të shkaktojë pasoja afatgjata në degradimin e habitatit.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike [5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve]; 7 Modifikimet e sistemeve natyrore [7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor [përdorimi në amvisëri], 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor [përdorimi në bujqësi]]; 9 Ndotja [9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet]; 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër [11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit].
Faktorët kryesorë, që e kërcënojnë këtë lloj, në Kosovë janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët. Në afërsi të lokalitetit ku është gjetur ky lloj, gjithashtu, operon një gurëthyes, i cila ndikon negativisht në habitat.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit [1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës]; 5. Ligji dhe politikat [5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit].
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi [1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia]; 3. Monitorimi [3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit].
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet. Të monitorohet funksionimi i gurëthyesit në afërsi të lokalitetit ku është gjetur ky lloj.

Referencat

Graf *et al.* 2008; Kumanski 1985





2.2 ACTINOPTERYGII

Anguilla anguilla Linnaeus, 1758

Ngjala

Actinopterygii: Trichoptera: Glossosomatidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Skajshmërisht i Rrezikuar, CR

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

Skajshmërisht i Rrezikuar, CR A2ac; B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Linda Grapci Kotori

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj është tipik migrator, me migrim katadromik. Është lloj territorial dhe vetmitar. Është peshk grabitqar, që ushqehet me një spektër të gjerë të ushqimit dhe kjo i mundëson të jetojë në kushte të ndryshme ekologjike dhe me një përhapje të madhe gjeografike. Mund të arrijë gjatësinë deri në 122 cm. Është raportuar se mund të arrijë moshën deri në 88 vjet (Freyhoff and Kottelat 2008).

Habitati

Lloji i habitatit: 5.Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat]).
Ky lloj është karakteristik për ujërat e ëmbla, por mund të haset edhe në mjedise detare. Zakonisht gjendet vetëm në ato ujëra të ëmbla të cilat janë të lidhura me sistemet detare, ku migron për t'u shumuar.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Afrikë Veriore.

Përhapja në Kosovë

Lumi Drini i Bardhë në Mirushë, Drini i Bardhë tek Ura e Shenjtë.

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Skajshmërisht i Rrezikuar, për shkak të reduktimit të vëzhguar të popullatës në të kaluarën, ku shkaktarët e rënies mund të mos kenë pushuar ende, bazuar në vëzhgimin direkt dhe rënien e cilësisë së habitateve të përshtatshme për llojin. Ky lloj është i njohur nga vetëm 2 lokacione, me zonën e pranisë ZP = 8 km2. Dikur popullata e ngjalës ka qenë mjaft e dendur në lumin Drini i Bardhë, ndërsa sot, për shkak të ndërtimit të pendës në anën e Shqipërisë, si dhe për shkak të ndryshimeve klimatike, është në rënie rapide.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi/përdorimi i ujit: 7.2.10 Diga të mëdha)]; 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane, 9.4 Mbeturinat dhe mbetjet e ngurta); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.2 Thatësirat).
Faktorët kryesorë, që e kërcënojnë këtë lloj, kanë të bëjnë me ndërtimin e pendave, menaxhimin dhe përdorimin e ujit, ndotjen me mbeturina të ngurta dhe thatësitë.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lokalitetin/lokalitetet ku gjendet dhe për llojet e tjera të pranishme.

Referencat

Freyhoff and Kottelat 2008





2.3 AVES

Aquila chrysaetos Linnaeus, 1758

Shqiponja e maleve

Aves: Accipitriformes: Accipitridae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Skajshmërisht i Rrezikuar, CR D

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Taulant Bino, Qenan Maxhuni, Nexhmedin Ramadani.

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e këtij lloji është 66–90 cm, mashkulli peshon 2840–4550 g, femra 3630–6665 g (rrallë deri në 7200 g), kurse hapja e krahëve është 180–234 cm. Femra peshon rreth 50% më shumë se mashkulli dhe është rreth 10% më e madhe se mashkulli. Si të rritur janë kryesisht sedentarë, kurse gjatë disa viteve të para të jetës së tyre shtegtojnë. Gjuajnë pre të llojeve të ndryshme si: gjitarë, reptile, shpendë, ujëtokësorë, peshq etj. (BirdLife International 2016f).

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare); 3 Shkurre (3.8. Shkurre të tipit mesdhetar) 4. Kullosa (4.4 Kullosa të klimës mesatare); 6 Zona shkëmbore (p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore).
Ky lloj mund të gjendet në një gamë të gjerë të habitateve të rrafshëta ose malore, kryesisht të hapura dhe shpesh edhe mbi nivelin e drunjve, nga niveli i detit deri në 4000 m (BirdLife International 2016f).

Përhapja e përgjithshme

Lloji është i pranishëm përgjatë hemisferës veriore.

Përhapja në Kosovë

Zaplluxhë, Bajgorë, Gropa e Erenikut.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Skajshmërisht i Rrezikuar, për shkak se popullatat native të këtij lloji janë në rënie e sipër nga helmimi i qëllimshëm dhe i paqëllimshëm. Ky lloj ka popullatë shumë të izoluar. Numri i individëve të rritur është ≤ 50.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 2 Bujqësia dhe akuakultura (2.2 Plantacionet e drurit dhe pulpës); 3 Prodhimi dhe minierat energjetike (3.3 Energjia e ripërtërishme); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.1 Gjuetia dhe grumbullimi i kafshëve tokësore: 5.1.1 Përdorimi i qëllimshëm (lloji që vlerësohet është i synuar), 5.1.3 Persekutimi/kontrolli, 5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve: 5.3.3 Efektet e paqëllimta: vjelja për jetesë/në shkallë të vogël (lloji që vlerësohet nuk është i synuar); 12 Opsione të tjera (12.1 Kërcënim tjetër (helmimi)).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura). Zona të caktuara ku është i përhapur lloji janë zona të mbrojtura.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës, 1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve). 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës); 5 Ligji dhe politika (5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit). Parandalim dhe kontrollim i aktiviteteve helmuese.

Referencat

BirdLife International 2016f





Ardea cinerea Linnaeus, 1758

Çapka e përhime

Aves: Pelecaniformes: Ardeidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Skajshmërisht i Rrezikuar, CR B2ab(iv)

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Taulant Bino, Qenan Maxhuni,

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e këtij lloji është 90–98 cm, pesha 1020–2073 g, kurse hapja e krahëve është 175–195 cm. Shumica e popullatave në Palearktik janë tërësisht shtegtare, kurse disa popullata jugore synojnë të jenë sedentare. Ushqehen me peshq, ngjala, shpendë të vegjël, brejtës të vegjël etj. [BirdLife International 2016d].

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore [kontinentale] [5.1. Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat], 5.4. Moçale, këneta, moçalishte, 5.5. Liqene të përhershme të ujërave të ëmbla [mbi 8ha], 5.6. Liqene sezonale/të përkohshme të ujërave të ëmbla [mbi 8ha], 5.7. Moçale/basene të përhershme të ujërave të ëmbla [nën 8ha], 5.8. Moçale/basene të përkohshme/sezonale të ujërave të ëmbla [nën 8ha]; 15. Artificiale/ujore [15.2 Pellgjet [nën 8ha], 15.3 Pellgjet e akuakulturës, 15.7 Tokat e ujitura [përfshirë kanalet e ujitjes], 15.9 Kanalet dhe kanalet e drenazhimit, kanalet].
Ky lloj mund të haset prej nivelit të detit deri në mbi 1000 m. Zakonisht folezon në koloni [BirdLife International 2016d].

Përhapja e përgjithshme

Në pjesën më të madhe të Palearktikut dhe më pak në Afrikë, Indi dhe Sri-Lankë.

Përhapja në Kosovë

Vërmicë, Henc, Vasilevë, Kaçanik, Bishtazhin, Partesh, Badovc, Kamenicë, Liqeni i Radoniqit.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj vlerësohet në kategorinë: Skajshmërisht i Rrezikuar, për shkak të arealit gjeografik të përhapjes gjatë kohës së folezimit, që është shumë i kufizuar [zona e pranisë ZP = 4 km2], numrit të lokacioneve, që është 1 dhe reduktimit të projektuar të madhësisë së popullatës, bazuar në rënien e numrit të lokacioneve. Është hasur në disa lokalitete por vetëm 1 koloni folezuese është raportuar deri më tani nga Kosova, e cila është e ndjeshme në rënie të mëtejme.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 7 Modifikimet e sistemeve natyrore [7.2 Digat dhe menaxhimi/përdorimi i ujit: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor [përdorim në amvisëri]]; 2 Bujqësia dhe akuakultura [2.1 Kulturat vjetore dhe shumëvjeçare jodrusore].

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloj i mbrojtur në Kosovë [Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura].

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit [1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës, 1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve]. 2. Menaxhimi i tokës/ujit [2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës]; 5 Ligji dhe politika [5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi].
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi [1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia]; 3. Monitorimi [3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit].
Habitatet e ujërave të ëmbla duhet të menaxhohen qëndrueshëm. Vendosja e zonave të mosndërhyrjes dhe ndalimi i prerjes së pyjeve përreth kolonive.

Referencat

BirdLife International 2016d





Gyps fulvus Hablizl, 1783

Shkaba

Aves: Accipitriformes: Accipitridae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Skajshmërisht i Rrezikuar, CR D

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Taulant Bino, Qenan Maxhuni, Nexhmedin Ramadani.

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e këtij lloji është 93–110 cm, pesha 6000–10000 g, kurse hapja e krahëve është 234–270 cm. Disa popullata janë shtegtare, kurse disa të tjera janë rezidente. Ushqehen kryesisht me mbeturinat e vdekura të gjitarëve të mëdhenj [BirdLife International 2018d].

Habitati

Lloji i habitatit: 4. Kullosa [4.4. Kullosa të klimës mesatare]; 6. Zona shkëmbore [p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore].
Ky është një lloj i vendeve të hapura në mjedise të ndryshme, që nga zonat malore deri në gjysmëshkretëtira. Haset nga niveli i detit deri në rreth 3000 m lartësi mbidetare [BirdLife International 2018d].

Përhapja e përgjithshme

Afrika veriperëndimore, Gadishulli Iberik, Franca Jugore drejt pellgut të Mesdheut [përfshirë Majorkën, Sardinian, Kretën dhe Qipron], Ballkani, Turqia, Lindja e Mesme, Arabia dhe Irani drejt Pamirit dhe Kazakistanit jugor dhe lindor.

Përhapja në Kosovë

Restelicë.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj vlerësohet si: Skajshmërisht i Rrezikuar, sepse dikur i pranishëm përgjatë tërë vendit, sot popullata e tij është shumë e kufizuar. Numri i individëve të rritur është ≤ 50.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 2 Bujqësia dhe akuakultura [2.3 Blegtoria dhe fermat: 2.3.2 Kullotja e vogël, fermat ose bujqësia]; 3 Prodhimi dhe minierat e energjisë [3.3 Energjia e ripërtërishme]; 4 Korridoret e transportit dhe shërbimeve [4.2 Linjat e shërbimeve]; 5 Përdorimi i burimeve biologjike [5.1 Gjuetia dhe mbledhja e kafshëve tokësore: 5.1.1 Përdorimi i qëllimshëm [lloji që vlerësohet nuk është i synuar]; 5.1.3 Persekutimi/kontrolli]; 12 Opsione të tjera [12.1 Kërcënim tjetër [helmimi]].

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur në Kosovë [Udhëzim Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura].

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit [1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës, 1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve]. 2. Menaxhimi i tokës/ujit [2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës]; 5 Ligji dhe politika [5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi].
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi [1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia]; 3. Monitorimi [3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit].
Ky lloj ka mundësi të rikuperohet në qoftë se mbrohet në mënyrë efektive, duke i siguruar qasje në burime të ushqimit.

Referencat

BirdLife International 2018d





2.4 MAMMALIA

Lynx lynx balcanicus Buresh, 1941

Rrëqebulli ballkanik

Mammalia: Carnivora: Felidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Skajshmërisht i Rrezikuar, CR A2ac; C2a(i)

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj

Të dhëna të përgjithshme

Rrëqebulli për nga pamja e jashtme është i ngjashëm me macen e egër dhe atë shtëpiake, por ka madhësi më të madhe. Gjatësia është prej 80 – 130 cm, kurse pesha rreth 32 kg. Mashkulli është më i madh se femra. Trupi është i mbuluar me qime të buta dhe të dendura. Gjatë verës, ngjyra e trupit është më e ndritshme, e verdhë ose me nuanca të arit, kurse gjatë dimrit është më e mbyllët në të kuqërremtë. Është shtazë shumë e shkathët, lëvizë natën, por edhe ditën brenda territorit deri në 25 km, të cilin e shënjon me anë të jashtëqitjeve. Ushqehet me gjitarë, por edhe me shpendë. Ky lloj jeton deri në 18 vjet.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje [1.4. Pyjet të klimës mesatare]; 3. Shkurre [3.4 Shkurre të klimës mesatare]; 4. Kullosa [4.4. Kullosa të klimës mesatare].
I banon zonat malore, duke filluar nga 700 m e deri në 2500 m lartësi mbidetare të tipit alpin, duke u ambientuar në klimën e tipit boreal. I preferon vendet shkëmbore dhe të thyeshme, të qeta dhe larg vendbanimeve.

Përhapja e përgjithshme

Rrëqebulli ballkanik është endemik i Ballkanit. Kosovë, Mali i Zi, Maqedoni, Shqipëri [Breitenmoser-Würsten & Obexer-Ruff 2003].

Përhapja në Kosovë

Reka e Allagës, Koshutan, Mbi fshatin Bogë, Tek hidrocentrali në Deçan.

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie
Popullatat janë në rënie e sipër në të gjithë arealin e përhapjes.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Skajshmërisht i Rrezikuar, për shkak të reduktimit të vëzhguar të popullatës në të kaluarën, ku shkaktarët e rënies mund të mos kenë pushuar ende, bazuar në vëzhgimin direkt dhe rënien e cilësisë së habitateve të përshtatshme për llojin. Rënia e vazhdueshme e vëzhguar bazohet në numrin e individëve të rritur, që është më pak se 50.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 4 Korridoret e transportit dhe shërbimit [4.1 Rrugët dhe hekurudhat]; 5 Përdorimi i burimeve biologjike [5.1 Gjuetia dhe mbledhja e kafshëve tokësore: 5.1.1 Përdorimi i qëllimshëm [lloji që vlerësohet është i synuar], 5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve]. 6 Ndërhyrjet njerëzore dhe shqetësimet [6.2 Luftra, trazira civile dhe stërvitje ushtarake]; 7 Modifikimet e sistemeve natyrore [7.2 Digat dhe menaxhimi/përdorimi i ujit]; 8 Llojet invazive dhe të tjera problematike, gjenet dhe sëmundjet [8.3 Materiale të futura gjenetike].
Kërcënimet kryesore për rrëqebullin ballkanik kanë të bëjnë me popullatën e vogël, bazën e kufizuar të presë për të, degradimin e habitatit dhe gjuetinë pa leje. Prerja e pyjeve, gjithashtu, është një faktor i rrezikimit të popullatës së këtij lloji.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur [Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura].

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit [1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës]; 5. Ligji dhe politikat [5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit].
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi [1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia]; 3. Monitorimi [3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit].
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Breitenmoser-Würsten & Obexer-Ruff 2003





LLOJET E RREZIKUARA (EN)

3.1 BIVALVIA

Unio crassus Philipsson, 1788

Bivalvia: Unionida: Unionidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Skajshmërisht i Rrezikuar, CR A2ac; C2a(i)

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj

Të dhëna të përgjithshme

Guaska është e errët, gati e zezë, ndonjëherë me nuanca të gjelbra, e shkurtër dhe eliptike (margjinat posteriore në anën e epërme rrethore, jo të drejta). Shumica e pjesëve solide gjenden prapa guaskës embrionale, e cila është zakonisht e gërryer, margjinat e poshtme të drejta, jo të lakuara, dhëmbi kryesor është konik dhe me majë. Madhësia 25-45 x 40x70 x 20-28 mm. Format juvenilie janë shumë të ndjeshme ndaj çfarëdo ndotjeje dhe kanë nevojë për sasi të madhe të oksigjenit. Adultët nuk mund të riprodhohen në ujëra të ndotura me nitrate. Ky është lloj indikator i Natura 2000.

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.1.Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat), 5.5. Liqene të përhershme të ujërave të ëmbla (nën 8 ha)).
Ky lloj është i kufizuar në ultësira, banon në lumenj (preferon seksionet e tyre të mesme) dhe në ujëra më të vogla të rrjedhshme, diku në kufijtë e liqenit. Parapëlqen substrate me rërë dhe gurë, por shmang substratin e ndotur me baltë.

Përhapja e përgjithshme

Europë.

Përhapja në Kosovë

Suharekë.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Trendi i popullatës së këtij lloji në Europë është në rënie (Lopes - Lima *et al.* 2014)

Arsyetimi i vlerësimit

Ky është një lloj gjerësisht i përhapur, por i lidhur me llojet e habitateve, që janë të rrezikuara shumë në të gjithë arealin e përhapjes së llojit. Dihet se cilësia e habitatit dhe numri i nënpopullatave janë në rënie në shumicën e rangut të përhapjes. Në Kosovë mund të supozohet vetëm një përhapje shumë e shpërndarë (deri më tani vetëm 1 nënpopullatë është konfirmuar, pra zona e pranisë ZP në Kosovë është me siguri më pak se 500 km2 dhe numri i lokacioneve është nën 5). Duke marrë të gjitha këto në konsideratë, bashkë me reduktimin e projektuar të madhësisë së popullatës, bazuar në rënien e zonës së pranisë ZP, kualitetin e habitatit të përshtatshëm dhe numrin e lokacioneve, lloji vlerësohet si: I Rrezikuar, në nivel vendi.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 7. Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2. Digat dhe menaxhimi/përdorimi i ujit, 7.3. Modifikime të tjera të ekosistemit); 8. Lloje invazive dhe të tjera problematike, gjenet dhe sëmundjet (8.1. Llojet jonative invazive/të huaja sëmundjet); 9. Ndotja (9.1. Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane), 9.3. Efluentët bujqësor dhe pyjor).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1.. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lokalitetin/lokalitetet ku gjendet dhe llojet e tjera.

Referencat

Lopes - Lima *et al.* 2014





3.2 OLIGOCHAETA

Eophila kosowensis Karaman, 1968

Oligochaeta: Opistophora: Lumbricidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Rrezikuar, EN B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Lucija Šerić Jelaska

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj është endemik i Ballkanit, i përshkruar nga Kosova (Karaman 1968). Trupin e ka cilindrik, me madhësi prej 110 – 250 mm dhe me numër të segmenteve prej 225-358. Jeton thellë në dhe, kurse në sipërfaqe mund të gjendet në biotope të ndryshme (Milutinović *et al.* 2015). Kampionët e parë janë gjetur në Prishtinë në numër të madh, në thellësi prej 1.5 m, gjatë groposjes për rregullimin e gypave të ujit. Sipas përhapjes së përgjithshme të llojit, mund të konstatojmë se zonat kodrinore-malore kanë rëndësi shumë të madhe për këtë lloj.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje [1.4 Pyje të klimës mesatare]; 4 Kullosa [4.4 Kullosa të klimës mesatare]; 14 Artificiale/tokësore [14.2 Kullosa, 14.5 Zona urbane].
Habitate të përshtatshme për këtë lloj janë pyjet e ahut, livadhet, kullosat, si dhe mjediset antropogjene (Stojanović *et al.* 2018).

Përhapja e përgjithshme

Greqi, Kosovë, Mali i Zi, Serbi.

Përhapja në Kosovë

Prishtinë, Ferizaj, Mitrovicë, Pejë (Karaman 1968; Milutinović et al 2015; Mršić 1991; Šapkarev 1975; Stojanović *et al.* 2008).

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie
Popullatat janë në rënie e sipër në të gjithë arealin e përhapjes.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është endemik i Ballkanit, me një zonë të vogël të përhapjes. Gjendet në habitate antropogjene, si dhe në pyje e kullosa, të cilat janë nën menaxhim intensiv, e kjo mund të shkaktojë kërcënim për këtë lloj, lokaliteti tipor i të cilit gjendet në Kosovë. Të dhënat momentale jokomplete [zona e pranisë ZP = 16 km2, shtrirja e përhapjes SHP = 2102 km2, numri i lokacioneve ≤ 5, rënia e kualitetit të habitatit], si dhe reduktimi i projektuar i madhësisë së nënpopullatave, bazuar në rënien e kualitetit të habitatit për llojin dhe numrin e lokacioneve, e kualifikojnë këtë lloj në kategorinë: I Rrezikuar. Zona e kufizuar e pranisë ZP dhe numri i lokacioneve, si dhe kërcënimet reale në të ardhmen, mund ta shtyjnë llojin shumë shpejt drejt kategorisë: Skajshmërisht i Rrezikuar, apo: I Zhdukur.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1. Zhvillimi rezidencial dhe komercial 7. Modifikimet e sistemeve natyrore [7.3 Modifikime të tjera të ekosistemit]; 11 Ndryshimet klimatike dhe moti i ashpër [11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit, 11.2 Thatësirat]; 12 Opsione të tjera [12.1 Kërcënim tjetër].

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit [1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës, 1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve]. 2. Menaxhimi i tokës/ujit [2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës];
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi [1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia]; 3. Monitorimi [3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit]

Referencat

Karaman 1968; Kerovec & Mršić 1981; Milutinović *et al.* 2015; Mršić 1991; Šapkarev 1975; Stojanović *et al.* 2008, 2018



3.3 INSECTA

Ecdyonurus graecus Braasch, 1984

Insecta: Ephemeroptera: Heptageniidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Rrezikuar, EN B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Agim Gashi, Bardh Xërxa

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 14 – 15 mm. Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për mënyrën e jetesës së fazës larvore dhe adulte të këtij lloji. Format adulte janë gjetur gjatë shtatorit dhe tetorit (Bauernfeind & Soldan 2012).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) [5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Ky lloj haset në ekosisteme të ujërave të ëmbla, në lartësi të ndryshme mbidetare deri në 1000 m.

Përhapja e përgjithshme

Lloj endemik i Ballkanit. Deri më tani i gjetur vetëm në Greqi dhe Kosovë.

Përhapja në Kosovë

Lumi i Letnicës në Letnicë, Përroskë në Korbiliq.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: I Rrezikuar, për shkak të zonës së pranisë ZP, që është më e vogël se 20 km2, numrit të lokacioneve ≤ 5 dhe rënies së vazhdueshme të pritur të popullatës, bazuar në kualitetin e habitatit dhe numrin e lokacioneve. Lokacionet ku është gjetur ky lloj janë nën presion të vazhdueshëm nga degradimi dhe ndotja.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike [5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve]; 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore [6.1 Aktivitetet rekreative]; 7 Modifikimet e sistemeve natyrore [7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujërave sipërfaqësore [përdorimi në amvisëri], 7.2.3 Eksploatimi i ujërave sipërfaqësore [përdorimi në bujqësi]); 9 Ndotja [9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet]; 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër [11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit].
Faktorët kryesorë, që e kërcënojnë këtë lloj, në Kosovë janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit [1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës]; 5. Ligji dhe politikat [5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit].
Hulumtimi i nevojshëm: 1.Hulumtimi [1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia]; 3. Monitorimi [3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit].
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për llojet e tjera të rëndësishme dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Bauernfeind & Soldan 2012





Epeorus yougoslavicus Šamal, 1935

Insecta: Ephemeroptera: Heptageniidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Rrezikuar, EN B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Agim Gashi, Bardh Xërxa

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 11 deri në 12 mm. Aspektet biologjike dhe ekologjike të këtij lloji nuk janë mjaftueshëm të njohura. Periudha e fluturimit është gjatë pranverës dhe verës (Bauernfeind & Soldan 2012).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat)), 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Larvat janë stenoterme të ftohta dhe kryesisht mund të gjenden në rrjedhat e epërme dhe të poshtme të përroskave të vogla me substrat shkëmbor.

Përhapja e përgjithshme

Bosnjë-Hercegovinë, Bullgari, Greqi, Maqedoni, Itali, Kosovë, Mali i Zi, Serbi.

Përhapja në Kosovë

Përroskë në Çakorr.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Të dhënat aktuale të izoluara (zona e pranisë ZP = 4 km2, numri i lokacioneve është 1, rënie e vazhdueshme e vlerësuar e popullatës, bazuar në kualitetin e habitatit dhe numrin e lokacioneve) e kualifikojnë këtë lloj për kategorinë: Skajshmërisht i Rrezikuar. Përveç kësaj, lokaliteti ku është gjetur ky lloj është nën presion të vazhdueshëm nga degradimi dhe ndotja. Sidoqoftë, rreziku nga zhdukja është më i vogël se sa sugjerojnë këto të dhëna të izoluara, sepse, me gjasë, lloji është i pranishëm edhe në lokalitete të tjera në Bjeshkët e Nemuna, por jo në më shumë se 5 lokacione. Për këtë arsye, ky lloj ulet për një kategori dhe vlerësohet si: I Rrezikuar, në nivel vendi.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)); 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).
Faktorët kryesorë, që e kërcënojnë këtë lloj, në Kosovë janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lokaliteti ku është gjetur ky lloj është në kuadër të zonës së mbrojtur.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për llojet e tjera të rëndësishme dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për llojet e tjera të rëndësishme dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Bauernfeind & Soldan 2012





Metreletus balcanicus Ulmer, 1920

Insecta: Ephemeroptera: Heptageniidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Rrezikuar, EN B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Agim Gashi, Bardh Xërxa

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 9 deri në 13 mm. Periudha e thatësisë mbijetohet në formë të vezës. Ky lloj e ka një gjeneratë në vit. Periudha e fluturimit është gjatë majit dhe qershorit (Bauernfeind & Soldan 2012).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat)), 5.2 Lumenj stinorë/të pandërprerë/të parregullt, përrenj, përroska, 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Ky lloj parapëlqen kryesisht përroskat e përkohshme, në ultësira me apo pa vegjetacion makrofitesh.

Përhapja e përgjithshme

Bosnjë-Hercegovinë, Belgjikë, Bullgari, Francë, Kosovë, Kroaci, Maqedoni, Luksemburg, Poloni, Sllovaki.

Përhapja në Kosovë

Përroskë në Keqekollë.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: I Rrezikuar, për shkak të zonës së pranisë ZP = 4 km2, numrit të lokacioneve që është 1, rënies së vazhdueshme të vlerësuar të popullatës, bazuar në kualitetin e habitatit dhe numrin e lokacioneve. Lokaliteti ku është gjetur ky lloj është nën presion të vazhdueshëm nga degradimi dhe ndotja. Edhe pse të dhënat aktuale të pakompletuara e klasifikojnë këtë lloj në kategorinë: Skajshmërisht i Rrezikuar, megjithatë, e kemi ulur për një kategori, sepse supozojmë se ky lloj mund të gjendet edhe në lokacione të tjera në Kosovë, por jo në më shumë se 5.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)); 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).
Faktorët kryesorë, që e kërcënojnë këtë lloj, në Kosovë janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për llojet e tjera të rëndësishme dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Bauernfeind & Soldan 2012





Serratella spinosa Ikonomov, 1961

Insecta: Ephemeroptera: Ephemerellidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Rrezikuar, EN B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Agim Gashi, Bardh Xërxa

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 7.8 – 9.3 mm. Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për aspektet biologjike dhe ekologjike të këtij lloji. Periudha e fluturimit është gjatë korrikut (Bauernfeind & Soldan 2012).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat), 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Larvat gjenden në përroska malore ose pranëmalore, me substrat guror. Mund të gjenden edhe në lumenj të vegjël. Preferojnë ujëra të pastra dhe të pasura me oksigjen. Mund të gjendet në lartësi të ndryshme mbidetare, prej 500 deri në 1500 m.

Përhapja e përgjithshme

Lloj endemik i Ballkanit. Deri më tani i njohur vetëm nga Bosnjë-Hercegovina, Greqia, Kosova dhe Maqedonia.

Përhapja në Kosovë

Përroskë në Krilevë.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për gjendjen e popullatave të këtij lloji apo për madhësinë e përhapjes.

Arsyetimi i vlerësimit

Të dhënat aktuale të izoluara (zona e pranisë ZP = 4 km2, numri i lokacioneve është 1, rënie e vazhdueshme e vlerësuar e popullatës, bazuar në kualitetin e habitatit dhe numrin e lokacioneve) e kualifikojnë këtë lloj për kategorinë: Skajshmërisht i Rrezikuar. Përveç kësaj, lokaliteti ku është gjetur ky lloj është nën presion të vazhdueshëm nga degradimi dhe ndotja. Sidoqoftë, rreziku nga zhdukja është më i vogël se sa sugjerojnë këto të dhëna të izoluara, sepse, me gjasë, lloji është i pranishëm edhe në lokalitete të tjera, sidoqoftë jo në më shumë se 5 lokacione. Për këtë arsye, ky lloj ulet për një kategori dhe vlerësohet si: I Rrezikuar, në nivel vendi.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)); 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).
Faktorët kryesorë, që e kërcënojnë këtë lloj, në Kosovë janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lokaliteti ku është gjetur ky lloj është në kuadër të zonës së mbrojtur.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për llojet e tjera të rëndësishme dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Bauernfeind & Soldan 2012





Brachyptera graeca Berthelemy, 1971

Insecta: Plecoptera: Taeniopterygidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Rrezikuar, EN B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Astrit Bilalli

Të dhëna të përgjithshme

Në fazën larvore jeton në ujë përgjatë një viti. Faza adulte paraqitet në periudhën e pranverës. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit, ku ka jetuar si larvë. Faza larvore është indikatore e ujërave të pastra dhe mesatarisht të pastra.

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat), 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Gjendet kryesisht në përroska të vogla malore. Haset në lartësi të mëdha mbidetare mbi 1000 m.

Përhapja e përgjithshme

Bosnjë-Hercegovinë, Greqi, Maqedoni, Kosovë.

Përhapja në Kosovë

Përroskë në Çakorr.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Në Kosovë është konstatuar në vetëm 1 lokalitet, me numër të vogël të individëve.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: I Rrezikuar, për shkak të zonës së pranisë ZP = 4 km2, numrit të lokacioneve, që është 1 dhe rënies së vazhdueshme të vlerësuar të popullatës, bazuar në kualitetin e habitatit dhe numrin e lokacioneve. Lokaliteti ku është gjetur ky lloj është nën presion të vazhdueshëm nga degradimi dhe ndotja. Ky lloj mund të gjendet edhe në lokalitete të tjera në Bjeshkët e Nemuna, por jo në më shumë se 5 lokacione.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)); 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).
Faktorët kryesorë, që e kërcënojnë këtë lloj, janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse. Lokaliteti ku është gjetur ky lloj është në kuadër të zonës së mbrojtur.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.



Rhyacophila palmeni McLachlan, 1879

Insecta: Trichoptera: Rhyacophilidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Rrezikuar, EN B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 13 deri në 15 mm. Ngjyra e krahëve është kafe e çelët. Në fazën larvore jeton në ujë përgjatë një viti dhe ushqehet si predatore. Faza larvore është treguese e ujërave të pastra dhe mesatarisht të pastra. Faza adulte paraqitet në periudhën korrik-gusht. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit, ku ka jetuar si larvë. Ky lloj ka një përhapje disjunkte në Europën juglindore, e kjo sugjeron se nënpopullatat nga Greqia dhe Kosova mund të paraqesin lloj kriptik, të ndryshëm nga popullatat e Kroacisë dhe Sllovenisë (Ibrahimi *et al.* 2012).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat)).
Gjendet kryesisht në zona të caktuara të rrjedhave të epërme dhe të mesme të lumenjve. Substrat i parapëlqyer i larvave të këtij lloji është zhavorri i trashë, gurët e madhësive të ndryshme, shtrati guror i lumit. Në Kosovë është hasur në lartësi të ndryshme mbidetare prej 1000 deri në 1600 m.

Përhapja e përgjithshme

Greqi, Kosovë, Kroaci dhe Sllloveni.

Përhapja në Kosovë

Lumbardhi i Prizrenit në Sredskë, Lumbardhi i Pejës në Kuqishtë.

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie
Në të gjitha lokalitetet ku është gjetur në Kosovë ky lloj karakterizohet me numër të vogël të individëve. Sipas informatave ekzistuese, është vërejtur rënie e nënpopullatave në Lumbardhin e Prizrenit në Sredskë, si rezultat i ndikimit antropogjen nëpërmjet zhvillimit infrastrukturor në këtë mjedis.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: I Rrezikuar, për shkak të zonës së pranisë ZP = 8 km2, numrit të lokacioneve që është ≤ 5, si dhe rënies së vazhdueshme të vlerësuar të popullatës bazuar në kualitetin e habitatit dhe numrin e lokacioneve. Lokalitetet ku është gjetur ky lloj janë nën presion të vazhdueshëm nga degradimi dhe ndotja, veçanërisht nënpopullata në Lumbardhin e Prizrenit në Sredskë është në rrezik nga zhdukja.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)); 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).
Faktorët kryesorë, që e kërcënojnë këtë lloj janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Ibrahimi *et al.* 2012





Apatura iris Linnaeus, 1758

Insecta: Lepidoptera: Nymphalidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Rrezikuar, EN B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj e ka gjerësinë e krahëve prej 65 deri në 80 mm. Ky lloj e ka një gjeneratë në vit. Adultët fluturojnë prej qershorit deri në gusht. Larvat ushqehen me bimët që i takojnë gjinisë *Salix*.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare).
Në Kosovë është vërejtur shpeshherë në pyje gjetherënëse, në afërsi të grykave të lumenjve apo duke pushuar përgjatë rrugëve.

Përhapja e përgjithshme

Europë qendrore, Europë juglindore.

Përhapja në Kosovë

Bogë, Grykë e Kaçanikut, Brezovicë, Radavc, Grykë e Rugovës (Jakšić 1988, 2003).

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie
Nënopullatat e këtij lloji janë të vogla dhe me tendenca të konsiderueshme të jostabilitetit.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: I Rrezikuar, për shkak të zonës së pranisë ZP = 20 km2, shtrirjes së përhapjes SHP = 1313 km2 dhe numrit të vogël të njohur të lokacioneve (5). Lloji nuk është vëzhguar në Kosovë qysh prej disa dekadash, prandaj janë të domosdoshme hulumtime më të detajuara në lokalitetet e raportuara, për të vërtetuar gjendjen e popullatave të llojit.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 4 Korridoret e transportit dhe shërbimit (4.1 Rrugët dhe hekurudhat); 5. Përdorimi i burimeve biologjike (5.3.Prerja dhe vjelja e pyjeve); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.1 Zjarret dhe luftimi i tyre, 7.3 Modifikime të tjera të ekosistemit); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Modifikimi dhe ndryshimi i habitatit).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloj i mbrojtur në Kosovë (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura). Habitatet e këtij lloji në parqet kombëtare Bjeshkët e Nemuna dhe Mali Sharr janë të mbrojtura me ligj.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Jakšić 1988, 2003





Euphydryas aurinia Rottemburg, 1775

Insecta: Lepidoptera: Nymphalidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Rrezikuar, EN B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj e ka gjerësinë e krahëve prej 30 deri në 42 mm. Është lloj arboreal tek i cili ekziston vetëm një gjeneratë në vit. Adultët paraqiten prej prillit deri në korrik. Bimë ushqyese të larvave të këtij lloji janë ato të gjinive: *Succisa, Scabiosa, Lonicera, Gentiana, Digitalis* etj.

Habitati

Lloji i habitatit: Ky lloj paraqitet në habitate të ndryshme, si: livadhe të hijezuara e të lagështa, përgjatë skajeve të moçaleve, në livadhet gëlqerore etj.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Afrikë, Azi.

Përhapja në Kosovë

Pashtrik, Koshtovë (Jakšić 1986; Jakšić dhe Živić 1995-1998).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Nuk ka të dhëna për popullatat e këtij lloji. Të dhënat e fundit për këtë lloj datojnë nga viti 1987.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: I Rrezikuar, për shkak të zonës së vogël të pranisë ZP = 8 km2 dhe numrit të vogël të njohur të lokacioneve të tij (2). Lloji nuk është vëzhguar në Kosovë qysh prej disa dekadash, prandaj janë të domosdoshme hulumtime më të detajuara në lokalitetet e raportuara, për të vërtetuar gjendjen e popullatave të llojit.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 2 Bujqësia dhe akuakultura; 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.3. Modifikime të tjera të ekosistemit).
Është vëzhguar se ky lloj ndikohet nga braktisja e tokave të menaxhuara.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Jakšić 1986, Jakšić dhe Živić 1995-1998



Euphydryas maturna Linnaeus, 1758

Insecta: Lepidoptera: Nymphalidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
I Cenuar, VU

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Rrezikuar, EN B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj e ka gjerësinë e krahëve prej 35 deri në 48 mm. Është lloj arboreal, tek i cili ekziston vetëm një gjeneratë në vit. Adultët paraqiten prej majit deri në korrik. Bimë ushqyese të larvave të këtij lloji janë ato të gjinive: *Fraxinus, Salix, Populus, Plantago, Veronica etj.*

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare); 4. Kullosa.
Habitate të parapëlqyera të këtij lloji janë pyjet gjetherënëse gjethegjera, pyjet e përziera, livadhet e lagështa dhe livadhet mezofile.

Përhapja e përgjithshme

Austri, Belgjikë, Çeki, Francë, Greqi, Gjermani, Hungari, Kazakistan, Kosovë, Lituani, Luksemburg, Mali i Zi, Poloni, Rumani, Rusi, Serbi, Suedi.

Përhapja në Kosovë

Gryka e Rugovës, Çakorr (Jakšić 2003).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Nuk ka të dhëna për popullatat e këtij lloji. Të dhënat e fundit për këtë lloj janë nga materiali i mbledhur në vitin 1996.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: I Rrezikuar, për shkak të zonës së kufizuar të pranisë ZP = 8 km2 dhe numrit të vogël të njohur të lokacioneve të tij (2). Lloji nuk është vëzhguar në Kosovë qysh prej disa dekadash, prandaj janë të domosdoshme hulumtime më të detajuara në lokalitetet e raportuara, për të vërtetuar gjendjen e popullatave të llojit.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 2 Bujqësia dhe akuakultura; 5. Përdorimi i burimeve biologjike (5.3.Prerja dhe vjelja e pyjeve: 5.3.3 Efektet e paqëllimshme: vjelja për jetesë/në shkallë të vogël [llojet që vlerësohen nuk synohen) [vjelja]]; 7 Modifikimet e sistemeve natyrore.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura). Disa nga lokalitetet, prej nga është raportuar ky lloj, janë tashmë në kuadër të zonës së mbrojtur.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1.Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Jakšić 2003



Phengaris arion Linnaeus, 1758

Insecta: Lepidoptera: Lycaenidae

Kaltëroshja njollazeze

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

I Rrezikuar, EN B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi

Të dhëna të përgjithshme

Ky është një nga llojet më të mëdha me ngjyrë të kaltër dhe dallohet nga rendi i pikave të zeza në pjesën e epërme të krahëve të përparmë. Ky lloj e ka një gjeneratë në vit. Bimë ushqyese të larvave të këtij lloji janë ato të gjinive: *Venera, Origanum dhe Thymus.* Adultët paraqiten në periudhën qershor – korrik. Larvat janë kryesisht heliofile dhe mirmekofile.

Habitati

Lloji i habitatit: 3. Shkurre; 4. Kullosa.
Është lloj arboreal, që gjendet kryesisht në vende të thata, me bar, apo me shkurre, si dhe në vende të hapura brenda pyjesh.

Përhapja e përgjithshme

Nga Spanja veriore dhe në lindje deri në Itali, Greqi dhe Skandinavi jugore.

Përhapja në Kosovë

Shkozë e Malishevës, Grykë e Rugovës, Lloqan, Junik, Strellc, Qafë e Morinës, Bjeshkët e Sharrit (Jakšić 2003, Jakšić dhe Živić 1995-1998, Zhushi *et al.* 2016).

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie
Ky lloj është konstatuar me nënpopullata, të cilat kanë numër jashtëzakonisht të vogël të individëve.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: I Rrezikuar, për shkak të numrit të vogël të lokacioneve (7), zonës së pranisë ZP = 28 km2, shtrirjes së përhapjes SHP = 1034 km2, si dhe rëndësisë dhe rrallësisë së llojit në nivel europian. Lokacionet ku është gjetur janë nën presion të vazhdueshëm nga degradimi dhe ndotja, gjëra që mund ta përkeqësojnë gjendjen e nënpopullatave të këtij lloji.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.1 Banimi dhe zonat urbane); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.2 Mbledhja e bimëve tokësore). Modifikimet e sistemeve natyrore (7.3 Modifikime të tjera të ekosistemit).
Ndër kërcënimet për këtë lloj është vërejtur se është edhe mbledhja e bimëve të gjinisë Thymus, si dhe braktisja e tokave bujqësore.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse. Megjithatë, disa nga lokalitetet ku gjendet ky lloj janë në kuadër të zonës së mbrojtur.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Jakšić 2003; Jakšić and Živić 1995-1998; Zhushi *et al.* 2016



Zerynthia polyxena Denis & Schiffermüller, 1775

Poliksena

Insecta: Lepidoptera: Papilionidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

I Rrezikuar, EN B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj e ka gjerësinë e krahëve prej 46 deri në 80 mm. Ky lloj e ka një gjeneratë në vit. Adultët paraqiten gjatë prillit dhe majit. Bimë ushqyese të këtij lloji janë ato që i takojnë gjinisë *Aristolochia.* Në të njëjtën bimë i lëshon edhe vezët.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare); 4. Kullosa.
Habitate të parapëlqyera të këtij lloji janë: livadhet e lagështa dhe bashkësitë e bimëve të larta, livadhet mezofile, livadhet e thata gëlqerore dhe zonat e pyllëzuara.

Përhapja e përgjithshme

Nga Franca jugore përgjatë Italisë dhe Austrisë juglindore deri në Greqi.

Përhapja në Kosovë

Shkozë, Brezovicë, Prizren (Jakšić 1998; Jakšić dhe Živić 1995-1998; Zhushi *et al.* 2017).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Ky lloj është konstatuar me nënpopullata me një numër të vogël të individëve.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: I Rrezikuar, për shkak të numrit të vogël të lokacioneve (3), zonës së pranisë ZP = 12 km2, shtrirjes së përhapjes SHP = 224 km2, rënies së vlerësuar të vazhdueshme të popullatës, bazuar në kualitetin e habitatit dhe numrin e lokacioneve, si dhe rëndësisë dhe rrallësisë së llojit në nivel europian. Tendencat në rritje të aktiviteteve që kanë të bëjnë me degradimin e habitatit të këtij lloji mund ta çojnë atë drejt zhdukjes në Kosovë.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 2 Bujqësia dhe akuakultura (2.3. Blegtoria dhe fermat: 2.3.2 Kullotja vogël, fermat apo bujqësia); 6. Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.1 Zjarret dhe luftimi i zjarrit, 7.3. Modifikime të tjera të ekosistemit).
Është vëzhguar se ky lloj ndikohet edhe nga aktivitetet e kositjes.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura). Të paktën një nga lokalitetet prej nga njihet ky lloj, është tashmë në kuadër të zonës së mbrojtur.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Jakšić 1998; Jakšić and Živić 1995-1998; Zhushi *et al.* 2017





3.4 ACTINOPTERYGII

Salmo marmoratus Cuvier, 1829

Trofta e mermertë

Actinopterygii: Salmoniformes: Salmonidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Rrezikuar, EN B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Linda Grapci Kotori

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj karakterizohet me trup të zgjatur. Ngjyra e trupit ka nuanca të ngjyrës së murme prej nga e ka marrë edhe emrin. Është shumë i rrezikuar viteve të fundit për shkak të hibridizimit. Mund të arrijë gjatësinë deri në 120 cm dhe moshën deri në 10 vjet (Maric *et al.* 2010).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat], 5.4 Këneta, moçale, moçalishte, 5.5 Liqene të përhershme të ujërave të ëmbla).
Zakonisht gjendet në ujëra të ftohta malore ku temperatura nuk ngritet mbi 15 °C. Mund të haset edhe në liqene me kushte të tilla të ftohta, në lartësi të mëdha mbidetare.

Përhapja e përgjithshme

Europë Juglindore, Itali.

Përhapja në Kosovë

Lumi Drini i Bardhë në Zllakuqan.

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie
Popullata e këtij lloji është vërejtur të ketë tendenca të rënies viteve të fundit.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: I Rrezikuar, për shkak të zonës së pranisë ZP = 4 km2, numrit të lokacioneve, që është 1 por pritet të jetë më i madh, megjithatë jo më shumë se 5, si dhe rënies së vazhdueshme të vlerësuar të popullatës bazuar në kualitetin e habitatit dhe numrin e lokacioneve. Lokaliteti ku është gjetur ky lloj është nën presion të vazhdueshëm nga degradimi dhe ndotja.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.1 Zonat rezidenciale dhe komerciale); 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane, 9.4 Mbeturinat dhe mbetjet e ngurta); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.2 Thatësirat).
Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj, kanë të bëjnë me vendbanimet dhe zonat urbane, ndotjen nga ujërat e zeza, ndotjen nga mbeturinat e ngurta dhe të tjera, si dhe me thatësirën.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lokalitetin/lokalitetet ku gjendet dhe për llojet e tjera të pranishme.

Referencat

Maric *et al.* 2010



3.5 ACTINOPTERYGII

Salamandra atra Laurenti, 1768

Salamandra e Alpeve ose Picërraku i Zi
Amphibia: Caudata: Salamandridae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Rrezikuar, EN B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj, Linda Grapci Kotori

Të dhëna të përgjithshme

Salamandra e Alpeve është lloj që ka shtrirje të gjerë në regjionin Alpin të Europës, kurse në vendin tonë është relativisht i rrallë. Ka trup të zgjatur cilindrik, me madhësi deri në 14 cm. Trupi ka kryesisht ngjyrë të zezë ose të murrme në të zezë, pa njolla të ngjyrave të tjera. Jetëgjatësia e këtyre shtazëve mesatarisht është deri në 10 vjet (Andreone *et al*. 2009).

Habitati

Lloji i habitatit: 1 Pyje (1.1 Pyje boreale, 1.4 Pyje të klimës mesatare); 4 Kullosa (4.4 Kullosa të klimës mesatare).
Është lloj kryesisht tokësor. Mund të haset në lartësi të ndryshme mbidetare, prej 400 deri në 2800 m.

Përhapja e përgjithshme

Bosnjë-Hercegovinë, Francë, Gjermani, Itali, Kosovë, Kroaci, Lihtenshtajn, Mali i Zi, Serbi, Sllloveni, Shqipëri, Zvicër.

Përhapja në Kosovë

Gurra e Gjatë, Gryka e Deçanit.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Në disa vende europiane popullatat e këtij lloji janë në rënie. Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për gjendjen e popullatave të këtij lloji në Kosovë, por nga vëzhgimet është vërejtur se ka tendenca të rënies së popullatave edhe në Kosovë.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: I Rrezikuar, për shkak të zonës së pranisë ZP të kufizuar = 8 km2, numrit të lokacioneve ≤ 5, si dhe rënies së vazhdueshme të vlerësuar të popullatës, bazuar në kualitetin e habitatit dhe numrin e lokacioneve. Lokalitetet ku është gjetur ky lloj janë nën presion të vazhdueshëm nga degradimi dhe ndotja.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit); 11. Ndryshimet klimatike dhe moti i ashpër.
Faktorët kryesorë, që e kërcënojnë këtë lloj, kanë të bëjnë me veprimtaritë e ndërlidhura me turizmin dhe aktivitetet rekreative, ndryshimin e habitatit, si dhe ndryshimet klimatike dhe motin ekstrem.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Andreone *et al*. 2009



Triturus alpestris Laurenti, 1768

Tritoni alpin

Amphibia: Caudata: Salamandridae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

I Rrezikuar, EN B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj, Linda Grapci Kotori

Të dhëna të përgjithshme

Tritoni alpin është lloj me madhësi mesatare të trupit prej 8 deri ne 12 cm, si dhe kokë relativisht të madhe dhe të gjerë. Meshkujt janë më të vegjël se femrat. Karakteristikë dalluese e këtij lloji është që në anën barkore trupi ka ngjyrë portokalli në të kuqërremtë, ndërsa në anën shpinore ka ngjyrë të mbyllët të murrme. Është aktiv më tepër gjatë pasdites dhe muzgut. Janë të njohura disa nënlloje në Europë, megjithëqë hulumtimet taksonomike të popullatave të ndryshme janë akoma duke u kryer. Ky lloj mund të jetojë deri në 20 vjet, edhe pse mesatarisht jeton 7 vjet (Arntzen *et al.* 2009).

Habitati

Lloji i habitatit: 5 Vende ujore (kontinentale) (5.11 Vende ujore alpine (përfshirë ujëra të përkohshme nga shkrirja e borës)]. Ky lloj mund të haset si në zonat litorale ashtu edhe në zonat limnetike të liqenit. Mund të haset edhe në zona alpine por edhe në lartësi më të vogla.

Përhapja e përgjithshme

Austri, Belgjikë, Bosnjë-Hercegovinë, Bullgari, Çeki, Danimarkë, Kosovë, Kroaci, Francë, Gjermani, Greqi, Hungari, Itali, Lihtenshtajn, Luksemburg, Maqedoni, Mali i Zi, Holandë, Poloni, Rumani, Serbi, Sllovaki, Sllloveni, Spanjë, Shqipëri, Zvicër, Ukrainë.

Përhapja në Kosovë

Liqeni i Leqinatit, Liqeni i Gjeravicës.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Në disa vende europiane popullatat e këtij lloji janë në rënie. Në Kosovë trendi i popullatës nuk është i njohur mirë.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: I Rrezikuar, për shkak të zonës së pranisë ZP prej vetëm 8 km2, numrit të lokacioneve (2) dhe rënies së vazhdueshme të vlerësuar të popullatës, bazuar në kualitetin e habitatit dhe numrin e lokacioneve.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit); 11. Ndryshimet klimatike dhe moti i ashpër
Faktorët kryesorë, që e kërcënojnë këtë lloj, kanë të bëjnë me veprimtaritë e ndërlidhura me turizmin dhe rekreacionin, ndryshimet klimatike dhe motin ekstrem.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse. Megjithatë, lokalitetet prej nga është i njohur ky lloj, janë pjesë e zonës së mbrojtur.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Arntzen *et al.* 2009



Aythya ferina Linnaeus, 1758

Kryekuqe e mjeme

Aves: Anseriformes: Anatidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

I Cenuar, VU

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

I Rrezikuar, EN B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Taulant Bino, Qenan Maxhuni.

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e këtij lloji është 42–49 cm, mashkulli peshon 585–1240 g, femra 467–1090 g, kurse hapja e krahëve është 72–82 cm. Ushqehet me pjesë të rrënjëve, fara, rizome, por gjithashtu edhe me organizma ujorë, përfshirë insekte, kërmij, ujëtokësorë dhe peshq të vegjël (BirdLife International 2017).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.4 Moçale, këneta, moçalishte, 5.5 Liqene të përhershme të ujërave të ëmbla (mbi 8ha)); 15 Artificiale - ujore (15.5. Gërmime (të hapura)).
Ky lloj parapëlqen këneta, moçale, liqene dhe lumenj me rrjedhje të ngadaltë me vegjetacion të bollshëm, eutrofike dhe neutrale, me zona të ujit të hapura dhe bimësi të bollshme emergjente. Lloji gjithashtu folezon në liqene të ujërave të njelmëta dhe ndonjëherë edhe në gjiret bregdetare të mbrojtura. Vendet e folezimit okupohen nga fillimi i marsit (në jug) deri në fillim të majit (në Siberi), kurse folezimi ndodh gjatë periudhës prill-maj. Gjatë dimrit, lloji frekuenton habitate të ngjashme me ato ku folezon, duke përfshirë liqene të mëdha, lumenj të ngadalshëm, rezervuarë, ujëra të njelmët, këneta dhe gropa të zhytura zhavori (BirdLife International 2017).

Përhapja e përgjithshme

Folezon në perëndim të Europës, në lindje nëpërmjet Azisë qendrore, (në gjerësitë 40–60° veri) drejt Siberisë jugqendrore dhe Kinës veriore drejt 120° Lindje. Dimëron në jug deri në veri dhe lindje të Afrikës, Indi dhe Azi jugore dhe lindore.

Përhapja në Kosovë

Henc, Obiliq, Graqanicë, Radoniq.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar si: I Rrezikuar, gjatë kohës së folezimit, sepse ka një zonë të vogël të pranisë ZP gjatë kësaj periudhe (= 16 km2). Numri i vendeve të folezimit (lokacioneve) është ≤ 5. Zona e pranisë ZP dyshohet se është në rënie të mëtejme.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.1 Gjuetia dhe grumbullimi i kafshëve tokësore: 5.1.1 Përdorimi i qëllimshëm (lloji që vlerësohet është i synuar), 5.4 Peshkimi dhe përdorimi i resurseve ujore: 5.4.4 Efektet e paqëllimshme: vjelje për jetesë/në shkallë të vogël (lloji që vlerësohet nuk është i synuar) [vjelja]); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi/përdorimi i ujit: 7.2.4 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi i panjohur)).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Disa zona të përhapjes së llojit janë të mbrojtura. Lloj i mbrojtur në Kosovë (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës, 1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve). 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës); 5 Ligji dhe politika (5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Ky lloj përfiton nga mbrojtja dhe mirëmbajtja e mjediseve ujore. Përdorimi i plumbit në gjueti duhet të ndalohet dhe legjislacioni të zbatohet siç duhet. Të reduktohet shkarkimi i nutrientëve nga tokat bujqësore.

Referencat

BirdLife International 2017





Aythya nyroca Güldenstädt, 1770

Kryekuqe e vogël

Aves: Anseriformes: Anatidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

I Rrezikuar, EN B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Taulant Bino, Qenan Maxhuni.

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e këtij lloji është 38–42 cm, mashkulli peshon 470–730 g, femra 464–727 g; kurse hapja e krahëve është 63–67 cm. Është kryesisht lloj shtegtar. Është gjithçkangrënës dhe ushqehet me material me origjinë bimore dhe shtazore (BirdLife International 2017a).

Habitati

Lloji i habitatit: 5 Vende ujore (kontinentale) (5.5) Liqene të përhershme të ujërave të ëmbla (mbi 8ha), 5.7 Këneta/Basene të përhershme të ujërave të ëmbla (nën 8ha), 15 Artificiale - ujore (15.1 Zonat e deponimit të ujit (mbi 8ha), 15.3. Basene të akuakulturës).
Ky lloj tregon parapëlqim të fortë për ujëra të ëmbla të ndenjura dhe rrallëherë gjendet në përrenj apo lumenj të rrjedhshëm. Folezon në basene dhe këneta eutrofike të cekëta, me vegjetacion të dendur submergjent, notues, emergjent dhe bregor (p.sh., kallamishte). Jashtë kohës së shumimit kërkesat për habitat janë të ngjashme me ato të folezimit, edhe pse mund të frekuentojnë në këtë kohë edhe liqenet e mëdha, lagunat e hapura, kënetat bregdetare me kallamishte dhe gjiret e cekëta, pastaj ngushticat dhe estuaret (BirdLife International 2017a).

Përhapja e përgjithshme

Popullatat e fragmentuara folezojnë nga Europa qendrore dhe jugore dhe Afrika veriore në lindje drejt Mongolisë perëndimore, popullata të izoluara nga Algjeria lindore drejt Pakistanit verilindor dhe Kinës. Përhapja gjatë dimërimit përputhet me përhapjen e folezimit dhe zgjerohet në Sahel, Lindje të Afërt dhe Azi juglindore.

Përhapja në Kosovë

Henc, Obiliq.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar si: I Rrezikuar, sepse ka zonë të pranisë ZP të vogël (= 8 km2). Numri i lokacioneve është ≤ 5. Zona e pranisë ZP dyshohet se është në rënie të mëtejme.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 2 Bujqësia dhe akuakultura (2.1 Kulturat vjetore dhe shumëvjeçare jodrusore); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.1 Gjuetia dhe grumbullimi i kafshëve tokësore: 5.1.1 Përdorimi i qëllimshëm (lloji që vlerësohet është i synuar)); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi/përdorimi i ujit: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloj i mbrojtur në Kosovë (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. . Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës, 1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve). 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës); 4. Edukim dhe vetëdijesim; 5 Ligji dhe politika (5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Promovim i menaxhimit me orientim mjedisor i kënetave dhe baseneve të peshqve, promovim i mbrojtjes dhe menaxhimit adekuat të lokaliteteve kyçe, promovim i konservimit më të gjerë në mjedis, që do të ishte në dobi të llojit dhe habitatit të tij, parandalim i mortalitetit dhe shqetësimit të llojit të shkaktuar nga gjuetia.

Referencat

BirdLife International 2017a





Botaurus stellaris Linnaeus, 1758

Gakthi

Aves: Pelecaniformes: Ardeidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Rrezikuar, EN B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Taulant Bino, Qenan Maxhuni.

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e këtij lloji është 64–80 cm, mashkulli peshon 750–2060 g, femra 650–1150 g, kurse hapja e krahëve 125–135 cm. Në vendet me dimra të butë është lloj sedentar, kurse në vende të tjera është shtegtar. Sa i përket të ushqyerit, ai është i ndryshëm në stinë të ndryshme, por i preferon peshqit, ujëtokësorët, insektet, merimangat etj. (BirdLife International 2016c).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.4 Moçale, këneta, moçalishte); 14. Artificiale/tokësore (14.1. Toka të punueshme).
Kanë kërkesa të kufizuara gjatë kohës së folezimit: kryesisht parapëlqejnë moçalishte pak të shqetësuara, vende përreth liqeneve dhe lumenjve, me pjesë kallamishtesh përreth (BirdLife International 2016c).

Përhapja e përgjithshme

Folezon prej Suedisë, Anglisë dhe Spanjës përgjatë Europës, Afrikës veriore, Lindjes së Afërt dhe Azisë qendrore, në lindje të Lindjes së largët të Rusisë, verilindjes së Kinës dhe Japonisë; dimëron në Europën qendrore dhe jugore, Pellgun e Mesdheut, në lindje drejt jugut dhe juglindjes së Azisë dhe Afrikës nënsahariane.

Përhapja në Kosovë

Henc.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar si: I Rrezikuar, për shkak të zonës së pranisë ZP të kufizuar (< 500 km2). Numri i lokaliteteve është ≤ 5. Zona e pranisë ZP ka tendencë të mëtejme të rënies.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 2 Bujqësia dhe akuakultura (2.1 Kulturat vjetore dhe shumëvjeçare jodrusore); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi/përdorimi i ujit: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri)].

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloj i mbrojtur në Kosovë (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës, 1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve). 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës); 5 Ligji dhe politika (5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

BirdLife International 2016c





Himantopus himantopus Linnaeus, 1758

Kalorësi

Aves: Charadriiformes: Recurvirostridae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Rrezikuar, EN B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Taulant Bino, Qenan Maxhuni.

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e këtij lloji është 35–40 cm, pesha 166–205 g (mesatarja e të gjitha racave), ose 112–223 g (nominal). Popullatat veriore janë shtegtare, ndërsa në zonat me klimë më të butë janë sedentare ose lokalisht shtegtare. Ushqehen me peshq, insekte ujore, molusqe, merimanga dhe nganjëherë edhe me fara bimësh (BirdLife International 2016e).

Habitati

Lloji i habitatit: 5 Vende ujore (kontinentale) (5.5. Liqene të përhershme të ujërave të ëmbla (mbi 8ha), 5.6. Liqene sezonale/të përkohshme të ujërave të ëmbla (mbi 8ha), 5.7. Moçale/basene të përhershme të ujërave të ëmbla (nën 8ha), 5.8. Moçale/basene të përkohshme/sezonale të ujërave të ëmbla (nën 8ha); 15. Artificiale/ujore (15.8.Toka bujqësore të përmbytura sezonale).

Përhapja e përgjithshme

Francë dhe jug i Iberisë drejt Afrikës nënsahariane dhe Madagaskarit, dhe në lindje drejt Azisë qendrore dhe Kinës veriqendrore, Nënkontinenti Indian (përfshirë Sri-Lankën), Indokinën dhe Tajvanin; dimëron në jug të Afrikës, Lindje të Mesme dhe jug dhe juglindje të Azisë drejt Borneos dhe Filipineve.

Përhapja në Kosovë

Henc, Obiliq, Nosalje.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar si: I Rrezikuar, për shkak të zonës së pranisë ZP të kufizuar (= 12 km2) dhe numrit të lokacioneve, që është ≤ 5. Zona e pranisë ZP dyshohet se është në rënie të mëtejme.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.2 Hapësirat komerciale dhe industriale); 6 Ndërhyrje dhe shqetësime njerëzore (6.3 Punë dhe aktivitete të tjera); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)].

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloj i mbrojtur në Kosovë (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. . Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës, 1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve). 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës); 5 Ligji dhe politika (5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Reduktim i presionit të gjuetisë në këtë lloj, krijim i fushatave vetëdijesuese me target gjuetinë. Zhvillim i skemave të menaxhimit për të reduktuar predatimin.

Referencat

BirdLife International 2016e





Tichodroma muraria Linnaeus, 1766

Zvarritësi krahëkuq

Aves: Passeriformes: Tichodromidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Rrezikuar, EN B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Taulant Bino, Qenan Maxhuni, Nexhmedin Ramadani

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e këtij lloji është 16·5–17 cm, kurse pesha 16·7–19·3 g. Ky lloj është shtegtar i distancave të shkurtra, kryesisht në aspektin longitudinal. Ushqehet me insekte, merimanga dhe parruazorë të tjerë (BirdLife International 2018b).

Habitati

Lloji i habitatit: 6. Zonat shkëmbore (p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore).
Ky lloj jeton në një sërë rajonesh shkëmbore, duke përfshirë shkëmbinjtë e pjerrët, të thyer, shpatet e shkëmbinjve dhe grykat e hijezuara në zonat malore, me vrima dhe çarje për fole dhe grumbullim. Për kërkim ushqimi janë të rëndësishme zonat e përziera me diell dhe hije. Në dimër, janë të parapëlqyera habitatet e ngjashme shkëmbore (BirdLife International 2018).

Përhapja e përgjithshme

Malet e Europës jugore dhe lindore (Spanja veriore dhe Franca jugore e lindore, përfshirë Korsikën në Itali, Ballkanin, Kaukazin, Turqinë jugore dhe lindore), në lindje deri në Iranin verior (Mali Elburz, mbase edhe Azerbajxhani dhe Mali Zagros). Nuk folezon në ultësira.

Përhapja në Kosovë

Prizren, Restelicë, Dy lokalitete në Pejë.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar si: I Rrezikuar, për shkak të zonës së vogël të pranisë ZP (< 500 km2). Numri i lokacioneve është ≤ 5. Zona e pranisë ZP dyshohet të jetë në rënie të mëtejme.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 4 Korridoret e transportit dhe shërbimit (4.1 Rrugët dhe hekurudhat); 6 Ndërhyrje dhe shqetësime njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloj i mbrojtur në Kosovë (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura). Disa pjesë të zonës së përhapjes së këtij lloji janë të caktuara si zonë e mbrojtur.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës, 1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve). 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës); 5 Ligji dhe politika (5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Zonat e rëndësishme të habitatit për këtë lloj duhet të identifikohen dhe të mbrohen nga zhvillimi dhe, po ashtu të kufizohet qarkullimi në këto zona.

Referencat

BirdLife International 2018b





Vanellus vanellus Linnaeus 1758

Gicvilja

Aves: Charadriiformes: Charadriidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Gati i Kërcënuar, NT

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Rrezikuar, EN B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Taulant Bino, Qenan Maxhuni.

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e këtij lloji është 28–31 cm, pesha 128–330 g, kurse hapja e krahëve 82–87 cm. Shumica e popullatave të këtij lloji janë shtegtare. Ushqehen me insekte të rendeve të ndryshme, si Ephemeroptera, Odonata, Lepidoptera etj. (BirdLife International 2017c).

Habitati

Lloji i habitatit: 4 Kullosa (4.4 Kullosa të klimës mesatare); 14 Artificiale/Tokësore (14.1. Toka të punueshme. 14.2. Livadhe).

Përhapja e përgjithshme

Europë, Turqi dhe veriperëndim i Iranit nëpërmjet Rusisë perëndimore dhe Kazakistanit drejt jugut dhe lindjes së Siberisë, Mongolisë dhe veriut të Kinës. Dimëron prej Europës perëndimore, ishujve të Atlantikut lindor dhe Afrikës veriore nëpërmjet pjesës mesdhetare të Lindjes së Mesme dhe Iranit, përgjatë Indisë veriore drejt Kinës juglindore, Koresë dhe Japonisë jugore.

Përhapja në Kosovë

Henc, Nosalje.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: I Rrezikuar, për shkak të zonës së pranisë ZP të kufizuar gjatë kohës së folezimit (= 8 km2). Numri i lokaliteteve të folezimit është ≤ 5. Zona e pranisë ZP dyshohet se është në rënie të mëtejme.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.2 Hapësirat komerciale dhe industriale); 6 Ndërhyrje dhe shqetësime njerëzore (6.3 Punë dhe aktivitete të tjera); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi/përdorimi i ujit: 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloj i mbrojtur në Kosovë (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. . Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës, 1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve). 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës); 5 Ligji dhe politika (5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Reduktim i presionit të gjuetisë në këtë lloj, krijim i fushatave vetëdijesuese me target gjuetinë. Zhvillim i skemave të menaxhimit për të reduktuar predatimin.

Referencat

BirdLife International 2017c





3.7 MAMMALIA

Capreolus capreolus Linnaeus, 1758

Kaprolli

Mammalia: Artiodactyla: Cervidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Rrezikuar, EN B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj

Të dhëna të përgjithshme

Gjatë stinës së verës ngjyra e trupit është e kuqërreme, kurse gjatë dimrit kafe e mbyllët apo e përhime. Gjatësia trupore sillet prej 0.9 – 1.3 m, lartësia trupore midis 66 – 88 cm dhe pesha trupore prej 15 – 35 kg. Mashkulli ka brirë me gjatësi prej 20 – 25 cm, të mbështjellë me një shtresë lëkurore, të cilët ndërrohen periodikisht. Është shtazë më shumë aktive natën se sa ditën. Nuk migron e as bie në letargji. Ushqehet me një numër të madh të llojeve bimore, gjethe, fara, fruta, bulëza, barishte etj. Është pre e ujkut, rrëqebullit, dhelprës, etj. Kaprolli jeton i vetmuar, por femra me pasardhësit jetojnë në grupe më të mëdha familjare ose më të vogla, në varshmëri edhe nga biotopi dhe dendësia e popullatës. Jetëgjatësia e këtij lloji është deri në 15 vjet (Danilkin 1996).

Habitati

Lloji i habitatit: 4 Pyje; 3. Shkurre; 4. Kullosa; 14. Artificiale/tokësore.
Mund të haset zakonisht në zonat pyjore të hapura gjetherënëse ose gjethembajtëse dhe me një vegjetacion të dendur bimor. Parapëlqen vende të pasura me kullosa, shkurre dhe sipërfaqe me kultura bujqësore.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Azi.

Përhapja në Kosovë

Shkrel, Malaj, Mushtisht, Bjeshkët e Junikut, Kaçandoll, Svilen, Llanisht, Nikoc, Jezerc, Vilan, Tunaj, Bjeshkët e Strellcit, Bjeshkët e Belegut, Kozhnjer.

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie
Trendi i nënpopullatave është i qëndrueshëm në nivel global, por në Kosovë është lloj në rënie dhe i kërcënuar për zhdukje.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: I Rrezikuar, për shkak të rënies së vazhdueshme të vëzhguar të popullatave të këtij lloji në të kaluarën, ku shkaktarët nuk kanë ndaluar ende, bazuar në vëzhgim direkt, rënie të cilësisë së habitateve të përshtatshme për llojin, si dhe për shkak të nivelit të eksploatimit. Gjithashtu, pritet një reduktim i nënpopullatave në vitet në vijim për shkak të trendeve të vazhdueshme që e kërcënojnë këtë lloj. Zona e pranisë ZP = 56 km2 dhe shtrirja e përhapjes SHP = 7157 km2.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 8 Lloje invazive dhe lloje të tjera problematike, gjene dhe sëmundje (8.1 Llojet jonative invazive/llojet / sëmundjet e huaja, 8.3 Materiale të futura gjenetike).
Faktorët kryesorë, që e kërcënojnë këtë lloj, janë: degradimi dhe shkatërrimi i habitatit, grabitja, gjuajtja dhe përndjekja nga njeriu për qëllime të ndryshme. Gjithashtu, ky lloj kërcënohet nga ujku, derri i egër, rrëqebulli, dhelpra, e sidomos të vegjlit janë pre e lehtë e tyre.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Me anë të vendimit të MMPH 04/03 të datës 23 maj 2003, neni 3 ky lloj është i mbrojtur me ligj, si lloj i rrallë dhe i rrezikuar.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Danilkin 1996





Rupicapra rupicapra Linnaeus, 1758

Dhia e egër

Mammalia: Artiodactyla: Bovidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

I Rrezikuar, EN A2acd+3cd

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj

Të dhëna të përgjithshme

Në Kosovë është i pranishëm nënlloji Rupicapra rupicapra balcanica Bolkay, 1925. Gjatësia trupore sillet prej 107 – 137 cm dhe lartësia trupore prej 70 – 80 cm. Të dy gjinitë i kanë brirët jo të gjatë dhe të lakuar, kurse te meshkujt janë më të trashë. Trupi ka ngjyrë kafe të gështenjtë gjatë pranverës dhe verës, kurse gjatë vjeshtës dhe dimrit më të mbyllët. Jetojnë në kope prej 15 – 30 e deri në 100 krerë, ndërsa meshkujt janë të prirë që të jetojnë të vetmuar, me përjashtim të kohës së aktivitetit seksual. Zakonisht, ushqehen me gjethe, bar, fruta dhe lule, kurse gjatë dimrit edhe me likene dhe myshqe, degë të imta të drunjve etj. (Nowak 1999). Janë kafshë shumë të shpejta dhe kanë thundra të posaçme, të cilat u mundësojnë përforcim për shkëmbinj, qofshin ata edhe të rrëshqitshëm.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4. Pyjet të klimës mesatare); 3. Shkurre (3.4 Shkurre të klimës mesatare); 4. Kullosa (4.4. Kullosa të klimës mesatare); 14. Artificiale/tokësore (14.2. Kullosa).

Haset në zonat malore shkëmbore në një lartësi mbidetare prej 500 deri në 3000 metra. Haset në zona të pasura me shumëllojshmëri habitatesh si: kullosa, livadhe, pyje të përziera dhe ato halore. Gjatë dimrit zbret në vende më të ulëta.

Përhapja e përgjithshme

Rupicapra rupicapra balcanica është endemik i Ballkanit: Bosnjë-Hercegovinë, Bullgari, Greqi, Kosovë, Kroaci, Maqedoni, Mali i Zi, Serbi, Sllloveni, Shqipëri.

Përhapja në Kosovë

Mushtisht, Bjeshkët e Junikut, Kozhnjer, Jabllanicë, Baballoq, Milishevc, Isniq.

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: I Rrezikuar, për shkak të rënies së vazhdueshme të vëzhguar të popullatave të këtij lloji në të kaluarën, ku shkaktarët nuk kanë ndaluar ende, bazuar në vëzhgim direkt, rënie të cilësisë së habitateve të përshtatshme për llojin, si dhe për shkak të nivelit të eksploatimit. Gjithashtu, pritet një reduktim i nënpopullatave në vitet në vijim, për shkak të trendeve të vazhdueshme që e kërcënojnë këtë lloj. Zona e pranisë ZP = 28 km2, shtrirja e përhapjes SHP = 1437 km2 dhe numri i lokacioneve është 7.



Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.1 Banimi dhe zonat urbane, 1.2 Hapësirat komerciale dhe industriale); 2 Bujqësia dhe akuakultura (2.1 Bimët vjetore dhe shumëvjeçare jodrusore, 2.3 Blegtoria dhe fermat); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.1 Gjuetia dhe mbledhja e kafshëve tokësore); 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 8 Llojet invazive dhe të tjera problematike, gjenet dhe sëmundjet (8.1 Llojet/sëmundjet invazive jonative / të huaja, 8.2 Llojet/sëmundjet vendore problematike; 8.3 Materiali gjenetik i futur, 8.4 Llojet problematike/sëmundjet me origjinë të panjohur, 8.5 Sëmundjet e shkaktuara virale).

Kërcënimet kryesore për këtë nënlloj janë: gjuetia ilegale, prerja e pyjeve si dhe degradimi i habitatit. Në disa vende në Ballkan rrezik paraqet edhe hibridizimi me nënlloje të tjera. Gjithashtu, urbanizimi dhe zgjerimi i vendbanimeve njerëzore është një nga rreziqet.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Nowak 1999



Libri i Kuq i Faunes se Kosoves | 1

LLOJET
E CENUARA
(VU)

4.1 GASTROPODA

Belgrandiella bumasta Schütt, 1960

Gastropoda: Littorinimorpha: Bythinellidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Cenuar, VU D2

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Zoltán Fehér

Të dhëna të përgjithshme

Guaska është e vogël (gjatësia 1.8-2.0 mm, gjerësia 1.0-1.2 mm), me ngjyrë kah e bardha, rrethore cilindrike, me maje të topitur. Apertura në formë trekëndëshi me maje të rrethuar (Schütt 1960).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. PVende ujore (kontinentale) (5.18. Sisteme ujore karstike dhe të tjera nëntokësore).
Është lloj nëntokësor. Gjendet në akuiferët karstikë dhe ujërat intersticiale të shtresës nëntokësore të rërës në burimet karstike.

Përhapja e përgjithshme

Kosovë

Përhapja në Kosovë

Rugovë

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Nuk ka të dhëna të mjaftueshme rreth trendit të popullatës së këtij lloji (Seddon 2011a).

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është i njohur vetëm nga Gryka e Rugovës në afërsi të Pejës. Për shkak të jetës së tij të fshehur është e pritshme se do të zbulohen në të ardhmen edhe nënpopullata dhe lokalitete të tjera të këtij lloji. Megjithatë, ky lloj ka një përhapje shumë të ngushtë, zona e pranisë ZP është më e vogël se 20 km2 dhe, me gjasë, numri i lokacioneve është më i vogël se 5. Për shkak të përhapjes së kufizuar dhe numrit të lokacioneve ky lloj vlerësohet si: I Cenuar.

Kërcënimet

Aktualisht nuk ka ndonjë kërcënim.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Popullata e njohur e këtij lloji është brenda zonës së mbrojtur.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1. Mbrojtja e lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lokalitetin/lokalitetet ku gjendet dhe për lloje të tjera.

Referencat

Schütt 1960; Seddon 2011a





Bythinella istoka Glöer & Pešić, 2014

Gastropoda: Littorinimorpha: Bythinellidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Cenuar, VU D2

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Zoltán Fehér

Të dhëna të përgjithshme

Guaska është e vogël (gjatësia 2.7-2.8 mm, gjerësia 1.5–1.6 mm), me ngjyrë kah e bardha, cilindrike, me majë të topitur dhe umbilikus të mbyllur. Sipërfaqja është e mëndafshtë dhe e shtresëzuar imët, apertura vezake, peristoma e trashur në kolumellë. Është lloj tipik i burimeve karstike (Glöer & Pešić 2014).

Habitati

Lloji i habitatit: 5.Vende ujore (kontinentale) (5.9. Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza, 5.18 Sisteme ujore karstike dhe të tjera nëntokësore).
Ky lloj është gjetur deri më tani në vetëm një burim karstik të vëllimit të lartë, ku u gjet se jeton në ujëra sipërfaqësore, bashkangjitur me zhavorr dhe gurë.

Përhapja e përgjithshme

Kosovë

Përhapja në Kosovë

Vrellë e Istogut.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për trendin e tanishëm të popullatës së këtij lloji.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është i njohur vetëm nga një burim i madh karstik në afërsi të Malit Mokna, në afërsi të Istogut. Bazuar në të dhënat e deritanishme, ai jeton në një zonë të pranisë ZP të ngushtë, që është më e vogël se 20 km2 dhe, me gjasë, edhe numri i lokacioneve është më i vogël se 5. Për shkak të përhapjes së kufizuar dhe numrit të lokacioneve, ky lloj është vlerësuar si: I Cenuar.

Kërcënimet

Aktualisht nuk ka ndonjë kërcënim.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1. Mbrojtja e lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lokalitetin/lokalitetet ku gjendet dhe për lloje të tjera.

Referencat

Glöer & Pešić 2014





Iglica illyrica Schütt, 1975

Gastropoda: Littorinimorpha: Moitessieriidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Cenuar, VU D2

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Zoltán Fehér

Të dhëna të përgjithshme

Guaska është shumë e vogël (gjatësia 1.5-1.7 mm, pesha 0.5-0.6 mm), forma turriforme, me mure të holla, me ngjyrë të bardhë transparente dhe me aperturë relativisht të vogël ovoide (Grego *et al.* 2017; Schütt 1975).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.18 Sisteme ujore karstike dhe të tjera nëntokësore).
I banon akuiferët karstikë dhe ujërat intersticiale të shtresës nëntokësore të rërës në burimet karstike.

Përhapja e përgjithshme

Kosovë, Mali i Zi.

Përhapja në Kosovë

Drini i Bardhë në Radavc, Mitrovicë, Deçan.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është i njohur vetëm nga 4 lokacione, 3 nga të cilat gjenden në Kosovë (Seddon 2011d). Prania e llojit në lokalitetin tipor është konfirmuar tash vonë (Grego *et al.* 2017). Në Deçan, ku është gjetur për herë të parë në vitin 2014, gjatë vitit 2016 nuk ka mundur të gjendet, sepse mbeturinat organike janë shpërlarë nga sipërfaqja e gurëve nga përmbytjet. Megjithëkëtë, lloji supozohet se është akoma i pranishëm në ujërat nëntokësore dhe në instalacionet e afërta të ujit (Grego *et al.* 2017). Për shkak të jetës së fshehur të llojit, është e mundshme që në të ardhmen të zbulohen nënpopullata/lokalitete të tjera. Megjithatë, ky është një lloj i rrallë, zona e pranisë ZP është më e vogël se 20 km2 dhe, me gjasë, numri i lokacioneve është më i vogël se 5. Për shkak të përhapjes së kufizuar dhe numrit të lokacioneve, ky lloj vlerësohet si: I Cenuar.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial; 6 Ndërhyrjet njerëzore dhe shqetësimet (6.3 Punë dhe aktivitete të tjera); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi/përdorimi i ujit: 7.2.7 Eksploatimi i ujit nëntokësor (përdorimi në bujqësi)).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1. Mbrojtja e lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lokalitetin/lokalitetet ku gjendet dhe për lloje të tjera.

Referencat

Grego *et al.* 2017; Seddon 2011d; Schütt 1975





Monachoides kosovoensis De Winter & Maassen, 1992

Gastropoda: Stylommatophora: Hygromiidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Gati i Kërcënuar, NT

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Cenuar, VU D2

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Zoltán Fehér

Të dhëna të përgjithshme

Guaska është e nënrrumbullakët me ngjyrë të çelët kafe, në sutura më e çelët, me një shirit të lehtë në periferi, e shtresuar në mënyrë të parregullt dhe me granula të imta, me 5-6 përdredhje, në periferi lehtas këndore apo rrethore, përdredhja e fundit lehtas në rënie përpara aperturës, apertura e ka buzën e brendshme, margjina reflekton në anën bazore dhe anësore të kolumellës, umbilikusi është i gjerë dhe i thellë, sa 1/5 e diametrit. Gjatësia e guaskës është 7-9 mm, kurse gjerësia 10-14 mm. Ky lloj jeton në drunj që janë në kalbje e sipër apo midis gjetheve në shpërbërje (De Winter and Maassen 1992; Fehér 2011b).

Habitati

Lloji i habitatit: 1 Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare).
Ky është një lloj silvikol, që preferon pyjet e pishës apo ato të përziera, të pishës dhe ahut.

Përhapja e përgjithshme

Kosovë

Përhapja në Kosovë

Çakorr.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është endemik i Çakorrit, në zonën ndërkufitare Kosovë-Mali i Zi. Edhe pse e tërë kjo zonë nuk është e hulumtuar mirë, supozohet se ky lloj ka një përhapje shumë të ngushtë. Një kërcënim potencial për llojin paraqet shpyllëzimi. Duke e konsideruar zonën e pranisë ZP shumë të ngushtë (më të vogël se 20 km2), si dhe ndjeshmërinë potenciale të habitatit, ky lloj vlerësohet si: I Cenuar, në nivel vendi.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i resurseve biologjike (5.3. Prerja dhe vjelja e pyjeve).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lokaliteti ku është gjetur lloji është në kuadër të zonës së mbrojtur.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. . Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Sipas njohurive tona të tanishme, kushtet e habitatit luajnë një rol kyç në ruajtjen e këtij lloji dhe nëse nuk ndryshojnë, mbijetesa e llojit duket e garantuar. Në të njëjtën kohë, prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lokalitetin/lokalitetet ku gjendet dhe për lloje të tjera.

Referencat

De Winter and Maassen 1992; Fehér 2011b





Montenegrina sporadica H. Nordsieck, 1974

Gastropoda: Stylommatophora: Clausiliidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Cenuar, VU D2

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Zoltán Fehér

Të dhëna të përgjithshme

Guaska e këtij lloji është fusiforme dhe lehtësisht brinore. Përdredhjet e poshtme janë të lëmuara, kurse ato të epërmet të lëmuara dhe me rrudha të lehta. Qafa është e shtresuar dhe e përdredhur përbrenda. Kreshtat bazale dhe periferike janë të dobëta. Peristoma është e ngjitur, ovoide deri në diçka këndore, me margjina lehtas të fryra. Gjatësia e guaskës është 15 mm, kurse gjerësia 3.2-3.7 mm. Ky është një lloj i obligueshëm shkëmbor, i lidhur me zona gëlqerore. Zakonisht mund të gjendet në sipërfaqe të hapura të shkëmbinjve ose në bazën e tyre (Fehér and Szekeres 2016; Fehér 2017; Nordsieck 1974).

Habitati

Lloji i habitatit: 6 Zona shkëmbore [p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore].
Ky lloj banon në habitatet e shkëmbinjve gëlqerorë dhe gjendet në çarje ose midis dhe nën gurë. Habitatet e përshtatshme përfshijnë shkëmbinjtë e vegjël deri të mëdhenj, grykat dhe pyjet shkëmbore.

Përhapja e përgjithshme

Kosovë, Shqipëri. Lloji nominal është i njohur vetëm nga Kosova.

Përhapja në Kosovë

Deçan.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Megjithëse pak dihet rreth trendit të tanishëm të popullatës, nuk ka arsye të supozojmë ndonjë luhatje ekstreme ose rënie të numrit të individëve maturë, sepse habitati gëlqeror, ku ndodhen këto kafshë, është relativisht pak i kërcënuar nga aktiviteti njerëzor.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është i njohur vetëm nga dy zona në Bjeshkët e Nemuna: fusha e Lumbardhit të Pejës në Kosovë dhe gryka e Lumit Tropoja në Shqipëri. Gjendet në një zonë të ngushtë të përhapjes, zona e pranisë ZP është më e vogël se 20 km2 dhe, me gjasë, numri i lokacioneve/nënpopullatave në Kosovë është 1. Në anën tjetër, ky lloj gjendet brenda një zone të mbrojtur dhe duke qenë kafshë që jeton në shkëmbinj, nuk ka arsye të supozohet se popullatat apo cilësia e habitatit do të pësojnë rënie dhe luhatje ekstreme. Për shkak të përhapjes së kufizuar dhe numrit të nënpopullatave, ky lloj vlerësohet si: I Cenuar.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.3. Modifikime të tjera të ekosistemit).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Popullata e njohur gjendet brenda zonës së mbrojtur.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Sipas njohurive tona të tanishme, kushtet e habitatit luajnë një rol kyç në ruajtjen e këtij lloji dhe nëse nuk ndryshojnë, mbijetesa e llojit duket e garantuar. Në të njëjtën kohë, prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lokalitetin/lokalitetet ku gjendet dhe për lloje të tjera.

Referencat

Fehér and Szekeres 2016; Fehér 2017; Nordsieck 1974





Plagigeyeria gladilini Kuščer, 1937

Gastropoda: Littorinimorpha: Hydrobiidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
I Cenuar, VU

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Cenuar, VU D2

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Zoltán Fehér

Të dhëna të përgjithshme

Guaska është konike (gjatësia 2.5-3.5 mm, gjerësia 1.7-2.0 mm), me ngjyrë kah e bardha e tejdukshme, me dredha konvekse. Apertura është ovoide, peristoma zgjerohet në mënyrë të barabartë (Grego *et al.* 2017; Kuščer 1937).

Habitati

Lloji i habitatit: 5 Vende ujore (kontinentale) (5.18 Sisteme ujore karstike dhe të tjera nëntokësore).
Është lloj nëntokësor. I banon akuiferët karstikë dhe ujërat intersticiale të shtresës nëntokësore të rërës në burimet karstike.

Përhapja e përgjithshme

Kosovë

Përhapja në Kosovë

Drini i Bardhë në Radavc.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për trendin e tanishëm të popullatës së këtij lloji.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është i njohur vetëm nga burimi i Drinit të Bardhë, afër Pejës. Ky lloj ka një përhapje të kufizuar, zona e pranisë ZP është më e vogël se 20 km2 dhe, me gjasë, numri i nënpopullatave është më i vogël se 5 (Georgiev 2010). Për këtë arsye ky lloj vlerësohet si: I Cenuar.

Kërcënimet

Nuk ka ndonjë rrezik aktualisht.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës)
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lokalitetin/lokalitetet ku gjendet dhe për lloje të tjera.

Referencat

Georgiev 2010; Grego *et al.* 2017; Kuščer 1937





Strigilodelima pentheri A.J. Wagner, 1919

Gastropoda: Stylommatophora: Clausiliidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Gati i Kërcënuar, NT

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Cenuar, VU D2

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Zoltán Fehér

Të dhëna të përgjithshme

Guaska është fusiforme, me ngjyrë të kuqe në të kaftë dhe shpesh me shtresa ngjyrë hiri, në mënyrë të rregullt dhe të shpeshtë e brirëzuar me 9-11 përdredhje. Cerviksi zakonisht rrethor, peristoma e pangjitur dhe gjerësisht e reflektueshme. Gjatësia e guaskës është 14 – 18 mm kurse gjerësia 3.3 – 3.7 mm. Edhe pse ky lloj nuk gjendet domosdoshmërish në shkëmbinj, ai kryesisht është i lidhur me zona gëlqerore, ku zakonisht gjendet nën gurë apo në bazën e shkëmbinjve (Wagner 1919b).

Habitati

Lloji i habitatit: 6 Zona shkëmbore [p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore].
Ky lloj banon në habitatet e shkëmbinjve gëlqerorë, dhe gjendet në çarje ose midis gurëve dhe nën gurë. Habitatet e përshtatshme përfshijnë shkëmbinj të vegjël deri të mëdhenj, gryka dhe pyje shkëmbore (Reischütz 2017d).

Përhapja e përgjithshme

Kosovë, Shqipëri.

Përhapja në Kosovë

Pashtrik.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Megjithëse ka pak të dhëna rreth trendit të tanishëm të popullatës, nuk ka arsye të supozojmë ndonjë luhatje ekstreme ose rënie të numrit të individëve maturë, sepse habitati gëlqeror, ku ndodhen këto kafshë, është relativisht pak i kërcënuar nga aktiviteti njerëzor.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky është një lloj endemik i Pashtrikut në Kosovë dhe Shqipëri. Me gjasë, më pak se 50% e popullatës globale jeton në Kosovë. Zona e pranisë ZP është nën 20 km2 dhe numri i njohur i lokacioneve/nënpopullatave është më pak se 5, e kjo paraqet kërcënim real për këtë lloj. Prandaj, ky lloj vlerësohet si: I Cenuar, në nivel vendi.

Kërcënimet

Nuk ka ndonjë rrezik aktualisht.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Sipas njohurive tona të tanishme, kushtet e habitatit luajnë një rol kyç në ruajtjen e këtij lloji dhe nëse nuk ndryshojnë, mbijetesa e llojit duket e garantuar. Në të njëjtën kohë, prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lokalitetin/lokalitetet ku gjendet dhe për lloje të tjera.

Referencat

Reischütz 2017d; Wagner 1919b





Plagigeyeria gladilini Kuščer, 1937

Gastropoda: Littorinimorpha: Hydrobiidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
I Cenuar, VU

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Cenuar, VU D2

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Zoltán Fehér

Të dhëna të përgjithshme

Guaska është konike (gjatësia 2.5-3.5 mm, gjerësia 1.7-2.0 mm), me ngjyrë kah e bardha e tejdukshme, me dredha konvekse. Apertura është ovoide, peristoma zgjerohet në mënyrë të barabartë (Grego *et al.* 2017; Kuščer 1937).

Habitati

Lloji i habitatit: 5 Vende ujore (kontinentale) (5.18 Sisteme ujore karstike dhe të tjera nëntokësore).
Është lloj nëntokësor. I banon akuiferët karstikë dhe ujërat intersticiale të shtresës nëntokësore të rërës në burimet karstike.

Përhapja e përgjithshme

Kosovë

Përhapja në Kosovë

Drini i Bardhë në Radavc.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për trendin e tanishëm të popullatës së këtij lloji.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është i njohur vetëm nga burimi i Drinit të Bardhë, afër Pejës. Ky lloj ka një përhapje të kufizuar, zona e pranisë ZP është më e vogël se 20 km2 dhe, me gjasë, numri i nënpopullatave është më i vogël se 5 (Georgiev 2010). Për këtë arsye ky lloj vlerësohet si: I Cenuar.

Kërcënimet

Nuk ka ndonjë rrezik aktualisht.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës)
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lokalitetin/lokalitetet ku gjendet dhe për lloje të tjera.

Referencat

Georgiev 2010; Grego *et al.* 2017; Kuščer 1937





Strigilodelima pentheri A.J. Wagner, 1919

Gastropoda: Stylommatophora: Clausiliidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Gati i Kërcënuar, NT

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Cenuar, VU D2

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Zoltán Fehér

Të dhëna të përgjithshme

Guaska është fusiforme, me ngjyrë të kuqe në të kaftë dhe shpesh me shtresa ngjyrë hiri, në mënyrë të rregullt dhe të shpeshtë e brirëzuar me 9-11 përdredhje. Cerviksi zakonisht rrethor, peristoma e pangjitur dhe gjerësisht e reflektueshme. Gjatësia e guaskës është 14 – 18 mm kurse gjerësia 3.3 – 3.7 mm. Edhe pse ky lloj nuk gjendet domosdoshmërish në shkëmbinj, ai kryesisht është i lidhur me zona gëlqerore, ku zakonisht gjendet nën gurë apo në bazën e shkëmbinjve (Wagner 1919b).

Habitati

Lloji i habitatit: 6 Zona shkëmbore [p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore].
Ky lloj banon në habitatet e shkëmbinjve gëlqerorë, dhe gjendet në çarje ose midis gurëve dhe nën gurë. Habitatet e përshtatshme përfshijnë shkëmbinj të vegjël deri të mëdhenj, gryka dhe pyje shkëmbore (Reischütz 2017d).

Përhapja e përgjithshme

Kosovë, Shqipëri.

Përhapja në Kosovë

Pashtrik.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Megjithëse ka pak të dhëna rreth trendit të tanishëm të popullatës, nuk ka arsye të supozojmë ndonjë luhatje ekstreme ose rënie të numrit të individëve maturë, sepse habitati gëlqeror, ku ndodhen këto kafshë, është relativisht pak i kërcënuar nga aktiviteti njerëzor.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky është një lloj endemik i Pashtrikut në Kosovë dhe Shqipëri. Me gjasë, më pak se 50% e popullatës globale jeton në Kosovë. Zona e pranisë ZP është nën 20 km2 dhe numri i njohur i lokacioneve/nënpopullatave është më pak se 5, e kjo paraqet kërcënim real për këtë lloj. Prandaj, ky lloj vlerësohet si: I Cenuar, në nivel vendi.

Kërcënimet

Nuk ka ndonjë rrezik aktualisht.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Sipas njohurive tona të tanishme, kushtet e habitatit luajnë një rol kyç në ruajtjen e këtij lloji dhe nëse nuk ndryshojnë, mbijetesa e llojit duket e garantuar. Në të njëjtën kohë, prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lokalitetin/lokalitetet ku gjendet dhe për lloje të tjera.

Referencat

Reischütz 2017d; Wagner 1919b





Terranigra kosovica Radoman, 1978

Gastropoda: Littorinimorpha: Hydrobiidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Gati i Kërcënuar, NT

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Cenuar, VU D2

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Zoltán Fehér

Të dhëna të përgjithshme

Guaska është e vogël (gjatësia 1.6-2.2 mm, gjerësia 0.8-1.1 mm), e pangjyrë, forma ovoide-cilindrike me maje të shtypur dhe dredha lehtas të fryra. Apertura është ovoide, rrethore në maje, peristoma e hollë, dhe umbilikusi në formë të prerë apo i mbyllur (Radoman 1978).

Habitati

Lloji i habitatit: 5 Vende ujore (kontinentale) (5.18. Sisteme ujore karstike dhe të tjera nëntokësore).
Është lloj nëntokësor (Radoman 1983). I banon akuiferët karstikë dhe ujërat intersticiale të shtresës nëntokësore të rërës në burimet karstike.

Përhapja e përgjithshme

Kosovë

Përhapja në Kosovë

Dy lokalitete në Nerodime të Epërme, Pridvoricë, Caralevë.

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie
Ky lloj nuk është gjetur gjatë hulumtimit të vitit 2018 në të paktën 2 nga 4 lokalitetet e njohura nga literatura. Kjo, nuk do të thotë patjetër se këto nënpopullata janë zhdukur, por është një indikator për rënie të nënpopullatave të këtij lloji.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është i njohur nga vetëm 4 lokacione në Kosovë, por në të ardhmen, me gjasë, do të gjenden nënpopullata të tjera (Seddon 2011c). Sidoqoftë, gjatë hulumtimit në teren, në 2 nga 4 lokalitetet e njohura më parë, ky lloj nuk është gjetur. Kjo nënkupton rënie të numrit të nënpopullatave, edhe pse për shkak të jetës së fshehur, lloji vështirë mblidhet, kështu që do të ishte shumë herët të supozohet se gjysma e nënpopullatave është zhdukur.

Sidoqoftë, është një lloj i rrallë, zona e pranisë ZP është më e vogël se 20 km2 dhe, me gjasë, numri i lokacioneve/nënpopullatave është më i vogël se 5. Për më tepër, mund të supozohet se trendi i popullatës dhe numri i lokacioneve është në rënie, si rezultat i aktiviteteve të ndërlidhura me habitatet e këtij lloji. Rrjedhimisht, lloji është vlerësuar si: I Cenuar.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial; 6 Ndërhyrjet njerëzore dhe shqetësimet (6.3 Punë dhe aktivitete të tjera); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi/përdorimi i ujit: 7.2.7 Eksploatimi i ujit nëntokësor (përdorimi në bujqësi)).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lokalitetin/lokalitetet ku gjendet dhe për lloje të tjera.

Referencat

Radoman 1978; Radoman 1983; Seddon 2011c





Triloba sandrii, Küster, 1847

Gastropoda: Stylommatophora: Clausiliidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Cenuar, VU D2

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Zoltán Fehér

Të dhëna të përgjithshme

Guaska është e fortë fusiforme, me mure të trasha, me ngjyrë të kuqe në të kaftë, dendësisht e shtresuar në përdredhjet e epërme, kurse e lëmuar në përdredhjet e poshtme, margjinat e aperturës të lidhura me kallus në anën parietale. Gjatësia e guaskës është 22- 27 mm, kurse gjerësia 5.5 – 7 mm (Nordsieck 1972).

Habitati

Lloji i habitatit: 1 . Pyje (1.4 Pyje të klimës mesatare); 5. Vende ujore (kontinentale) (5.1. Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat]).
Ky lloj preferon pyjet e paprekura të ahut dhe mund të gjendet në drunj, që janë në shpërbërje e sipër (Dedov 2017b). Rrallë herë ndodhet përgjatë lumenjve të vegjël, ku haset në mjedise jashtëzakonisht të lagështa midis biméve barishtore dhe nën mbeturinat e gjetheve në anën lumore.

Përhapja e përgjithshme

Kosovë (prania duhet konfirmuar), Maqedoni, Shqipëri.

Përhapja në Kosovë

Pashtrik.

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie
Për shkak të aktiviteteve të shpeshta të prerjes së pyjeve (kryesisht në Shqipëri), brenda arealit të llojit, zona dhe cilësia e tipit të habitatit të përshtatshëm për llojin po zvogëlohet. Mund të supozohet se nënpopullatat më të vogla janë zhdukur në të kaluarën e afërt.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj gjendet në pjesën qendrore të Shqipërisë dhe në pjesën perëndimore të Maqedonisë, duke mbërritur pjesën veriore të përhapjes në Pashtrik. Zona e pranisë ZP në Kosovë është më e vogël se 20 km2 dhe, me gjasë, numri i lokacioneve është më i vogël se 5.

Për më tepër, ky lloj është i lidhur me pyje ahu të pacenuara ku jeton në drunjtë që janë në shpërbërje e sipër, habitat ky i cili është në rënie e sipër edhe në gjerësi, por edhe në kualitet përgjatë tërë rajonit. Prandaj, ky lloj vlerësohet si: I Cenuar, në nivel vendi.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i resurseve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lokalitetin/lokalitetet ku gjendet dhe për lloje të tjera.

Referencat

Dedov 2017b; Nordsieck 1972





Vertigo moulinsiana Dupuy, 1849

Gastropoda: Stylommatophora: Vertiginidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Gati i Kërcënuar, NT

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Cenuar, VU D2

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Zoltán Fehér

Të dhëna të përgjithshme

Guaska e këtij lloji ka formë vezake, me ngjyrë të verdhë ose të kuqe, e tejdukshme, e shkëlqyeshme dhe gati e lëmuar, me 3.5 deri 4.5 përdredhje konvekse, e fundit nga to është shumë e madhe, gati sa 2/3 e gjatësisë totale. Apertura është me 4 shtresime të ngushta, peristoma e mprehtë, lehtas e reflektuar dhe zakonisht e lidhur me një kallus të dobët parietal. Madhësia e guaskës është 2.25 – 2.75 mm, kurse gjerësia 1.3 -1.65 mm. Ky lloj preferon habitate të lagështa, përkohësisht të mbuluara nga uji. Vështirë e toleron çfarëdo çrregullimi të shkaktuar nga njeriu, kullotjen dhe vjeljen e kullosave. Është një lloj indikator i Natura 2000.

Habitati

Lloji i habitatit: 5 . Vende ujore (kontinentale) [5.4 Moçale, këneta, moçalishte [përgjithësisht mbi 8 ha], 5.6 Liqene të ujërave të ëmbla sezonale/të përhershme [mbi 8 ha], 5.7 Këneta/basene të përhershme të ujërave të ëmbla [përafërsisht 8 ha], 5.8 Këneta/basene të përkohshme të ujërave të ëmbla [nën 8 ha]].

Përhapja e përgjithshme

Lloj europian. Nga Irlanda deri në Rusi dhe Afrikë veriore, por popullatat kryesore janë në Europën perëndimore dhe qendrore. Ka vetëm disa gjetje të njohura nga Europa jugore dhe Afrika veriore. Kufiri jugor i përhapjes së llojit nuk është mirë i njohur (Seddon and Holyoak 1993; Welter-Schultes 2012).

Përhapja në Kosovë

Drajkoc. Nënpopullata e parë e njohur është gjetur tash vonë (Killien *et al.* 2012).

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie
Ka dëshmi për rënie të madhësisë së popullatës së këtij lloji, numrit të nënpopullatave dhe kualitetit të habitatit në shumë vende europiane.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky është një lloj gjerësisht i përhapur, por i lidhur me llojet e habitateve që janë të rrezikuara shumë në të gjithë vargun e përhapjes së llojit.

Në të kaluarën është vërejtur një rënie në madhësinë e popullatës së këtij lloji, ku këta shkaktarë mund të mos kenë pushuar ende, bazuar në vëzhgim direkt dhe rënie të cilësisë së habitatit të parapëlqyer për këtë lloj. Për më tepër, Kosova është në periferi të arealit ku mund të supozohet përhapje shumë e fragmentuar (deri tani vetëm 1 nënpopullatë është e njohur, pra zona e pranisë ZP është nën 20 km2), e kjo paraqet kërcënim serioz për llojin. Duke marrë parasysh të gjitha këto, lloji vlerësohet si: I Cenuar, në nivel vendi

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1. Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.1 Banesat dhe zonat urbane, 1.2 Hapësirat komerciale dhe industriale, 1.3 Hapësirat turistike dhe rekreative); 2. Bujqësia dhe akuakultura (2.1 Kulturat vjetore dhe shumëvjeçare jodrusore, 2.2. Plantacionet e drurit dhe pulpës, 2.3 Blegtoria dhe fermat); 6. Ndërhyrjet njerëzore dhe shqetësimet (6.1. Aktivitetet rekreative, 6.3. Punë dhe aktivitete të tjera); 7. Modifikimet e sistemeve natyrore (7.3. Modifikime të tjera të ekosistemit); 11. Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës)
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lokalitetin/lokalitetet ku gjendet dhe për lloje të tjera.

Referencat

Killien *et al.* 2012; Seddon and Holyoak 1993; Welter-Schultes 2012





Libri i Kuq i Faunes se Kosoves | 1

4.2 MALACOSTRACA

Alpioniscus metohicus Pljakic, 1971

Malacostraca: Isopoda: Trichoniscidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Cenuar, VU D2

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Lucija Šerić Jelaska

Të dhëna të përgjithshme

Është lloj endemik me përhapje të ngushtë. Gjatësia e trupit të mashkullit varion prej 4.6 deri në 7.5 mm, kurse femrat janë pak më të mëdha, prej 5.5 deri në 7.7 mm. Ngjyrat e trupit është e bardhë pa pigment okular (Pljakić 1971).

Habitati

Lloji i habitatit: 7. Shpella dhe habitate nëntokësore (joujore) (7.1 Shpella, 7.2. Habitate të tjera nëntokësore).

Përhapja e përgjithshme

Kosovë.

Përhapja në Kosovë

Shpella e Radavcit (Ćurčić & Decu 2008; Pljakić 1971; Schmalfuss 2003).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky është një lloj endemik. Përhapja e tij është kufizuar në vetëm një shpellë, në Radavc. Është vlerësuar në kategorinë: I Cenuar, për arsye se popullata e këtij lloji ka një zonë të pranisë shumë të kufizuar (ZP = më pak se 20 km2) dhe numri i lokacioneve është më i vogël se 5. Popullatat e këtij lloji janë shumë të ndjeshme ndaj luhatjeve të temperaturës apo lagështisë. Çfarëdo shqetësimi i habitatit (shpellës) mund të çojë në humbje drastike të popullatës.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 6. Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); Modifikimet e sistemeve natyrore (7.3 Modifikimet e tjera të ekosistemit).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Habitati i llojit është i mbrojtur (Mbrojtje permanente, 987.66) dhe i klasifikuar si Monument natyre në Kosovë; Institucioni RCCH-Pejë.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës / ujit (1.1 Mbrojtja e arealit / zonës). 2. Menaxhimi i tokës / ujit (2.1 Menaxhimi i arealit / zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Në rastet e përdorimit turistik të shpellës, duhet siguruar se intervenimet dhe përdorimi i shpellës nuk çojnë në ndryshimin e mikroklimës.

Referencat

Ćurčić & Decu 2008; Pljakić 1971; Schmalfuss 2003



4.3 DIPLOPODA

Brachydesmus jalzici Mrsic, 1988

Diplopoda: Polydesmida: Polydesmidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Cenuar, VU D2

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Lucija Šerić Jelaska

Të dhëna të përgjithshme

Ky është një lloj endemik me lokalitetin tipor në Kosovë. I takon grupit vermosanus, i cili ka disa lloje endemike në rajonin karstik dinarik të Ballkanit. I ka dy procese femorale dhe një endomerit të ndarë. Gjatësia trupore është prej 10-12.5 mm, me 19 segmente trupore (Antić *et al.* 2013; Makarov *et al.* 2004; Mršić 1985; Strasser 2017).

Habitati

Lloji i habitatit: 7. Shpella dhe habitate nëntokësore (joujore) (7.1 Shpella, 7.2. Habitate të tjera nëntokësore).

Përhapja e përgjithshme

Kosovë.

Përhapja në Kosovë

Shpella e Dushit në Klinë (Mršić 1985, 1988).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky është një lloj endemik. Është vlerësuar në kategorinë: I Cenuar, për arsye se popullata e këtij lloji ka një zonë të pranisë ZP shumë të kufizuar, që është më e vogël se 20 km2, numri i lokaliteteve është më pak se 5 dhe është shumë i ndjeshëm ndaj luhatjeve të temperaturës apo lagështisë. Çfarëdo shqetësimi i habitatit (shpellës) mund të çojë në humbje drastike të popullatës.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 6. Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.3 Modifikimet e tjera të ekosistemit).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ka ndonjë masë ekzistuese mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës). 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Në rastet e përdorimit turistik të shpellës duhet siguruar se intervenimet dhe përdorimi i shpellës nuk çojnë në ndryshimin e mikroklimës.

Referencat

Antić *et al.* 2013; Makarov *et al.* 2004; Mršić 1985; Mršić 1988; Strasser 2017





Brachydesmus ljubetensis Attems, 1912

Diplopoda: Polydesmida: Polydesmidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

I Cenuar, VU D2

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Lucija Šerić Jelaska

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj i takon grupit ljubetensis, në të cilin fusha e setave gonopodale është e vendosur medialisht në anën kaudale, në kufi midis prefemurit dhe femurit (Antić *et al.* 2013).

Habitati

Lloji i habitatit: 7. . Shpella dhe habitate nëntokësore (joujore) (7.1 Shpella, 7.2. Habitate të tjera nëntokësore).

Përhapja e përgjithshme

Kosovë, Maqedoni.

Përhapja në Kosovë

Luboten, Kaçanik (Attems 1929; Makarov *et al.* 2004; Strasser 1971).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky është një lloj endemik. Është vlerësuar në kategorinë: I Cenuar, për arsye se popullata e këtij lloji ka një zonë të pranisë ZP shumë të kufizuar (më e vogël se 20 km2), numri i lokacioneve është më pak se 5 dhe është shumë i ndjeshëm ndaj luhatjeve të temperaturës apo lagështisë. Çfarëdo shqetësimi i habitatit (shpellës) mund të çojë në humbje drastike të popullatës.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 6. Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.3 Modifikimet e tjera të ekosistemit).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ka ndonjë masë ekzistuese mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës). 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Në rastet e përdorimit turistik të shpellës duhet siguruar se intervenimet dhe përdorimi i shpellës nuk çojnë në ndryshimin e mikroklimës.

Referencat

Antić *et al.* 2013; Attems 1929; Makarov *et al.* 2004; Strasser 1971



Polydesmus undeviginti Strasser, 1971

Diplopoda: Polydesmida: Polydesmidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

I Cenuar, VU D2

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Lucija Šerić Jelaska

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj është gjetur në afërsi të burimit të Drinit të Bardhë (Makarov *et al.* 2004; Mršić 1985) dhe në shpellën e Radavcit në afërsi të Pejës (Stasser 1971a).

Habitati

Lloji i habitatit: 7. Pyje (1.4. Pyjet të klimës mesatare); 5. Vende ujore (kontinentale) (5.1. Lumenj, përrenj, përroska të përhershme (përfshirë ujëvara); 7. Shpella dhe habitate nëntokësore (joujore) (7.1 Shpella, 7.2. Habitate të tjera nëntokësore).
Ky lloj kryesisht ndodhet në pyje ahu dhe në shpella e habitate të tjera nëntokësore (Attems 1929).

Përhapja e përgjithshme

Kosovë.

Përhapja në Kosovë

Burimi i Drinit të Bardhë, Shpella e Radavcit (Makarov *et al.* 2004; Mršić 1985; Strasser 1971a).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky është një lloj endemik. Është vlerësuar në kategorinë: I Cenuar, për arsye se popullata e këtij lloji ka një zonë të pranisë ZP shumë të kufizuar, e kjo është më e vogël se 20 km2, numri i lokacioneve është më pak se 5 dhe është shumë i ndjeshëm ndaj luhatjeve të temperaturës apo lagështisë. Çfarëdo shqetësimi i habitatit (shpellës) mund të çojë në humbje drastike të popullatës.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 6. Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7. Modifikimet e sistemeve natyrore (7.3 Modifikimet e tjera të ekosistemit).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Habitati i llojit është i mbrojtur (Mbrojtje permanente, 987.66) dhe i klasifikuar si Monument natyre në Kosovë; Institucioni RCCH-Pejë.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës). 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Në rastet e vlerësimit turistik të shpellës, duhet siguruar se intervenimet dhe përdorimi i shpellës nuk çojnë në ndryshimin e mikroklimës.

Referencat

Makarov *et al.* 2004; Mršić 1985; Strasser 1971a



4.4 INSECTA

Deltomerus (Deltomerus) nopcsai Csiki, 1940

Insecta: Coleoptera: Carabidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Cenuar, VU D2

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Gabor Mesaroš

Të dhëna të përgjithshme

Lloj me madhësi mesatare (9-12 mm). Është lloj predator, që aktivisht e kërkon prenë edhe si adult, por edhe si larvë. Me gjasë, është lloj nokturn.

Habitati

Lloji i habitatit: 4. Kullosa (4.4 Kullosa të klimës mesatare); 6 Zona shkëmbore (p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore].
Jeton në habitate subalpine dhe alpine mbi nivelin e drunjve.

Përhapja e përgjithshme

Kosovë.

Përhapja në Kosovë

Koprivnik (Csiki 1940).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është regjistruar në habitate alpine vetëm në majat më të larta në malet e Koprivnikut dhe paraqet lloj stenoendemik për Kosovën. Ky lloj vlerësohet si: I Cenuar, për shkak të zonës së pranisë ZP, që është më pak se 2000 km2, numrit të lokacioneve, që është ≤ 10, si dhe rënies së vazhdueshme të pritur të popullatës, bazuar në cilësinë e habitatit dhe numrin e lokacioneve. Këto zona janë të përshtatshme për zhvillimin e turizmit, si p.sh., për sportet e dimrit dhe prandaj, ekziston rreziku i shkatërrimit të tyre.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit]; 6 Ndërhyrjet njerëzore dhe shqetësimet (6.1 Aktivitetet rekreative].

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. . Mbrojtja e tokës / ujit (1.1 Mbrojtja e arealit / zonës].
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia]; 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit].
Kontrolli i zhvillimit dhe ndërtimit të infrastrukturës turistike.

Referencat

Csiki 1940



Pavicevicia comottiorum Giachino, 2006

Insecta: Coleoptera: Leiodidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

I Cenuar, VU D2

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Gabor Mesaroš

Të dhëna të përgjithshme

Është lloj me madhësi shumë të vogël (2-2.7 mm). Jeton në mjedise nëntokësore, duke u ushqyer me mbetje të trupave të kafshëve të tjera. Trupi është i përshtatur mirë për të jetuar në mjedise nëntokësore: mungesë e tërësishme e syve, antena shumë mirë të zhvilluara dhe mungesë e pigmentimit të trupit (ngjyra e kitinës është bojëkafe e çelët).

Habitati

Lloji i habitatit: 5 Vende ujore (kontinentale) (5.18 Sisteme karstike dhe të tjera hidrologjike nëntokësore [kontinentale]); 7 Shpella dhe habitate nëntokësore (joujore) (7.1 Shpella).
Jeton në shpella dhe kavitete të tjera karstike nëntokësore.

Përhapja e përgjithshme

Kosovë.

Përhapja në Kosovë

Rugovë (Giachino 2006).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Përhapja e këtij lloji është e kufizuar në vetëm një shpellë në Rugovë. Ky lloj është vlerësuar si: I Cenuar, për shkak se popullata e këtij lloji e ka zonën e pranisë ZP shumë të ngushtë (më pak se 20 km2), numri i lokacioneve, me gjasë, është më i vogël se 5, si dhe për shkak të faktit se lloji është shumë i ndjeshëm në çfarëdo luhatje të temperaturës dhe lagështisë. Çfarëdo shqetësimi i habitatit (shpellës) mund të çojë në humbje drastike të popullatës.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); Modifikimet e sistemeve natyrore (7.3 Modifikimet e tjera të ekosistemit).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. . . Mbrojtja e tokës/ujit (1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve); 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Në rastet e përdorimit turistik të shpellës duhet siguruar se intervenimet dhe përdorimi i shpellës nuk çojnë në ndryshimin e mikroklimës.

Referencat

Giachino 2006



Pavicevicia pretneri Perreau, 2008

Insecta: Coleoptera: Leiodidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

I Cenuar, VU D2

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Gabor Mesaroš

Të dhëna të përgjithshme

Është lloj me madhësi shumë të vogël (1.9-2,3 mm). Jeton në mjedise nëntokësore duke u ushqyer me mbetje të trupave të kafshëve të tjera. Trupi është i përshtatur mirë për të jetuar në mjedise nëntokësore: mungesë e tërësishme e syve, antena shumë mirë të zhvilluara dhe mungesë të pigmentimit të trupit (ngjyra e kitinës është bojëkafe e çelët).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.18 Sisteme karstike dhe të tjera hidrologjike nëntokësore [kontinentale]); 7 Shpella dhe habitate nëntokësore (joujore) (7.1 Shpella).
Jeton në shpella dhe kavitete të tjera karstike nëntokësore.

Përhapja e përgjithshme

Kosovë.

Përhapja në Kosovë

Shpella Lazina (Perreau 2008).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Përhapja e këtij lloji është e kufizuar në vetëm një shpellë në Rugovë. Ky lloj është vlerësuar si: I Cenuar, për shkak se popullata e këtij lloji e ka zonën e pranisë ZP shumë të ngushtë (më pak se 20 km2), numri i lokacioneve, me gjasë, është më i vogël se 5, si dhe për shkak të faktit se lloji është shumë i ndjeshëm në çfarëdo luhatje të temperaturës dhe lagështisë. Çfarëdo shqetësimi i habitatit (shpellës) mund të çojë në humbje drastike të popullatës.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); Modifikimet e sistemeve natyrore (7.3 Modifikimet e tjera të ekosistemit).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës / ujit (1.1 Mbrojtja e arealit 1. Mbrojtja e tokës / ujit (1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve) 2. Menaxhimi i tokës / ujit (2.1 Menaxhimi i arealit / zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Në rastet e përdorimit turistik të shpellës duhet siguruar se intervenimet dhe përdorimi i shpellës nuk çojnë në ndryshimin e mikroklimës.

Referencat

Perreau 2008



Glossosoma discophorum Klapálek, 1902

Insecta: Trichoptera: Glossosomatidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

I Cenuar, VU A2ac; B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Gabor Mesaroš

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 6.5 deri në 7 mm. Në fazën larvore jeton në ujë përgjatë një viti. Faza larvore shërben si tregues i ujërave mesatarisht të pastra. Faza larvore për nga aspekti i të ushqyerit bën pjesë në grupin e gërryesve dhe mbledhësve/kolektorëve. Faza adulte paraqitet në periudhën qershor - shtator. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë, në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit (Graf *et al.* 2008; Kumanski 1985).

Habitati

Lloji i habitatit: 5Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Gjendet kryesisht në zona të caktuara të rrjedhave të epërme dhe zonave burimore të përroskave malore. Substrati i parapëlqyer i larvave të këtij lloji përbëhet nga zhavorri i madhësive të ndryshme, gurët e madhësive të ndryshme, etj. Kryesisht jeton në lartësi të mëdha mbidetare deri në mbi 2000 m.

Përhapja e përgjithshme

Bosnjë-Hercegovinë, Bullgari, Kosovë, Kroaci, Mali i Zi, Maqedoni, Rumani, Serbi, Shqipëri.

Përhapja në Kosovë

Lumbardhi i Prizrenit në Prevallë.

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: I Cenuar, për shkak të vëzhgimit të rënies së popullatës së llojit në të kaluarën, ku shkaktarët e rënies mund të mos kenë përfunduar ende, bazuar në vëzhgim direkt dhe rënie të cilësisë së habitateve të përshtatshme për këtë lloj. Aktualisht, numri i lokacioneve prej nga njihet lloji është 1 dhe zona e pranisë ZP është e kufizuar (4 km2), por supozohet që është i pranishëm në më shumë lokacione, sidoqoftë ≤ 10.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)]; 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).
Faktorët kryesorë që e rrezikojnë këtë lloj në Kosovë, janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lokaliteti ku është gjetur ky lloj është në kuadër të zonës së mbrojtur.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për llojet e tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Graf *et al.* 2008; Kumanski 1985





Plectrocnemia mojkovacensis Malicky, 1982

Insecta: Trichoptera: Polycentropodidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

I Cenuar, VU A2ac; B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 4.5 deri në 5 mm. Në fazën larvore jeton në ujë përgjatë një viti. Faza adulte paraqitet në periudhën e pranverës. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë, në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit. Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për vlerat indikative të tolerancës së këtij lloji. Ky lloj bën pjesën në grupin e llojeve jashtëzakonisht të rralla të gjinisë Plectrocnemia Stephens, 1836 (Graf *et al.* 2008; Kumanski 1985).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Gjendet kryesisht në zona të caktuara të rrjedhave të epërme të përroskave malore.

Përhapja e përgjithshme

Lloj endemik i Ballkanit. Deri më tani është gjetur vetëm në Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë dhe Serbi.

Përhapja në Kosovë

Shpella Lazina (Perreau 2008).

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie
Në Kosovë është konstatuar në vetëm 1 lokalitet me numër të vogël të individëve.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: I Cenuar, për shkak të rënies së vëzhguar të popullatës në të kaluarën, ku shkaktarët e rënies mund të mos kenë pushuar, bazuar në vëzhgim direkt dhe rënie të cilësisë së habitateve të përshtatshme për këtë lloj. Aktualisht, ky lloj njihet nga vetëm 1 lokacion, me zonën e kufizuar të pranisë ZP (4 km2), por supozohet që është i pranishëm në më shumë lokacione, sidoqoftë ≤ 10.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)]; 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).
Faktorët kryesorë që e rrezikojnë këtë lloj në Kosovë, janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për llojet e tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Graf *et al.* 2008; Kumanski 1985



Psychomyia klapaleki Malicky, 1995

Insecta: Trichoptera: Psychomyiidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Cenuar, VU A2ac; B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 3.5 deri në 4.5 mm. Në fazën larvore jeton në ujë përgjatë një viti. Faza adulte paraqitet në periudhën e pranverës. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë, në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit. Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për vlerat indikative të tolerancës së këtij lloji, mirëpo gjetja e tij në rrjedha të mesme të lumenjve sugjeron se e toleron relativisht mirë ndotjen e ujërave (Graf *et al.* 2008; Kumanski 1985).

Habitati

Lloji i habitatit: 5 . Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat)].
Gjendet kryesisht në zona të caktuara të rrjedhave të mesme dhe të poshtme të lumenjve të mëdhenj dhe më rrallë në segmente të përroskave malore.

Përhapja e përgjithshme

Bosnjë-Hercegovinë, Itali, Kosovë, Kroaci, Serbi, Sllloveni, Shqipëri.

Përhapja në Kosovë

Lumi Ibër në Koshtovë.

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie
Në Kosovë deri më tani është konstatuar në vetëm 1 lokalitet me numër të kufizuar të individëve.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: I Cenuar, për shkak të rënies së vëzhguar të popullatës në të kaluarën, ku shkaktarët e rënies mund të mos kenë pushuar, bazuar në vëzhgim direkt dhe rënie të cilësisë së habitateve të përshtatshme për këtë lloj. Aktualisht, ky lloj njihet nga vetëm 1 lokacion, me zonën e kufizuar të pranisë ZP (4 km2), por supozohet që është i pranishëm në më shumë lokacione, sidoqoftë ≤ 10.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amviséri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)]; 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).
Faktorët kryesorë që e rrezikojnë këtë lloj në Kosovë, janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lokaliteti ku është gjetur ky lloj është në kuadër të zonës së mbrojtur.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për llojet e tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Graf *et al.* 2008; Kumanski 1985





Rhyacophila bosnica Schmid, 1970

Flutura e Bosnës

Insecta: Trichoptera: Rhyacophilidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Cenuar, VU A2ac; B1ab(iii,iv)+2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 7 deri në 9 mm. Ngjyra e krahëve është bojëkafe e mbyllët. Në fazën larvore jeton në ujë përgjatë një viti. Nuk ka të dhëna të mjaftueshme rreth mënyrës së të ushqyerit të fazës larvore. Faza larvore është treguese e ujërave të pastra. Faza adulte paraqitet prej shkurtit deri në maj. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë, në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit. Është ndër llojet e para të Trichoptera-ve që paraqitet në fillim të vitit si adult (Graf *et al.* 2008; Kumanski 1985).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat), 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Gjendet kryesisht në zonat burimore dhe rrjedhat e epërme të përroskave malore. Substrati i parapëlqyer i larvave të këtij lloji përbëhet nga zhavorri i trashë, gurët e madhësive të ndryshme, shtrati guror i lumit etj. Ky lloj preferon lartësitë e mëdha mbidetare (Graf *et al.* 2008; Kumanski 1985).

Përhapja e përgjithshme

Lloj endemik i Ballkanit. Deri më tani është gjetur vetëm në Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë, Serbi dhe Shqipëri.

Përhapja në Kosovë

Përroskë në Bjeshkët e Sharrit, Përroskë në Bjeshkët e Nemuna.

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie
Në të gjitha lokalitetet ku është gjetur në Kosovë ky lloj karakterizohet me numër të vogël të individëve. Në disa lokalitete është vërejtur rënie e lehtë e nënpopullatave, për shkak të veprimeve antropogjene në mjedis, si prerja e pyjeve dhe degradimi i habitateve të ujërave të ëmbla

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: I Cenuar, për shkak të vëzhgimit të rënies së popullatës së llojit në të kaluarën,

ku shkaktarët e rënies mund të mos kenë përfunduar ende, bazuar në vëzhgim direkt dhe rënie të cilësisë së habitateve të përshtatshme për këtë lloj. Aktualisht, ky lloj është i njohur nga një numër i vogël (2) i lokacioneve, me zonën e pranisë ZP të kufizuar (8 km2), por supozohet që është i pranishëm në më shumë lokacione, sidoqoftë në ≤ 10.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amviséri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)]; 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).
Faktorët kryesorë që e rrezikojnë këtë lloj në Kosovë, janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për llojet e tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Graf *et al.* 2008; Kumanski 1985





Rhyacophila obtusa Klapálek, 1894

Insecta: Trichoptera: Rhyacophilidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Cenuar, VU A2ac; B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 7 deri në 9 mm. Ngjyra e krahëve është bojëkafe e mbyllët. Në fazën larvore jeton në ujë përgjatë një viti. Faza larvore është treguese e ujërave të pastra. Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për mënyrën e të ushqyerit të fazës larvore. Faza adulte paraqitet në periudhën prill - tetor. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë, në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit (Graf *et al.* 2008; Ibrahimi *et al.* 2012; Kumanski 1985).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Gjendet kryesisht në zona të caktuara të rrjedhave të epërme të lumenjve dhe përroskave malore. Substrati i parapëlqyer i larvave të këtij lloji përbëhet nga zhavorri i trashë, gurët e madhësive të ndryshme dhe shtrati guror i lumit. Mund të haset në lartësi të ndryshme mbidetare, prej 300 deri në mbi 1600 m.

Përhapja e përgjithshme

Bosnjë-Hercegovinë, Bullgari, Greqi, Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi, Serbi, Shqipëri, Turqi.

Përhapja në Kosovë

Bjeshkët e Sharrit, Bjeshkët e Nemuna.

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie
Në të gjitha lokalitetet ku është gjetur në Kosovë ky lloj karakterizohet me numër të vogël të individëve dhe nënpopullata të paqëndrueshme, bazuar në vëzhgim të vazhdueshëm.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: I Cenuar, për shkak të vëzhgimit të rënies së popullatës së llojit në të kaluarën, ku shkaktarët e rënies mund të mos kenë përfunduar ende, bazuar në vëzhgim direkt dhe rënie të cilësisë së habitateve të përshtatshme për këtë lloj.

Aktualisht, ky lloj është i njohur nga një numër i vogël (2) i lokacioneve, me zonën e pranisë ZP të kufizuar (8 km2), por supozohet që është i pranishëm në më shumë lokacione, sidoqoftë në ≤ 10.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)]; 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).
Faktorët kryesorë që e rrezikojnë këtë lloj në Kosovë, janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lokalitetet ku është gjetur ky lloj janë në kuadër të zonave të mbrojtura.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lokalitetin ku gjendet.

Referencat

Graf *et al.* 2008; Ibrahimi *et al.* 2012; Kumanski 1985





Synagapetus slavorum Botosaneanu, 1960

Insecta: Trichoptera: Glossosomatidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Cenuar, VU A2ac; B1ab(iii,iv)+2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është rreth 4 mm. Në fazën larvore jeton në ujë përgjatë një viti. Faza larvore është treguese e ujërave mesatarisht të pastra. Faza larvore për nga aspekti i të ushqyerit bën pjesë në grupin e gërryesve dhe mbledhësve/kolektorëve. Faza adulte paraqitet në periudhën qershor - tetor. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë, në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit (Graf *et al.* 2008; Kumanski 1985).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) ((5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza)).
Gjendet kryesisht në zona të caktuara të rrjedhave të epërme dhe zonave burimore të përroskave malore, por mund të haset edhe në rrjedhat e mesme të lumenjve. Substrati i parapëlqyer i larvave të këtij lloji përbëhet nga zhavorri i madhësive të ndryshme, si dhe gurët e madhësive të ndryshme. Mund të haset në lartësi të ndryshme mbidetare, prej 300 deri në 1200 m.

Përhapja e përgjithshme

Bosnjë-Hercegovinë, Bullgari, Greqi, Kosovë, Mali i Zi, Rumani.

Përhapja në Kosovë

Përroskë në fshatin Mollopolc.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Në Kosovë deri më tani është konstatuar me vetëm një individ në vetëm 1 lokalitet.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: I Cenuar, për shkak të rënies së dyshuar të pritur të popullatës së llojit në të ardhmen, bazuar në rënien e cilësisë së habitateve të përshtatshme për këtë lloj. Aktualisht, ky lloj njihet nga vetëm 1 lokacion me zonën e kufizuar të pranisë ZP (4 km2), por supozohet që është i pranishëm në më shumë lokacione, sidoqoftë ≤ 10.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)]; 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).
Faktorët kryesorë që e rrezikojnë këtë lloj në Kosovë, janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për llojet e tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Graf *et al.* 2008; Kumanski 1985





Tinodes janssensi Jacquemart, 1957

Insecta: Trichoptera: Psychomyiidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Cenuar, VU A2ac; B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 4.5 deri në 5 mm. Në fazën larvore jeton në ujë përgjatë një viti. Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për vlerat indikatore të fazës larvore dhe mënyrën e jetesës së saj. Faza adulte paraqitet në periudhën qershor – nëntor. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë, në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit ku kanë jetuar si larva (Graf *et al.* 2008; Kumanski 1985).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Gjendet kryesisht në zona të caktuara të rrjedhave të epërme të përroskave malore. Substrati i parapëlqyer i larvave të këtij lloji përbëhet nga zhavorri i trashë, gurët e madhësive të ndryshme, shtrati guror i lumit, si dhe mjediset e pasura me material bimor, si degë e gjethe të rëna.

Përhapja e përgjithshme

Lloj endemik i Ballkanit. Është hasur në numër të kufizuar lokalitetesh në Bullgari, Greqi, Kosovë dhe Shqipëri.

Përhapja në Kosovë

Përroskë në Blinajë.

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie
Në Kosovë është konstatuar në vetëm 1 lokalitet me numër të vogël të individëve.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: I Cenuar, për shkak të rënies së vëzhguar të popullatës në të kaluarën, ku shkaktarët e rënies mund të mos kenë pushuar, bazuar në vëzhgim direkt dhe rënie të cilësisë së habitateve të përshtatshme për këtë lloj. Aktualisht, ky lloj njihet nga vetëm 1 lokacion, me zonën e kufizuar të pranisë ZP (4 km2), por supozohet që është i pranishëm në më shumë lokacione, sidoqoftë ≤ 10.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)]; 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet]; 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit].
Faktorët kryesorë që e rrezikojnë këtë lloj në Kosovë, janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lokaliteti ku është gjetur lloji është në kuadër të Rezervatit të Mbrojtur të Gjuetisë në Blinajë.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për llojet e tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Graf *et al.* 2008; Kumanski 1985





Carcharodus floccifera Zeller, 1847

Insecta: Lepidoptera: Hesperiidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Gati i Kërcënuar, NT

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Cenuar, VU A2ac; B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi, Pajtim Bytyqi

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj e ka gjerësinë e krahëve prej 32 deri në 35 mm. Ngjyra themelore e krahëve të përparmë është e mermertë gri-kafe, me njolla kafe të errët dhe të qarta. Adultët fluturojnë prej majit deri në qershor, ose prej korrikut në shtator në dy gjenerata, por në lartësi më të mëdha mbidetare ekziston vetëm një gjeneratë, prej qershorit deri në gusht. Larvat ushqehen në bimët e gjinive: Stachys, Marrubium, Thymus dhe Ballota.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare); 4. Kullosa.
Është lloj kryesisht malor dhe gjendet në zonat skajore të diellëzuara të pyjeve, në lëndina dhe në zonat e ndriçuara të kullosave e livadheve.

Përhapja e përgjithshme

Spanjë, Francë, Itali, Alpe, Ballkan, Europë jugore dhe qendrore, në veri deri në Gjermaninë qendrore dhe në lindje deri në Maqedoni dhe Bullgari.

Përhapja në Kosovë

Dy lokalitete në Mirushë, Malet e Shkozës (Zhushi *et al.* 2017), Pashtrik (Jakšić 2007), Malet e Berishës.

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie
Është regjistruar me nënpopullata me numër të konsiderueshëm të individëve në shumicën e rasteve, por me tendenca të rënies. Gjithashtu, është vërejtur tendencë e degradimit të habitatit në të shumtën e rasteve.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: I Cenuar, për shkak të rënies së vëzhguar të popullatës në të kaluarën, ku shkaktarët e rënies mund të mos kenë pushuar, bazuar në vëzhgim direkt dhe rënie të cilësisë së habitateve të përshtatshme për këtë lloj. Aktualisht, ky lloj njihet nga 5 lokacione, me zonën e pranisë ZP = 20 km2 dhe shtrirjen e përhapjes SHP = 371 km2, por supozohet që është i pranishëm në më shumë lokacione, sidoqoftë ≤ 10.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 2 Bujqësia dhe akuakultura (2.3. Blegtoria dhe fermat: 2.3.2 Kullotja e vogël, fermat apo bujqësia]; 6. Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative]; 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.1 Zjarret dhe luftimi i zjarrit].
Ky lloj është vëzhguar të jetë i ndikuar nga kositja intensive.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për llojet e tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Jakšić 2007; Zhushi *et al.* 2017





Carterocephalus palaemon Pallas, 1771

Insecta: Lepidoptera: Hesperiidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Cenuar, VU A2ac; B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj e ka gjerësinë e krahëve prej 2.5 deri në 3.2 cm. E ka një gjeneratë në vit. Adultët paraqiten në periudhën maj – qershor.

Habitati

Lloji i habitatit: 1 Pyje [1.4. Pyje të klimës mesatare]; 5 Vende ujore [kontinentale].
Ky lloj është arboreal. Shpeshherë haset në pjesë të lagështa të pyjeve. Haset gjithashtu edhe në brigje të lumenjve dhe përroskave, si dhe pjesë të hapura me bar të pyjeve.

Përhapja e përgjithshme

Europa qendrore, veriore dhe lindore, Azia qendrore dhe veriore deri në Japoni dhe në Amerikën veriore.

Përhapja në Kosovë

Jezerc, Gryka e Rugovës [Jakšić 1987].

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie
Ky lloj ka nënpopullata të vogla në Kosovë dhe me tendencë të vazhdueshme të rënies.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: I Cenuar, për shkak të rënies së vëzhguar të popullatës në të kaluarën, ku shkaktarët mund të mos kenë pushuar, bazuar në vëzhgim direkt dhe rënie të kualitetit të habitatit. Aktualisht, ky lloj është i njohur nga vetëm 2 lokacione, zona e pranisë ZP është 8 km2, por numri i lokacioneve pritet të jetë më i madh, sidoqoftë ≤ 10.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 4 Transporti dhe koridoret e shërbimit [4.1 Rrugët dhe hekurudhat]; 5 Përdorimi i burimeve biologjike [5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve]; 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore [6.1 Aktivitetet rekreative]; 9 Ndotja [9.3. Efluentët bujqësor dhe pyjor: 9.3.2 Erozioni i tokës, sedimentimi].

Masat ekzistuese mbrojtëse

Habitatet e këtij lloji në Parkun Kombëtar Bjeshkët e Nemuna janë të mbrojtura me ligjin për Parkun Kombëtar.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit [1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës]; 5. Ligji dhe politikat [5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit].
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi [1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia]; 3. Monitorimi [3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit].
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për llojet e tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Jakšić 1987





Erebia rhodopensis Nicholl, 1900

Insecta: Lepidoptera: Nymphalidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Cenuar, VU A2ac; B2ab(ii,iii)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj e ka gjerësinë e krahëve prej 19 deri në 20 mm. Në pjesën e sipërme të krahëve të përparmë dominon ngjyra kafe e errët. Ky lloj e ka një gjeneratë në vit. Adultët fluturojnë në periudhën korrik – gusht. Nuk ka njohuri të mjaftueshme rreth bimëve ushqyese të larvave.

Habitati

Lloji i habitatit: Kullosa.
Kryesisht haset në shpate të hapura me bar, pothuajse pa shkurre ose pemë. Në Kosovë, zakonisht haset në lartësi të mëdha mbidetare.

Përhapja e përgjithshme

Europë Juglindore.

Përhapja në Kosovë

Disa lokalitete në Sharr, Rudokë, Gjeravicë, Çakorr [Jakšić 2001, 2003].

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm
Është hasur në nënpopullata të vogla por aktualisht stabile.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: I Cenuar, për shkak të rënies së vëzhguar të popullatës në të kaluarën, ku shkaktarët mund të mos kenë pushuar, bazuar në vëzhgim direkt dhe rënie të kualitetit të habitatit. Aktualisht, zona e pranisë ZP është 24 km2, shtrirja e përhapjes SHP është 2192 km2 dhe numri i lokacioneve është ≤ 10.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial [1.3 Zona turistike dhe rekreative]; 2 Bujqësia dhe akuakultura [2.3 Blegtoria dhe fermat: 2.3.2 Kullotja e vogël, fermat ose bujqësia]; 7 Modifikimet e sistemeve natyrore [7.1 Zjarri dhe luftimi i tij, 7.3 Modifikimet e tjera të ekosistemit]; 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër [11.1 Modifikimi dhe ndryshimi i habitatit].
Ky lloj është vëzhguar të jetë i ndjeshëm ndaj praktikës së kositjes së kullotave.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Habitatet e këtij lloji në parqet kombëtare Bjeshkët e Nemuna dhe Sharri janë të mbrojtura ligjërisht.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit [1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës]; 5. Ligji dhe politikat [5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit].
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi [1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia]; 3. Monitorimi [3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit].
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për llojet e tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Jakšić 2001, 2003



Lycaena dispar Haworth, 1802

Fluturza e bakërt e madhe

Insecta: Lepidoptera: Lycaenidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Cenuar, VU A2ac; B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj i ka krahët ngjyrë bakri-portokalli të ndritshme dhe të mbuluar me të zezë. I ka dy gjenerata në vit. Adultët shfaqen nga maji në qershor. Bimë ushqyese e larvave të këtij lloji është Rumex hydrolapathum. Është lloj relativisht i ndjeshëm në veprime antropogjene të degradimit të habitatit.

Habitati

Lloji i habitatit: 1 Pyje [1.4. Pyje të klimës mesatare];
4. Kullosa.
Habitate të parapëlqyera të këtij lloji janë: livadhet e lagështa dhe bashkësitë e larta bimore, fierajat, livadhet mezofile, pyjet gjetherënëse gjethegjera, livadhet dhe stepet e thata gëlqerore etj. Në Kosovë mund të haset kryesisht në brigje lumenjsh ose në toka të lagështa.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Turqi.

Përhapja në Kosovë

Nerodime, Vushtrri, Shtërpcë, Dy lokalitete në Malishevë, Klinë, Gryka e Kaçanikut, Kalaja e Prizrenit, Istog, Deçan [Jakšić 2003; Jakšić and Živić 1995-1998, Zhushi *et al.* 2016; Zhushi *et al.* 2017].

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie
Ky lloj është konstatuar me nënpopullata të cilat kanë numër të vogël të individëve. Edhe në Europë është vërejtur viteve të fundit trendi i rënies së popullatave të këtij lloji, edhe pse më tepër në Europën veriore.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: I Cenuar, për shkak të rënies së vëzhguar të popullatës në të kaluarën, ku shkaktarët mund të mos kenë pushuar, bazuar në vëzhgim direkt dhe rënie të kualitetit të habitatit. Aktualisht, zona e pranisë ZP është 40 km2, shtrirja e përhapjes SHP është 3725 km2 dhe numri i lokaliteteve është 10.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 2 Bujqësia dhe akuakultura; 7 Modifikimet e sistemeve natyrore [7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.2 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi komercial), 7.2.8 Eksploatimi i ujit nëntokësor (përdorimi i panjohur) 7.3 Modifikime të tjera të ekosistemit]; 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër [11.1 Modifikimi dhe ndryshimi i habitatit].
Ndër kërcënimet për këtë lloj është vërejtur të jetë edhe kositja e livadheve.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit [1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës]; 5. Ligji dhe politikat [5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit].
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi [1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia]; 3. Monitorimi [3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit].
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për llojet e tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Jakšić 2003; Jakšić and Živić 1995-1998, Zhushi *et al.* 2016; Zhushi *et al.* 2017





Nymphalis antiopa Linnaeus, 1758

Flutura Njollablu e Zezë (Zimbajtësja)

Insecta: Lepidoptera: Nymphalidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Cenuar, VU A2ac; B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj e ka gjerësinë e krahëve prej 57 deri në 101 mm. E ka një gjeneratë në vit. Adultët fluturojnë prej qershorit deri në korrik. Është lloj arboreal, që hibernon në stadin e adultit në muajin mars të vitit të ardhshëm. Larvat ushqehen me bimët që u takojnë gjinive: Salix, Populus, Betula etj.

Habitati

Lloji i habitatit: 6 Zona shkëmbore [p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore]; 14 Artificiale/tokësore [14.5 Zona urbane].
Është lloj që haset në lartësi të ndryshme mbidetare. Në rrethinën e Podujevës është vërejtur edhe në toka të kultivuara.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Azi, Amerikë jugore.

Përhapja në Kosovë

Dy lokalitete në Podujevë, Grykë e Kaçanikut, Brezovicë, Dy lokalitete në Shtërpcë, Dragash, Grykë e Rugovës [Jakšić and Živić 1995-1998; Zhushi *et al.* 2017].

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie
Disa nga nënpopullatat e këtij lloji të vëzhguara viteve të fundit kanë qëndrueshmëri të konsiderueshme, por në shumë raste është vërejtur rënie e tyre.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: I Cenuar, për shkak të rënies së vëzhguar të popullatës në të kaluarën, ku shkaktarët mund të mos kenë pushuar, bazuar në vëzhgim direkt dhe rënie të cilësisë së habitatit Aktualisht, zona e pranisë ZP është 28 km2, shtrirja e përhapjes SHP është 6238 km2 dhe numri i lokacioneve është ≤ 10.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike [5.1 Gjuetia dhe mbledhja e kafshëve tokësore: 5.1.3 Persekutimi/kontrolli]; 8 Lloje invazive dhe të tjera problematike, gjenet dhe sëmundjet [8.2 Lloje vendore problematike/sëmundje].
Ky lloj rrezikohet në veçanti nga numri i madh i predatorëve dhe nga parazitoidët e Hymenopterave.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Disa nga lokalitetet ku është gjetur ky lloj janë në kuadër të zonës së mbrojtur.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit [1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës]; 5. Ligji dhe politikat [5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit].
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi [1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia]; 3. Monitorimi [3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit].
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për llojet e tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Jakšić and Živić 1995-1998; Zhushi *et al.* 2017



Parnassius apollo Linnaeus, 1758

Apollonja

Insecta: Lepidoptera: Papilionidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Gati i Kërcënuar, NT

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Cenuar, VU B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj e ka gjerësinë e krahëve prej 32 deri në 35 mm. Karakterizohet me ngjyrën e bardhë dhe njollat e zeza në krahët e përparmë dhe me njollat e kuqe në formë syri në krahët e pasmë. Ky lloj ka kërkesa specifike, të cilat përfshijnë, ndër të tjera, dimra të ftohtë dhe vera me shumë diell. Ky lloj e ka një gjeneratë në vit dhe adultët mund të shfaqen nga maji deri në shtator, në varshmëri nga lartësia mbidetare.

Habitati

Lloji i habitatit: 4. Kullosa.
Ky është një lloj tipik malor dhe parapëlqen kryesisht kullosa dhe livadhe alpine.

Përhapja e përgjithshme

Gjendet në shumicën e zonave të mëdha malore të Europës dhe Turqisë.

Përhapja në Kosovë

Bogë, Zhleb, Çakorr, Deçan, Grykë e Rugovës, Lloqan, Milishevc, Veriq, Strellc, Sharr (Jakšić 2003; Jakšić and Živić 1995-1998).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Ky lloj është konstatuar me popullata me numër të vogël të individëve.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: I Cenuar, për shkak të zonës së pranisë ZP, që është 36 km2, shtrirjes së përhapjes SHP, që është 2028 km2, numrit të vogël të lokacioneve, që është ≤ 10, dhe pritjes së parashikuar të rënies së vazhdueshme të popullatës, bazuar në cilësinë e habitatit dhe numrin e lokacioneve.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.1 Strehimi dhe zonat urbane, 1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit); 2 Bujqësia dhe akuakultura (2.3 Blegtoria dhe fermat 2.3.1 Kullotja nomade); 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Modifikimi dhe ndryshimi i habitatit).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për llojet e tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Jakšić 2003; Jakšić and Živić 1995-1998





Phengaris alcon Denis & Schiffermüller, 1775

Insecta: Lepidoptera: Lycaenidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Cenuar, VU A2ac; B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj e ka një gjeneratë në vit. Bimë ushqyese të larvave të këtij lloji janë ato të gjinisë Gentiana. Larat janë mirmekofile. Adultët paraqiten në periudhën qershor – korrik. Haset shpesh në habitate të thata. Nënpopullatat e këtij lloji në Kosovë konsiderohet se i takojnë nënllojit rebeli, që jeton në lartësi të mëdha mbidetare. Megjithatë, statusi taksonomik i këtij nënlloji është akoma i paqartë.

Habitati

Lloji i habitatit: 5 Vende ujore (kontinentale).
Është lloj arboreal që jeton në livadhe kënetore të lidhura me lumenj apo liqene.

Përhapja e përgjithshme

Në Europën qendrore ky lloj gjendet prej jugut të Suedisë deri në veriun e Spanjës dhe nga Franca kah lindja. Është i pranishëm edhe në Turqinë lindore dhe në lindje nëpërmjet Siberisë deri në Mongoli dhe Alltai.

Përhapja në Kosovë

Pashtrik, Luboten, Qafa e Morinës (Jakšić and Živić 1995-1998; Rebel and Zerny 1931).

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie
Ky lloj është konstatuar me nënpopullata, të cilat kanë numër të vogël të individëve, me tendence të zvogëlimit.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: I Cenuar, për shkak të rënies së vëzhguar të popullatës në të kaluarën, ku shkaktarët mund të mos kenë pushuar, bazuar në vëzhgim direkt dhe rënie të kualitetit të habitatit. Aktualisht, ky lloj është gjetur në vetëm 3 lokacione, zona e pranisë ZP është 12 km2, por pritet që numri i lokacioneve të jetë më i madh, sidoqoftë ≤ 10.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi, 7.3 Modifikimet e tjera të ekosistemit); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Modifikimi dhe ndryshimi i habitatit, 11.2 Thatësirat).
Ndër kërcënimet për këtë lloj është edhe braktisja e tokave bujqësore dhe parazitizmi i Ichneumon eumerus.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Në Bjeshkët e Sharrit dhe në Bjeshkët e Nemuna habitatet e këtij lloji janë të mbrojtura me ligj.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për llojet e tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Jakšić and Živić 1995-1998; Rebel and Zerny 1931





Pyrgus sidae Esper, 1784

Insecta: Lepidoptera: Hesperiidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Cenuar, VU A2ac; B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj e ka gjerësinë e krahëve prej 32 deri në 38 mm, e kjo e bën ndër llojet me krahë më të mëdhenj të kësaj gjinie në Europë. E ka një gjeneratë në vit. Adultët mund të hasen gjatë periudhës maj – korrik. Ushqehet me bimën Albutilon avicennae.

Habitati

Lloji i habitatit: 4. Kullosa; 6 Zona shkëmbore [p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore].
Ky lloj gjendet shpesh në brigjet me bar të lumenjve, në livadhe dhe shpate gurore. Shumica e habitateve ku gjendet ky lloj, përmbajnë numër të madh të bimëve të gjinive Vicia dhe Achillea.

Përhapja e përgjithshme

Bosnjë-Hercegovinë, Greqi, Francë, Itali, Kosovë, Kroaci, Rumani, Serbi, Spanjë, disa pjesë të Azisë.

Përhapja në Kosovë

Disa lokalitete në Mirushë, Pashtrik, Grykë e Kaçanikut, Disa lokalitete në Malishevë, Strellc [Jakšić and Živić 1995-1998].

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie
Ky lloj ka nënpopullata të vogla dhe të fragmentuara në Kosovë, me tendenca të vazhdueshme të rënies.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: I Cenuar, për shkak të rënies së vëzhguar të popullatës në të kaluarën, ku shkaktarët mund të mos kenë pushuar, bazuar në vëzhgim direkt dhe rënie të cilësisë së habitatit. Zona e pranisë ZP e këtij llloji është 32 km2, shtrirja e përhapjes SHP është 1314 km2, kurse numri i lokacioneve është ≤ 10.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike [5.1 Gjuetia dhe grumbullimi i kafshëve tokësore: 5.1.1 Përdorimi i qëllimshëm [lloji që vlerësohet është i synuar]]; 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër [11.1 Modifikimi dhe ndryshimi i habitatit].
Ky lloj është vëzhguar se ndikohet nga përdorimi i pesticideve.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit [1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës]; 5. Ligji dhe politikat [5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit].
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi [1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia]; 3. Monitorimi [3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit].
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për llojet e tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Jakšić and Živić 1995-1998.





Thecla betulae Linnaeus, 1758

Bishtakja e mështeknës

Insecta: Lepidoptera: Lycaenidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Cenuar, VU A2ac; B2ab(ii,iii)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj e ka gjerësinë e krahëve prej 25 deri në 40 mm. E ka një gjeneratë në vit, kurse adultët hasen në periudhën korrik – shtator. Llojet ushqyese të larvave u takojnë gjinive Prunus dhe Betula.

Habitati

Lloji i habitatit: 1 Pyje [1.4. Pyje të klimës mesatare].
Ky lloj është i shpeshtë në pyje gjetherënëse. Në Kosovë është konstatuar në pyje të hapura me Prunus spinosa.

Përhapja e përgjithshme

Europë, nëpërmjet Azisë deri në Kore.

Përhapja në Kosovë

Reçicë, Malet e Shalës, Shkozë, Pashtrik, Brezovicë [Jakšić 1998; Jakšić 2007; Zhushi *et al.* 2016].

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Ky lloj është konstatuar me nënpopullata të cilat kanë numër të vogël të individëve dhe në mënyrë të lokalizuar.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: I Cenuar, për shkak të rënies së vëzhguar të popullatës në të kaluarën, ku shkaktarët mund të mos kenë pushuar, bazuar në vëzhgim direkt dhe rënie të kualitetit të habitatit. Aktualisht, numri i lokacioneve është 5, zona e pranisë ZP është 20 km2, shtrirja e përhapjes SHP është 1900 km2, por pritet që numri i lokacioneve të jetë më i madh, sidoqoftë ≤ 10.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial; 2 Bujqësia dhe akuakultura [2.3 Bujqësia dhe fermat]; 8 Llojet invazive dhe të tjera problematike, gjenet dhe sëmundjet [8.1 Llojet jonative invazive/të huaja/sëmundjet].
Ky lloj është i kërcënuar edhe nga armiqtë e saj natyrorë Ichnemounidea.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit [1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës]; 5. Ligji dhe politikat [5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit].
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi [1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia]; 3. Monitorimi [3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit].
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për llojet e tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Jakšić 1998; Jakšić 2007; Zhushi *et al.* 2016





4.5 ACTINOPTERYGII

Cyprinus carpio Linnaeus, 1758

Krapi

Actinopterygii: Cypriniformes: Cyprinidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
I Cenuar, VU

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Cenuar, VU A3e

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Linda Grapci Kotori

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj jeton deri në 50 vjet. Maturimin seksual e arrin pas moshës 3-5 vjeçare dhe shumohet kryesisht nga muaji maj e deri në qershor, atëherë kur temperatura e ujit arrin deri në 18 *C. Ushqehet me larva të makroinvertebrorëve dhe me bimësi (Vukovič and Ivanovič 1971). Është aktiv në muzg dhe në agim. Është shumë tolerant në uljen e sasisë së oksigjenit të tretur në ujë (Simonovič 2001).

Habitati

Lloji i habitatit: 5 Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat], 5.4 Këneta, moçale, moçalishte, 5.5 Liqene të përhershme të ujërave të ëmbla).
Ky lloj është karakteristik për ujërat e qeta dhe për liqene. Adultët i banojnë ujërat e ngrohta e të thella me rrjedhje të ngadalshme, si p.sh., rrjedhat e poshtme të lumenjve, si dhe liqenet e pasura me vegjetacion.

Përhapja e përgjithshme

Europë dhe më gjerë.

Përhapja në Kosovë

Drini i Bardhë, Lumbardhi i Prizrenit, Lumi Drenica, Lumi Llap, Lumi Ibër dhe të gjitha ujërat liqenore.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Është mjaft abundant, por për shkak të hibridizimit me lloje të futura artificialisht, po bëhet gjithnjë e më vështire të flitet për popullata native të këtij lloji.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: I Cenuar, për shkak të reduktimit të dyshuar të pritur të popullatës në të ardhmen si rezultat i rrezikut që i kanoset nga hibridizimi me lloje joautoktone.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.1 Zonat për banim dhe komerciale); 8 Llojet invazive dhe të tjera problematike, gjenet dhe sëmundjet (8.3 Materiali gjenetik i futur);11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.2 Thatësirat).
Faktorët kryesorë që e rrezikojnë këtë lloj, kanë të bëjnë me ndikimin nga vendbanimet dhe mjediset urbane, ndotjen nga ujërat e zeza, ndotjen nga mbeturinat e ngurta dhe të tjera, si dhe thatësirën. Faktor tjetër, që e rrezikon këtë lloj, është edhe hibridizimi me lloje joautoktone.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloj i mbrojtur në Kosovë (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lokalitetin ku gjendet dhe llojet e tjera të pranishme.

Referencat

Simonovič 2001; Vukovič and Ivanovič 1971





4.6 AMPHIBIA

Triturus cristatus Laurenti, 1768

Nepërka e vogël e malit

Reptilia: Squamata: Viperidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Cenuar, VU A2ac; B2ab(iii,iv)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj, Linda Grapci Kotori.

Të dhëna të përgjithshme

Ky është një lloj me përhapje të gjerë dhe me disa nënlloje. Në Kosovë është i pranishëm nënlloji Vipera ursinii macrops (Méhely, 1911). Ky nënlloj dallohet prej llojit Vipera ursinii para së gjithash, për nga gjatësia trupore. Tek ky nënlloj kjo gjatësi është deri në 40 cm (Arnold & Ovenden 2002). Bën pjesë në grupin e gjarpërinjve helmues, por është i parrezikshëm për njeriun, për shkak të ndërtimit të aparatit helmues. Ana barkore e trupit është me ngjyrë të përhime dhe njolla të bardha, kurse ana shpinore e përhime e ndritshme me një larë me pozitë zigzage, me ngjyrë të errët ulliri. Aktivizohet vonë në pranverë, kah mesi i prillit dhe fillimi i majit. Femra lind të vegjël, më së shpeshti 2 – 5, kah fundi i gushtit dhe fillimi i shtatorit. Ushqehet kryesisht me karkaleca dhe nuk e përdorë asnjëherë aparatin helmues.

Habitati

Lloji i habitatit: 4 4. Kullosa (4.4. Kullosa të klimës mesatare); 6. Zona shkëmbore (p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore); 14. Artificiale/tokësore (14.2 Kullosa).
Vipera ursinii dhe nënlloji macrops janë tipik për rajonet malore me një lartësi mbidetare prej 1500 e deri në 3000 m. Habitatet e këtij lloji karakterizohen me lagështi të madhe. Haset edhe në zona shkëmbore të mbuluara me bar, livadhe, kullosa dhe shkurre.

Përhapja e përgjithshme

Vipera ursinii: Europë, Azi. Nënlloji macrops: Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë, Mali i Zi, Maqedoni, Serbi, Shqipëri.

Përhapja në Kosovë

Kobilicë, Afër Gurit të Zi, Bellopaqë, Koshutan.

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie
Në nivel global, por edhe në Ballkan, trendi i popullatave është në rënie. Në Kosovë, gjithashtu, është vërejtur rënie e konsiderueshme e popullatave të këtij lloji.



Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: I Cenuar, për shkak të prezencës së tij në një numër të kufizuar të lokaliteteve (≤ 5 me pritje të jetë më i madh por ≤ 10), zonës së pranisë ZP të vogël, që është 16 km2, shtrirjes së përhapjes SHP, që është 876 km2, si dhe rënies së vazhdueshme të zonës së pranisë ZP dhe kualitetit të habitatit.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.1 Zjarret dhe luftimi i tyre); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.3 ekstremet e temperaturës).
Duke qenë se ky lloj jeton në një areal shumë të vogël dhe të fragmentuar, faktori kryesor kërcënues vjen nga dëmtimi ose shkatërrimi i habitatit, qoftë nga njeriu apo nga procese natyrore. Një faktor tjetër që e rrezikon këtë lloj ka të bëjë me temperaturat ekstreme, të cilat, poashtu ndikojnë negativisht në kualitetin apo ekzistencën e jetës së llojit. Vipera ursini është lloj stenofag, kështu që zhdukja e insekteve (Caelifera dhe Gryllidae) në mënyrë indirekte e rrezikon edhe këtë lloj. Faktor tjetër potencial në rrezikimin e këtij lloji paraqet dukuria e zjarrvënies së qëllimshme të fushave, arave e pyjeve, të cilat janë të shpeshta në mjediset ku jeton lloji.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1.Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për llojet e tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Arnold & Ovenden 2002

4.7 REPTILIA

Vipera ursinii Bonaparte, 1835

Tritoni me kreshta

Amphibia: Caudata: Salamandridae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

I Cenuar, VU

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

I Cenuar, VU B2ab(ii,iii)

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj

Të dhëna të përgjithshme

Është lloj me një përhapje të gjerë në mbarë Europën, ndërsa në Kosovë është i lokalizuar kryesisht në ultësira dhe vende me ujëra të qeta. Madhësia mesatare e trupit është deri në 16 cm. Trupi është i hollë, ndërsa koka mjaft e gjerë. Tek meshkujt, në anën ventrale të trupit ndodhet një hulli me ngjyrë të verdhë, e cila mungon tek femrat. Në pjesët anësore të trupit ka pika me ngjyrë të bardhë. Në periudhën e shumimit seksual te meshkujt paraqitet një e ngritur lëkurore, që shtrihet përgjatë tërë gjatësisë së trupit. Riprodhimi bëhet në ujërat e përhershme dhe në ujërat gjysmë të rrjedhshme si pellgje, rrallë liqene, gurore të përmbytura, kanale vaditëse dhe kanale. Përdorimi i pellgjeve të vogla është tipik në të gjithë vargun e përhapjes.

Habitati

Lloji i habitatit: 1 Pyje (1.1 Pyje boreale, 1.4 Pyje të klimës mesatare); 3. Shkurre (3.3 Shkurre boreale, 3.4. Shkurre të klimës mesatare).
Ky lloj mund të gjendet në habitate të modifikuara, edhe pse nuk konsiderohet të jetë shumë i adaptueshëm.

Përhapja e përgjithshme

Austri, Bjellorusi, Belgjikë, Çeki, Danimarkë, Estoni, Francë, Gjermani, Hungari, Kosovë, Letoni, Lihtenshtajn, Lituani, Luksemburg, Mbretëri e Bashkuar, Moldavi, Holandë, Norvegji, Poloni, Rumani, Rusi, Serbi, Sllovaki, Suedi, Zvicër, Ukrainë.

Përhapja në Kosovë

Skënderaj, Drenas, Jezerc, Ivajë, Stanet e Dubravës, Viti, Kralan, Cërmjan, Krilevë.

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie
Në disa vende europiane, popullatat e këtij lloji janë në rënie. Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për gjendjen e nënpopullatave të këtij lloji në Kosovë, por është vëzhguar tendencë e rënies së nënpopullatave në disa nga lokalitetet e vrojtuara.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: I Cenuar, për shkak të rënies së vëzhguar të disa prej nënpopullatave në të kaluarën, ku shkaktarët e reduktimit mund të mos kenë pushuar, bazuar në vëzhgim direkt dhe rënie të cilësisë së habitateve të përshtatshme për llojin. Zona e pranisë ZP është 68 km2 dhe shtrirja e përhapjes SHP është 3473 km2.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.1 Banimi dhe zonat urbane, 1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve: 5.3.1 Përdorimi i qëllimshëm: vjelje për jetesë/në shkallë të vogël (lloji që vlerësohet është i synuar) [vjelja]; 11. Ndryshimet klimatike dhe moti i ashpër.
Faktorët kryesorë që e rrezikojnë këtë lloj kanë të bëjnë me: veprimtaritë që vijnë nga amvisëritë dhe zonat urbane, veprimtaritë nga turizmi dhe rekreacioni, ndryshimet klimatike dhe moti ekstrem.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloj i mbrojtur në Kosovë (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për llojet e tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.



4.8 AVES

Accipiter brevipes Severtsov, 1850

Gjeraqina këmbëshkurtër

Aves: Accipitriformes: Accipitridae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Cenuar, VU D2

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi[t]

Taulant Bino, Qenan Maxhuni

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e këtij lloji është 30–37 cm, mashkulli peshon 140–275 g, femra 183–290 g, kurse hapja e krahëve është 64–74 cm. Është lloj shtegtar. Ushqehet kryesisht me hardhuca dhe insekte të mëdha (BirdLife International 2018a).

Habitati

Lloji i habitatit: 1 Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare); 14. Artificiale/tokësore (14.3. Plantacione).
Ky lloj mund të gjendet në fusha pyjore, shpesh pranë ujit, dhe mund të gjendet deri në 1000 m (BirdLife International 2018a).

Përhapja e përgjithshme

Europa juglindore dhe lindore, Ukraina dhe Rusia jugperëndimore deri në Kazakistanin perëndimor, më shumë i lokalizuar në Turqi, Kaukaz, Irak dhe Iran. Mendohet se dimëron kryesisht në zonën lindore të Sahelit të Afrikës nënsahariane.

Përhapja në Kosovë

Dy lokalitete afër fshatit Gjurgjedell.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj vlerësohet si: I Cenuar, sepse është lloj i rrallë dhe habitati i folezimit është nën presion nga prerja e pakontrolluar e pyjeve. Zona e pranisë ZP është shumë e kufizuar (8 km2) dhe numri i lokacioneve është i vogël (≤ 5).

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 2 Bujqësia dhe akuakultura (2.2 Plantacionet e drurit dhe pulpës); 3 Prodhimi dhe minierat energjetike (3.3 Energjia e ripërtërishme); 5) Përdorimi i burimeve biologjike (5.1 Gjuetia dhe grumbullimi i kafshëve tokësore: 5.1.1 Përdorimi i qëllimshëm (lloji që vlerësohet është i synuar), 5.1.3 Persekutimi/kontrollimi, 5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve: 5.3.3 Efektet e padëshiruara: vjelja për jetesë/në shkallë të vogël (lloji që vlerësohet nuk është i synuar); 12 Opsione të tjera (12.1 Kërcënim tjetër (helmimi)).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Është lloj i mbrojtur në Kosovë (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës, 1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve). 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës); 5 Ligji dhe politika (5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi). **Hulumtimi i nevojshëm:** 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit). gjendet.

Referencat

BirdLife International 2018a





Alcedo atthis Linnaeus, 1758

Bilbili i ujit

Aves: Coraciiformes: Alcedinidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Cenuar, VU B2ab(iii)

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Taulant Bino, Qenan Maxhuni

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e këtij lloji është 16–18 cm, mashkulli peshon 23–35 g, kurse femra 30–35 g. Në pjesën më të madhe të rangut të tij të përhapjes, është bilbili i ujit i vetëm i vogël. Popullatat jugore janë sedentare, kurse të tjerat shtegtojnë. Ushqehen me peshq, insekte të ujit, flutura, ujëtokësorë, gaforre dhe izopode (BirdLife International 2016i).

Habitati

Lloji i habitatit: 5 . Vendet ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat), 5.4 Këneta, moçale, moçalishte, 5.5 Liqene të përhershme të ujërave të ëmbla (mbi 8ha); 15. Artificiale/ujore (15.2. Pellgjet (nën 8ha), 15.5 Gërmimet (e hapura), 15.9 Kanalet dhe kanalet e kullimit).
Ky lloj parapëlqen ujërat e ndenjura ose me rrjedhje të ngadaltë me shumë peshq të vegjël në to, si dhe me kallame apo shkurre në brigje. Përrenjtë, lumenjtë e vegjël dhe kanalet janë më të parapëlqyera, por gjithashtu edhe liqenet dhe pellgjet. Brigjet e përshtatshme janë të nevojshme për folezim gjatë periudhës së folezimit (BirdLife International 2016i).

Përhapja e përgjithshme

Afrikë veriperëndimore dhe Spanjë jugore dhe lindore deri në Bullgari në lindje, Afganistan dhe Indi veriperëndimore, pastaj në veri deri në qendër të Siberisë dhe Kinës veriperëndimore; dimëron në jug të Egjiptit, Sudan verilindor, Oman dhe Pakistan.

Përhapja në Kosovë

Badovc, Liqeni i Radoniqit, Kamenicë, Liqeni i Livoqit, Obiliq, Fushë Kosovë.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: I Cenuar, për shkak të numrit të lokacioneve, që është 6, zonës së pranisë ZP, që është 24 km2, shtrirjes së përhapjes SHP, që është 1303 km2 dhe rënies së pritur të cilësisë së habitatit. Habitatet folezuese të këtij lloji janë nën presion direkt nga prerja e pakontrolluar e pyjeve.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 3 Prodhimi dhe minierat e energjisë (3.2 Miniera dhe gurore); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.1 Gjuetia dhe grumbullimi i kafshëve tokësore: 5.1.1 Përdorimi i qëllimshëm (lloji që vlerësohet është i synuar); 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.3 Punë dhe aktivitete të tjera).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Është lloj i mbrojtur në Kosovë (Udhëzim Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt Të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës, 1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve). 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës); 5 Ligji dhe politika (5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Të vazhdohet me monitorimin e vendeve folezuese. Ruajtja e lumenjve dhe përroskave duhet të ndërmjetësohet nëpërmjet industrisë, bujqësisë dhe autoriteteve ujore.

Referencat

BirdLife International 2016i





Alectoris graeca Meisner, 1804

Thëllëza e malit

Aves: Galliformes: Phasianidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Gati i Kërcënuar, NT

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Cenuar, VU D1+2

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Qenan Maxhuni, Taulant Bino

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e këtij lloji është 32–37 cm, pesha te mashkulli është 550–850 g, te femra 410–720 g, kurse hapja e krahëve 46–53 cm. Është lloj i përhershëm monogam dhe ushqehet kryesisht me pjesë të bimëve si fara, frute, kërcej dhe gjethe. Nuk shtegton, por gjatë vitit kryen vetëm shtegtime të vogla vertikale.

Habitati

Lloji i habitatit: 1 Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare); 3. Shkurre (3.8. Vegjetacion shkurror i tipit mesdhetar).
Ky lloj mund të gjendet në tipa të ndryshme habitatesh dhe në lartësi të ndryshme mbidetare, deri në 3000 m në Alpe dhe krejtësisht në nivel deti në Shqipëri. Përgjithësisht, lloji parapëlqen habitate të hapura, malore me zona me barishtore, shkurre të ulëta dhe pjesërisht pyje halore (BirdLife International 2018).

Përhapja e përgjithshme

Lloj endemik i Europës. Gjendet vetëm në Alpe, Apenine, Sicili dhe Ballkan.

Përhapja në Kosovë

Mushtishtë, Restelicë, Prush.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: I Cenuar, për shkak të numrit të vogël të individëve të rritur (më pak se 1 000), zonës së pranisë ZP të vogël (12 km2) dhe numrit të lokacioneve, që është 3. Kërcënim serioz për këtë lloj në një të ardhme të afërt paraqet humbja e habitatit dhe degradimi i tij.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.1 Gjuetia dhe grumbullimi i kafshëve tokësore: 5.1.1 Përdorimi i qëllimshëm (lloji që vlerësohet është i synuar) 6 Ndërhyrjet njerëzore dhe shqetësimet (6.1 Aktivitetet rekreative) 11 Ndryshimet klimatike dhe moti i ashpër (11.2 Thatësirat).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Është lloj i mbrojtur në Kosovë (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës, 1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve). 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës); 5 Ligji dhe politika (5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Duhet përmirësuar njohuritë mbi efektet e gjuetisë në këtë lloj. Të zbatohen masa për të reduktuar braktisjen e aktiviteteve tradicionale agropastorale. Duhet përmirësuar legjislacioni dhe zbatimi i tij, për të zvogëluar gjuetinë e paqëndrueshme dhe atë jolegale.

Referencat

BirdLife International 2018





Alcedo atthis Linnaeus, 1758

Bilbili i ujit

Aves: Coraciiformes: Alcedinidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Cenuar, VU B2ab(iii)

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Taulant Bino, Qenan Maxhuni

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e këtij lloji është 16–18 cm, mashkulli peshon 23–35 g, kurse femra 30–35 g. Në pjesën më të madhe të rangut të tij të përhapjes, është bilbili i ujit i vetëm i vogël. Popullatat jugore janë sedentare, kurse të tjerat shtegtojnë. Ushqehen me peshq, insekte të ujit, flutura, ujëtokësorë, gaforre dhe izopode (BirdLife International 2016i).

Habitati

Lloji i habitatit: 5 . Vendet ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat), 5.4 Këneta, moçale, moçalishte, 5.5 Liqene të përhershme të ujërave të ëmbla (mbi 8ha); 15. Artificiale/ujore (15.2. Pellgjet (nën 8ha), 15.5 Gërmimet (e hapura), 15.9 Kanalet dhe kanalet e kullimit).
Ky lloj parapëlqen ujërat e ndenjura ose me rrjedhje të ngadaltë me shumë peshq të vegjël në to, si dhe me kallame apo shkurre në brigje. Përrenjtë, lumenjtë e vegjël dhe kanalet janë më të parapëlqyera, por gjithashtu edhe liqenet dhe pellgjet. Brigjet e përshtatshme janë të nevojshme për folezim gjatë periudhës së folezimit (BirdLife International 2016i).

Përhapja e përgjithshme

Afrikë veriperëndimore dhe Spanjë jugore dhe lindore deri në Bullgari në lindje, Afganistan dhe Indi veriperëndimore, pastaj në veri deri në qendër të Siberisë dhe Kinës veriperëndimore; dimëron në jug të Egjiptit, Sudan verilindor, Oman dhe Pakistan.

Përhapja në Kosovë

Badovc, Liqeni i Radoniqit, Kamenicë, Liqeni i Livoqit, Obiliq, Fushë Kosovë.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: I Cenuar, për shkak të numrit të lokacioneve, që është 6, zonës së pranisë ZP, që është 24 km2, shtrirjes së përhapjes SHP, që është 1303 km2 dhe rënies së pritur të cilësisë së habitatit. Habitatet folezuese të këtij lloji janë nën presion direkt nga prerja e pakontrolluar e pyjeve.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 3 Prodhimi dhe minierat e energjisë (3.2 Miniera dhe gurore); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.1 Gjuetia dhe grumbullimi i kafshëve tokësore: 5.1.1 Përdorimi i qëllimshëm (lloji që vlerësohet është i synuar); 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.3 Punë dhe aktivitete të tjera).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Është lloj i mbrojtur në Kosovë (Udhëzim Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt Të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës, 1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve). 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës); 5 Ligji dhe politika (5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Të vazhdohet me monitorimin e vendeve folezuese. Ruajtja e lumenjve dhe përroskave duhet të ndërmjetësohet nëpërmjet industrisë, bujqësisë dhe autoriteteve ujore.

Referencat

BirdLife International 2016i





Falco biarmicus Schlegel, 1843

Skifteri i Mesdheut

Aves: Falconiformes: Falconidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Gati i Kërcënuar, NT

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
I Cenuar, VU D2

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Taulant Bino

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e këtij lloji është 32–37 cm, pesha te mashkulli është 550–850 g, te femra 410–720 g, kurse hapja e krahëve 46–53 cm. Është lloj i përhershëm monogam dhe ushqehet kryesisht me pjesë të bimëve si fara, frute, kërcej dhe gjethe. Nuk shtegton, por gjatë vitit kryen vetëm shtegtime të vogla vertikale.

Habitati

Lloji i habitatit: 1 Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare); 3. Shkurre (3.8. Vegjetacion shkurror i tipit mesdhetar).
Ky lloj mund të gjendet në tipa të ndryshme habitatesh dhe në lartësi të ndryshme mbidetare, deri në 3000 m në Alpe dhe krejtësisht në nivel deti në Shqipëri. Përgjithësisht, lloji parapëlqen habitate të hapura, malore me zona me barishtore, shkurre të ulëta dhe pjesërisht pyje halore (BirdLife International 2018).

Përhapja e përgjithshme

Lloj endemik i Europës. Gjendet vetëm në Alpe, Apenine, Sicili dhe Ballkan.

Përhapja në Kosovë

Mushtishtë, Restelicë, Prush.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar si: I Cenuar, për shkak se është shumë i rrallë dhe habitatet e tij folezuese janë nën presion nga prerja e pakontrolluar e pyjeve. Popullata është shumë e kufizuar (zona e pranisë ZP < 20 km2) dhe numri i lokacioneve është 1, edhe pse presim të jetë i pranishëm në më shumë lokacione, por jo më shumë se 5.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 2 Bujqësia dhe akuakultura (2.1 Kulturat vjetore dhe shumëvjeçare jodrusore); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.1 Gjuetia dhe grumbullimi i kafshëve tokësore: 5.1.2 Efektet e padëshiruara (lloji që vlerësohet nuk është i synuar), 5.1.3 Persekutimi/kontrolli, 5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve: 5.3.4 Efektet e padëshiruara: në shkallë të gjerë (lloji që vlerësohet nuk është i synuar) [vjelja]).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloj i mbrojtur në Kosovë (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës, 1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve). 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës); 5 Ligji dhe politika (5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Monitorim sistematik. Mbrojtja e lokaliteteve ku gjendet lloji. Rritja e vetëdijes për mbrojtjen e tij.

Referencat

BirdLife International 2016k





4.9 MAMMALIA

Rhinolophus blasii Peters, 1866

Lakuriq nate hundëpatkua i Blasius-it

Aves: Accipitriformes: Accipitridae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

I Cenuar, VU

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

I Cenuar, VU B2ab(ii,iii)

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Philippe Théou

Të dhëna të përgjithshme

Ky është një lloj lakuriqi hundëpatkua me madhësi mesatare, me një gjatësi prej 46,5- 56 mm dhe një peshë prej 12 deri në 15 g. Konsiderohet si lloj sedentar. Dimrin e kalon në vende nëntokësore. Në rajonin e Mesdheut zakonisht ushqen në shkurre dhe pyje, edhe pse mund të depërtojë në habitatin e shkretëtirës (Amr 2000). Kolonitë mbarështuese verore janë të vendosura në vende nëntokësore natyrore dhe artificiale, kurse në disa zona përdoren edhe nënkulmet (Taylor 2016a).

Habitati

Lloji i habitatit: 1 Pyje, 2. Savana, 3. Shkurre, 7. Shpella dhe habitate nëntokësore (joujore), 8. Shkretëtira.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Afrikë, Azi.

Përhapja në Kosovë

Shpella e Banuar, Gryka e Rugovës, Shpella e Radavcit (Paunović 2016; Presetnik *et al.* 2018).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për trendin e popullatave në Kosovë. Trendi i popullatave në nivel europian është në rënie.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar si: I Cenuar, për shkak të numrit të kufizuar të lokacioneve, që në këtë rast është 3, zonës së pranisë ZP, që është 12 km2, shtrirjes së përhapjes SHP, që është 181 km2, si dhe rënies së projektuar të popullatës, bazuar në zonën e pranisë ZP dhe rënien e kualitetit të habitatit. Ky lloj pritet nga më shumë lokacione, sidoqoftë ≤ 10.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore.
Kërcënimet kryesore që e rrezikojnë këtë lloj, kanë të bëjnë me fragmentimin dhe izolimin e habitateve, ndryshimet në regjimin menaxhues të pyjeve gjethegjera dhe tokave bujqësore, humbjen e popullatave të insekteve si rezultat i përdorimit të pesticideve, si dhe prishjen dhe humbjen e habitateve nëntokësore dhe nënkulmeve.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1.Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për llojet e tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Amr 2000; Paunović 2016; Presetnik *et al.* 2018; Taylor 2016a



LLOJET GATI TË KËRCËNUARA (NT)

5.1 GASTROPODA

Campylaea ljubetenensis A.J. Wagner, 1914

Gastropoda: Stylommatophora: Helicidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Zoltán Fehér

Të dhëna të përgjithshme

Guaska e këtij lloji është diskoidale me ngjyrë të verdhë në të bardhë me tre shirita të kaftë, i ka 4-5 përdredhje të shtrira, pjesa e epërme pothuajse e rrafshët, pjesa e poshtme konvekse, dredha e fundit rrethore dhe thellësisht e rënë afër aperturës, margjinat e bardha dhe lehtas të trasha, të palidhura me anën paerietale, umbilikusi i ngushtë. Gjatësia e guaskës është 13-18 mm, kurse gjerësia 23-25 mm. Sipas listës së Fauna Europaea, ky lloj konsiderohet si nënlloj i Cattania trizona (Rossmässler, 1835), por sipas Groenenberg *et al.* (2016) ky është një lloj i veçantë dhe i takon gjinisë Campylaea.

Habitati

Lloji i habitatit: 6 Zona shkëmbore [p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore].
Ky lloj banon në habitatet e shkëmbinjve gëlqerorë. Habitatet e përshtatshme përfshijnë shkëmbinj të vegjël deri të mëdhenj dhe gryka, ku ato gjenden në çarje ose midis gurëve.

Përhapja e përgjithshme

Kosovë, Maqedoni (Dedov 2003).

Përhapja në Kosovë

Gllobogicë.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Megjithëse pak dihet rreth trendit të tanishëm të popullatës, nuk ka arsye të supozojmë ndonjë luhatje ekstreme ose rënie të numrit të individëve maturë, sepse habitati gëlqeror, ku ndodhen këto kafshë, nuk është i kërcënuar nga aktiviteti njerëzor.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është endemik Lubotenit, në pjesën lindore të Bjeshkëve të Sharrit, në zonën ndërkufitare Kosovë-Maqedoni (Dedov 2003). Në Kosovë, zona e pranisë ZP është më e vogël se 20 km2 dhe numri i lokacioneve është më i vogël se 5. Duke qenë një lloj që jeton në zona shkëmbore gëlqerore, nuk është i ndjeshëm ndaj modifikimeve të ekosistemit apo rreziqeve të tjera reale, prandaj vlerësohet si: Gati i Kërcënuar, në nivel vendi. Nga Kosova pritet të gjenden edhe nënpopullata të tjera.

Kërcënimet

Aktualisht, nuk ka ndonjë kërcënim.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Sipas njohurive të tanishme, kushtet e habitatit luajnë një rol kyç në ruajtjen e këtij lloji dhe nëse nuk ndryshojnë, mbijetesa e llojit duket e garantuar.

Referencat

Dedov 2003; Groenenberg *et al.* 2016





Helix dormitoris Kobelt, 1898

Gastropoda: Stylommatophora: Helicidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Zoltán Fehér

Të dhëna të përgjithshme

Guaska e këtij lloji është e rrumbullakët (krahasuar me llojet e tjera të kësaj gjinie) me ngjyrë hiri në të bardhë me pesë shirita spiralë ngjyrë gështenje, nga të cilët i dyti dhe i treti janë të fuzionuar në një shirit. I ka 3-4 përdredhje, sipërfaqja e guaskës është e lëmuar me brirëza aksialë të imët dhe disa ngushtime spirale nënsuturale. Përdredhja e fundit lehtas në rënie drejt periferisë, apertura rrethore, hyrja e aperturës e ngushtë, kallusi labial i dobët me ngjyrë kremi në të bardhë, trekëndëshi kolumelar i vogël, umbilikusi i mbyllur në guaskat e të rriturve. Gjatësia e guaskës është 33-47 mm, kurse gjerësia 30-43 mm.

Habitati

Lloji i habitatit: 1 Pyje [1.4 Pyje të klimës mesatare]; 4. Kullosa [4.4 Kullosa të klimës mesatare]; 6 Zona shkëmbore [p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore]
Ky lloj është i lidhur me habitate shkëmbore gëlqerore, shkurre gurore, pyje dhe kullosa gurore.

Përhapja e përgjithshme

Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë, Mali i Zi, Maqedoni, Serbi, Shqipëri.

Përhapja në Kosovë

Hajle [Knipper 1939; Neubert 2014].

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Megjithëse pak dihet rreth trendit të tanishëm të popullatës, nuk ka arsye të supozojmë ndonjë luhatje ekstreme ose rënie të numrit të individëve maturë, sepse habitati gëlqeror, ku ndodhen këto kafshë, nuk është i kërcënuar nga aktiviteti njerëzor [Fehér 2011a].

Arsyetimi i vlerësimit

Ky është një lloj endemik i Ballkanit me disa gjetje të shkapërderdhura në Kosovë. Zona e pranisë ZP është më e vogël se 20 km2 dhe numri i lokacioneve më i vogël se 5. Është i lidhur me habitate shkëmbore në bazë gëlqerore, të cilat nuk janë të kërcënuara nga aktivitetet njerëzore dhe prandaj nuk ka arsye për të supozuar se zona e pranisë ZP, numri i lokacioneve, numri i nënpopullatave apo cilësia e habitatit janë duke rënë ose duke u luhatur në mënyrë të skajshme. Për këtë arsye, ky lloj vlerësohet si: Gati i Kërcënuar, në nivel vendi.

Kërcënimet

Nuk ka ndonjë kërcënim aktual.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit [1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës]
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi [1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia]; 3. Monitorimi [3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit].
Sipas njohurive tona të tanishme, kushtet e habitatit luajnë një rol kyç në ruajtjen e këtij lloji dhe nëse nuk ndryshojnë, mbijetesa e llojit duket e garantuar.

Referencat

Fehér 2011a; Knipper 1939; Neubert 2014





Herilla illyrica Moellendorff, 1899

Gastropoda: Stylommatophora: Clausiliidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Zoltán Fehér

Të dhëna të përgjithshme

Guaska fusiforme me 11-13 përdredhje. Përdredhjet trupore janë ngjyrë kafe, kurse përdredhjet e mëhershme me ngjyrë vjollce të çelët, sipërfaqja është gati e lëmuar. Gjatësia e guaskës është 20 – 31 mm, kurse gjerësia 5 – 8.5 mm (Nordsieck 1971; Wagner 1919a; Welter-Schultes 2012). Ky është një lloj i ndërlidhur me gurë dhe zona gëlqerore, por mund të gjendet edhe në çarje ose në bazë të gurëve. Në Kosovë është gjetur tash vonë nënlloji Herilla illyrica diabasis (Wagner, 1919). Janë të njohura gjashtë nënlloje të këtij lloji.

Habitati

Lloji i habitatit: 6 Zona shkëmbore [p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore].
Ky lloj banon në habitatet e shkëmbinjve gëlqerorë, dhe gjendet në çarje ose midis gurëve dhe nën gurë (Fehér and Erőss 2009). Habitatet e përshtatshme përfshijnë shkëmbinj të vegjël deri të mëdhenj, gryka dhe pyje shkëmbore.

Përhapja e përgjithshme

Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë, Mali i Zi, Shqipëri.

Përhapja në Kosovë

Shkozë.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Megjithëse pak dihet rreth trendit të tanishëm të popullatës, nuk ka arsye të supozojmë ndonjë luhatje ekstreme ose rënie të numrit të individëve maturë, sepse habitati gëlqeror, ku ndodhen këto kafshë, nuk është i kërcënuar nga aktiviteti njerëzor.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky është një lloj endemik i Ballkanit perëndimor [Reischütz 2017a] dhe pjesa juglindore e përhapjes së tij shtrihet në Kosovë. Në Kosovë, zona e pranisë ZP është më e vogël se 20 km2 dhe numri i lokacioneve është më pak se 5. Duke qenë një lloj që banon në zona shkëmbore, nuk është shumë i ndjeshëm në modifikimet e ekosistemit apo nga kërcënime të tjera reale. Për shkak të këtyre argumenteve, nuk ka ndonjë arsye për të supozuar se popullata e këtij lloji, cilësia e habitatit apo shtrirja e tij janë duke rënë apo në luhatje ekstreme, prandaj ky lloj vlerësohet si: Gati i Kërcënuar, në nivel vendi.

Kërcënimet

Aktualisht, nuk ka ndonjë kërcënim.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit [1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës].
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi [1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia]; 3. Monitorimi [3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit].
Sipas njohurive të tanishme, kushtet e habitatit luajnë një rol kyç në ruajtjen e këtij lloji dhe nëse nuk ndryshojnë, mbijetesa e llojit duket e garantuar.

Referencat

Fehér and Erőss 2009; Nordsieck1971; Reischütz 2017; Wagner 1919a; Welter-Schultes 2012





Macedonica frauenfeldi Rossmässler, 1856

Gastropoda: Stylommatophora: Helicidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Zoltán Fehér

Të dhëna të përgjithshme

Guaska është e zgjatur fusiforme me 10-11 përdredhje me ngjyrë të çelët qershie kah e kafta, shpesh me bri ngjyrë të kaltër, me sipërfaqe gati të lëmuar ose lehtas të shtresuar. Gjatësia e guaskës 17 – 24 mm, kurse gjerësia 4-5.5 mm. Ky është një lloj i obligueshëm shkëmbor, i lidhur me zona gëlqerore. Zakonisht, mund të gjendet në sipërfaqe të hapur të shkëmbinjve ose në bazën e tyre (Dedov 2017a; Welter-Schultes 2012). Në Kosovë është prezent nënlloji Macedonica frauenfeldi occidentalis S. H. F. Jaeckel, 1954, e ky është njëri nga 8 nënllojet e njohura (Jaeckel 1954).

Habitati

Lloji i habitatit: 6 Zona shkëmbore [p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore]
Ky lloj banon në habitatet e shkëmbinjve gëlqerorë dhe gjendet në çarje ose midis dhe nën gurë. Habitatet e përshtatshme përfshijnë shkëmbinj të vegjël deri të mëdhenj, gryka dhe pyje shkëmbore.
kullosa gurore.

Përhapja e përgjithshme

Endemik i Ballkanit. Bullgari, Kosovë dhe Serbi. Nënlloji occidentalis është i njohur vetëm nga Kosova.

Përhapja në Kosovë

Prizren, Mirushë, Istog.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Megjithëse pak dihet rreth trendit të tanishëm të popullatës, nuk ka arsye të supozojmë ndonjë luhatje ekstreme ose rënie të numrit të individëve maturë, sepse habitati gëlqeror, ku ndodhen këto kafshë, nuk është i kërcënuar nga aktiviteti njerëzor.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky është lloj endemik i pjesës qendrore të Ballkanit ku pjesa jugperëndimore e përhapjes së tij shtrihet deri në Kosovë. Në Kosovë, zona e pranisë ZP është më e vogël se 20 km2 dhe numri i lokacioneve është më pak se 5. Duke qenë një lloj që banon në zona shkëmbore, nuk është shumë i ndjeshëm në modifikimet e ekosistemit apo nga kërcënime të tjera reale. Për shkak të këtyre argumenteve, nuk ka ndonjë arsye për të supozuar se popullata e këtij lloji, cilësia e habitatit apo shtrirja e tij janë duke rënë apo në luhatje ekstreme, prandaj ky lloj vlerësohet si: Gati i Kërcënuar, në nivel vendi.

Kërcënimet

Nuk ka ndonjë kërcënim aktual.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse. Të paktën, një nga nënpopullatat e njohura gjendet brenda një zone të mbrojtur.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës)
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Sipas njohurive tanishme, kushtet e habitatit luajnë një rol kyç në ruajtjen e këtij lloji dhe nëse nuk ndryshojnë, mbijetesa e llojit duket e garantuar.

Referencat

Dedov 2017a; Jaeckel 1954; Welter-Schultes 2012





Orcula wagneri Sturany, 1914

Gastropoda: Stylommatophora: Orculidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Gati i Kërcënuar, NT

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Zoltán Fehér

Të dhëna të përgjithshme

Guaska pupiforme me maje të gjerë konike rrethore, me ngjyrë të verdhë ose në të kuqe, me brirëza periostrakalë, që prodhojnë shkëlqim të mëndafshtë, i ka 7-8 përdredhje të lehta konvekse, e fundit e të cilave lehtas në rënie, apertura me kallus të fortë palatal, umbilikusi shumë i ngushtë. Gjatësia e guaskës është 5.3 – 6.5 mm, kurse gjerësia 2.9 – 3.3 mm (Harl *et al.* 2011; Sturany and Wagner 1915). Ky lloj, zakonisht, gjendet nën gurë apo midis tufave të barit. Sipas Fauna Europaea, ekzistojnë dy nënlloje të këtij lloji, O. w.wagneri Sturany, 1914 dhe O.w. ljubetensis Sturany, 1914. Lidhja midis tyre, sikundër edhe me O. schmidtii (Küster, 1843) duhet të qartësohet (Harl *et al.* 2014).

Habitati

Lloji i habitatit: 4 Kullosa (4.4. Kullosa të klimës mesatare); 6. Zona shkëmbore (p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore).
Ky lloj mund të gjendet në livadhe alpine dhe subalpine (mbi 1800-2000 m) në substrate gëlqerore dhe haset zakonisht nën gurë dhe midis tufave të barit, e nganjëherë në afërsi të bazës së shkëmbinjve të mëdhenj.

Përhapja e përgjithshme

Greqi, Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi, Serbi, Shqipëri.

Përhapja në Kosovë

Luboten, Brezovicë, Rapçe, Radevë, Koshutan.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Megjithëse pak dihet rreth trendit të tanishëm të popullatës, nuk ka arsye të supozojmë ndonjë luhatje ekstreme ose rënie të numrit të individëve adultë, sepse habitati gëlqeror, ku ndodhen këto kafshë, nuk është i kërcënuar nga aktiviteti njerëzor.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj haset sporadikisht në malet më të larta të disa vendeve ballkanike (Páll-Gergely 2011). Zona e pranisë ZP është nën 20 km2 dhe numri i lokacioneve të njohura është nën 5. Ky lloj jeton kryesisht në kullosa alpine dhe subalpine, nën dhe ndërmjet gurëve. Edhe pse ky habitat është potencialisht i ndjeshëm ndaj ndryshimeve dhe çrregullimeve të ekosistemit, megjithatë, nuk ka ndonjë kërcënim aktual, që do të ndikonte në nënpopullatat në Kosovë. Me gjasë, nënpopullata të tjera do të gjenden, prandaj vlerësohet si: Gati i Kërcënuar, në nivel vendi.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.3. Modifikime të tjera të ekosistemit).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Sipas njohurive të tanishme, kushtet e habitatit luajnë një rol kyç në ruajtjen e këtij lloji dhe nëse nuk ndryshojnë, mbijetesa e llojit duket e garantuar.

Referencat

Harl *et al.* 2011; Harl *et al.* 2014; Páll-Gergely 2011; Sturany and Wagner 1915





Paraegopis mauritii Westerlund, 1886

Gastropoda: Stylommatophora: Helicidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Zoltán Fehér

Të dhëna të përgjithshme

Guaska diskoide, me ngjyrë kafe, dendësisht e shtresuar në anën e epërme. Ana e poshtme lehtas më e çelët, e lëmuar dhe e shkëlqyer, me 5.5-5 përdredhje lehtas konvekse nga të cilat të epërmet janë të përkulura, kurse e fundit e përmbyllur. Apertura është me buzën e brendshme të dobët dhe të bardhë, umbilikusi është i gjerë dhe perspektivor. Gjatësia e guaskës është 8-14 mm, kurse gjerësia 18-28 mm (Riedel 2000).

Habitati

Lloji i habitatit: 6 Zona shkëmbore [p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore]; 3. Shkurre [3.8 Vegjetacion shkurror mesdhetar].
Ky lloj është i lidhur me habitate gurore gëlqerore, si pyje gurore apo shkurre gurore, ku zakonisht gjendet në të çarat dhe midis gjetheve në shpërbërje e sipër në bazën e shkëmbinjve.

Përhapja e përgjithshme

Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë, Kroaci, Mali i Zi, Serbi.

Përhapja në Kosovë

Dushkajë.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Megjithëse pak dihet rreth trendit të tanishëm të popullatës, nuk ka arsye të supozojmë ndonjë luhatje ekstreme ose rënie të numrit të individëve adultë, sepse habitati gëlqeror, ku ndodhen këto kafshë, nuk është i kërcënuar nga aktiviteti njerëzor (Slapnik 2007).

Arsyetimi i vlerësimit

Ky është një lloj endemik i Ballkanit perëndimor, pjesa juglindore e arealit të të cilit shtrihet në Kosovë. Në Kosovë, zona e pranisë ZP është nën 20 km2 dhe numri i lokacioneve është nën 5. Ky lloj është i lidhur me habitate gëlqerore shkëmbore, prandaj nuk është shumë i ndjeshëm ndaj modifikimeve të ekosistemit ose kërcënimeve të tjera reale. Ky lloj, siç duket, ka përhapje ndërkufitare në Moknë. Për shkak të mundësisë së migrimit dhe rikolonizimit të nënpopullatave nga vendet fqinje, lloji nënlistohet për një kategori si: Gati i Kërcënuar, në nivel vendi

Kërcënimet

Nuk ka ndonjë rrezik aktual.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit [1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës].
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi [1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia]; 3. Monitorimi [3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit].
Sipas njohurive të tanishme, kushtet e habitatit luajnë një rol kyç në ruajtjen e këtij lloji dhe nëse nuk ndryshojnë, mbijetesa e llojit duket e garantuar.

Referencat

Riedel 2000; Slapnik 2017.





Protoherilla baleiformis Boettger, 1909

Gastropoda: Stylommatophora: Clausiliidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Zoltán Fehér

Të dhëna të përgjithshme

Guaska është e fryrë fusiforme, me ngjyrë kafe apo ulliri në të gjelbër, e shtresuar dobët me 8 – 10 përdredhje mesatarisht konvekse. Margjinat e aperturës lehtas të reflektueshme, palimi parietal i shkurtër dhe i dobët, lamela është spirale, lunela dhe palimi bazal mungojnë, lamela nënkolumellare është e dukshme në aperturë. Gjatësia e guaskës 9 – 11 mm, kurse gjerësia 3 – 3.5 mm.

Habitati

Lloji i habitatit: 1 Pyje [1.4 Pyje të klimës mesatare]; 4. Kullosa [4.4 Kullosa të klimës mesatare]; 6 Zona shkëmbore [p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore].
Ky lloj gjendet në kullosa alpine dhe subalpine, si dhe në rrëpira në bazën e shkëmbinjve më të mëdhenj, ku zakonisht gjendet nën dhe midis gurëve. Ky lloj është i lidhur shpeshherë me bazë shkëmbore gëlqerore, edhe pse jo gjithmonë.

Përhapja e përgjithshme

Kosovë, Mali i Zi, Shqipëri.

Përhapja në Kosovë

Zhleb [Reischütz 2017b; Urbański 1977; Wagner 1921].

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është endemik i Bjeshkëve të Nemuna në zonën ndërkufitare Kosovë - Mali i Zi -Shqipëri. Zona e pranisë ZP në Kosovë është nën 20 km2 dhe numri i lokacioneve të njohura është nën 5. Edhe pse habitati i tij është potencialisht i ndjeshëm ndaj shqetësimeve dhe modifikimeve të ekosistemit, megjithatë, nuk ka ndonjë kërcënim aktual që ndikon në nënpopullatën në Kosovë. Përveç kësaj, pritet të gjinden edhe nënpopullata të tjera. Prandaj, ky lloj vlerësohet në kategorinë: Gati i Kërcënuar, në nivel vendi.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 7 Modifikimet e sistemeve natyrore [7.3. Modifikime të tjera të ekosistemit].

Masat ekzistuese mbrojtëse

Popullata e njohur gjendet brenda zonës së mbrojtur.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit [1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës]
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi [1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia]; 3. Monitorimi [3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit].
Sipas njohurive të tanishme, kushtet e habitatit luajnë një rol kyç në ruajtjen e këtij lloji dhe nëse nuk ndryshojnë, mbijetesa e llojit duket e garantuar.

Referencat

Reischütz 2017b; Urbański 1977; Wagner 1921





Protoherilla pseudofallax Nordsieck, 1972

Gastropoda: Stylommatophora: Clausiliidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Zoltán Fehér

Të dhëna të përgjithshme

Guaska është e fryrë fusiforme, me ngjyrë kafe ose ulliri, lehtas e brirëzuar me 8 – 10 përdredhje. Cerviksi rrethor me përkulje të lehtë bazale, apertura e ngjitur, margjinat e saj të ngushta, lehtësisht të reflektueshme dhe të palidhura me anët parietale. Parietalisi i shkurtër, nuk e mbërrin spiralisin, pllaka e klausiliumit gjithmonë në tërësi e dukshme. Gjatësia e guaskës 11 – 14.5 mm, kurse gjerësia 3.5 – 4.5 mm (Nordsieck 1972).

Habitati

Lloji i habitatit: 1 Pyje (1.4 Pyje të klimës mesatare); 4. Kullosa (4.4 Kullosa të klimës mesatare); 6 Zona shkëmbore (p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore).
Ky lloj gjendet në kullosa alpine dhe subalpine, si dhe në rrëpira në bazën e shkëmbinjve më të mëdhenj, ku zakonisht gjendet nën dhe midis gurëve. Ky lloj gjithmonë është i lidhur, por jo ekskluzivisht, me bazën shkëmbore gëlqerore.

Përhapja e përgjithshme

Kosovë, Shqipëri, Mali i Zi.

Përhapja në Kosovë

Kuqishtë, Koshutanë, Strellc i Epërm.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është endemik i Bjeshkëve të Nemuna në zonën ndërkufitare Kosovë - Mali i Zi – Shqipëri (Reischütz 2017c). Zona e pranisë ZP në Kosovë është nën 20 km2 dhe numri i lokacioneve të njohura është nën 5. Ky lloj jeton kryesisht në kullosa gurore të zonave alpine dhe subalpine, nën apo mbi gurë. Ky habitat është potencialisht i ndjeshëm ndaj shqetësimeve dhe modifikimeve të ekosistemit, por nuk ka ndonjë kërcënim aktual që ndikon në nënpopullatat në Kosovë. Nga Kosova pritet të gjenden nënpopullata të tjera. Prandaj, ky lloj vlerësohet në kategorinë: Gati i Kërcënuar, në nivel vendi.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 7. Modifikimet e sistemeve natyrore (7.3. Modifikime të tjera të ekosistemit).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës)
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Sipas njohurive tona të tanishme, kushtet e habitatit luajnë një rol kyç në ruajtjen e këtij lloji dhe nëse nuk ndryshojnë, mbijetesa e llojit duket e garantuar.

Referencat

Nordsieck 1972; Reischütz 2017c.





Saxurinator schlickumi Schütt, 1960

Gastropoda: Littorinimorpha: Hydrobiidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Zoltán Fehér

Të dhëna të përgjithshme

Guaska është e ngushtë konike (gjatësia 1.8-2.0 mm, gjerësia 0.9-1.0 mm), me ngjyrë kah e bardha e tejdukshme, me mure të holla dhe aperturë trekëndëshe-ovoide të zgjeruar fuqishëm (Grego *et al.* 2017; Schütt 1960). Përcaktimi sistematik i këtij lloji aktualisht është i bazuar në morfologjinë e guaskës dhe prandaj është shumë i dyshimtë. Nuk mund të përjashtohet mundësia që ky lloj t'i takojë familjes Moitessieriidae. Në të ardhmen kjo do të zgjidhet me anë të analizave të ADN-së.

Habitati

Lloji i habitatit: 5 Vende ujore (kontinentale) (5.18 Sisteme ujore karstike dhe të tjera nëntokësore).
Është lloj nëntokësor. I banon akuiferët karstikë dhe ujërat intersticialë të shtresës nëntokësore të rërës në burimet karstike.

Përhapja e përgjithshme

Kosovë.

Përhapja në Kosovë

Burimi i Istogut, Pejë, Mitrovicë.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Nuk ka të dhëna të mjaftueshme rreth trendit të popullatës së këtij lloji (Seddon 2011b).

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është i njohur vetëm nga 3 lokalitete në veri të Kosovës. E ka një përhapje të kufizuar, zona e pranisë ZP është më e vogël se 20 km2, numri i nënpopullatave me gjasë është nën 5, por nuk ka ndonjë kërcënim aktual dhe prandaj vlerësohet si: Gati i Kërcënuar. Për shkak të jetesës së fshehur të llojit, në të ardhmen pritet që të gjenden nënpopullata/lokacione të tjera.

Kërcënimet

Aktualisht, nuk ka ndonjë kërcënim për llojin.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse. Dy nënpopullata janë brenda zonës së mbrojtur.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Sipas njohurive të tanishme, kushtet e habitatit luajnë një rol kyç në ruajtjen e këtij lloji dhe nëse nuk ndryshojnë, mbijetesa e llojit duket e garantuar. Në të njëjtën kohë, prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lokalitetin/lokalitetet ku gjendet dhe për lloje të tjera.

Referencat

Grego *et al.* 2017; Schütt 1960; Seddon 2011b





Vitrea kiliasi L. Pintér, 1972

Gastropoda: Stylommatophora: Pristilomatidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Zoltán Fehér

Të dhëna të përgjithshme

Guaska e këtij lloji është diskoidale, me ngjyrë në të bardhë, gati e lëmuar, zakonisht me më shumë se 5 përdredhje. Përdredhja e fundit gati dy herë më e gjerë se sa përdredhja e parafundit, umbilikusi shumë i gjerë, perspektivor, të gjitha përdredhjet mirë të dukshme nga brenda. Gjatësia e guaskës është 1.3 -1.5 mm, dhe gjerësia 3.3 – 3.5 mm.

Habitati

Lloji i habitatit: 6 Zona shkëmbore (p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore); 7. Shpella dhe habitate nëntokësore (joujore) (7.1 Shpella, 7.2 Habitate të tjera nëntokësore).
Një nga dy gjetjet e këtij lloji vjen nga shpella, kurse tjetri nga një pyll (Pintér 1972; Walther 2017). Pak dihet rreth preferencave të habitatit për këtë lloj, por, me gjasë, sikur llojet e tjera të së njëjtës gjini, edhe ky është i lidhur me habitate gurore gëlqerore. Bazuar në njohuritë nga llojet e përafërta, ky lloj nuk do të duhej të konsiderohej si banues i shpellës në kuptimin strikt, por, më tepër si një lloj që jeton në substrat të cekët mesovoid, për shembull, në çarjet dhe hapësirat e shkëmbinjve.

Përhapja e përgjithshme

Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë.

Përhapja në Kosovë

Radavc.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Megjithëse pak dihet rreth trendit të tanishëm të popullatës, nuk ka arsye të supozojmë ndonjë luhatje ekstreme ose rënie të numrit të individëve adultë, sepse habitati gëlqeror, ku ndodhen këto kafshë, nuk është i kërcënuar nga aktiviteti njerëzor.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj duket se ka një përhapje shumë sporadike në Ballkan. Pozita sistematike e nënpopullimeve të largëta duhet të sqarohet, por, deri atëherë vlerësimi bëhet sipas statusit aktual të llojit. Zona e pranisë ZP është nën 20 km2 dhe numri i lokacioneve të njohura është nën 5. Lloji është i lidhur me habitatet shkëmbore gëlqerore, me siguri jeton në substratet e cekëta mesovoide dhe për këtë arsye nuk është i ndikuar nga shqetësimet e shkaktuara nga njeriu dhe modifikimet e ekosistemit, prandaj vlerësohet si: Gati i Kërcënuar në nivel vendi.

Kërcënimet

Nuk ka ndonjë rrezik aktual.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Popullata e njohur është brenda zonës së mbrojtur.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Sipas njohurive të tanishme, kushtet e habitatit luajnë një rol kyç në ruajtjen e këtij lloji dhe nëse nuk ndryshojnë, mbijetesa e llojit duket e garantuar.

Referencat

Pintér 1972; Walther 2017





5.2 OLIGOCHAETA

Aporrectodea smaragdina Rosa, 1892

Oligochaeta: Opistophora: Lumbricidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Zoltán Fehér

Të dhëna të përgjithshme

Është lloj epigjeik, higrofil, me ngjyrë intensive me nuancë të gjelbër. Trupi është 40 – 90 mm i gjatë, i përbërë nga 65 deri në 120 segmente me turberkula pubertatis përgjatë segmenteve 29, 30, 32 dhe 33 (Mršić 1991). Ka përhapje dinariko-karpatike.

Habitati

Lloji i habitatit: 1 Pyje (1.4 Pyje të klimës mesatare]; 4 Kullosa (4.4 Kullosa të klimës mesatare]; 5 Vende ujore (kontinentale] (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat]]; 14 Artificiale/tokësore (14.1 Toka të punueshme, 14.2 Kullosa; 14.4 Kopshte rurale).
Ky lloj gjendet shpesh në dhera të zonave pyjore, kullosa, afër lumenjve, shkëmbinj gëlqerorë si dhe shkurre përgjatë rrugëve (Stojanović *et al.* 2018; Szederjesi 2013).

Përhapja e përgjithshme

Austri, Bosnjë-Hercegovinë, Itali, Kosovë, Kroaci, Mal i Zi, Poloni, Rumani, Serbi, Sllloveni (Mršić 1991; Rota 2013; Stojanović *et al.* 2008).

Përhapja në Kosovë

Çakorr (Šapkarev 1975).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj nuk është shumë i përhapur dhe gjendet kryesisht në zona pyjore përgjatë zonës alpino-dinariko-karpatike. Nuk kualifikohet për kategoritë e rrezikshmërisë, por, duke pasur parasysh trendin e degradimit të habitatit, mund të rrezikohet ndjeshëm në të ardhmen. Prandaj, e vlerësojmë llojin në kategorinë: Gati i Kërcënuar.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Popullata e njohur është brenda zonës së mbrojtur.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës, 1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve). 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 3. Monitorimi (3.1. Trendi i popullatës, 3.4. Trendi i habitatit).
Të promovohen praktikat menaxhuese të pylltarisë të orientuara kah konservimi, me prerje të reduktuara dhe sigurim të drurit të vdekur

Referencat

Mršić 1991; Šapkarev 1975; Stojanović *et al.* 2018; Szederjesi 2013



Dendrobaena alpina Rosa, 1884

Oligochaeta: Opistophora: Lumbricidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Lucija Šerić Jelaska

Të dhëna të përgjithshme

Ky është një lloj politipik, që shtrihet nga Franca përgjatë Europës qendrore dhe jugore deri në Turqi. Në Ballkan janë të njohura nënllojet D. a. popi dhe D. a. clujensis. Është lloj epigjeik, i cili gjendet në pyje të ahut (Szederjesi 2013), kryesisht në dhera të lagështa silikate, të zeza acidike ose të kafta podzole (Pop *et al.* 2007). Trupi është i kuqërremtë, 121 mm i gjatë, i përbërë nga 64 deri në 138 segmente. Klitelumi shtrihet nga segmentet 26, 27, 28 deri në 33, 34, kurse tuberkula pubertatis është prezente në segmentet 29, 30 deri në ½ 32 (Mršić 1991).

Habitati

Lloji i habitatit: 1 Pyje (1.4 Pyje të klimës mesatare).
Gjendet përgjatë shiritit subalpin të bimëve të gjinive Mugo, Juniperus dhe Vaccinium, si dhe në shiritin e pyjeve të bredhit ose pyjeve të përziera të bredhit dhe ahut (Pop *et al.*2007).

Përhapja e përgjithshme

Kosovë, Lindje e Afërt, Maqedoni, Mali i Zi, Poloni, Rumani, Serbi, Sllovaki, Sllloveni, Zvicër, Ukrainë, prezencë e dyshimtë në Gjermani (Rota 2013).

Përhapja në Kosovë

Çakorr (Šapkarev 1975; Mršić 1991).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj nuk është shumë i përhapur dhe gjendet kryesisht përgjatë zonës alpino-dinariko-karpatike në habitate të pyjeve alpine. Ky lloj nuk kualifikohet për kategoritë e rrezikshmërisë, por, për shkak të trendit të degradimit të habitatit e kemi vlerësuar në kategorinë: Gati i Kërcënuar, sepse mund të kërcënohet ndjeshëm në të ardhmen.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit, 11.2 Thatësirat).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Popullata e këtij lloji është në kuadër të zonës së mbrojtur.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Mršić 1991; Pop *et al.*2007; Rota 2013; Šapkarev 1975; Szederjesi 2013





5.3 INSECTA

Baetis buceratus Eaton, 1870

Insecta: Ephemeroptera: Baetidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Agim Gashi, Bardh Xërxa

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 7.5 – 11 mm. Nganjëherë larvat dominojnë në kushtet ß-mezosaprobe të ndotjes organike. Ky lloj i ka dy gjenerata në vit. Periudha e fluturimit është gjatë pranverës, verës dhe vjeshtës (Bauernfeind & Soldan 2012).

Habitati

Lloji i habitatit: 5 Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat]).
Larvat gjenden kryesisht në lumenj të mëdhenj fushorë. Preferojnë shpejtësi mesatare deri të lartë të rrjedhjes së ujit dhe substrat guror, por shpesh gjenden midis vegjetacionit ujor.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Azi. I përhapur gjerësisht në Palearktikun perëndimor.

Përhapja në Kosovë

Përroskë në Makovc, Përroskë në Mramor, Përroskë në Slivovë, Përroskë në Zhegër, Lumbardhi i Prizrenit në Vlashnje.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Të dhënat aktuale të izoluara (zona e pranisë ZP = 20 km2, shtrirja e përhapjes SHP = 3076 km2, numri i lokacioneve ≤ 10, rënia e cilësisë së habitatit) e kualifikojnë këtë lloj për kategoritë e rrezikimit. Sidoqoftë, rreziku i zhdukjes së këtij lloji është më i vogël se sa sugjerojnë këto të dhëna, sepse lloji, me gjasë është i pranishëm edhe në më shumë se 10 lokalitete në Kosovë, duke pasur parasysh praninë e habitateve potenciale të llojit dhe duke ditur mënyrën e përhapjes së tij. Për shkak të të gjitha këtyre argumenteve, lloji vlerësohet si: Gati i Kërcënuar.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrje dhe shqetësime njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)]; 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet]; 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).
Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj në Kosovë, janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera të rëndësishme dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Bauernfeind & Soldan 2012





Baetis melanonyx Pictet,1843

Insecta: Ephemeroptera: Baetidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Agim Gashi, Bardh Xërxa

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 7.9 – 11.5 mm. Është lloj univoltin veror, edhe pse në lokalitete të lartësive më të ulëta mbidetare është raportuar edhe si lloj me dy gjenerata në vit. Periudha e fluturimit është nga maji deri në pjesën e parë të korrikut, por në lartësi më të mëdha mbidetare periudha e fluturimit realizohet më vonë, në gusht apo edhe në tetor (Bauernfeind & Soldan 2012).

Habitati

Lloji i habitatit: 5 Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat), 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Larvat gjenden në lumenj dhe përroska të lartësive të ndryshme mbidetare prej 300-1900 metra. Larvat parapëlqejnë kryesisht pjesët e rrjedhave të epërme dhe të mesme.

Përhapja e përgjithshme

Pjesa më e madhe e Europës, Turqi, Izrael.

Përhapja në Kosovë

Lumbardhi i Prizrenit në Vlashnje, Lumbardhi i Prizrenit në Reçan, Përroskë në Slivovë, Ereniku në Junik, Lumbardhi i Deçanit në Deçan, Lumi Lepenc në Brod, Lumi Lepenc, Morava e Binçës në Binçë, Përroskë në Keqekollë.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Në të gjitha lokalitetet ku është gjetur në Kosovë ky lloj karakterizohet me numër të vogël të individëve.

Arsyetimi i vlerësimit

Të dhënat aktuale të izoluara për këtë lloj (zona e pranisë ZP = 32 km2, shtrirja e përhapjes SHP = 4779 km2, numri i lokacioneve është 9, rënia e cilësisë së habitatit) e kualifikojnë këtë lloj për kategoritë e rrezikimit. Sidoqoftë, rreziku i zhdukjes së këtij lloji është më i vogël se sa sugjerojnë këto të dhëna, sepse lloji, me gjasë, është i pranishëm edhe në më shumë se 10 lokalitete në Kosovë, duke pasur parasysh praninë e habitateve potenciale të llojit dhe duke ditur mënyrën e përhapjes së tij. Për shkak të të gjitha këtyre argumenteve, lloji vlerësohet si: Gati i Kërcënuar.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrje dhe shqetësime njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)]; 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet]; 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit). Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj në Kosovë, janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera të rëndësishme dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Bauernfeind & Soldan 2012





Ecdyonurus vitoshensis Jacob & Braasch, 1984

Insecta: Ephemeroptera: Heptageniidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Agim Gashi, Bardh Xërxa

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 11-13 mm. Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për aspektet biologjike dhe ekologjike të llojit. Periudha e fluturimit është prej majit deri në gusht (Bauernfeind & Soldan 2012).

Habitati

Lloji i habitatit: 5 Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat), 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Larvat gjenden kryesisht në zonat burimore dhe në rrjedhat e epërme të përroskave të ndryshme me substrat guror. Mund të gjendet në lartësi të ndryshme mbidetare, prej 400 deri në 1200 m.

Përhapja e përgjithshme

Bullgari, Greqi, Kosovë, Kroaci, Rumani, Serbi.

Përhapja në Kosovë

Përroskë në Keçekollë, Lumi i Letnicës, Lumi Nerodime, Përroskë në Lugun e Kopilaçës.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Në të gjitha lokalitetet ku është gjetur në Kosovë ky lloj karakterizohet me numër të vogël të individëve.

Arsyetimi i vlerësimit

Të dhënat aktuale të izoluara për këtë lloj (zona e pranisë ZP = 16 km2, shtrirja e përhapjes SHP = 1201 km2, numri i lokacioneve ≤ 5, rënia e cilësisë së habitatit) e kualifikojnë atë për kategoritë e rrezikimit. Sidoqoftë, rreziku i zhdukjes është më i vogël se sa sugjerojnë këto të dhëna, sepse lloji, me gjasë, është i pranishëm edhe në më shumë se 10 lokalitete në Kosovë, duke pasur parasysh praninë e habitateve potenciale të llojit dhe duke ditur mënyrën e përhapjes së tij. Për shkak të të gjitha këtyre argumenteve, lloji vlerësohet si: Gati i Kërcënuar.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrje dhe shqetësime njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)]; 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet]; 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit). Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj në Kosovë, janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera të rëndësishme dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Bauernfeind & Soldan 2012





Ephemera parnassiana Demoulin, 1958

Insecta: Ephemeroptera: Ephemeridae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Agim Gashi

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 14 – 22 mm. Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për aspektet biologjike dhe ekologjike të këtij lloji. Periudha e fluturimit është gjatë pranverës (Bauernfeind & Soldan 2012).

Habitati

Lloji i habitatit: 5 Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për habitatin e parapëlqyer të këtij lloji.

Përhapja e përgjithshme

Lloj endemik i Ballkanit. Deri më tani është gjetur vetëm në Kosovë dhe Greqi.

Përhapja në Kosovë

Përroska të ndryshme në Komunën e Prishtinës, Përroska të ndryshme në Komunën e Vitisë, Istog, Ferizaj.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm

Arsyetimi i vlerësimit

Të dhënat aktuale të izoluara për këtë lloj (zona e pranisë ZP = 40 km2, shtrirja e përhapjes SHP = 4655 km2, numri i lokaliteteve është 12, rënia e cilësisë së habitatit) e kualifikojnë këtë lloj për kategoritë e rrezikimit. Sidoqoftë, rreziku i zhdukjes së këtij lloji është më i vogël se sa sugjerojnë këto të dhëna të izoluara sepse lloji, me gjasë, është i pranishëm edhe në më shumë lokalitete në Kosovë, duke pasur parasysh praninë e habitateve potenciale të llojit dhe duke ditur mënyrën e përhapjes së tij. Përveç kësaj, trendi i popullatës së këtij lloji është i qëndrueshëm. Për shkak të këtyre argumenteve, lloji vlerësohet si: Gati i Kërcënuar.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrje dhe shqetësime njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)]; 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet]; 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit]. Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj në Kosovë, janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera të rëndësishme dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Bauernfeind & Soldan 2012





Ephemera parnassiana Demoulin, 1958

Insecta: Ephemeroptera: Ephemeridae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Agim Gashi, Bardh Xërxa

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 14 – 22 mm. Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për aspektet biologjike dhe ekologjike të këtij lloji. Periudha e fluturimit është gjatë pranverës (Bauernfeind & Soldan 2012).

Habitati

Lloji i habitatit: 5 Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për habitatin e parapëlqyer të këtij lloji.

Përhapja e përgjithshme

Lloj endemik i Ballkanit. Deri më tani është gjetur vetëm në Kosovë dhe Greqi.

Përhapja në Kosovë

Përroska të ndryshme në Komunën e Prishtinës, Përroska të ndryshme në Komunën e Vitisë, Istog, Ferizaj.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm

Arsyetimi i vlerësimit

Të dhënat aktuale të izoluara për këtë lloj (zona e pranisë ZP = 40 km2, shtrirja e përhapjes SHP = 4655 km2, numri i lokaliteteve është 12, rënia e cilësisë së habitatit) e kualifikojnë këtë lloj për kategoritë e rrezikimit. Sidoqoftë, rreziku i zhdukjes së këtij lloji është më i vogël se sa sugjerojnë këto të dhëna të izoluara sepse lloji, me gjasë, është i pranishëm edhe në më shumë lokalitete në Kosovë, duke pasur parasysh praninë e habitateve potenciale të llojit dhe duke ditur mënyrën e përhapjes së tij. Përveç kësaj, trendi i popullatës së këtij lloji është i qëndrueshëm. Për shkak të këtyre argumenteve, lloji vlerësohet si: Gati i Kërcënuar.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrje dhe shqetësime njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)]; 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet]; 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit]. Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj në Kosovë, janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera të rëndësishme dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Bauernfeind & Soldan 2012





Cordulegaster bidentata Selys, 1843

Insecta: Odonata: Cordulegastridae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Gati i Kërcënuar, NT

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi

Të dhëna të përgjithshme

Gjatësia e trupit të këtij lloji është 69 deri 78 mm. Zhvillimi i larvës zgjat prej 3 deri 5 vjet, por mund të zgjasë edhe më shumë në qoftë se kushtet klimatike shkaktojnë ngrirjen e ujit. Adultët fluturojnë nga maji deri në gusht.

Habitati

Lloji i habitatit: 5 Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat), 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Larvat e këtij lloji jetojnë kryesisht në burime e përroska malore. Në Kosovë, ky lloj është hasur në lumenj dhe përroska të hapura, si dhe në përroska me substrat guror dhe me rrjedhje të shpejtë.

Përhapja e përgjithshme

Europë.

Përhapja në Kosovë

Lumi i Prishtinës në Makovc, Degë e lumit Llap në Marincë, Lumbardhi i Prizrenit në Prevallë.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Nënpopullatat e këtij lloji janë të vogla.

Arsyetimi i vlerësimit

Të dhënat aktuale të izoluara (zona e pranisë ZP = 12 km2, shtrirja e përhapjes SHP = 963 km2, numri i lokacioneve ≤ 10, rënia e cilësisë së habitatit) e kualifikojnë këtë lloj për kategoritë e rrezikimit. Sidoqoftë, rreziku i zhdukjes së këtij lloji është më i vogël se sa sugjerojnë këto të dhëna, sepse lloji, me gjasë, është i pranishëm edhe në më shumë se 10 lokalitete në Kosovë, duke pasur parasysh praninë e habitateve potenciale të llojit dhe duke ditur mënyrën e përhapjes së tij. Për shkak të këtyre argumenteve, lloji vlerësohet si: Gati i Kërcënuar.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)); 9 Ndotja (9.3 Mbeturinat bujqësore dhe pyjore); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.2 thatësirat).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.





Cordulegaster heros Theischinger, 1979

Insecta: Odonata: Cordulegastridae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Gati i Kërcënuar, NT

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi

Të dhëna të përgjithshme

Është lloji më i madh i gjinisë Cordulegaster Selys, 1843 i dallueshëm edhe për shkak të unazave të verdha në trup, i cili, është i zi. Në Ballkan, ky lloj e zëvendëson llojin C. boltoni (Donovan, 1807). Madhësia e trupit të mashkullit është 84 mm kurse e femrës 88-96 mm.

Habitati

Lloji i habitatit: 5 Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat), 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Larvat e këtij lloji jetojnë në përroska të hijezuara në pyje dhe kodrina, me substrat shkëmbor dhe ranor.

Përhapja e përgjithshme

Lloj endemik i Europës qendrore dhe juglindore nga Austria dhe SIlovakia deri në pjesën më të madhe të Ballkanit.

Përhapja në Kosovë

Lumi i Prishtinës në Makovc, Lumi Llap në Brecë.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm

Arsyetimi i vlerësimit

Të dhënat aktuale të izoluara (zona e pranisë ZP = 8 km2, numri i lokacioneve ≤ 10, rënia e cilësisë së habitatit) e kualifikojnë këtë lloj për kategoritë e rrezikimit. Sidoqoftë, rreziku i zhdukjes së këtij lloji është më i vogël se sa sugjerojnë këto të dhëna, sepse lloji, me gjasë, është i pranishëm edhe në më shumë se 10 lokalitete në Kosovë, duke pasur parasysh praninë e habitateve potenciale të llojit dhe duke ditur mënyrën e përhapjes së tij. Për shkak të këtyre argumenteve, lloji vlerësohet si: Gati i Kërcënuar.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)); 9 Ndotja (9.3 Mbeturinat bujqësore dhe pyjore); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.2 Thatësirat).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.





Gomphus vulgatissimus Linnaeus, 1758

Insecta: Odonata: Gomphidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi

Të dhëna të përgjithshme

Periudha e fluturimit të adultëve është prej prillit deri në gusht. Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për biologjinë dhe ekologjinë e këtij lloji.

Habitati

Lloji i habitatit: 5 Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Larvat e këtij lloji jetojnë në lumenj dhe përroska me rrjedhje të ngadalshme të ujit me substrat ranor. Po ashtu, haset shpesh në rrjedhat e mesme dhe të poshtme të lumenjve, por edhe në liqene.

Përhapja e përgjithshme

Europë.

Përhapja në Kosovë

Lumi Sitnica në Lumadh, Lumi Lepenc në Nikë (Zhushi Etemi 2005).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Të dhënat aktuale të izoluara (zona e pranisë ZP = 8 km2, numri i lokacioneve ≤ 10, rënia e cilësisë së habitatit) e kualifikojnë këtë lloj për kategoritë e rrezikimit. Sidoqoftë, rreziku i zhdukjes së këtij lloji është më i vogël se sa sugjerojnë këto të dhëna, sepse lloji, me gjasë, është i pranishëm edhe në më shumë se 10 lokalitete në Kosovë, duke pasur parasysh praninë e habitateve potenciale të llojit dhe duke ditur mënyrën e përhapjes së tij. Për shkak të këtyre argumenteve, lloji vlerësohet si: Gati i Kërcënuar.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane, 9.3 Mbeturinat bujqësore dhe pyjore).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Zhushi Etemi 2005





Onychogomphus forcipatus Linnaeus, 1758

Insecta: Odonata: Gomphidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi

Të dhëna të përgjithshme

Kompletimi i ciklit prej vezës deri në adult zgjat 3 -5 vjet. Adultët paraqiten prej qershorit deri në shtator, por në disa raste është vërejtur se mund të shfaqen edhe qysh në prill.

Habitati

Lloji i habitatit: 5 Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Larvat e këtij lloji jetojnë kryesisht në ujëra të pastra dhe me rrjedhje relativisht të shpejtë, me substrat guror. Në raste të rralla mund të gjenden edhe në lumenj të mëdhenj.

Përhapja e përgjithshme

Lloj endemik i Europës qendrore dhe jugllindore nga Austria dhe SIlovakia deri në pjesën më të madhe të Ballkanit.

Përhapja në Kosovë

Lumi i Letnicës në Letnicë, Dy lokalitete në Blinajë, Përroskë në Mollopolc, Përroskë në Carralevë.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Të dhënat aktuale të izoluara (zona e pranisë ZP = 20 km2, shtrirja e përhapjes SHP = 389 km2, numri i lokacioneve ≤ 10, rënia e cilësisë së habitatit) e kualifikojnë këtë lloj për kategoritë e rrezikimit. Sidoqoftë, rreziku i zhdukjes së këtij lloji është më i vogël se sa sugjerojnë këto të dhëna, sepse lloji, me gjasë, është i pranishëm edhe në më shumë se 10 lokalitete në Kosovë, duke pasur parasysh praninë e habitateve potenciale të llojit dhe duke ditur mënyrën e përhapjes së tij. Për shkak të këtyre argumenteve, lloji vlerësohet si: Gati i Kërcënuar.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 3 Prodhimi i energjisë dhe minierat (3.2 Miniera dhe gurore); 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse. Nënopullata në Blinajë është në kuadër të rezervatit të mbrojtur të gjuetisë.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.



Ceruchus chrysomelinus Hochenwarth, 1785

Insecta: Coleoptera: Lucanidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Gati i Kërcënuar, NT

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Gabor Mesaroš

Të dhëna të përgjithshme

Është lloj me madhësi mesatare (11-16 mm). Është lloj i detyrueshëm saproksilik, larvat e të cilit zhvillohen pothuajse tërësisht në trupa të rrëzuar në shpërbërje e sipër dhe më rrallë në trungje që qëndrojnë. Cikli i zhvillimit zgjat prej 3-4 vjet.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare).
Gjendet në pyje gjetherënëse apo halore të llojeve të ndryshme, por gjithmonë në drunj të vjetër dhe pyje nga të cilat nuk largohen trungjet dhe degët e vdekura.

Përhapja e përgjithshme

Europë.

Përhapja në Kosovë

Rugovë.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Edhe pse ky lloj ka relativisht përhapje të gjerë, gjendet vetëm në habitate shumë specifike. Zona e pranisë ZP e këtij lloji në Kosovë mund të mos jetë më e madhe se 2,000 km2. Norma e humbjes së habitatit të përshtatshëm në Kosovë nuk është përcaktuar, por është e qartë dhe mund të tejkalojë 20% në 10 vjetët e ardhshëm. Për këto arsye, lloji vlerësohet në kategorinë: Gati i Kërcënuar.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lokaliteti ku është gjetur ky lloj është në kuadër të zonës së mbrojtur.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve); 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i zonës / zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Promovimi i përdorimit të praktikave menaxhuese në pyje të orientuara kah konservimi, me reduktim të praktikës së prerjeve të tërësishme dhe sigurim të pranisë së drunjve të vdekur.





Prostomis mandibularis Fabricius, 1801

Insecta: Coleoptera: Prostomidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Gati i Kërcënuar, NT

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Gabor Mesaroš

Të dhëna të përgjithshme

Është lloj me trup të vogël (5-6 mm), me trup të zgjatur paralel anash dhe të shtypur, ngjyra është e kuqe kah e kafta, koka prognatike ka mandibulla të mëdha, të forta dhe të fuqishme. Trupi është i shtypur edhe gjatë fazës larvore, por edhe gjatë imagos, si një përshtatje për të jetuar nën lëvozhgën e drurit. Imagot janë ksilofage, që do të thotë se ushqehen me pjesën e brendshme të kalbur të drunjve që rrinë të paprekur në pyje. Është në tërësi lloj i varur nga drunjtë e vjetër për shkak të mënyrës së të ushqyerit, prandaj habitatet e tilla janë të fragmentuara dhe në rënie e sipër në Europë. Është lloj relikt i pyjeve nga periudha postglaciale.

Habitati

Lloji i habitatit: 1 Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare).
Parapëlqen drunj të vdekur, që qëndrojnë të paprekur në pyjet gjetherënëse dhe halore.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Iran, Turqi.

Përhapja në Kosovë

Kuqishtë.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Edhe pse ky lloj ka relativisht përhapje të gjerë, ai, megjithatë, gjendet vetëm në habitate shumë specifike. Zona e pranisë ZP e këtij lloji në Kosovë mund të mos jetë më e madhe se 2,000 km2. Norma e humbjes së habitatit të përshtatshëm në Kosovë nuk është përcaktuar, por është e qartë për shkak të përdorimit dhe zhvillimit të infrastrukturës turistike dhe mund të tejkalojë 20% në 10 vjetët e ardhshëm, prandaj vlerësohet në kategorinë: Gati i Kërcënuar.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve); 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i zonës / zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Promovimi i përdorimit të praktikave menaxhuese në pyje të orientuara kah konservimi, me reduktim të praktikës së prerjeve të tërësishme dhe sigurim të pranisë së drunjve të vdekur.





Agapetus delicatulus McLachlan, 1884

Insecta: Trichoptera: Glossosomatidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Të dhënat aktuale të pakompletuara (zona e pranisë ZP = 8 km2, numri i lokacioneve ≤ 5, rënia e cilësisë së habitatit) e kualifikojnë këtë lloj për kategoritë e rrezikimit. Sidoqoftë, rreziku i zhdukjes së këtij lloji është më i vogël se sa sugjerojnë këto të dhëna, sepse lloji, me gjasë, është i pranishëm edhe në më shumë se 10 lokalitete në Kosovë, duke pasur parasysh praninë e habitateve potenciale të llojit dhe duke ditur mënyrën e përhapjes së tij. Përveç kësaj, trendi i popullatës është i qëndrueshëm. Për shkak të këtyre argumenteve, lloji vlerësohet si: Gati i Kërcënuar.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare).
Gjendet në pyje gjetherënëse apo halore të llojeve të ndryshme, por gjithmonë në drunj të vjetër dhe pyje nga të cilat nuk largohen trungjet dhe degët e vdekura.

Përhapja e përgjithshme

Europë.

Përhapja në Kosovë

Rugovë.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Edhe pse ky lloj ka relativisht përhapje të gjerë, gjendet vetëm në habitate shumë specifike. Zona e pranisë ZP e këtij lloji në Kosovë mund të mos jetë më e madhe se 2,000 km2. Norma e humbjes së habitatit të përshtatshëm në Kosovë nuk është përcaktuar, por është e qartë dhe mund të tejkalojë 20% në 10 vjetët e ardhshëm. Për këto arsye, lloji vlerësohet në kategorinë: Gati i Kërcënuar.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)]; 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).
Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj në të gjitha lokalitetet ku është gjetur në Kosovë, janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët. Në veçanti shqetësues është trendi i shpyllëzimit në të dy lokalitetet ku është gjetur ky lloj.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Graf *et al.* 2008; Kumanski 1985





Agapetus laniger Pictet, 1843

Insecta: Trichoptera: Glossosomatidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 3.8 deri në 5 mm. Në fazën larvore jeton në ujë përgjatë një viti. Faza larvore është treguese e ujërave mesatarisht të pastra. Faza larvore për nga aspekti i të ushqyerit bën pjesë në grupin e gërryesve dhe mbledhësve/kolektorëve. Faza adulte paraqitet në periudhën qershor - tetor. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit (Graf *et al.* 2008; Kumanski 1985).

Habitati

Lloji i habitatit: 5 Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat]).
Gjendet kryesisht në zona të caktuara të rrjedhave të epërme dhe të mesme të lumenjve. Substrati i parapëlqyer i larvave të këtij lloji përbëhet nga zhavorri i madhësive të ndryshme, gurët e madhësive të ndryshme, etj. Kryesisht jeton në lartësi të ulëta mbidetare.

Përhapja e përgjithshme

Belgjikë, Bosnjë-Hercegovinë, Bullgari, Çeki, Francë, Gjermani, Greqi, Holandë, Hungari, Itali, Kosovë, Kroaci, Luksemburg, Mali i Zi, Maqedoni, Poloni, Portugali, Rumani, Rusi, Sllovaki, Slloveni, Spanjë, Serbi, Shqipëri, Turqi, Zvicër.

Përhapja në Kosovë

Drini i Bardhë.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm

Arsyetimi i vlerësimit

Të dhënat aktuale të pakompletuara (zona e pranisë ZP = 8 km2, numri i lokacioneve ≤ 5, rënia e cilësisë së habitatit) e kualifikojnë këtë lloj për kategoritë e rrezikimit. Sidoqoftë, rreziku i zhdukjes së këtij lloji është më i vogël se sa sugjerojnë këto të dhëna, sepse lloji, me gjasë, është i pranishëm edhe në më shumë se 10 lokalitete në Kosovë, duke pasur parasysh praninë e habitateve potenciale të llojit dhe duke ditur mënyrën e përhapjes së tij. Përveç kësaj, trendi i popullatës së këtij lloji është i qëndrueshëm. Për shkak të këtyre argumenteve, lloji vlerësohet si: Gati i Kërcënuar.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrje dhe shqetësime njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)]; 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).
Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj në Kosovë, janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Graf *et al.* 2008; Kumanski 1985





Agapetus ochripes Curtis, 1834

Insecta: Trichoptera: Glossosomatidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 4 deri në 5 mm. Në fazën larvore jeton në ujë përgjatë një viti. Faza larvore është treguese e ujërave të pastra. Faza larvore për nga aspekti i të ushqyerit bën pjesë në grupin e gërryesve dhe mbledhësve/kolektorëve. Faza adulte paraqitet në periudhën qershor - gusht. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit (Graf *et al.* 2008; Kumanski 1985).

Habitati

Lloji i habitatit: 5 Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat), 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Gjendet kryesisht në zona të caktuara të rrjedhave të epërme dhe zonave burimore të përroskave malore. Substrati i parapëlqyer i larvave të këtij lloji përbëhet nga: zhavorri i madhësive të ndryshme, gurët e madhësive të ndryshme, etj. Kryesisht jeton në lartësi mbidetare mbi 500 metra.

Përhapja e përgjithshme

Andorrë, Austri, Belgjikë, Bosnjë-Hercegovinë, Britani e Madhe, Bullgari, Çeki, Danimarkë, Estoni, Finlandë, Francë, Gjermani, Greqi, Holandë, Hungari, Irlandë, Kosovë, Kroaci, Letoni, Lihtenshajn, Lituani, Luksemburg, Mali i Zi, Norvegji, Poloni, Rumani, Rusi, Sllovaki, Serbi,. Sllloveni, Spanjë, Suedi, Zvicër.

Përhapja në Kosovë

Lumi Kaçandoll në Kaçandoll.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm

Arsyetimi i vlerësimit

Të dhënat aktuale të pakompletuara (zona e pranisë ZP = 4 km2, numri i lokacioneve ≤ 5, rënia e cilësisë së habitatit) e kualifikojnë këtë lloj për kategoritë e rrezikimit. Sidoqoftë, rreziku i zhdukjes së këtij lloji është më i vogël se sa sugjerojnë këto të dhëna të pakompletuara, sepse lloji, me gjasë, është i pranishëm edhe në më shumë se 10 lokalitete në Kosovë, duke pasur parasysh praninë e habitateve potenciale të llojit dhe duke ditur mënyrën e përhapjes së tij. Përveç kësaj, trendi i popullatës së këtij lloji është i qëndrueshëm. Për shkak të këtyre argumenteve, lloji vlerësohet si: Gati i Kërcënuar.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)]; 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).
Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj në Kosovë, janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Graf *et al.* 2008; Kumanski 1985



Annitella triloba Marinkovic-Gospodnetic, 1957

Insecta: Trichoptera: Limnephilidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 8.5 deri në 14 mm. Në fazën larvore jeton në ujë përgjatë një viti. Faza larvore është treguese e ujërave të pastra. Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për mënyrën e të ushqyerit dhe jetesën e fazës larvore të këtij lloji. Faza adulte paraqitet në periudhën e vjeshtës. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit (Graf *et al.* 2008; Kumanski 1988).

Habitati

Lloji i habitatit: 5 Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat), 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Gjendet kryesisht në zonat burimore dhe në rrjedhat e epërme të përroskave e lumenjve malorë. Mund të haset prej 800 deri në mbi 2300 m lartësi mbidetare, edhe pse zakonisht preferon më tepër lartësitë e mëdha.

Përhapja e përgjithshme

Lloj endemik i Ballkanit: Bosnjë-Hercegovinë; Bullgari, Greqi, Kosovë, Mali i Zi, Shqipëri.

Përhapja në Kosovë

Bjeshkët e Nemuna, Lumi Brod në Brod të Dragashit.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm

Arsyetimi i vlerësimit

Të dhënat aktuale të pakompletuara (zona e pranisë ZP = 8 km2, numri i lokacioneve ≤ 5, rënia e cilësisë së habitatit) e kualifikojnë këtë lloj për kategoritë e rrezikimit. Sidoqoftë, rreziku i zhdukjes së këtij lloji është më i vogël se sa sugjerojnë këto të dhëna, sepse lloji, me gjasë, është i pranishëm edhe në më shumë se 10 lokalitete në Kosovë, duke pasur parasysh praninë e habitateve potenciale të llojit dhe duke ditur mënyrën e përhapjes së tij. Përveç kësaj, trendi i popullatës së këtij lloji është i qëndrueshëm. Për shkak të këtyre argumenteve, lloji vlerësohet si: Gati i Kërcënuar.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrje dhe shqetësime njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)]; 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).
Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj në të gjitha lokalitetet ku është gjetur në Kosovë, janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse. Sidoqoftë, njëra nga nënpopullatat gjendet në kuadër të zonës së mbrojtur.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Graf *et al.* 2008; Kumanski 1988





Chaetopteryx bosniaca Marinkovic-Gospodnetic, 1959

Insecta: Trichoptera: Limnephilidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 9 deri në 13 mm. Në fazën larvore jeton në ujë përgjatë një viti. Faza larvore është treguese e ujërave të pastra. Faza adulte paraqitet në periudhën e vjeshtës dhe dimrit. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit. Femrat kanë aftësi të vogël fluturimi dhe të shumtën e kohës më tepër ecin se sa që fluturojnë (Graf *et al.* 2008; Kumanski 1988).

Habitati

Lloji i habitatit: 5 Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Gjendet kryesisht në zonat burimore dhe në rrjedhat e epërme të përroskave e lumenjve malorë. Substrati i parapëlqyer i larvave të këtij lloji përbëhet nga: zhavorri i madhësive të ndryshme, gurët e madhësive të ndryshme, si dhe mjediset e pasura me material bimor. Ky lloj mund të gjendet në lartësi të ndryshme mbidetare, prej 400 deri në mbi 1500 m.

Përhapja e përgjithshme

Lloj endemik i Ballkanit: Bosnjë-Hercegovinë, Bullgari, Greqi, Kosovë, Kroaci, Mali i Zi, Poloni, Serbi, Shqipëri.

Përhapja në Kosovë

Lumi Llap në Murgull, Përroskë në Blinajë.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm

Arsyetimi i vlerësimit

Të dhënat aktuale të pakompletuara (zona e pranisë ZP = 8 km2, numri i lokacioneve ≤ 5, rënia e cilësisë së habitatit) e kualifikojnë këtë lloj për kategoritë e rrezikimit. Sidoqoftë, rreziku i zhdukjes së këtij lloji është më i vogël se sa sugjerojnë këto të dhëna, sepse lloji, me gjasë, është i pranishëm edhe në më shumë se 10 lokalitete në Kosovë, duke pasur parasysh praninë e habitateve potenciale të llojit dhe duke ditur mënyrën e përhapjes së tij. Përveç kësaj, trendi i popullatës së këtij lloji është i qëndrueshëm. Për shkak të këtyre argumenteve, lloji vlerësohet si: Gati i Kërcënuar.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrje dhe shqetësime njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor [përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor [përdorimi në bujqësi]); 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit). Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj në të gjitha lokalitetet ku është gjetur në Kosovë, janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse. Nënpopullata në Blinajë është në kuadër të rezervatit të mbrojtur të gjuetisë.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Graf *et al.* 2008; Kumanski 1988





Chaetopteryx stankovici Marinkovic, 1966

Insecta: Trichoptera: Limnephilidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 8.5 deri në 14 mm. Në fazën larvore jeton në ujë përgjatë një viti. Faza larvore është treguese e ujërave të pastra. Faza adulte paraqitet në periudhën e vjeshtës. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit (Graf *et al.* 2008; Kumanski 1988).

Habitati

Lloji i habitatit: 5 Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Gjendet kryesisht në zonat burimore dhe në rrjedhat e epërme të përroskave e lumenjve malorë. Substrati i parapëlqyer i larvave të këtij lloji përbëhet nga: zhavorri i madhësive të ndryshme, gurët e madhësive të ndryshme, si dhe mjediset e pasura me material bimor. Mund të haset prej 800 deri në mbi 2300 m lartësi mbidetare, edhe pse zakonisht preferon më tepër lartësitë e mëdha.

Përhapja e përgjithshme

Lloj endemik i Ballkanit: Bosnjë-Hercegovinë, Bullgari, Greqi, Kosovë, Mali i Zi, Maqedoni, Serbi, Shqipëri.

Përhapja në Kosovë

Përroskë në Zaplluxhë.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Të dhënat aktuale të pakompletuara (zona e pranisë ZP = 4 km2, numri i lokacioneve = 1, rënia e cilësisë së habitatit) e kualifikojnë këtë lloj për kategoritë e rrezikimit. Sidoqoftë, rreziku i zhdukjes së këtij lloji është më i vogël se sa sugjerojnë këto të dhëna, sepse lloji, me gjasë, është i pranishëm edhe në më shumë se 10 lokalitete në Kosovë, duke pasur parasysh praninë e habitateve potenciale të llojit dhe duke ditur mënyrën e përhapjes së tij. Për shkak të këtyre argumenteve, lloji vlerësohet si: Gati i Kërcënuar.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrje dhe shqetësime njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor [përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor [përdorimi në bujqësi]); 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit). Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj në të gjitha lokalitetet ku është gjetur në Kosovë, janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet

Referencat

Graf *et al.* 2008; Kumanski 1988





Drusus krusniki Malicky, 1981

Flutura e Krushnikut

Insecta: Trichoptera: Limnephilidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 7 deri në 9 mm. Në fazën larvore jeton në ujë përgjatë një viti. Faza larvore është treguese e ujërave të pastra. Faza adulte paraqitet në periudhën shkurt – nëntor. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit. Ky lloj bën pjesë në nënfamiljen Drusinae, e cila karakterizohet me potencial të lartë të endemizmit në Ballkan, me një numër të madh të llojeve të reja të përshkruara viteve të fundit nga Shqipëria, Kosova, Serbia, Bosnjë-Hercegovina, Maqedonia dhe Mali i Zi (Ibrahimi *et al.* 2014).

Habitati

Lloji i habitatit: 5 Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Gjendet kryesisht në zonat burimore dhe në rrjedhat e epërme të përroskave malore. Substrati i parapëlqyer i larvave të këtij lloji përbëhet nga: zhavorri i madhësive të ndryshme, gurët e madhësive të ndryshme, si dhe mjediset e pasura me material bimor. Mund të haset prej 600 deri në mbi 2000 m lartësi mbidetare.

Përhapja e përgjithshme

Lloj endemik i Ballkanit. Gjendet në numër të kufizuar të lokaliteteve në Kosovë, Mal të Zi dhe Shqipëri.

Përhapja në Kosovë

Bjeshkët e Nemuna.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm

Arsyetimi i vlerësimit

Të dhënat aktuale të pakompletuara (zona e pranisë ZP = 16 km2, shtrirja e përhapjes SHP = 991 km2, numri i lokacioneve ≤ 5, rënia e cilësisë së habitatit) e kualifikojnë këtë lloj për kategoritë e rrezikimit. Sidoqoftë, rreziku i zhdukjes së këtij lloji është më i vogël se sa sugjerojnë këto të dhëna, sepse lloji, me gjasë, është i pranishëm edhe në më shumë se 10 lokalitete në Kosovë, duke pasur parasysh praninë e habitateve potenciale të llojit dhe duke ditur mënyrën e përhapjes së tij. Të dhënat preliminare tregojnë se ky lloj është i pranishëm në rrjedhat e epërme dhe në zonat burimore të një numri të madh të lumenjve dhe përroskave në Bjeshkët e Nemuna. Përveç kësaj, trendi i popullatës së këtij lloji është i qëndrueshëm. Për shkak të këtyre argumenteve, lloji vlerësohet si Gati i Kërcënuar.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrje dhe shqetësime njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)); 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit). Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj në të gjitha lokalitetet ku është gjetur në Kosovë, janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse. Megjithatë, numri më i madh i nënpopullatave është në kuadër të zonës së mbrojtur.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Ibrahimi *et al.* 2014





Hydropsyche modesta Navás, 1925

Insecta: Trichoptera: Hydropsychidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 10 deri në 13 mm. Në fazën larvore jeton në ujë përgjatë një viti. Faza larvore mund të tolerojë relativisht mirë ndotjen e ujit. Faza larvore në aspektin e të ushqyerit bën pjesë në grupin e gërryesve, filtruesve, por mund të ushqehet edhe në mënyrë predatore. Faza adulte paraqitet në periudhën e pranverës. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit (Graf *et al.* 2008; Kumanski 1985).

Habitati

Lloji i habitatit: 5 Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat]).
Gjendet kryesisht në zona të caktuara të rrjedhave të mesme dhe të poshtme të përroskave dhe lumenjve. Substrati i parapëlqyer i larvave të këtij lloji përbëhet nga: zhavorri i madhësive të ndryshme, gurët e madhësive të ndryshme, makrofitet, myshqet, rrënjët e bimëve, degët dhe gjethet e rëna të drunjve. Mund të haset në lartësi deri në 700 m.

Përhapja e përgjithshme

Bosnjë-Hercegovinë, Bullgari, Çeki, Francë, Greqi, Hungari, Kosovë, Itali, Kroaci, Maqedoni, Poloni, Rumani, Sllovaki, Sllloveni, Serbi, Spanjë, Shqipëri, Turqi, Zvicër.

Përhapja në Kosovë

Përroskë në Kuzhnin.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm

Arsyetimi i vlerësimit

Të dhënat aktuale të pakompletuara (zona e pranisë ZP = 4 km2, numri i lokacioneve ≤ 5, rënia e cilësisë së habitatit) e kualifikojnë këtë lloj për kategoritë e rrezikimit. Sidoqoftë, rreziku i zhdukjes së këtij lloji është më i vogël se sa sugjerojnë këto të dhëna, sepse lloji, me gjasë, është i pranishëm edhe në më shumë se 10 lokalitete në Kosovë, duke pasur parasysh praninë e habitateve potenciale të llojit dhe duke ditur mënyrën e përhapjes së tij. Përveç kësaj, trendi i popullatës është i qëndrueshëm. Për shkak të këtyre argumenteve, lloji vlerësohet si: Gati i Kërcënuar.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrje dhe shqetësime njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)); 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit). Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj në Kosovë, janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Graf *et al.* 2008; Kumanski 1985





Micropterna fissa McLachlan, 1875

Insecta: Trichoptera: Limnephilidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 17 deri në 22 mm. Në fazën larvore jeton në ujë përgjatë një viti. Faza adulte paraqitet në periudhën maj - tetor. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit. Faza larvore është indikatore e ujërave të pastra dhe mesatarisht të pastra. Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për mënyrën e të ushqyerit dhe jetesës së fazës larvore të këtij lloji (Graf *et al.* 2008; Kumanski 1988).

Habitati

Lloji i habitatit: 5 Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Gjendet kryesisht në rrjedhat e epërme dhe të mesme të lumenjve dhe përroskave malore. Substrati i parapëlqyer i larvave të këtij lloji përbëhet nga zhavorri i madhësive të ndryshme, gurët e madhësive të ndryshme, si dhe mjediset e pasura me material bimor. Ky lloj haset në lartësi të ndryshme mbidetare prej 200 deri në mbi 1000 m.

Përhapja e përgjithshme

Bullgari, Gjermani, Greqi, Itali, Kosovë, Kretë, Kroaci, Itali, Portugali, Spanjë, Shqipëri, Turqi, Zvicër.

Përhapja në Kosovë

Përroskë në Kuzhnin.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Të dhënat aktuale të pakompletuara (zona e pranisë ZP = 4 km2, numri i lokacioneve është 1, rënia e cilësisë së habitatit) e kualifikojnë këtë lloj për kategoritë e rrezikimit. Sidoqoftë, rreziku i zhdukjes së këtij lloji është më i vogël se sa sugjerojnë këto të dhëna, sepse lloji, me gjasë, është i pranishëm edhe në më shumë se 10 lokalitete në Kosovë, duke pasur parasysh praninë e habitateve potenciale të llojit dhe duke ditur mënyrën e përhapjes së tij. Për shkak të këtyre argumenteve, lloji vlerësohet si: Gati i Kërcënuar.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrje dhe shqetësime njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)]; 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet]; 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit). Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës]; 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia]; 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Graf *et al.* 2008; Kumanski 1988





Philopotamus variegatus Scopoli, 1763

Insecta: Trichoptera: Philopotamidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 8 deri në 10.5 mm. Krahët i ka me nuanca të ndryshme të ngjyrës së kaftë. Në fazën larvore jeton në ujë përgjatë një viti. Faza larvore është treguese e ujërave mesatarisht të pastra. Faza adulte paraqitet në periudhën mars - tetor. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit (Graf *et al.* 2008; Kumanski 1985). Bashkë me llojin Philopotamus montanus (Donovan, 1813), janë dy llojet e vetme të kësaj gjinie që jetojnë në Kosovë. Në disa lokalitete mund edhe të gjenden të dy llojet së bashku, por për dallim nga P. montanus, ky është më pak i përhapur.

Habitati

Lloji i habitatit: 5 Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Gjendet kryesisht në zona të caktuara të rrjedhave të epërme dhe zonave burimore të përroskave malore. Substrati i parapëlqyer i larvave të këtij lloji përbëhet nga: zhavorri i madhësive të ndryshme, gurët e madhësive të ndryshme, si dhe mjediset e pasura me material bimor si degë e gjethe të rëna.

Përhapja e përgjithshme

Andorrë, Austri, Belgjikë, Bosnjë-Hercegovinë, Bullgari, Çeki, Francë, Gjermani, Greqi, Hungari, Itali, Korsikë Kosovë, Kretë, Kroaci, Lihtenshtajn, Luksemburg, Maqedoni, Poloni, Portugali, Rumani, Sardenjë, Sllovaki, Slloveni, Spanjë, Serbi, Shqipëri, Turqi, Zvicër.

Përhapja në Kosovë

Përroskë në rrethinën e Prishtinës, Përroskë në Drelaj, Kujavqe.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm

Arsyetimi i vlerësimit

Të dhënat aktuale të pakompletuara (zona e pranisë ZP = 12 km2, shtrirja e përhapjes SHP = 956 km2, numri i lokacioneve ≤ 10, rënia e cilësisë së habitatit) e kualifikojnë këtë lloj për kategoritë e rrezikimit.

Sidoqoftë, rreziku i zhdukjes së këtij lloji është më i vogël se sa sugjerojnë këto të dhëna, sepse lloji, me gjasë, është i pranishëm edhe në më shumë se 10 lokalitete në Kosovë, duke pasur parasysh praninë e habitateve potenciale të llojit dhe duke ditur mënyrën e përhapjes së tij. Përveç kësaj, trendi i popullatës së këtij lloji është i qëndrueshëm. Për shkak të këtyre argumenteve, lloji vlerësohet si: Gati i Kërcënuar.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrje dhe shqetësime njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)]; 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet]; 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit). Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj në Kosovë, janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës]; 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia]; 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Graf *et al.* 2008; Kumanski 1985





Rhadicoleptus macedonicus Botosaneanu & Riedel, 1965

Insecta: Trichoptera: Limnephilidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 11 deri në 15 mm. Në fazën larvore jeton në ujë përgjatë një viti. Faza larvore është treguese e ujërave të pastra. Faza adulte paraqitet në periudhën qershor - tetor. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit. Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për mënyrën e të ushqyerit dhe jetesës së fazës larvore të këtij lloji. Deri në vitin 2015 është konsideruar si nënlloj i llojit Rhadicoleptus alpestris (Kolenati, 1848), por për shkak të dallimeve morfologjike është ngritur në nivel të llojit (Oláh *et al.* 2015).

Habitati

Lloji i habitatit: 5 Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat), 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Gjendet kryesisht në rrjedhat e epërme të përroskave të hapura apo malore. Substrati i parapëlqyer i larvave të këtij lloji përbëhet nga zhavorri i madhësive të ndryshme, si dhe gurët e madhësive të ndryshme. Ky lloj haset kryesisht në lartësi të mëdha mbidetare.

Përhapja e përgjithshme

Lloj endemik i Ballkanit.

Përhapja në Kosovë

Përroskë në Bjeshkën e Lloqanit.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm

Arsyetimi i vlerësimit

Të dhënat aktuale të pakompletuara (zona e pranisë ZP = 4 km2, numri i lokacioneve është 1, rënia e cilësisë së habitatit) e kualifikojnë këtë lloj për kategoritë e rrezikimit. Sidoqoftë, rreziku i zhdukjes së këtij lloji është më i vogël se sa sugjerojnë këto të dhëna të pakompletuara, sepse lloji, me gjasë, është i pranishëm edhe në më shumë se 10 lokalitete në Kosovë, duke pasur parasysh praninë e habitateve potenciale të llojit dhe duke ditur mënyrën e përhapjes së tij.

Përveç kësaj, trendi i popullatës së këtij lloji është i qëndrueshëm. Për shkak të këtyre argumenteve, lloji vlerësohet si: Gati i Kërcënuar.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrje dhe shqetësime njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)); 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit). Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse. Megjithatë, nënpopullata e gjetur e këtij lloji është në kuadër të zonës së mbrojtur.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Oláh *et al.* 2015





Rhyacophila armeniaca Guerin, 1834

Flutura e Armenisë

Insecta: Trichoptera: Rhyacophilidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 15 deri në 17.5 mm. Ngjyra e krahëve është kafe e çelët. Në fazën larvore jeton në ujë përgjatë një viti. Nuk ka të dhëna të mjaftueshme rreth mënyrës së të ushqyerit të larvave. Faza larvore është treguese e ujërave të pastra. Faza adulte paraqitet prej majit deri në gusht. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit ku ka jetuar si larvë (Graf *et al.* 2008; Kumanski 1985).

Habitati

Lloji i habitatit: 5 Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat), 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Gjendet kryesisht në zonat burimore dhe në rrjedhat e epërme të përroskave malore. Substrati i parapëlqyer i larvave të këtij lloji përbëhet nga: zhavorri i trashë, gurët e madhësive të ndryshme, shtrati guror i lumit etj. Mund të haset në lartësi të ndryshme mbidetare, prej 700 deri në mbi 2000 m, edhe pse më tepër parapëlqen lartësitë e mëdha mbidetare (Graf *et al.* 2008; Kumanski 1985).

Përhapja e përgjithshme

Bullgari, Greqi, Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi, Rumani, Serbi, Shqipëri.

Përhapja në Kosovë

Lumi i Kaçandollit në Kaçandoll, Përroskë në rrethinën e Prishtinës, Përroskë në Brezovicë, Lumbardhi i Prizrenit në Prevallë, Grykë e Rugovës, Lumbardhi i Pejës në afërsi të Pejës, Përroskë në Bjeshkët e Lloqanit.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm
Në të gjitha lokalitetet ku është gjetur ky lloj në Kosovë karakterizohet me numër të vogël të individëve, por në suaza të qëndrueshme. Në lumin e Kaçandollit është mbledhur disa herë gjatë viteve të fundit, por me numër shumë të vogël të individëve. Në Bjeshkët e Nemuna dhe në Bjeshkët e Sharrit nënpopullatat janë paksa më të mëdha sesa në Kaçandoll.

Arsyetimi i vlerësimit

Të dhënat aktuale të pakompletuara (zona e pranisë ZP = 28 km2, shtrirja e përhapjes SHP = 5016 km2, numri i lokacioneve ≤ 10, rënia e cilësisë së habitatit) e kualifikojnë këtë lloj për kategoritë e rrezikimit. Sidoqoftë, rreziku i zhdukjes së këtij lloji është më i vogël se sa sugjerojnë këto të dhëna, sepse lloji, me gjasë, është i pranishëm edhe në më shumë se 10 lokalitete në Kosovë, duke pasur parasysh praninë e habitateve potenciale të llojit dhe duke ditur mënyrën e përhapjes së tij. Përveç kësaj, trendi i popullatës së këtij lloji është i qëndrueshëm. Për shkak të këtyre argumenteve, lloji vlerësohet si: Gati i Kërcënuar.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrje dhe shqetësime njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)); 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).
Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj në të gjitha lokalitetet ku është gjetur në Kosovë, e në veçanti në Bjeshkët e Nemuna dhe në Bjeshkët e Sharrit, janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët. Në Prishtinë, kërcënim kryesor paraqet ndotja e ujërave, eksploatimi i ujit për qëllime bujqësore dhe prerja e pyjeve.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse. Disa nga nënpopullatat gjenden në kuadër të zonave të mbrojtura.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Graf *et al.* 2008; Kumanski 1985





Rhyacophila balcanica Radovanovic, 1953

Flutura e Ballkanit

Insecta: Trichoptera: Rhyacophilidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 15 deri në 18 mm. Ngjyra e krahëve është kafe e çelët. Në fazën larvore jeton në ujë përgjatë një viti. Faza larvore është treguese e ujërave të pastra. Nuk ka të dhëna të mjaftueshme rreth mënyrës së të ushqyerit të larvave. Faza adulte paraqitet prej majit deri në gusht. Si adult jeton disa ditë deri në disa javë në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit (Graf *et al*. 2008; Kumanski 1985).

Habitati

Lloji i habitatit: 5 Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Gjendet kryesisht në zonat burimore dhe në rrjedhat e epërme të përroskave malore. Substrati i parapëlqyer i larvave të këtij lloji përbëhet nga zhavorri i trashë, gurët e madhësive të ndryshme, shtrati guror i lumit etj. Kryesisht haset në lartësi të mëdha mbidetare (Kumanski 1985).

Përhapja e përgjithshme

Lloj endemik i Ballkanit: Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë, Kroaci, Mali i Zi, Maqedoni, Serbi, Shqipëri.

Përhapja në Kosovë

Dy lokalitete në Bjeshkët e Nemuna.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm

Arsyetimi i vlerësimit

Të dhënat aktuale të pakompletuara (zona e pranisë ZP = 8 km2, numri i lokacioneve ≤ 5, rënia e cilësisë së habitatit) e kualifikojnë këtë lloj për kategoritë e rrezikimit. Sidoqoftë, rreziku i zhdukjes së këtij lloji është më i vogël se sa sugjerojnë këto të dhëna, sepse lloji, me gjasë, është i pranishëm edhe në më shumë se 10 lokalitete në Kosovë, duke pasur parasysh praninë e habitateve potenciale të llojit dhe duke ditur mënyrën e përhapjes së tij. Përveç kësaj, trendi i popullatës së këtij lloji është i qëndrueshëm. Për shkak të këtyre argumenteve, lloji vlerësohet si: Gati i Kërcënuar.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrje dhe shqetësime njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri)); 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).
Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj në Kosovë, janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse. Megjithatë, nënpopullatat janë në kuadër të zonës së mbrojtur.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Graf *et al*. 2008; Kumanski 1985





Rhyacophila fischeri Botosaneanu, 1957

Flutura e Fisherit

Insecta: Trichoptera: Rhyacophilidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 11 deri në 12 mm. Ngjyra e krahëve është kafe e çelët me nuanca kah e mbyllta. Në fazën larvore jeton në ujë përgjatë një viti. Faza larvore është indikatore e ujërave të pastra. Nuk ka të dhëna të mjaftueshme rreth mënyrës së të ushqyerit të larvave. Faza adulte paraqitet prej prillit deri në shtator. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit (Kumanski 1985).

Habitati

Lloji i habitatit: 5 Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Gjendet kryesisht në zonat burimore dhe në rrjedhat e epërme të përroskave të vogla. Substrati i parapëlqyer i larvave të këtij lloji përbëhet nga: zhavorri i trashë, gurët e madhësive të ndryshme, shtrati guror i lumit etj. Ky lloj mund të haset në lartësi të ndryshme mbidetare, nga 300 deri në zonat subalpine.

Përhapja e përgjithshme

Bullgari, Greqi, Kosovë, Mali i Zi, Rumani, Serbi, Shqipëri.

Përhapja në Kosovë

Bajgorë, Prishtinë, Llap, Sharr, Bjeshkët e Nemuna.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm

Arsyetimi i vlerësimit

Të dhënat aktuale të pakompletuara (zona e pranisë ZP = 32 km2, shtrirja e përhapjes SHP = 5365 km2, numri i lokacioneve ≤ 10, rënia e cilësisë së habitatit) e kualifikojnë këtë lloj për kategoritë e rrezikimit. Sidoqoftë, rreziku i zhdukjes së këtij lloji është më i vogël se sa sugjerojnë këto të dhëna, sepse lloji, me gjasë, është i pranishëm edhe në më shumë se 10 lokalitete në Kosovë, duke pasur parasysh praninë e habitateve potenciale të llojit dhe duke ditur mënyrën e përhapjes së tij.

Përveç kësaj, trendi i popullatës së këtij lloji është i qëndrueshëm dhe nuk është vërejtur ndonjë rënie. Për shkak të këtyre argumenteve, lloji vlerësohet si: Gati i Kërcënuar.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrje dhe shqetësime njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)); 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).
Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj në Kosovë, janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët. Në Prishtinë, kërcënim kryesor paraqet ndotja e ujërave, eksploatimi i ujit për qëllime bujqësore dhe prerja e pyjeve.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse. Disa nga nënpopullatat janë në kuadër të zonës së mbrojtur.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Kumanski 1985





Rhyacophila laevis Pictet, 1834

Insecta: Trichoptera: Rhyacophilidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 7 deri në 7.5 mm. Në fazën larvore jeton në ujë përgjatë një viti. Faza larvore është treguese e ujërave të pastra dhe ushqehet kryesisht duke e copëzuar ushqimin me prejardhje bimore. Faza adulte paraqitet gjatë pranverës, kryesisht në qershor. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit (Graf *et al.* 2008; Kumanski 1985).

Habitati

Lloji i habitatit: 5 Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Gjendet kryesisht në zonat burimore dhe në rrjedhat e epërme të përroskave të vogla. Substrati i parapëlqyer i larvave të këtij lloji përbëhet nga zhavorri i trashë, gurët e madhësive të ndryshme, shtrati guror i lumit etj. Mund të haset në lartësi të ndryshme mbidetare, nga 700 deri në mbi 2000 m, megjithëse preferon vendet më të larta.

Përhapja e përgjithshme

Austri, Bosnjë-Hercegovinë, Bullgari, Francë, Gjermani, Greqi, Hungari, Itali, Kosovë, Kroaci, Mali i Zi, Poloni, Rumani, Sllovaki, Sllloveni, Zvicër, Serbi, Spanjë.

Përhapja në Kosovë

Përroskë në rrethinën e Prishtinës, Përroskë në Marec, Lumbardhi i Pejës në Kuqishtë.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm
Në të gjitha lokalitetet ku është gjetur në Kosovë ky lloj karakterizohet me numër të vogël të individëve. Në lokalitetet e gjetura në rrethinën e Prishtinës është konstatuar rënie e lehtë e nënpopullatës për shkak të ndikimeve antropogjene.

Arsyetimi i vlerësimit

Të dhënat aktuale të pakompletuara (zona e pranisë ZP = 12 km2, shtrirja e përhapjes SHP = 565 km2, numri i lokacioneve ≤ 5, rënia e cilësisë së habitatit) e kualifikojnë këtë lloj për kategoritë e rrezikimit. Sidoqoftë, rreziku i zhdukjes së këtij lloji është më i vogël se sa sugjerojnë këto të dhëna të pakompletuara, sepse lloji, me gjasë, është i pranishëm edhe në më shumë se 10 lokalitete në Kosovë, duke pasur parasysh praninë e habitateve potenciale të llojit dhe duke ditur mënyrën e përhapjes së tij. Përveç kësaj, trendi i popullatës së këtij lloji është i qëndrueshëm dhe nuk është vëzhguar ndonjë rënie e rëndësishme. Për shkak të këtyre argumenteve, lloji vlerësohet si: Gati i Kërcënuar.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)]; 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet]; 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).
Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj në të gjitha lokalitetet ku është gjetur, janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët. Në Prishtinë, kërcënim kryesor paraqet ndotja e ujërave, eksploatimi i ujit për qëllime bujqësore dhe prerja e pyjeve.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Graf *et al.* 2008; Kumanski 1985





Rhyacophila mocsaryi Klapálek, 1894

Insecta: Trichoptera: Rhyacophilidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 15 deri në 17.5 mm. Ngjyra e krahëve është kafe e çelët. Larvat janë kryesisht predatore, edhe pse të dhënat për mënyrën e të ushqyerit të larvës janë të pakëta. Në fazën larvore jeton në ujë përgjatë një viti. Faza adulte paraqitet kryesisht gjatë qershorit dhe korrikut. Faza larvore është treguese e ujërave të pastra. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit. Janë të njohura dy nënlloje të llojit Rhyacophila mocsaryi. Në Kosovë jeton nënlloji nominal (Graf *et al.* 2008; Kumanski 1985).

Habitati

Lloji i habitatit: 5 Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Gjendet kryesisht në zonat burimore dhe në rrjedhat e epërme të përroskave të vogla. Substrati i parapëlqyer i larvave të këtij lloji përbëhet nga: zhavorri i trashë, gurët e madhësive të ndryshme, shtrati guror i lumit etj. Mund të haset në lartësi të ndryshme mbidetare, prej 700 deri në mbi 1600 m, edhe pse më tepër preferon lartësitë e mëdha mbidetare (Graf *et al.* 2008; Kumanski 1985).

Përhapja e përgjithshme

Nënlloji nominal është endemik i Ballkanit i cili gjendet në numër të vogël të lokaliteteve në Bosnjë-Hercegovinë, Bullgari, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe Shqipëri.

Përhapja në Kosovë

Bajgorë, Prishtinë, Llap, Sharr, Bjeshkët e Nemuna.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm

Arsyetimi i vlerësimit

Të dhënat aktuale të pakompletuara (zona e pranisë ZP = 8 km2, numri i lokacioneve ≤ 5, rënia e cilësisë së habitatit) e kualifikojnë këtë lloj për kategoritë e rrezikimit. Sidoqoftë, rreziku i zhdukjes së këtij lloji është më i vogël se sa sugjerojnë këto të dhëna të pakompletuara, sepse lloji, me gjasë, është i pranishëm edhe në më shumë se 10 lokalitete në Kosovë, duke pasur parasysh praninë e habitateve potenciale të llojit dhe duke ditur mënyrën e përhapjes së tij. Përveç kësaj, trendi i popullatës së këtij lloji është i qëndrueshëm. Për shkak të këtyre argumenteve, lloji vlerësohet si: Gati i Kërcënuar.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrje dhe shqetësime njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)]; 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet]; 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).
Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj në të gjitha lokalitetet ku është gjetur, janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse. Megjithatë, të paktën një nga nënpopullatat është në kuadër të zonës së mbrojtur.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Graf *et al.* 2008; Kumanski 1985





Rhyacophila obliterata McLachlan, 1863

Insecta: Trichoptera: Rhyacophilidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 12 deri në 14 mm. Ngjyra e krahëve është kafe e çelët. Në fazën larvore jeton në ujë përgjatë një viti. Larvat janë predatore. Faza adulte paraqitet kryesisht prej gushtit deri në nëntor. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit (Graf *et al.* 2008; Kumanski 1985).

Habitati

Lloji i habitatit: 5 Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat]).
Gjendet kryesisht në zona të caktuara të rrjedhave të epërme dhe të mesme të lumenjve. Mund të haset në lartësi të ndryshme mbidetare, prej 700 deri në mbi 2000 m. Substrati i parapëlqyer i larvave të këtij lloji përbëhet nga zhavorri i trashë, gurët e madhësive të ndryshme, shtrati guror i lumit etj. (Graf *et al.* 2008; Kumanski 1985).

Përhapja e përgjithshme

Austri, Bosnjë-Hercegovinë, Belgjikë, Britani e Madhe, Bullgari, Çeki, Finlandë, Francë, Gjermani, Greqi, Hungari, Kosovë, Kroaci, Letoni, Lituani, Luksemburg, Mali i Zi, Maqedoni, Poloni, Portugali, Rumani, Rusi, Sllovaki, Sllloveni, Spanjë, Suedi, Zvicër, Shqipëri.

Përhapja në Kosovë

Bjeshkët e Sharrit, Bjeshkët e Nemuna.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm

Arsyetimi i vlerësimit

Të dhënat aktuale të pakompletuara (zona e pranisë ZP = 12 km2, shtrirja e përhapjes SHP = 317 km2, numri i lokacioneve ≤ 5, rënia e cilësisë së habitatit) e kualifikojnë këtë lloj për kategoritë e rrezikimit. Sidoqoftë, rreziku i zhdukjes së këtij lloji është më i vogël se sa sugjerojnë këto të dhëna të pakompletuara, sepse lloji, me gjasë, është i pranishëm edhe në më shumë se 10 lokalitete në Kosovë, duke pasur parasysh praninë e habitateve potenciale të llojit dhe duke ditur mënyrën e përhapjes së tij. Përveç kësaj, trendi i popullatës së këtij lloji është i qëndrueshëm. Për shkak të këtyre argumenteve, lloji vlerësohet si: Gati i Kërcënuar.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrje dhe shqetësime njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)); 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).
Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj në të gjitha lokalitetet ku është gjetur në Kosovë, janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse. Megjithatë, nënpopullatat gjenden në kuadër të zonave të mbrojtura.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Graf *et al.* 2008; Kumanski 1985





Tinodes braueri McLachlan, 1878

Insecta: Trichoptera: Psychomyiidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 4.5 deri në 5 mm. Në fazën larvore jeton në ujë përgjatë një viti. Në aspektin e të ushqyerit, faza larvore bën pjesë në grupin e gërryesve, mbledhësve dhe filtruesve. Faza adulte paraqitet në periudhën e pranverës dhe verës. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit (Graf *et al.* 2008; Kumanski 1985).

Habitati

Lloji i habitatit: 5 Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat]).
Gjendet kryesisht në zona të caktuara të rrjedhave të mesme të lumenjve dhe në segmente të caktuara të përroskave malore.

Përhapja e përgjithshme

Lloj endemik i Europës juglindore. Është i njohur vetëm nga një numër i kufizuar lokalitetesh në Bosnjë-Hercegovinë, Greqi, Kosovë, Kroaci, Serbi dhe Shqipëri.

Përhapja në Kosovë

Përroskë në fshatin Kuzhnin.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm

Arsyetimi i vlerësimit

Të dhënat aktuale të pakompletuara (zona e pranisë ZP = 4 km2, numri i lokacioneve ≤ 5 rënia e cilësisë së habitatit) e kualifikojnë këtë lloj për kategoritë e rrezikimit. Sidoqoftë, rreziku i zhdukjes së këtij lloji është më i vogël se sa sugjerojnë këto të dhëna, sepse lloji, me gjasë, është i pranishëm edhe në më shumë se 10 lokalitete në Kosovë, duke pasur parasysh praninë e habitateve potenciale të llojit dhe duke ditur mënyrën e përhapjes së tij. Përveç kësaj, trendi i popullatës së këtij lloji është i qëndrueshëm. Për shkak të këtyre argumenteve, lloji vlerësohet si: Gati i Kërcënuar.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrje dhe shqetësime njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)); 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).
Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj në Kosovë, janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Graf *et al.* 2008; Kumanski 1985





Wormaldia pulla Mclachlin, 1878

Insecta: Trichoptera: Philopotamidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 5 deri në 6 mm. Në fazën larvore jeton në ujë përgjatë një viti. Faza larvore është treguese e ujërave mesatarisht të pastra deri në të pastra. Faza larvore në aspektin e të ushqyerit bën pjesë në grupin e filtruesve. Faza adulte paraqitet në periudhën qershor - gusht. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit (Graf *et al.* 2008; Kumanski 1985).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Gjendet kryesisht në zona të caktuara të rrjedhave të epërme dhe zonave burimore të përroskave dhe lumenjve malorë. Substrati i parapëlqyer i larvave të këtij lloji përbëhet nga zhavorri i madhësive të ndryshme, si dhe gurët e madhësive të ndryshme. Jeton në lartësi të ndryshme mbidetare prej 100 deri në 1500 m.

Përhapja e përgjithshme

Austri, Bullgari, Bosnjë-Hercegovinë, Çeki, Francë, Gjermani, Greqi, Itali, Kosovë, Maqedoni, Poloni, Rumani, Serbi, Sllovaki, Sllloveni, Spanjë, Zvicër.

Përhapja në Kosovë

Lumi Kaçandoll në Kaçandoll.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Të dhënat aktuale të pakompletuara (zona e pranisë ZP = 4 km2, numri i lokacioneve ≤ 5, rënia e cilësisë së habitatit) e kualifikojnë këtë lloj për kategoritë e rrezikimit. Sidoqoftë, rreziku i zhdukjes së këtij lloji është më i vogël se sa sugjerojnë këto të dhëna, sepse lloji, me gjasë, është i pranishëm edhe në më shumë se 10 lokalitete në Kosovë, duke pasur parasysh praninë e habitateve potenciale të llojit dhe duke ditur mënyrën e përhapjes së tij. Përveç kësaj, trendi i popullatës së këtij lloji është i qëndrueshëm. Për shkak të këtyre argumenteve, lloji vlerësohet si: Gati i Kërcënuar.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)]; 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).
Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj në Kosovë, janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Graf *et al.* 2008; Kumanski 1985



Wormaldia subnigra McLachlan, 1865

Insecta: Trichoptera: Philopotamidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 5.5 deri në 6.5 mm. Në fazën larvore jeton në ujë përgjatë një viti. Faza larvore është treguese e ujërave mesatarisht të pastra. Faza larvore në aspektin e të ushqyerit bën pjesë në grupin e filtruesve. Faza adulte paraqitet në periudhën qershor - korrik. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit (Graf *et al.* 2008; Kumanski 1985).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Gjendet kryesisht në zona të caktuara të përroskave malore. Substrati i parapëlqyer i larvave të këtij lloji përbëhet nga zhavorri i madhësive të ndryshme, si dhe gurët e madhësive të ndryshme. Mund të haset në lartësi të ndryshme mbidetare deri në 1000 m.

Përhapja e përgjithshme

Austri, Belgjikë, Bosnjë-Hercegovinë, Britani e Madhe, Bullgari, Danimarkë, Estoni, Finlandë, Francë, Gjermani, Greqi, Irlandë, Itali, Kosovë, Kretë, Kroaci, Letoni, Lituani, Luksemburg, Norvegji, Sllloveni, Çeki, Poloni, Rumani, Rusi, Spanjë, Suedi, Holandë, Serbi, Shqipëri, Turqi, Zvicër.

Përhapja në Kosovë

Përroskë në rrethinën e Prishtinës, Drini i Bardhë në Mrasor.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm

Arsyetimi i vlerësimit

Të dhënat aktuale të pakompletuara (zona e pranisë ZP = 8 km2, numri i lokacioneve ≤ 5, rënia e cilësisë së habitatit) e kualifikojnë këtë lloj për kategoritë e rrezikimit. Sidoqoftë, rreziku i zhdukjes së këtij lloji është më i vogël se sa sugjerojnë këto të dhëna, sepse lloji, me gjasë, është i pranishëm edhe në më shumë se 10 lokalitete në Kosovë, duke pasur parasysh praninë e habitateve potenciale të llojit dhe duke ditur mënyrën e përhapjes së tij. Përveç kësaj, trendi i popullatës së këtij lloji është i qëndrueshëm. Për shkak të këtyre argumenteve, lloji vlerësohet si: Gati i Kërcënuar.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)]; 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).
Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj kanë të bëjnë me humbjen dhe degradimin e habitatit, para së gjithash, nëpërmjet prerjes së pyjeve dhe ndotjes së ujërave, pastaj aktivitetet që vijnë në mjedis nëpërmjet aktiviteteve turistike dhe rekreative të pamenaxhuara mirë, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët. Në lokalitetin në Drinin e Bardhë në Mrasor, eksploatimi i rërës paraqet kërcënim për llojin.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Graf *et al.* 2008; Kumanski 1985



Aricia anteros Freyer, 1838

Insecta: Lepidoptera: Lycaenidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Gati i Kërcënuar, NT

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj e ka gjerësinë e krahëve prej 30 deri në 34 mm. Meshkujt karakterizohen nga ngjyra ndriçuese e kaltër. Ky lloj e ka një gjeneratë në vit, por në disa zona të lartësive të mëdha mbidetare edhe dy gjenerata. Adultët paraqiten prej majit deri në korrik.

Habitati

Lloji i habitatit: 3. Shkurre; 4. Kullosa.
Ky lloj gjendet kryesisht në zona të hapura të pasura me lule, ndonjëherë në vende të pyllëzuara apo zona të ndriçuara midis pyjesh, dhe kryesisht në toka gëlqerore.

Përhapja e përgjithshme

Ballkan, Iran, Turqi, Ukrainë.

Përhapja në Kosovë

Brezovicë, Çakorr (Jakšić 2003; Jakšić and Živić 1995-1998).

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm
Ky lloj është konstatuar me nënpopullata të vogla në Kosovë.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Gati i Kërcënuar, për shkak të rëndësisë dhe rrallësisë së llojit në nivel europian, si dhe tendencës në rritje të aktiviteteve, të cilat mund ta çojnë këtë lloj drejt zhdukjes në Kosovë. Edhe pse numri i vogël i lokacioneve (2) e kualifikon këtë lloj për kategoritë e rrezikimit, megjithatë, bazuar në praninë e habitateve potenciale për llojin në Kosovë dhe njohuritë nga vendet fqinje, ne supozojmë se në Kosovë ekzistojnë edhe nënpopullata të tjera.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 2 Bujqësia dhe akuakultura; 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.1 Zjarret dhe luftimi i tyre, 7.3 Modifikime të tjera të ekosistemit).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse. Disa nga nënpopullatat janë në kuadër të zonave të mbrojtura.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Jakšić 2003; Jakšić and Živić 1995-1998





Carcharodus lavatherae Esper, 1783

Insecta: Lepidoptera: Hesperiidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Gati i Kërcënuar, NT

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi

Të dhëna të përgjithshme

Gjerësia e krahëve të këtij lloji është prej 28 – 34 mm. Pjesa e sipërme e krahëve të përparmë është e gjelbër ose e verdhë në të kaftë me shenja të errëta. E ka një gjeneratë në vit dhe fluturon kryesisht nga maji në qershor. Larvat e këtij lloji ushqehen kryesisht me bimët Stachys recta dhe Sideritis scordioides.

Habitati

Lloji i habitatit: 6 Zona shkëmbore (p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore).
Adultët mund të vërehen kryesisht në shkëmbinj të ngrohtë dhe të thatë.

Përhapja e përgjithshme

Nga Europa qendrore dhe jugore deri në Kaukaz, Transkaukaz dhe Azi të Vogël.

Përhapja në Kosovë

Gryka e Rugovës, Strellc, Pashtrik (Jakšić and Živić 1995-1998).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjouhr

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Gati i Kërcënuar, për shkak të rëndësisë dhe rrallësisë së llojit në nivel europian, si dhe tendencës në rritje të aktiviteteve, të cilat mund ta çojnë këtë lloj drejt zhdukjes në Kosovë. Edhe pse numri i vogël i lokaliteteve (3), zona e pranisë ZP = 12 km2 dhe shtrirja e përhapjes SHP = 101 km2 e kualifikojnë këtë lloj për kategoritë e rrezikimit, megjithatë, rreziku është më i vogël për shkak të supozimit se në Kosovë do të gjenden edhe nënpopullata të tjera, bazuar në praninë e habitateve potenciale për llojin në Kosovë dhe njohuritë nga vendet fqinje.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.1 Zjarret dhe luftimi i tyre, 7.3 Modifikime të tjera të ekosistemit); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.2 thatësirat).
Ky lloj është vëzhguar të jetë i ndikuar nga kositja intensive.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Habitatet e këtij lloji në Bjeshkët e Nemuna janë të mbrojtura ligjërisht.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Jakšić and Živić 1995-1998





Chazara briseis Linnaeus, 1764

Briseida

Insecta: Lepidoptera: Nymphalidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Gati i Kërcënuar, NT

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi, Pajtim Bytyqi

Të dhëna të përgjithshme

Gjerësia e krahëve të këtij lloji është prej 28 – 34 mm. Pjesa e sipërme e krahëve të përparmë është e gjelbër ose e verdhë në të kaftë me shenja të errëta. E ka një gjeneratë në vit dhe fluturon kryesisht nga maji në qershor. Larvat e këtij lloji ushqehen kryesisht me bimët Stachys recta dhe Sideritis scordioides.

Habitati

Lloji i habitatit: 6. Zona shkëmbore [p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore].
Adultët mund të vërehen kryesisht në shkëmbinj të ngrohtë dhe të thatë.

Përhapja e përgjithshme

Afrikë veriore, Spanjë, Francë jugore, disa pjesë të Italisë dhe Zvicrës, Europë jug-lindore, Kinë.

Përhapja në Kosovë

Shkozë, Tri lokalitete në Mirushë, Grykë e Kaçanikut, Brezovicë, Rrëzë Kopaonikut, Pashtrik, Grykë e Rugovës [Jakšić and Živić 1995-1998; Rebel and Zerny 1931; Zhushi et al. 2017].

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm
Nënpopullatat e këtij lloji janë në numër të kënaqshëm, por të vogla dhe fragmentuara.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Gati i Kërcënuar për shkak të rëndësisë dhe rrallësisë së llojit në nivel europian, si dhe tendencës në rritje të aktiviteteve të cilat mund ta çojnë këtë lloj drejt zhdukjes në Kosovë. Edhe pse numri i vogël i lokacioneve (9), zona e pranisë ZP = 36 km2 dhe shtrirja e përhapjes SHP = 5475 km2 e kualifikojnë këtë lloj për kategoritë e rrezikimit, megjithatë, bazuar në praninë e habitateve potenciale për llojin në Kosovë dhe njohuritë nga vendet fqinje, ne supozojmë se në Kosovë ekzistojnë edhe nënpopullata të tjera.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 2 Bujqësia dhe akuakultura [2. 3. Blegtoria dhe fermat: 2.3.2 Kullotja e vogël, fermat apo bujqësia]; 7 Modifikimet e sistemeve natyrore [7.3 Modifikime të tjera të ekosistemit]; 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër [11.1 Modifikimi dhe ndryshimi i habitatit].
Është vërejtur se ky lloj ndikohet nga fragmentimi i habitatit, braktisja e tokave të menaxhuara dhe mbikullotja.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit [1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës]; 5. Ligji dhe politikat [5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit].
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi [1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia]; 3. Monitorimi [3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit].
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Jakšić and Živić 1995-1998; Rebel and Zerny 1931; Zhushi et al. 2017





Cupido decolorata Staudinger, 1886

Insecta: Lepidoptera: Lycaenidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Gati i Kërcënuar, NT

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi, Pajtim Bytyqi

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj e ka gjerësinë e krahëve prej 21 deri në 25 mm. Është një flutur me madhësi të vogël. I ka dy gjenerata në vit. Adultët paraqiten në periudhën maj-gusht. Në Kosovë haset kryesisht në vende me bimë të familjes Fabacea dhe shkurre, në lartësi të ndryshme mbidetare nga 300 deri në 800 metra.

Habitati

Lloji i habitatit: 1 Pyje [1.4. Pyje të klimës mesatare]; 14 Artificiale/tokësore [14.2. Kullosa].
Ky lloj jeton më së shpeshti në kullosa mezofite, të shumtën në pyje.

Përhapja e përgjithshme

Ky lloj gjendet kryesisht në Europën lindore, por është hasur edhe në vende të tjera europiane, si Spanjë, Austri, SIlovaki etj.

Përhapja në Kosovë

Dy lokalitete në Mirushë, Tri lokalitete në Shkozë, Kaçanik [Jakšić and Živić 1995-1998; Zhushi et al. 2017].

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm
Ky lloj është konstatuar me nënpopullata kryesisht stabile në lokalitetet e hulumtuara, por me numër të vogël të individëve.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Gati i Kërcënuar, për shkak të rëndësisë dhe rrallësisë së llojit në nivel europian, si dhe tendencës në rritje të aktiviteteve, të cilat mund ta çojnë këtë lloj drejt zhdukjes në Kosovë. Edhe pse numri i vogël i lokacioneve (6), zona e pranisë ZP = 24 km2 dhe shtrirja e përhapjes SHP = 200 km2 e kualifikojnë këtë lloj për kategoritë e rrezikimit, megjithatë, bazuar në praninë e habitateve potenciale për llojin në Kosovë dhe njohuritë nga vendet fqinje, ne supozojmë se në Kosovë ekzistojnë edhe nënpopullata të tjera.

Kërcënimet

Ky lloj nuk ka ndonjë kërcënim direkt për momentin në Kosovë, por për shkak të përhapjes së kufizuar në Europën lindore është i rëndësishëm në aspektin e konservimit.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit [1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës]; 5. Ligji dhe politikat [5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit].
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi [1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia]; 3. Monitorimi [3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit].
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Jakšić and Živić 1995-1998; Zhushi et al. 2017



Hipparchia fagi Scopoli, 1763

Briseida

Insecta: Lepidoptera: Nymphalidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Gati i Kërcënuar, NT

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj e ka një gjeneratë në vit. Adultët fluturojnë prej qershorit deri në shtator. Larvat ushqehen me lloje të ndryshme të bimëve të gjinive Brachypodium, Bromus, Festuca, Holcus etj.

Habitati

Lloji i habitatit: 1 Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare).
Në Kosovë haset rrëzë masiveve të mëdha malore.

Përhapja e përgjithshme

Nga rrëzë Pirinejeve në Spanjë, nëpërmjet Francës jugore, në lindje përfshirë Italinë dhe Ballkanin.

Përhapja në Kosovë

Katër lokalitete në Malishevë, Grykë e Kaçanikut (Jakšić and Živić 1995-1998; Zhushi et al. 2017).

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm
Nënpopullatat e këtij lloji janë në numër të vogël, por të qëndrueshme.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Gati i Kërcënuar, për shkak të rëndësisë dhe rrallësisë së llojit në nivel europian, si dhe tendencës në rritje të aktiviteteve, të cilat mund ta çojnë këtë lloj drejt zhdukjes në Kosovë. Edhe pse numri i vogël i lokacioneve (5), zona e pranisë ZP = 20 km2 dhe shtrirja e përhapjes SHP = 846 km2 e kualifikojnë këtë lloj për kategoritë e rrezikimit, megjithatë, bazuar në praninë e habitateve potenciale për llojin në Kosovë dhe njohuritë nga vendet fqinje, ne supozojmë se në Kosovë ekzistojnë edhe nënpopullata të tjera.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 2 Bujqësia dhe akuakultura; 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.3 Modifikime të tjera të ekosistemit); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Modifikimi dhe ndryshimi i habitatit).
Është vëzhguar se ky lloj ndikohet nga braktisja e kullosave dhe fragmentimi i habitatit.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Jakšić and Živić 1995-1998; Zhushi et al. 2017



Hipparchia statilinus Hufnagel, 1766

Insecta: Lepidoptera: Nymphalidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Gati i Kërcënuar, NT

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj e ka një gjeneratë në vit. Adultët fluturojnë prej qershorit deri në tetor. Larvat ushqehen me lloje të ndryshme të bimëve të familjeve Poaceae dhe Cyperaceae.

Habitati

Lloji i habitatit: 1 Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare); 6 Zona shkëmbore [p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore].
Në Kosovë mund të haset shpesh përgjatë rrugëve ose në vende të ulëta, shpesh duke pushuar në gurë e shkëmbinj, duke u ngrohur me krahë të paluar.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Afrikë veriore, Turqi.

Përhapja në Kosovë

Dy lokalitete në Malishevë, Llapqevë, Grykë e Rugovës, Grykë e Ibrit, Kalaja e Prizrenit (Jakšić and Živić 1995-1998; Zhushi et al. 2017).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Nënpopullatat e këtij lloji janë të izoluara dhe të fragmentuara.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Gati i Kërcënuar, për shkak të rëndësisë dhe rrallësisë së llojit në nivel europian, si dhe tendencës në rritje të aktiviteteve të cilat mund ta çojnë këtë lloj drejt zhdukjes në Kosovë. Edhe pse numri i vogël i lokacioneve (6), zona e pranisë ZP = 24 km2 dhe shtrirja e përhapjes SHP = 2059 km2 e kualifikojnë për kategoritë e rrezikimit, megjithatë, bazuar në praninë e habitateve potenciale për llojin në Kosovë dhe njohuritë nga vendet fqinje, ne supozojmë se në Kosovë ekzistojnë edhe nënpopullata të tjera.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 2. Bujqësia dhe akuakultura; 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.3 Modifikime të tjera të ekosistemit); 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.2 Kullimet); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Modifikimi dhe ndryshimi i habitatit).
Është vëzhguar se ky lloj ndikohet nga braktisja e kullosave, fragmentimi dhe izolimi i habitateve dhe përdorimi i plehrave.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Të paktën një nënpopullatë është në kuadër të zonës së mbrojtur.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Jakšić and Živić 1995-1998; Zhushi et al. 2017



Hipparchia volgensis Mazochin-Porshnjakov, 1952

Insecta: Lepidoptera: Nymphalidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi

Të dhëna të përgjithshme

Gjatësia e krahëve të mashkullit nga baza deri në majë është 27-28 mm. Ky lloj e ka një gjeneratë në vit. Adultët fluturojnë prej qershorit deri në gusht. Është lloj arboreal.

Habitati

Lloji i habitatit: 1 Pyje [1.4. Pyje të klimës mesatare]; 3. Shkurre; 4. Kullosa; 6 Zona shkëmbore [p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore].
Haset në vende të thata, të ngrohta me shkurre, në vende me gurë dhe/ose shkëmbore, ose pranë pyjeve gjetherënëse dhe halore, si dhe në shpatet shkëmbore me diell.

Përhapja e përgjithshme

Ballkan, Rusi jugore.

Përhapja në Kosovë

Mitrovicë, Disa lokalitete në Mirushë, Malishevë, Pashtrik, Lloqan, Grykë e Rugovës, Pejë, Gërmi, Sredskë, Grykë e Ibrit, Rrëzë Kopaonikut [Jakšić and Živić 1995-1998; Zhushi et al. 2017].

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Nënpopullatat e këtij lloji janë të izoluara dhe të fragmentuara.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Gati i Kërcënuar, për shkak të rëndësisë dhe rrallësisë së llojit në nivel europian, si dhe tendencës në rritje të aktiviteteve, të cilat mund ta çojnë këtë lloj drejt zhdukjes në Kosovë.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 2 Bujqësia dhe akuakultura [2. 3. Blegtoria dhe fermat: 2.3.2 Kullotja e vogël, fermat apo bujqësia]; 5. Përdorimi i burimeve biologjike [5.3.Prerja dhe vjelja e pyjeve]; 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër [11.1 Modifikimi dhe ndryshimi i habitatit].

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit [1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës]; 5. Ligji dhe politikat [5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit].
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi [1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia]; 3. Monitorimi [3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit].
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Jakšić and Živić 1995-1998; Zhushi et al. 2017



Papilio machaon Linnaeus, 1758

Flutura Bajrake

Insecta: Lepidoptera: Papilionidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj e ka gjerësinë e krahëve prej 65 deri në 75 mm. Është lloj palearktik arboreal. Adultët paraqiten prej prillit deri në gusht. I ka dy gjenerata në vit. Lloje ushqyese të larvave janë një numër i madh dhe i takojnë zakonisht gjinive: Aegopodium, Anethum, Carum, Daucus, Falcaria dhe Foeniculum.

Habitati

Lloji i habitatit: 5 Vende ujore (kontinentale) [5.4 Moçale, këneta, moçalishte (përgjithësisht mbi 8ha)]; 14 Artificiale/tokësore [14.1. Toka të punueshme].
Ky lloj mund të haset në habitate të ndryshme, të hapura apo gjysmë të hapura. Gjithashtu mund të gjendet në zona të mëdha të hapura brenda pyjeve.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Afrikë, Azi, Amerikë veriore.

Përhapja në Kosovë

Lloqan, Pashtrik, Oshlak, Kalaja e Prizrenit, Gryka e Rugovës, Brezovicë, Katër lokalitete në Mirushë [Jakšić 1999; Jakšić and Živić 1995-1998; Rebel and Zerny 1931].

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Ky lloj është konstatuar me nënpopullata që kanë numër shumë të vogël të individëve.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Gati i Kërcënuar, për shkak të tendencës në rritje të aktiviteteve të cilat mund ta çojnë këtë lloj drejt zhdukjes në Kosovë. Edhe pse numri i vogël i lokacioneve (10), zona e pranisë ZP = 36 km2 dhe shtrirja e përhapjes SHP = 1324 km2 e kualifikojnë këtë lloj për kategoritë e rrezikimit, megjithatë, bazuar në praninë e habitateve potenciale për llojin në Kosovë dhe njohuritë nga vendet fqinje, ne supozojmë se në Kosovë ekzistojnë edhe nënpopullata të tjera.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 2. Bujqësia dhe akuakultura [2. 3. Blegtoria dhe fermat: 2.3.2 Kullotja e vogël, fermat apo bujqësia]; 7 Modifikimet e sistemeve natyrore [7.1 Zjarret dhe luftimi i tyre, 7.3. Modifikime të tjera të ekosistemit].
Është vëzhguar se ky lloj ndikohet nga braktisja e tokave të menaxhuara.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Disa nënpopullata janë në kuadër të zonave të mbrojtura.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit [1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës]; 5. Ligji dhe politikat [5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit].
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi [1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia]; 3. Monitorimi [3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit].
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Jakšić 1999; Jakšić and Živić 1995-1998; Rebel and Zerny 1931





Plebejus pylaon Fischer von Waldheim, 1832

Insecta: Lepidoptera: Lycaenidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj e ka gjerësinë e krahëve prej 28 deri në 34 mm. E ka një gjeneratë në vit. Ngjyra e krahëve të përparmë të meshkujve në anën e epërme është vjollce në të kaltër. Bimë ushqyese të larvave të këtij lloji janë ato të gjinisë Astragalus. Larvat janë mirmekofile. Adultët paraqiten në periudhën maj – korrik.

Habitati

Lloji i habitatit: 4 Kullosa; 6 Zona shkëmbore [p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore].
Ky lloj paraqitet shpesh në livadhe të pasura me lule, në kodrina shkëmbore dhe në skaje të pyjeve. Gjithashtu, mund të gjendet në stepa dhe zona ranore të thata, rrallëherë në vende të hapura brenda pyjeve.

Përhapja e përgjithshme

Nga Spanja, përgjatë Europës jugore, Hungari, Ballkan, Rusi dhe Lindje e Afërt deri në Iran.

Përhapja në Kosovë

Gërmi, Brezovicë, Koshtovë [Jakšić 1987; Jakšić and Živić 1995-1998].

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm
Ky lloj është konstatuar me nënpopullata kryesisht stabile në lokalitetet e hulumtuara, por me numër të vogël të individëve.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Gati i Kërcënuar, për shkak të rëndësisë dhe rrallësisë së llojit në nivel europian, si dhe tendencës në rritje të aktiviteteve, të cilat mund ta çojnë këtë lloj drejt zhdukjes në Kosovë. Edhe pse numri i vogël i lokacioneve [3] e kualifikon këtë lloj për kategoritë e rrezikimit, megjithatë, bazuar në praninë e habitateve potenciale për llojin në Kosovë dhe njohuritë nga vendet fqinje, ne supozojmë se në Kosovë ekzistojnë edhe nënpopullata të tjera.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 2 Bujqësia dhe akuakultura; 5 Përdorimi i burimeve biologjike [5.1. Gjuetia dhe mbledhja e kafshëve tokësore: 5.1.2 Efektet e paqëllimshme (lloji që vlerësohet nuk është i synuar); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore [7.2 Digat dhe menaxhimi/përdorimi i ujit, 7.3 Modifikime të tjera të ekosistemit]; 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër [11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit].

Masat ekzistuese mbrojtëse

Të paktën një nënpopullatë është në kuadër të zonës së mbrojtur.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit [1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës]; 5. Ligji dhe politikat [5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit].
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi [1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia]; 3. Monitorimi [3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit].
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Jakšić 1987; Jakšić and Živić 1995-1998



Pseudophilotes bavius Eversmann, 1832

Insecta: Lepidoptera: Papilionidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj e ka gjerësinë e krahëve prej 24 deri në 30 mm. I ka dy gjenerata në vit, kurse adultët hasen në periudhën prill – maj dhe pastaj sërish qershor - korrik. Llojet ushqyese të larvave i takojnë gjinisë Salvia. Larvat janë mirmekofile.

Habitati

Lloji i habitatit: 6 Zona shkëmbore [p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore].
Në Kosovë është konstatuar në shpate shkëmbore dhe në toka gëlqerore.

Përhapja e përgjithshme

Greqi, Kosovë, Maqedoni, Rumani, Serbi. Gjendet gjithashtu në Krime, Turqi, Kaukaz dhe Afrikë veriperëndimore.

Përhapja në Kosovë

Kalaja e Prizrenit, Dikance, Gërmi, Grykë e Rugovës [Jakšić and Živić 1995-1998].

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm
Ky lloj është konstatuar me nënpopullata që kanë numër të vogël të individëve, por stabile.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Gati i Kërcënuar, për shkak të rëndësisë dhe rrallësisë së llojit në nivel europian, si dhe tendencës në rritje të aktiviteteve, të cilat mund ta çojnë këtë lloj drejt zhdukjes në Kosovë. Edhe pse numri i vogël i lokacioneve [4], zona e pranisë ZP = 16 km2 dhe shtrirja e përhapjes SHP = 3385 km2 e kualifikojnë këtë lloj për kategoritë e rrezikimit, megjithatë, bazuar në praninë e habitateve potenciale për llojin në Kosovë dhe njohuritë nga vendet fqinje, ne supozojmë se në Kosovë ekzistojnë edhe nënpopullata të tjera.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 2. Bujqësia dhe akuakultura [2. 3. Blegtoria dhe fermat: 2.3.2 Kullotja e vogël, fermat apo bujqësia]; 7 Modifikimet e sistemeve natyrore [7.1 Zjarri dhe luftimi i tij, 7.3 Modifikime të tjera të ekosistemit]; 8 Llojet invazive dhe të tjera problematike, gjenet dhe sëmundjet [8.1 Llojet jonative invazive/të huaja/sëmundjet].
Larvat e këtij lloji sulmohen nga lloji parazit Apanteles lycaena i cili i përket rendit Diptera. Një kërcënim tjetër është vëzhguar të jetë ndryshimi në përdorimin e tokës nga bujqësia.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur [Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura].

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit [1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës]; 5. Ligji dhe politikat [5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit].
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi [1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia]; 3. Monitorimi [3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit].
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Jakšić and Živić 1995-1998



Thymelicus acteon Rottemburg, 1775

Insecta: Lepidoptera: Hesperiidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Gati i Kërcënuar, NT

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi, Pajtim Bytyqi.

Të dhëna të përgjithshme

Gjerësia e krahëve të këtij lloji është 24 deri 28 mm. Mashkulli ka ngjyrë më të errët, kurse femra dallohet për nga gjysmëhëna e portokalltë në krahët e përparmë, e cila ose mungon tërësisht ose është më e zbehtë te meshkujt. Ushqim primar i larvave është Brachypodium pinnatum. Është lloj i përhapur gjerësisht, por në mënyrë lokale.

Habitati

Lloji i habitatit: 1 Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare); 4. Kullosa.
Ky lloj gjendet kryesisht në livadhe dhe stepa gëlqerore, në livadhe mezofile, livadhe të thata silikate, pyje gjetherënëse gjethegjera dhe në zona shkurrore sklerofile.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Afrikë veriore, Azi e Vogël.

Përhapja në Kosovë

Shkozë, Bistrë (Etemi-Zhushi and Bytyqi 2016; Jakšić 1998).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Popullata e këtij lloji është e vogël dhe me numër të vogël të individëve.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Gati i Kërcënuar, për shkak të rëndësisë dhe rrallësisë së llojit në nivel europian, si dhe tendencës në rritje të aktiviteteve, të cilat mund ta çojnë këtë lloj drejt zhdukjes në Kosovë. Edhe pse numri i vogël i lokacioneve (2) e kualifikon këtë lloj për kategoritë e rrezikimit, megjithatë, bazuar në praninë e habitateve potenciale për llojin në Kosovë dhe njohuritë nga vendet fqinje, ne supozojmë se në Kosovë ekzistojnë edhe nënpopullata të tjera, prandaj edhe kërcënimi për llojin është më i vogël nga ajo që sugjerojnë të dhënat momentale të pakompletuara.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 2 Bujqësia dhe akuakultura (2. 3. Blegtoria dhe fermat: 2.3.2 Kullotja e vogël, fermat apo bujqësia); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.3. Modifikime të tjera të ekosistemit).
Ky lloj është vëzhguar të jetë ndikuar nga ndryshimi i aktiviteteve bujqësore dhe mbikullosja.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Etemi-Zhushi and Bytyqi 2016; Jakšić 1998





Zerynthia cerisy Godart, 1824

Insecta: Lepidoptera: Papilionidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj e ka gjerësinë e krahëve prej 52 deri në 62 mm. Adultët paraqiten gjatë prillit dhe majit, por në lartësi të mëdha mbidetare edhe në qershor e korrik. Bimë ushqyese të këtij lloji janë bimët e gjinisë Aristolochia.

Habitati

Lloji i habitatit: 3. Shkurre; 4. Kullosa; 16 Vegjetacion i introduktuar.
Haset kryesisht në habitate gjysmë të hapura.

Përhapja e përgjithshme

Europë juglindore, Turqi.

Përhapja në Kosovë

Reçicë, Dy lokalitete në Han të Elezit, Prizren, Vratnicë (Jakšić 1998; Zhushi et al. 2017).

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm
Ky lloj është konstatuar me nënpopullata që kanë numër të vogël të individëve, por të qëndrueshme.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Gati i Kërcënuar, për shkak të rëndësisë dhe rrallësisë së llojit në nivel europian, si dhe tendencës në rritje të aktiviteteve, të cilat mund ta çojnë këtë lloj drejt zhdukjes në Kosovë. Edhe pse numri i vogël i lokacioneve (5), zona e pranisë ZP = 20 km2 dhe shtrirja e përhapjes SHP = 2325 km2 e kualifikojnë këtë lloj për kategoritë e rrezikimit, megjithatë, bazuar në praninë e habitateve potenciale për llojin në Kosovë dhe njohuritë nga vendet fqinje, ne supozojmë se në Kosovë ekzistojnë edhe nënpopullata të tjera.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1. Zhvillimi rezidencial dhe komercial; 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.3 Modifikime të tjera të ekosistemit); 9 Ndotja (9.3 Mbetjet e bujqësisë dhe pylltarisë: 9.3.3 Herbicidet dhe pesticidet).
Është vërejtur se ky lloj ndikohet nga aktiviteti i braktisjes së tokave bujqësore.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Jakšić 1998; Zhushi et al. 2017



Plebejus pylaon Fischer von Waldheim, 1832

Insecta: Lepidoptera: Lycaenidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj e ka gjerësinë e krahëve prej 28 deri në 34 mm. E ka një gjeneratë në vit. Ngjyra e krahëve të përparmë të meshkujve në anën e epërme është vjollce në të kaltër. Bimë ushqyese të larvave të këtij lloji janë ato të gjinisë Astragalus. Larvat janë mirmekofile. Adultët paraqiten në periudhën maj – korrik.

Habitati

Lloji i habitatit: 4 Kullosa; 6 Zona shkëmbore [p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore].
Ky lloj paraqitet shpesh në livadhe të pasura me lule, në kodrina shkëmbore dhe në skaje të pyjeve. Gjithashtu, mund të gjendet në stepa dhe zona ranore të thata, rrallëherë në vende të hapura brenda pyjeve.

Përhapja e përgjithshme

Nga Spanja, përgjatë Europës jugore, Hungari, Ballkan, Rusi dhe Lindje e Afërt deri në Iran.

Përhapja në Kosovë

Gërmi, Brezovicë, Koshtovë [Jakšić 1987; Jakšić and Živić 1995-1998].

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm
Ky lloj është konstatuar me nënpopullata kryesisht stabile në lokalitetet e hulumtuara, por me numër të vogël të individëve.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Gati i Kërcënuar, për shkak të rëndësisë dhe rrallësisë së llojit në nivel europian, si dhe tendencës në rritje të aktiviteteve, të cilat mund ta çojnë këtë lloj drejt zhdukjes në Kosovë. Edhe pse numri i vogël i lokacioneve [3] e kualifikon këtë lloj për kategoritë e rrezikimit, megjithatë, bazuar në praninë e habitateve potenciale për llojin në Kosovë dhe njohuritë nga vendet fqinje, ne supozojmë se në Kosovë ekzistojnë edhe nënpopullata të tjera.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 2 Bujqësia dhe akuakultura; 5 Përdorimi i burimeve biologjike [5.1. Gjuetia dhe mbledhja e kafshëve tokësore: 5.1.2 Efektet e paqëllimshme (lloji që vlerësohet nuk është i synuar); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore [7.2 Digat dhe menaxhimi/përdorimi i ujit, 7.3 Modifikime të tjera të ekosistemit]; 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër [11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit].

Masat ekzistuese mbrojtëse

Të paktën një nënpopullatë është në kuadër të zonës së mbrojtur.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit [1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës]; 5. Ligji dhe politikat [5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit].
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi [1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia]; 3. Monitorimi [3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit].
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Jakšić 1987; Jakšić and Živić 1995-1998



Pseudophilotes bavius Eversmann, 1832

Insecta: Lepidoptera: Papilionidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj e ka gjerësinë e krahëve prej 24 deri në 30 mm. I ka dy gjenerata në vit, kurse adultët hasen në periudhën prill – maj dhe pastaj sërish qershor - korrik. Llojet ushqyese të larvave i takojnë gjinisë Salvia. Larvat janë mirmekofile.

Habitati

Lloji i habitatit: 6 Zona shkëmbore [p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore].
Në Kosovë është konstatuar në shpate shkëmbore dhe në toka gëlqerore.

Përhapja e përgjithshme

Greqi, Kosovë, Maqedoni, Rumani, Serbi. Gjendet gjithashtu në Krime, Turqi, Kaukaz dhe Afrikë veriperëndimore.

Përhapja në Kosovë

Kalaja e Prizrenit, Dikance, Gërmi, Grykë e Rugovës [Jakšić and Živić 1995-1998].

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm
Ky lloj është konstatuar me nënpopullata që kanë numër të vogël të individëve, por stabile.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Gati i Kërcënuar, për shkak të rëndësisë dhe rrallësisë së llojit në nivel europian, si dhe tendencës në rritje të aktiviteteve, të cilat mund ta çojnë këtë lloj drejt zhdukjes në Kosovë. Edhe pse numri i vogël i lokacioneve [4], zona e pranisë ZP = 16 km2 dhe shtrirja e përhapjes SHP = 3385 km2 e kualifikojnë këtë lloj për kategoritë e rrezikimit, megjithatë, bazuar në praninë e habitateve potenciale për llojin në Kosovë dhe njohuritë nga vendet fqinje, ne supozojmë se në Kosovë ekzistojnë edhe nënpopullata të tjera.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 2. Bujqësia dhe akuakultura [2. 3. Blegtoria dhe fermat: 2.3.2 Kullotja e vogël, fermat apo bujqësia]; 7 Modifikimet e sistemeve natyrore [7.1 Zjarri dhe luftimi i tij, 7.3 Modifikime të tjera të ekosistemit]; 8 Llojet invazive dhe të tjera problematike, gjenet dhe sëmundjet [8.1 Llojet jonative invazive/të huaja/sëmundjet].
Larvat e këtij lloji sulmohen nga lloji parazit Apanteles lycaena i cili i përket rendit Diptera. Një kërcënim tjetër është vëzhguar të jetë ndryshimi në përdorimin e tokës nga bujqësia.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur [Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura].

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit [1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës]; 5. Ligji dhe politikat [5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit].
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi [1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia]; 3. Monitorimi [3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit].
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Jakšić and Živić 1995-1998



5.4 CYCLOSTOMATA

Eudontomyzon stankokaramani Karaman, 1974

Cyclostomata: Petromyzontiformes: Petromyzontidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Linda Grapci Kotori

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj i banon kryesisht ujërat e pastra. Është lloj jograbitqar. Madhësia e individëve të rritur është përafërsisht 20 cm (Holčik and Šorić 2004). Metamorfozën e kryen prej nëntorit deri në prill. Nuk ka ndonjë rëndësi në aspektin e peshkimit (Freyhoff and Kottelat 2007).

Habitati

Lloji i habitatit: 5 Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Kryesisht gjendet në zonat pranëmalore dhe malore, në rrjedha të vogla ujore, të pasura me shumë oksigjen. Larvat e këtij lloji, amocitet, jetojnë në fundin e shtratit të pasur me detritus dhe zhavor të imët.

Përhapja e përgjithshme

Lloj endemik i Ballkanit. Deri më tani është konstatuar vetëm në Liqenin e Ohrit, Liqenin e Shkodrës dhe Drinin e Bardhë.

Përhapja në Kosovë

Lumbardhi i Pejës në Grabanicë, Lumi Erenik te Prroni i Necit, Lumi Erenik në Trava.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Në Kosovë është konstatuar në vetëm disa lokalitete, por me numër të konsiderueshëm të individëve. Megjithatë, në disa prej lokaliteteve ku është konstatuar janë vërejtur aktivitete që e rrezikojnë dukshëm habitatin e këtij lloji.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Gati i Kërcënuar, për shkak të rëndësisë dhe rrallësisë së llojit në nivel europian, si dhe tendencës në rritje të aktiviteteve, të cilat mund ta çojnë këtë lloj drejt zhdukjes në Kosovë. Numri momental i njohur i lokacioneve (3), zona e pranisë ZP = 12 km2 dhe shtrirja e përhapjes SHP = 121 km2 e kualifikojnë këtë lloj për kategoritë e zhdukjes, megjithatë, presim që lloji të jetë më shumë i përhapur në Kosovë. Ndikimi nga pendat e vogla në pellgun e Drinit të Bardhë në nënpopullatat e këtij lloji, duhet të vlerësohet.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2. Digat dhe menaxhimi/përdorimi i ujit: 7.2.9 Digat e vogla, 7.3 Modifikime të tjera të ekosistemit); 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane, 9.4 Mbeturinat dhe mbetjet e ngurta); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.2 Thatësirat).
Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj, kanë të bëjnë me ndërtimin e pendave, modifikimet e ndryshme të ekosistemeve, ndotjen nga ujërat e zeza, ndotjen nga mbeturinat e ngurta dhe të tjera, si dhe me thatësirën.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lokalitetin ku gjendet dhe llojet e tjera prezente.

Referencat

Holčik and Šorić 2004; Freyhoff and Kottelat 2008





5.5 ACTINOPTERYGII

Barbus rebeli Koller, 1926

Mrena e fanit

Actinopterygii: Cypriniformes: Cyprinidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Linda Grapci Kotori

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj, edhe pse i përhapur gjerësisht dhe lokalisht abundant, megjithatë është shumë i ndjeshëm ndaj ndryshimeve të habitatit, sidomos në përroska të vogla, të cilat mund të shterren gjatë verës. E arrin madhësinë deri në 25 cm (Kottelat and Freyhof 2007).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat], 5.4 Këneta, moçale, moçalishte, 5.5 Liqene të përhershme të ujërave të ëmbla).
Ky lloj mund të gjendet në lumenj, por edhe në liqene. I parapëlqen segmentet me ujë të pastër.

Përhapja e përgjithshme

Lloj endemik i Ballkanit.

Përhapja në Kosovë

Ujërat e pellgut të detit Adriatik, Ujërat e pellgut të detit të Zi, Ujërat e pellgut të detit Egje.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm
Aty ku ndodhet, popullatat janë abundante, por të fragmentuara, sepse përdoret shumë edhe në peshkatari.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Gati i Kërcënuar, për shkak të rëndësisë dhe rrallësisë së llojit në nivel europian, duke qenë lloj endemik i Ballkanit, si dhe faktorëve të cilët mund ta çojnë këtë lloj drejt zhdukjes në Kosovë siç janë peshkimi dhe përhapja e fragmentuar. Ky lloj është akoma gjerësisht i përhapur në pellgut e Drinit të Bardhë.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.1 Zonat rezidenciale dhe komerciale); 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane, 9.4 Mbeturinat dhe mbetjet e ngurta); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.2 Thatësirat).
Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë, lloj kanë të bëjnë me ndikimin nga vendbanimet dhe mjediset urbane, ndotjen nga ujërat e zeza, ndotjen nga mbeturinat e ngurta dhe të tjera, si dhe me thatësirën.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lokalitetin ku gjendet dhe llojet e tjera prezente.

Referencat

Kottelat and Freyhof 2007





Carassius carassius Linnaeus, 1758

Karashi i bronztë

Actinopterygii: Cypriniformes: Cyprinidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Linda Grapci Kotori

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj karakterizohet me format adulte që mund të mbijetojë në temperatura të larta dhe në përqendrime shumë të ulëta të oksigjenit gjatë verës, kurse në stinën e dimrit i gjejmë nën mbulesën e akullit. Mund të jetojnë deri në 10 vjet dhe të mbërrijnë gjatësi deri në 64 cm. Ata zhyten në baltë në sezonin e thatë ose gjatë dimrit. Gjithashtu, mund të tolerojnë sasi të konsiderueshme të ndotësve organikë në ujë. Zakonisht nuk janë të rëndomtë për ujërat ku ka lloje të shumta të peshqve (Kottelat and Freyhoff 2006).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat], 5.4 Këneta, moçale, moçalishte 5.5 Liqene të përhershme të ujërave të ëmbla).
Ky lloj është karakteristik për pellgje të ceketa, liqene të pasura me biměsi dhe lumenj të ngadaltë në lëvizje.

Përhapja e përgjithshme

Europë.

Përhapja në Kosovë

Liqeni i Badovcit.

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie
Popullatat e këtij lloji janë të fragmentuara dhe me tendencë zvogëlimi.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Gati i Kërcënuar, për shkak të rëndësisë dhe rrallësisë së llojit në nivel europian, si dhe tendencës në rritje të aktiviteteve, të cilat mund ta çojnë këtë lloj drejt zhdukjes në Kosovë. Numri momental i njohur i lokacioneve (1) e kualifikon këtë lloj për kategoritë e zhdukjes, megjithatë, presim që lloji të jetë më shumë i përhapur në Kosovë.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.1 Zonat rezidenciale dhe komerciale); 8 Speciet invazive dhe të tjera problematike, gjenet dhe sëmundjet (8.3 Materiali gjenetik i futur);11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.2 Thatësirat).
Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj, kanë të bëjnë me ndikimin nga vendbanimet dhe mjediset urbane, ndotjen nga ujërat e zeza, ndotjen nga mbeturinat e ngurta dhe të tjera, si dhe me thatësirën. Faktor tjetër, që e rrezikon këtë lloj, është edhe hibridizimi me lloje joautoktone.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloj i mbrojtur në Kosovë (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lokalitetin ku gjendet dhe llojet e tjera prezente.

Referencat

Kottelat and Freyhoff 2006





Pachychilon pictum Heckel & Kner, 1858

Larëza, Skorta shqiptare

Actinopterygii: Cypriniformes: Cyprinidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Linda Grapci Kotori

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj ushqehet kryesisht me organizma të planktonit, si dhe me larva të insekteve e pjesëtarë të tjerë të makrozoobentosit. Mund të ushqehet gjithashtu me lloje të tjera të peshqve, por edhe me perifiton. Shumohet në pranverë, në periudhën kur temperatura e ujit ngritet mbi 12 °C. Madhësia e trupit arrinë deri në 20 cm dhe pesha deri në 70 gr (Frayhof 2006; Marič 1995).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat], 5.4 Këneta, moçale, moçalishte, 5.5 Liqene të përhershme të ujërave të ëmbla).
Ky lloj jeton në ujëra të ëmbla me shpejtësi të vogël ose mesatare, por mund të haset edhe në liqene.

Përhapja e përgjithshme

Lloj endemik i Ballkanit, por si i introduktuar haset edhe në Francë, Itali dhe disa vende të tjera të Europës.

Përhapja në Kosovë

Lumbardhi i Pejës, Drini i Bardhë, Ereniku, Lumbardhi i Prizrenit, Lumbardhi i Deçanit.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm
Popullata e këtij lloji ka një shtrirje relativisht të gjerë në të gjitha ujërat që i takojnë pellgut të detit Adriatik. Megjithatë, viteve të fundit në disa prej lokaliteteve është vërejtur tendencë e degradimit të habitatit.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Gati i Kërcënuar, për shkak të rëndësisë dhe rrallësisë së llojit në nivel europian, si dhe tendencës në rritje të aktiviteteve, të cilat mund ta çojnë këtë lloj drejt zhdukjes në Kosovë. Numri momental i njohur i lokacioneve (9) e kualifikon këtë lloj për kategoritë e zhdukjes, megjithatë, presim që lloji të jetë më shumë i përhapur në Kosovë.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane, 9.4 Mbeturinat dhe mbetjet e ngurta); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.2 Thatësirat).
Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë, lloj kanë të bëjnë me ndërtimin e pendave, modifikimet e ndryshme të ekosistemeve, ndotjen nga ujërat e zeza, ndotjen nga mbeturinat e ngurta dhe të tjera, si dhe me thatësirën.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lokalitetin ku gjendet dhe llojet e tjera prezente.

Referencat

Frayhof 2006; Marič 1995



Rhodeus amarus Bloch, 1782

Idhtaku

Actinopterygii: Cypriniformes: Cyprinidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Linda Grapci Kotori, Qenan Maxhuni

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj, shumimin e fillon menjëherë pas vitit të parë të jetës. Madhësia e individëve të rritur mund të mbërrijë deri në 30-35 cm. Ky lloj jeton deri në 5 vjet, por shumica e individëve nuk e mbijetojnë vitin e riprodhimit të parë të tyre, kështu që madhësia e popullatave ndryshon dukshëm përgjatë viteve (Freyhoff and Kottelat 2008). Shumohet gjatë muajve prill dhe gusht. Ushqehet kryesisht me bimë, por në masë më të vogël edhe me krimba, gaforre dhe larva insektesh. Është karakteristik për vendosjen e vezëve të tij në kavitetin e guacave Unio.

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat], 5.4 Këneta, moçale, moçalishte, 5.5 Liqene të përhershme të ujërave të ëmbla).
Kryesisht haset në ato mjedise ku rjedhja e ujit është e ngadalshme, por edhe në ujëra të ndenjura, shpesh herë me fund të pasur me baltë. Haset shpesh në mjedise të pasura me vegjetacion.

Përhapja e përgjithshme

Europë dhe më gjerë.

Përhapja në Kosovë

Lumi Drenica në Çikatovë, Lumi Drenica në Grabovc.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Të dhënat për përhapjen e tij dhe trendet e popullatës janë akoma të pamjaftueshme, por është vërejtur se popullata e tij ka luhatje të madhe, pasi që shumica e individëve nuk e mbijetojnë vitin e parë të shumimit.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Gati i Kërcënuar, për shkak të rëndësisë dhe rrallësisë së llojit në nivel europian, si dhe tendencës në rritje të aktiviteteve, të cilat mund ta çojnë këtë lloj drejt zhdukjes në Kosovë.

Numri momental i njohur i lokacioneve (2) dhe zona e pranisë ZP = 8 km2 e kualifikojnë këtë lloj për kategoritë e zhdukjes, megjithatë, presim që ai të jetë më shumë i përhapur në Kosovë.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 8 Llojet invazive dhe të tjera problematike, gjenet dhe sëmundjet (8.1 Llojet invazive jonative/të huaja/sëmundjet); 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane, 9.4 Mbeturinat dhe mbetjet e ngurta); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.2 Thatësirat).
Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë, lloj kanë të bëjnë me sëmundjet që mund të vijnë nga llojet e huaja dhe/apo joautoktone, pastaj ndotja urbane dhe nga amvisëritë, ndotja me mbeturina të ngurta dhe të tjera si dhe thatësira.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lokalitetin ku gjendet dhe llojet e tjera prezente.

Referencat

Freyhoff and Kottelat 2008





5.6 REPTILIA

Ablepharus kitaibelii Bibron & Bory St. Vincent, 1833

Hardhuca këmbëshkurtër

Reptilia: Squamata: Scincidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj ka gjatësi trupore prej 10 deri në 11 cm. Koka e vogël kalon në qafë pa ndonjë kufi të qartë. Trupi përfundon me bisht të hollë e të gjatë. Ngjyra e trupit është mjaft variabile dhe mund të jetë e përhimët, ngjyrë ulliri, ngjyrë kafe ose e bronztë, kurse nga ana barkore është më e ndritshme. Ushqehet me lloje të ndryshme të merimangave, dipterëve, krahfortëve, fluturave dhe me lloje të tjera të pakurrizorëve. Është lloj ovipar. Femra, e cila piqet seksualisht në moshën dyvjeçare, prodhon 2 deri në 5 vezë në fund të majit ose në fillim të qershorit, ndërsa prej tyre dalin të vegjlit me madhësi deri në 4 mm në fund të korrikut ose në fillim të gushtit (Bohme et al. 2009).

Habitati

Lloji i habitatit: 1 Pyje; 3. Shkurre; 4. Kullosa; 14. Artificiale/tokësore.
Ky lloj zakonisht haset në vende të thata me gjethe e biměsi të vogël.

Përhapja e përgjithshme

Bullgari, Greqi, Hungari, Kosovë, Kroaci, Maqedoni, Rumani, Serbi, Sllovaki, Shqipëri, Turqi.

Përhapja në Kosovë

Prizren, Novo Bërdë, Radavc, Gazimestan, Zatra.

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie
Trendi i popullatave në nivel global është i qëndrueshëm. Në Kosovë, në bazë të të dhënave të deritanishme, nënpopullatat janë të fragmentuara dhe jostabile.

Arsyetimi i vlerësimit

Trendi i popullatës së këtij lloji është në rënie në Kosovë. Megjithatë, numri i nënpopullatave pritet të jetë shumë më i madh sesa dihen tani. Aktualisht, ky lloj nuk kualifikohet për kategoritë më të larta të rrezikshmërisë, por në qoftë se intensifikohen aktivitetet kërcënuese për këtë lloj, atëherë mund të rrezikohet ndjeshëm. Për këto arsye, lloji vlerësohet si: Gati i Kërcënuar.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 2 Bujqësia dhe akuakultura (2.1 Bimët vjetore dhe shumëvjeçare jodrusore: 2.1.1 Zhvendosja e bujqësisë); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.1 Zjarret dhe luftimi i tyre); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).
Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj, kanë të bëjnë me fragmentimin e habitatit si rezultat i zhvillimit të bujqësisë intensive, ndërrimin e destinacionit të kulturave bujqësore dhe krijimin e sipërfaqeve të reja, të cilat kërkojnë infrastrukturë të re. Faktorë potencial kërcënues janë po ashtu: keqmenaxhimi i mjediseve pyjore, zjarrvëniet e arave, fushave, kullosave e pyjeve, ndërtimet urbanistike pa plan, si dhe hapja e rrugëve të reja me infrastrukturën përcjellëse. Zhvillimi i popullatave të këtij lloji varet edhe nga dinamika e zhvillimit të disa pakurrizorëve me të cilët ushqehet lloji, por edhe nga dinamika e zhvillimit të disa shpendëve dhe gjitarëve të tjerë.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Bohme et al. 2009





Coronella austriaca Laurenti, 1768

Gjarpri i butë

Reptilia: Squamata: Colubridae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj

Të dhëna të përgjithshme

Është gjarpër johelmues dhe shumë i ngathët. Gjatësia e trupit është 80 – 90 cm. Trupi është i mbuluar me lëfore të lëmuara me shkëlqim. Mashkulli, në anën shpinore karakterizohet me ngjyrë hiri të errët ose të verdhë në të kuqërreme, kurse te femra dominon ngjyra e hirit. Ky lloj ushqehet me reptile të tjera dhe gjitarë të imtë. Është ovovivipar. Në muajin shtator zakonisht femrat i lindin 5 – 8 të vegjël, e rrallë ndonjëherë edhe deri në 15.

Habitati

Mund të haset kryesisht në viset kodrinore shkëmbore të thata, afër pyjeve, por edhe në vise të larta malore deri në 2000 m lartësi mbidetare.

Përhapja e përgjithshme

Armeni, Austri, Azerbajxhan, Bjellorusi, Belgjikë, Bosnjë-Hercegovinë, Bullgari, Çeki, Estoni, Finlandë, Francë, Gjeorgji, Gjermani, Greqi, Iran, Itali, Kazakistan, Kosovë, Kroaci, Letoni, Lituani, Luksemburg, Maqedoni, Mbretëri e Bashkuar, Moldavi, Mali i Zi, Holandë, Norvegji, Poloni, Portugali, Rumani, Rusi, Serbi, Sllovaki, Slloveni, Spanjë, Suedi, Shqipëri, Zvicër, Turqi, Ukrainë.

Përhapja në Kosovë

Muzhevinë, Osojan, Matiqan, Caralevë, Rapçe, Kërstec, Dobërdol, Gërmi, Nerodime e Epërme, Maja e Zezë, Zatra, Leposaviq, Shutman.

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie
Trendi i popullatave në nivel global është në rënie e sipër. Në Kosovë, gjithashtu, nënpopullatat e këtij lloji kanë trend negativ.

Arsyetimi i vlerësimit

Trendi i popullatës së këtij lloji është në rënie në Kosovë. Megjithatë, numri i nënpopullatave është akoma i madh, me disa të tjera që pritet të gjenden nga hulumtime të tjera.

Tash për tash, ky lloj nuk kualifikohet për tri kategoritë më të larta të rrezikshmërisë, por në qoftë se intensifikohen aktivitetet kërcënuese për këtë lloj, atëherë mund të rrezikohet ndjeshëm. Për këto arsye, lloji vlerësohet si: Gati i Kërcënuar.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 2 Bujqësia dhe akuakultura (2.1 Bimët vjetore dhe shumëvjeçare jo drusore: 2.1.1 Zhvendosja e bujqësisë); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); Modifikimet e sistemeve natyrore (7.3 Modifikime të tjera të ekosistemit).
Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj, kanë të bëjnë me degradimin dhe fragmentimin e habitatit nëpërmjet keqmenaxhimit të sipërfaqeve pyjore, djegies së pyjeve, shkurreve dhe bimësisë, por edhe nga intensifikimi i bujqësisë dhe ndërrimi i destinacioneve të kulturave bujqësore, si dhe hapja e sipërfaqeve të reja për kultura të cilat kërkojnë kushte specifike klimatike.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.





Darevskia praticola Eversmann, 1834

Hardhuca e pyllit

Reptilia: Squamata: Lacertidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Gati i Kërcënuar, NT

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj

Të dhëna të përgjithshme

Te ky lloj kemi një heterogjenitet të madh të lëforeve sa i përket numrit dhe madhësisë së tyre. Gjatësia trupore arrin midis 12 dhe 15 cm. Ana shpinore e trupit ka ngjyrë hiri, kafe apo ulliri. Ana barkore e trupit te meshkujt ka ngjyrë të gjelbër, kurse te femrat të verdhë. Është lloj ovipar. Femra prodhon 4 – 6 vezë në maj ose prill, prej të cilave dalin format e reja në korrik ose gusht. Jetëgjatësia e këtij lloji është deri në 6 vjet.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje; 4. Kullosa; 14. Artificiale/tokësore.
Ky lloj haset në zona kodrinore-malore të pasura me kullosa, shkurre, si dhe në trungjet e drunjve të vjetër. Përveç zonave të ulëta, mund të haset edhe në lartësi mbidetare deri në mbi 1700 m.

Përhapja e përgjithshme

Armeni, Azerbejxhan; Bullgari, Greqi, Gjeorgji, Iran, Kosovë, Rumani, Rusi, Serbi, Turqi.

Përhapja në Kosovë

Osojan, Gërmi, Banjskë, Breznicë.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Trendi i popullatave në nivel global është në rënie e sipër. Në Kosovë nuk ka të dhëna të mjaftueshme për trendin e popullatave të këtij lloji, por viteve të fundit është vërejtur me numër të vogël të individëve në disa lokalitete.

Arsyetimi i vlerësimit

Trendi i popullatës së këtij lloji në Kosovë nuk është tërësisht stabil, megjithëqë nuk njihet detajisht. Megjithatë, numri i nënpopullatave pritet të jetë shumë më i madh se sa dihen tani. Aktualisht, ky lloj nuk kualifikohet për tri kategoritë më të larta të rrezikshmërisë, por në qoftë se intensifikohen aktivitetet kërcënuese për këtë lloj, atëherë mund të rrezikohet ndjeshëm. Për këto arsye, lloji vlerësohet si: Gati i Kërcënuar.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.2 Hapësirat komerciale dhe industriale); 4 Korridoret e transportit dhe shërbimit (4.1 Rrugët dhe hekurudhat); 6 Ndërhyrje dhe shqetësime njerëzore (6.1 Aktivitete rekreative; 6.2 Luftëra, trazira civile dhe ushtrime ushtarake).
Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj, kanë të bëjnë me fragmentimin, humbjen dhe shkatërrimin e habitateve si rezultat i zhvillimit të infrastrukturës, turizmit dhe urbanizimit, pastaj kushtet klimatike ekstreme. Lufta e armatosur në Kosovë, përkatësisht lëvizja e automjeteve të rënda ushtarake duket se e ka dëmtuar dukshëm këtë lloj. Një faktor tjetër, që e rrezikon këtë lloj, është edhe aktiviteti rekreativ i njeriut.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.





Emys orbicularis Linnaeus, 1758

Breshkujca

Reptilia: Testudines: Emydidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Gati i Kërcënuar, NT

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj

Të dhëna të përgjithshme

Gjatësia trupore e këtij lloji mund të jetë prej 20 deri në 30 cm (Arnold & Ovenden 2002). Karapaksi ka ngjyrë të mbylltë me njolla të verdha në formë të një mozaiku. Gjatë ditës qëndron në ujë dhe pranë ujit, kurse natën largohet në një distancë të caktuar nga uji. Ushqehet me peshq, bretkosa dhe larva të tyre, pakurrizorë e në disa raste edhe me bimë (Ficetola & De Bernardi 2006). Fekondimi kryhet në ujë gjatë muajit maj dhe pas një muaji femra prodhon zakonisht 6 deri në 10 vezë e rrallë deri në 20, të cilat i vendos në një gropë afër ujit, të cilën e ka përgatitur më parë. Vezët dimërojnë në gropëz dhe pastaj në pranverë pas disa muajsh, nga to dalin format e reja.

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale); 15. Artificiale/ujore dhe detare.
Ky lloj mund të gjendet kryesisht në ujëra të ndenjura ose në ujëra me rrjedhje të ngadalshme ku ka edhe vegjetacion ujor.

Përhapja e përgjithshme

Europë jugore, Europë e mesme, nga lindja deri në detin Kaspik dhe Aral, Afrikë veriperëndimore.

Përhapja në Kosovë

Krushë e Vogël, Gjakovë, Krushë e Madhe, Komoran, Rruga Prizren-Dragash në afërsi të Drinit të Bardhë, Gjurakoc.

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie
Trendi i popullatave në nivel global është në rënie. Në Kosovë, gjithashtu, gjendja e nënpopullatave të këtij lloji është në rënie.

Arsyetimi i vlerësimit

Trendi i popullatës së këtij lloji është në rënie në Kosovë. Megjithatë, numri i nënpopullatave është akoma i madh, me disa të tjera që pritet të gjenden nga hulumtime të tjera. Tash për tash, ky lloj nuk kualifikohet për tri kategoritë e rrezikshmërisë, por në qoftë se intensifikohen aktivitetet kërcënuese për këtë lloj, atëherë mund të rrezikohet ndjeshëm. Për këto arsye, lloji vlerësohet si: Gati i Kërcënuar.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.2 Zonat tregtare dhe industriale 1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit); 4 Korridoret e transportit dhe shërbimit (4.1 Rrugët dhe hekurudhat); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi/përdorimi i ujit); 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Ujërat e zeza, 9.1.2 Shkarkimet); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.2 Thatësirat).
Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj, kanë të bëjnë me fragmentimin dhe degradimin e habitatit. Meqenëse ky lloj jeton në ujëra të qeta dhe të lokalizuara afër tokave pjellore, ai është i kërcënuar nga ndryshimi i këtyre sipërfaqeve duke i tharë ato, qoftë nën ndikimin e temperaturave ekstreme ose duke e bërë kullimin e tyre nëpërmes kanaleve të ndryshme. Ky lloj shpeshherë rrezikohet edhe nga ndikimet në shtretërit e lumenjve për shkak të shfrytëzimit të rërës, pastaj nga ndotja e lumenjve, si dhe derdhja e ujërave të zeza të cilat përmbajnë pesticide.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.





Natrix natrix Linnaeus, 1758

Gjarpri i barit

Reptilia: Squamata: Colubridae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj

Të dhëna të përgjithshme

Është gjarpër johelmues dhe i padëmshëm. Është shumë lehtë i identifikueshëm nga gjarpërinjtë e tjerë, për shkak të prezencës së dy njollave në formë gjysmëhëne me ngjyrë të bardhë ose të verdhë, të cilat janë të lokalizuara në të dy anët e pasme të kokës. Ngjyra e trupit është e ndryshme. Nga ana shpinore zakonisht mund të jetë e hirtë, e gjelbër, ngjyrë ulliri ose e spërkatur me njolla të zeza ose bojëkafe, kurse nga ana barkore është tërësisht e ndritshme dhe vetëm kah bishti me njolla të zeza. Ushqehet kryesisht me bretkosa, peshq dhe larva të tyre, si dhe me shtazë të tjera të imta. Është ovipar. Femra prodhon 15 – 20 vezë, e ato të moshuarat edhe deri në 35. Për një muaj e gjysmë ose dy dalin format e reja, të cilat ushqehen me larva të peshqve dhe ujëtokësorëve.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje; 3. Shkurre; 4. Kullosa 5. Vende ujore (kontinentale); 14. Artificiale/tokësore; 15. Artificiale/ujore dhe detare
Mund të haset zakonisht në ujë ose pranë ujërave të qeta dhe të rrjedhshme, pastaj në kanale, pellgje të lumenjve, por edhe në vende të larta deri në 2000 m.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Afrikë veriore, Azi perëndimore.

Përhapja në Kosovë

Pogragjë, Tucep, Veriq, Mramor, Nerodime e Epërme, Drajkoc, Nedakovc, Moknë, Ujmirë.

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie
Në nivel global trendi i popullatave është në rënie. Në Kosovë, gjithashtu, është vërejtur rënie e popullatave të këtij lloji

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Gati i Kërcënuar, për shkak të numrit të vogël të lokaliteteve ku gjendet, si dhe tendencës në rritje të aktiviteteve të cilat mund ta çojnë këtë lloj drejt zhdukjes në Kosovë.

Aktualisht ky lloj nuk kualifikohet për tri kategoritë më të larta të rrezikshmërisë, por në qoftë se intensifikohen aktivitetet kërcënuese për këtë lloj, atëherë mund të rrezikohet ndjeshëm. Ky lloj aktualisht është i njohur nga 9 lokacione, por mund të pritet edhe nga disa të tjera.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.1 Banimi dhe zonat urbane); 4 Korridoret e transportit dhe shërbimit (4.1 Rrugët dhe hekurudhat); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.1 Gjuetia dhe mbledhja e kafshëve tokësore: 5.1.3 Përndjekja/kontrolli).
Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj, janë veprimtaritë antropogjene, që kanë të bëjnë me degradimin, fragmentimin, modifikimin apo humbjen e tërësishme të habitateve. Para së gjithash, faktorë kërcënues për këtë lloj janë zhvillimet që vijnë nëpërmjet urbanizimit, si ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës rrugore, por edhe intensifikimi i bujqësisë. Një faktor tjetër, që e rrezikon llojin, është edhe përndjekja nga njeriu.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloj i mbrojtur në Kosovë (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.





Podarcis tauricus Pallas, 1814

Hardhuca e barit

Reptilia: Testudines: Emydidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj

Të dhëna të përgjithshme

Është gjarpër johelmues dhe i padëmshëm. Është shumë lehtë i identifikueshëm nga gjarpërinjtë e tjerë, për shkak të prezencës së dy njollave në formë gjysmëhëne me ngjyrë të bardhë ose të verdhë, të cilat janë të lokalizuara në të dy anët e pasme të kokës. Ngjyra e trupit është e ndryshme. Nga ana shpinore zakonisht mund të jetë e hirtë, e gjelbër, ngjyrë ulliri ose e spërkatur me njolla të zeza ose bojëkafe, kurse nga ana barkore është tërësisht e ndritshme dhe vetëm kah bishti me njolla të zeza. Ushqehet kryesisht me bretkosa, peshq dhe larva të tyre, si dhe me shtazë të tjera të imta. Është ovipar. Femra prodhon 15 – 20 vezë, e ato të moshuarat edhe deri në 35. Për një muaj e gjysmë ose dy dalin format e reja, të cilat ushqehen me larva të peshqve dhe ujëtokësorëve.

Habitati

Lloji i habitatit: 3. Shkurre; 4. Kullosa; 14. Artificiale/tokësore.
Këtë lloj e hasim kryesisht në zona të hapura, livadhe, fusha dhe ara të punuara, si dhe në toka ranore. Po ashtu, shpesh mund të vrojtohen në vende të thata e të diellosura mirë, pastaj në vise kodrinore të ulëta dhe me vegjetacion të varfër. Mund të haset në lartësi mbidetare deri mbi 2000 m.

Përhapja e përgjithshme

Europë juglindore nga Danubi e deri në Krime dhe në jug deri në detin Mesdhe.

Përhapja në Kosovë

Kievë, Gllarevë, Gërmi, Mirushë, Zhur, Caralevë, Potok, Bozhevce.

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie
Trendi i popullatave në nivel global është i qëndrueshëm. Në Kosovë në bazë të të dhënave të deritanishme nënpopullatat janë të fragmentuara dhe jostabile.

Arsyetimi i vlerësimit

Trendi i popullatës së këtij lloji është në rënie në Kosovë. Megjithatë, numri i nënpopullatave pritet të jetë shumë më i madh sesa është tani.

Tash për tash, ky lloj nuk kualifikohet për kategoritë më të larta të rrezikshmërisë, por në qoftë se intensifikohen aktivitetet kërcënuese, atëherë mund të rrezikohet ndjeshëm. Për këto arsye, lloji vlerësohet si: Gati i Kërcënuar.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial; 2 Bujqësia dhe akuakultura (2.1 Bimët vjetore dhe shumëvjeçare jodrusore: 2.1.1 Zhvendosja e bujqësisë); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.1 Zjarret dhe luftimi i tyre); 9 Ndotja.
Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj, kanë të bëjnë me degradimin, fragmentimin dhe humbjen e habitateve si rezultat i intensifikimit të bujqësisë, pastaj hapja e sipërfaqeve të reja, si dhe ndërrimi i destinacionit të kulturave bujqësore. Faktorë të tjerë kërcënues, janë edhe përdorimi i agrokemikaleve të ndryshme, pastaj zjarrvëniet e qëllimshme të arave, fushave, kullosave dhe pyjeve.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Chondropoulos & Lykakis 1983





Testudo hermanni Gmelin, 1789

Breshka e zakonshme

Reptilia: Testudines: Testudinidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Gati i Kërcënuar, NT

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj

Të dhëna të përgjithshme

Është lloj biměngrënës, por nganjëherë ushqehet edhe me insekte. Gjatësia e trupit është midis 20 dhe 25 cm. Ngjyra e trupit nga ana shpinore është e verdhë me njolla të zeza. Femrat janë më të mëdha se meshkujt. Ato prodhojnë 6 – 8 vezë prej majit e deri në korrik, kurse koha e inkubimit është prej 60 deri në 90 ditë.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje; 3. Shkurre; 14. Artificiale/tokësore.
Ky lloj mund të gjendet kryesisht në habitate të thata dhe shkëmbore, të mbuluara me bar dhe me shkurre, pastaj pranë rrugëve, arave dhe pemishteve në lartësi deri në 500 m. Në Ballkan, ky lloj, megjithatë mund të gjendet edhe në mbi 1300 m (Bertolero et al. 2011).

Përhapja e përgjithshme

Bosnjë-Hercegovinë, Bullgari, Francë, Greqi, Itali, Kosovë, Kroaci, Mali i Zi, Rumani, Serbi, Spanjë, Shqipëri, Turqi.

Përhapja në Kosovë

Potok, Batushë, Morinë, Firajë, Mramor, Marec, Qabiq, Gjurgjevik i Madh, Veriq, Osojan, Zhur, Krushë e Vogël, Malishevë, Tifek, Gajre, Rahovec, Nerodime e Epërme, Nerodime e Poshtme, Malishevë, Lipa, Zhazhë, Baks, Prejlep.

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie
Trendi i popullatave në nivel global është në rënie. Në Kosovë, gjithashtu, gjendja e nënpopullatave të këtij lloji është në rënie.

Arsyetimi i vlerësimit

Trendi i popullatës së këtij lloji është në rënie në Kosovë. Megjithatë, numri i nënpopullatave pritet të jetë më i madh. Tash për tash, ky lloj nuk kualifikohet për kategoritë më të larta të rrezikshmërisë, por në qoftë se intensifikohen aktivitetet kërcënuese, atëherë mund të rrezikohet ndjeshëm. Për këto arsye, lloji vlerësohet si: Gati i Kërcënuar.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.1 Strehimi dhe zonat urbane, 1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit); 2 Bujqësia dhe akuakultura (2.1 Bimët vjetore dhe shumëvjeçare jodrusore: 2.1.1 Zhvendosja e bujqësisë); 4 Korridoret e transportit dhe shërbimit (4.1 Rrugët dhe hekurudhat); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.1 Gjuetia dhe grumbullimi i kafshëve tokësore: 5.1.2 Efektet e padëshiruara (llojet që vlerësohen nuk janë të synuara), 5.1.3 Përndjekja/kontrolli); 6 Ndërhyrje dhe shqetësime njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.1 Zjarret dhe luftimi i tyre); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Bertolero et al. 2011





Zootoca vivipara Jacquin, 1787

Hardhuca gjallëpjellëse

Reptilia: Squamata: Lacertidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj

Të dhëna të përgjithshme

Për nga pamja e jashtme, ky lloj i ngjason hardhucës së murit. Gjatësia trupore sillet prej 14 deri në 16 cm. Ngjyra e trupit nga ana shpinore është kafe e mbyllët ose e hirit, e spërkatur me njolla të zeza dhe pika të bardha. Ana barkore e trupit te meshkujt ka ngjyrë të verdhë në të portokalltë dhe me pika të zeza, kurse tek femrat ajo është ngjyrë hiri ose e gjelbër. Aktivizohet herët në pranverë. Fekondimi ndodh në maj, kurse femrat lindin në gusht, zakonisht 5 – 8 të vegjël. Përfaqësuesit e këtij lloji që jetojnë në viset veriore janë viviparë, kurse ata nga rajonet jugore janë oviparë (Mayer et al. 2000). Meshkujt e arrijnë pjekurinë në moshën 2 vjeçare, kurse femrat më vonë. Të vegjlit pavarësohen menjëherë, një ditë pas lindjes. Jetëgjatësia mesatare është 5 – 6 vjet.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje; 3. Shkurre; 4. Kullosa; 5. Vende ujore (kontinentale); 14. Artificiale/tokësore.
Ky lloj mund të haset në vise të larta malore, prej 100 e deri më 3000 m lartësi mbidetare. Kryesisht është lloj i kufizuar në terrene të mbuluara me barë. Gjithashtu, gjendet shpesh përreth ekosistemeve të ujërave të ëmbla.

Përhapja e përgjithshme

Gati i tërë Palearktiku, nga jugu deri në Pirineje dhe në lindje në Mongoli dhe ishujt Sahalin.

Përhapja në Kosovë

Pllajnik, Peri Breg, Shtëpia e Stojkut.

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie
Trendi i popullatave në nivel global është në rënie e sipër. Në Kosovë, gjithashtu, nënpopullatat e këtij lloji janë në rënie.

Arsyetimi i vlerësimit

Trendi i popullatës së këtij lloji është në rënie në Kosovë. Megjithatë, numri i nënpopullatave pritet të jetë shumë më i madh se sa dihen tani.

Tash për tash, ky lloj nuk kualifikohet për kategoritë më të larta të rrezikshmërisë, por në qoftë se intensifikohen aktivitetet kërcënuese, atëherë mund të rrezikohet ndjeshëm. Për këto arsye, lloji vlerësohet si: Gati i Kërcënuar.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.3 Zona turistike dhe rekreative); 6 Ndërhyrje dhe shqetësime njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative, 6.3 Punë dhe aktivitete të tjera); 11 Ndryshimet klimatike dhe moti i ashpër (11.2 Thatësirat, 11.3 Ekstremet e temperaturës).
Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj kanë, të bëjnë me degradimin dhe shkatërrimin e habitateve për shkak të zhvillimit intensiv të bujqësisë, infrastrukturës, objekteve agroindustriale, kurse në viset e larta malore edhe për shkak të zhvillimit të turizmit dhe aktiviteteve rekreative. Lufta e armatosur në Kosovë, përkatësisht lëvizja e automjeteve të rënda ushtarake, duket se e ka dëmtuar dukshëm këtë lloj. Një faktor tjetër, që e rrezikon këtë lloj, është edhe aktiviteti rekreativ i njeriut.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloj i mbrojtur në Kosovë (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Mayer et al. 2000





5.7 AVES

Acrocephalus palustris Bechstein, 1798

Bilbilthi i verdhemë

Aves: Passeriformes: Acrocephalidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Taulant Bino, Qenan Maxhuni

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e këtij lloji është 13 cm, kurse pesha 10–13 g (mesatarja 11·9 g). Ky është një lloj shtegtar dhe ushqehet kryesisht me insekte, arahnidë, kërmij dhe fruta (BirdLife International 2016m).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.4. Moçale, këneta, moçalishte).
Ky lloj parapëlqen bimësinë e grumbulluar, të dendur e të lartë, veçanërisht të gjinive Urtica dhe Filipendula apo Rubus fructuousus, shpesh në afërsi të shkurreve apo pemëve të ulëta. Gjithashtu, mund të gjendet në fusha misri dhe toka të tjera bujqësore, përreth të cilave ekziston shirit shkurresh. Lloji mund të gjendet edhe në djerrina dhe vende me bar të lartë e shkurre të ulëta, pastaj në vegjetacion të gjatë barishtor përgjatë kanaleve, në bimësi të moçaleve në skajet e kënetave, në tokë të thatë e madje edhe në kopshte (BirdLife International 2016m).

Përhapja e përgjithshme

Angli jugore (lokalist), Skandinavi jugore, Francë veriore dhe lindore dhe Itali veriore në lindje drejt Kazakistanit veriperëndimor, në jug deri në Ballkanin verior, Turqinë lindore dhe Iranin veriperëndimor; dimëron në Afrikën juglindore.

Përhapja në Kosovë

Henc.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj ka përhapje të kufizuar në Kosovë, në bazë të njohurive prezente dhe u është nënshtruar kërcënimeve, të cilat mund ta rrezikojnë në të ardhmen e afërt. Megjithatë, ky lloj nuk kualifikohet për kategoritë më të larta të rrezikshmërisë, sepse supozojmë se është më shumë i përhapur nga sa dihet tani. Për këtë arsye, e vlerësojmë në kategorinë: Gati i Kërcënuar.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 2 Bujqësia dhe akuakultura (2.1 Bimët vjetore dhe shumëvjeçare jodrusore) 11 Ndryshimet klimatike dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Ky lloj është i mbrojtur në Kosovë (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës, 1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve). 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës); 5 Ligji dhe politika (5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

BirdLife International 2016m





Anas crecca Linnaeus, 1758

Rosa kërre

Aves: Anseriformes: Anatidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Taulant Bino, Qenan Maxhuni

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e këtij lloji është 34–38 cm, mashkulli peshon 250–450 g, femra 200–400 g, kurse hapja e krahëve 58–64 cm. Në pjesën veriore të përhapjes është lloj shtegtar, kurse në vendet me klimë mesatare është më tepër lloj sedentar. Gjatë folezimit ushqehet kryesisht me ushqim me prejardhje shtazore, kurse gjatë dimrit me fara të bimëve ujore (BirdLife International 2016a).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat)], 5.5 Liqene të përhershme të ujërave të ëmbla (mbi 8ha), 5.7 Moçale/basene të përhershme të ujërave të ëmbla (nën 8ha), 5.8 Moçale/basene të përkohshme/sezonale të ujërave të ëmbla (nën 8ha)).
Ky lloj parapëlqen ujërat e cekët të përhershme në sezonin e folezimit, sidomos ato në afërsi të pyjeve me mbulesë barishtore mjaft të dendur, në dispozicion të afërt për folezim. Liqenet dhe kënetat e vogla të ujërave të ëmbla me bimësi të bollshme emergjente parapëlqehen më shumë se trupat e vegjël ujorë, që formojnë pjesë të ligatinave më të mëdha. Habitatet e tjera të përshtatshme përfshijnë pellgje të vogla, pishina dhe rrjedha të ngadalta. Jashtë sezonit të folezimit ky lloj frekuenton habitate të ngjashme. Gjatë dimrit parapëlqen kënetat me fund me baltë (BirdLife International 2016a).

Përhapja e përgjithshme

Folezon në pjesën më të madhe të Palearktikut verior dhe qendror; dimëron në Eurazinë qendrore dhe jugore dhe Afrikë.

Përhapja në Kosovë

Henc, Obiliq.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj ka numër të kufizuar të individëve gjatë kohës së folezimit, si dhe habitatet e folezimit janë të rrezikuara. Sidoqoftë, konsiderojmë se këto të dhëna nuk janë të kompletuara dhe presim që lloji të jetë më i përhapur në Kosovë nga sa dihet tani. Duke marrë këtë parasysh, e vlerësojmë llojin në kategorinë: Gati i Kërcënuar.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 2 Bujqësia dhe akuakultura (2.1 Kulturat vjetore dhe shumëvjeçare jo drusore); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.1 Gjuetia dhe grumbullimi i kafshëve tokësore: 5.1.1 Përdorimi i qëllimshëm (lloji që vlerësohet është i synuar)]; 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi/përdorimi i ujit: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri)].

Masat ekzistuese mbrojtëse

Ky lloj është i mbrojtur në Kosovë (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim:
1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës, 1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve). 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës); 5 Ligji dhe politika (5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Të ndërmerren veprime të menaxhimit të habitatit, të cilat sigurojnë ligatina të cekëta, të pasura me ushqim, sepse janë të dobishme për këtë lloj.

Referencat

BirdLife International 2016a





Picoides tridactylus Brehm, 1831

Qukapiku tregishtor

Aves: Piciformes: Picidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Taulant Bino, Qenan Maxhuni

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e këtij lloji është 20–24 cm (Eurazi). Ky lloj shpeshherë gjendet në ato vende ku shqetësimet si zjarri, për shembull, kanë shkaktuar shpërthim të insekteve (BirdLife International 2016j).

Habitati

Lloji i habitatit: Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare).
Ky lloj gjendet në pyje të rritura halore, veçanërisht në ato të Picea spp.

Përhapja e përgjithshme

Malet e Europës qendrore, jugore dhe juglindore (përveç Karpateve perëndimore), Tien Shan, Kore verilindore dhe Japoni veriore (Hokkaido)

Përhapja në Kosovë

Kuqishtë, Junik, Deçan.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj ka përhapje të kufizuar në Kosovë dhe i është nënshtruar kërcënimeve, të cilat në të ardhmen e afërt mund ta rrezikojnë. Megjithatë, nuk kualifikohet për kategoritë më të larta të rrezikshmërisë, sepse supozojmë se është më shumë i përhapur nga se dihet tani. Për këtë arsye, e vlerësojmë në kategorinë: Gati i Kërcënuar.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve: 5.3.4 Efektet e padëshiruara: vjelja për jetesë/në shkallë të vogël (lloji që vlerësohet nuk është i synuar).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Ky lloj është i mbrojtur në Kosovë (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës, 1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve). 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës); 5 Ligji dhe politika (5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Duhet të shmanget menaxhimi intensiv i habitateve të parapëlqyera të këtij lloji, si p.sh., pyjeve të vjetra të dominuara nga bredhi apo pisha me sasi të madhe të drunjve të vjetër brenda tyre. Në pyjet e menaxhuara në mënyrë intensive, drunjtë e vdekur ose duke u shpërbërë, duhet të lihen të paprekur. Nëse nuk ka mjaftueshëm drunj të vdekur, atëherë preferohet prerja e drunjve të rritur rreth 10 metra dhe lënia e tyre për t'u shpërbërë, e kjo ofron vende të përshtatshme për fole për këtë lloj.

Referencat

BirdLife International 2016a





Tetrao urogallus Linnaeus, 1758

Gjeli i egër

Aves: Galliformes: Phasianidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Taulant Bino, Qenan Maxhuni

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e këtij lloji është 80–115 cm, femra shumë më e vogël, 59–64 cm, mashkulli peshon 3300–4300 g (deri në 6500 g), femra 1440–2500 g. Ushqehet kryesisht me hala të pishës, gjethe, kërcej dhe fruta, kurse të vegjlit mund të ushqehen edhe me insekte. Është lloj sedentar me lëvizje të vogla gjatë dimrit (BirdLife International 2016).

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare).

Ky lloj gjendet në zona malore, kryesisht halore apo, të përziera halore dhe gjetherënëse. Preferon zona të gjera të pyjeve të vjetra me hije, shpesh me tokë të lagur dhe të ndërthurur me zona moçalore, zona të torfeve ose lëndinave, dhe me një shtresë të dendur të bimëve të familjes Ericacea, por me vegjetacion as shumë të hapur, as të mbyllur (BirdLife International 2016).

Përhapja e përgjithshme

Lloji ka përhapje të gjerë prej Europës deri në veri të Azisë.

Përhapja në Kosovë

Junik, Mushtisht.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Habitatet folezuese të këtij lloji janë të rrezikuara nga prerja e pyjeve, ndërsa vetë lloji është i rrezikuar nga gjuetia ilegale. Edhe pse të dhënat e izoluara të pakompletuara sugjerojnë vendosjen e këtij lloji në kategoritë e rrezikimit, megjithatë, ne supozojmë se lloji është më i përhapur në Kosovë nga sa dihet tani, bazuar edhe në të dhënat nga vendet përreth. Prandaj, këtë lloj e vlerësojmë në kategorinë: Gati i Kërcënuar.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.1 Gjuetia dhe mbledhja e kafshëve tokësore:: 5.1.1 Përdorimi i qëllimshëm (lloji që vlerësohet është i synuar), 5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve: 5.3.3 Efektet e paqëllimshme: vjelje për jetesë/në shkallë të vogël (lloji që vlerësohet nuk është i synuar)); 6 Ndërhyrje dhe shqetësime njerëzore (6.3 Punë dhe aktivitete të tjera).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloj i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura). Një pjesë e vargut të përhapjes është përcaktuar si zonë e mbrojtur.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës, 1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve). 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës); 5 Ligji dhe politika (5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi).

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Duhet përmirësuar njohuritë mbi efektet e gjuetisë në këtë lloj. Të zbatohen masa për të reduktuar braktisjen e aktiviteteve tradicionale agropastorale. Duhet përmirësuar legjislacioni dhe zbatimi i tij për të zvogëluar gjuetinë e paqëndrueshme dhe atë jolegale.

Referencat

BirdLife International 2016





5.8 MAMMALIA

Felis silvestris Schreber, 1777

Macja e egër

Mammalia: Carnivora: Felidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj

Të dhëna të përgjithshme

Trupi është i mbuluar me qime të dendura dhe të shkurtra me ngjyrë të ngjashme me atë të habitatit, e kjo e bën të vështirë dallimin. Ngjyra e trupit mund të jetë hiri ose kafe me njolla dhe lara ngjyrë të zezë, të cilat konvergjojnë në mes veti. Gjatësia e trupit është prej 51 – 71 cm, e bishtit prej 21 – 35 cm, kurse pesha trupore prej 2.7 – 7 kg. Është lloj karnivor dhe ushqehet me gjitarë të imët, shpendë dhe vezë të tyre, reptilë, amfibë dhe insekte. Është lloj mjaft i shkathët dhe me sukses ia arrin të mbrohet nga grabitqarët, të cilët janë edhe disa herë më të mëdhenj. Zakonisht e hasim natën në kërkim të ushqimit. Në ekosistem kanë pak ose aspak ndikim negativ për njeriun. Nuk migrojnë e as hibernojnë. Jetojnë 13 – 15 vjet (Weigle 2005).

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje; 3. Shkurre.
Ky lloj mund të haset në një gamë të gjerë habitatesh, duke filluar nga zonat pyjore, shkurret e pasura me vegjetacion dhe zonat e hapura shkëmbore, por duke i shmangur zonat në të cilat janë të koncentruar njerëzit.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Azi, Afrikë.

Përhapja në Kosovë

Svilen, Junik Mountains, Kërstec, Stanaj, Rahovë, Kaçandoll, Mushtisht.

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie
Trendi i popullatave është në rënie e sipër në nivel global. Gjithashtu, në Kosovë popullatat e këtij lloji janë të rrezikuara.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Gati i Kërcënuar, për shkak të numrit të vogël të lokaliteteve ku gjendet, trendit të popullatës, si dhe tendencës në rritje të aktiviteteve të cilat mund ta çojnë këtë lloj drejt zhdukjes në Kosovë. Tash për tash, ky lloj nuk kualifikohet për kategoritë e rrezikshmërisë, por në qoftë se intensifikohen aktivitetet kërcënuese, atëherë mund të rrezikohet ndjeshëm.

Kërcënimet

Faktorët kryesorë, që mund ta rrezikojnë, këtë lloj janë: humbja dhe fragmentimi i habitateve, degradimi i habitateve, hibridizimi me macet shtëpiake, pastaj gjuajtja për shkak të qëndrimit armiqësor dhe dëmtimit të shpendëve nga to etj.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Weigle 2005





Lutra lutra Linnaeus, 1758

Lundërza ose Vidra

Mammalia: Carnivora: Mustelidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Gati i Kërcënuar, NT

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj

Të dhëna të përgjithshme

Është gjitar gjysmëujor. Ka trup të mbuluar me gëzof ngjyrë kafe dhe me njolla të vogla të shndritshme, që shkëlqen dhe është rezistent ndaj ujit. Ka bisht të trashë dhe mjaft muskulor. Ka gjatësi trupore prej 57 – 95 cm dhe bisht prej 35 – 45 cm. Pesha trupore mund të jetë prej 7 – 24 kg. Mashkulli është zakonisht më i madh se femra. Është lloj mishngrënës dhe ushqehet me peshq, gaforre, bretkosa, kërmij, insekte, por edhe me gjitarë e shpendë të imët (Heggberget & Moseid 1994). Zakonisht është aktiv natën, kurse ditën qëndron në fole të ndërtuara nga rrënjët e drunjve. Është pre e ujqve, rrëqebullit, shpendëve grabitqarë dhe njeriut. Nuk migron dhe nuk bie në letargji. I pranishëm me disa nënlloje.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje; 3. Shkurre; 4. Kullosa; 15. Artificiale/ujore dhe detare.
Haset kryesisht në ujëra të pandotura, si lumenj, liqene, këneta etj., të cilat janë të pasura me kafshë ujore dhe peshq.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Azi, Afrikë veriore.

Përhapja në Kosovë

Mjak, Samakovë, Kralan, Deçan, Broliq, Grabanicë, Istog.

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Gati i Kërcënuar, për shkak të trendit të popullatës në rënie në nivel europian dhe tendencës në ngritje të aktiviteteve që e rrezikojnë këtë lloj në Kosovë. Tash për tash, ky lloj nuk kualifikohet për kategoritë e rrezikshmërisë, pasi që, me gjasë, në Kosovë ka edhe nënpopullata të tjera, por në qoftë se intensifikohen aktivitetet kërcënuese, atëherë mund të rrezikohet ndjeshëm në të ardhmen.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.1 Banimi dhe zonat urbane, 1.2 Hapësirat komerciale dhe industriale 1.3 Zonat turistike dhe rekreative); 2 Bujqësia dhe akuakultura (2.4 Akuakultura detare dhe e ujërave të ëmbla); 3 Prodhimi dhe minierat e energjisë (3.1 Eksploatimi i naftës dhe gazit, 3.2 Miniera dhe gurore 3.3 Energjia e ripërtërishme); 4 Korridoret e transportit dhe shërbimit (4.1 Rrugët dhe hekurudhat, 4.3 Korsitë transportuese); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.1 Gjuetia dhe mbledhja e kafshëve tokësore, 5.2 Mbledhja e bimëve tokësore, 5.4 Peshkimi dhe korrja e burimeve ujore); 6 Ndërhyrje dhe shqetësime njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi/përdorimi i ujit); 9 Ndotja.
Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj, kanë të bëjnë me aktivitetet e njeriut në sisteme ujore dhe përreth, si ndotja, prerja e pyjeve, pastrimi i bimëve përreth brigjeve të lumit, ndërtimi i digave, kullimi i ligatinave dhe tharja e kënetave, ndryshimi i habitateve, zgjerimi i vendbanimeve etj.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Heggberget & Moseid 1994



Miniopterus schreibersii Kuhl, 1817

Mammalia: Chiroptera: Vespertilionidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Gati i Kërcënuar, NT

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Philippe Théou

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj e kërkon ushqimin në një shumëllojshmëri të habitateve natyrore dhe artificiale, të hapura dhe gjysmë të hapura, duke përfshirë zonat periferike. Ushqehet kryesisht me flutura nate dhe herë pas here me miza. Ky është një lloj kolonial, që strofullon kryesisht në shpella dhe miniera (megjithëse, mund të gjendet edhe në tunele, gërmadha dhe ndërtesa të tjera), shpesh në koloni të mëdha të përziera me specie të tjera të lakuriqëve që banojnë në shpellë. Gjatë dimrit, hibernon në vende nëntokësore (zakonisht shpella të mëdha me një mikroklimë të vazhdueshme). Është lloj migrant, i cili i ndërron strofujt disa herë gjatë vitit. Lëvizjet në distanca të gjata ndodhin herë pas here (Hutterer et al. 2005; Hutson et al. 2007h).

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje, 3. Shkurre, 4. Kullosa 7. Shpella dhe habitate nëntokësore (joujore), 14. Artificiale/tokësore.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Afrikë, Azi.

Përhapja në Kosovë

Ostrovicë, Shpella e Banuar, Shpella e Dushit, Shpella e Radavcit, Grykë e Rugovës, Lumbardhi i Pejës në Pejë, Shpella e Kusarit, Shpella e Kishnarekës (Paunović 2016; Presetnik et al. 2018).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për gjendjen e popullatave të këtij lloji në Kosovë. Trendi i popullatave në nivel europian është në rënie.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Gati i Kërcënuar, për shkak të trendit të popullatave në nivel europian, si dhe tendencës në rritje të aktiviteteve të cilat mund ta çojnë këtë lloj drejt zhdukjes në Kosovë. Tash për tash, ky lloj nuk kualifikohet për kategoritë e rrezikshmërisë, por në qoftë se intensifikohen aktivitetet kërcënuese, atëherë mund të rrezikohet ndjeshëm.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1. Zhvillimi rezidencial dhe komercial; 6. Ndërhyrje dhe shqetësime njerëzore; 9. Ndotja.
Kërcënimet kryesore, që e rrezikojnë këtë lloj, kanë të bëjnë me fragmentimin dhe izolimin e habitateve, ndryshimet në regjimin menaxhues të pyjeve gjethegjera dhe tokave bujqësore, humbjen e popullatave të insekteve si rezultat i përdorimit të pesticideve, prishjen dhe humbjen e habitateve nëntokësore.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Paunović 2016; Presetnik et al. 2018; Hutson et al. 2007h





Myotis blythii Tomes, 1857

Lakuriq nate veshmiu i vogël

Mammalia: Chiroptera: Vespertilionidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Philippe Théou

Të dhëna të përgjithshme

Është një lloj relativisiht i madh, 62-70 mm i gjatë dhe me peshë 16-26 gramë. Gjendet kryesisht në shpella, ndërtesa të vjetra por edhe në miniera. Është një lloj që hibernon gjatë dimrit dhe një migrant i herëpashershëm. E kërkon ushqimin në mjedise si zonat me vegjetacion të pakët, livadhet, duke përfshirë tokat bujqësore dhe kopshtet. Ndotja, ndryshimi i menaxhimit të tokës dhe veçanërisht ndotja e zhurmës ka reduktuar ndjeshëm popullatat e këtij lloji në disa zona në Europë, gjatë viteve të fundit (Hutson et al. 2007e).

Habitati

Lloji i habitatit: 4. Kullosa; 3. Shkurre, 7. Shpella dhe habitate nëntokësore (joujore), 14. Artificiale/tokësore.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Azi.

Përhapja në Kosovë

Shpella e Dushit, Shpella e Banuar, Mirushë, Ura e Terzive, Shpella e Kusarit, Shpella e Radavcit, Shpella e Kishnarekës (Dundarova 2017; Presetnik et al. 2018).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për gjendjen e popullatave të këtij lloji në Kosovë. Janë vëzhguar vetëm disa individë. Trendi i popullatave në nivel europian është në rënie.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Gati i Kërcënuar, për shkak të trendit të popullatave në nivel europian, si dhe tendencës në rritje të aktiviteteve të cilat mund ta çojnë këtë lloj drejt zhdukjes në Kosovë. Ky lloj, me gjasë, është më i përhapur në Kosovë nga sa dihet tani. Aktualisht, ky lloj nuk kualifikohet për kategoritë e rrezikshmërisë, por në qoftë se intensifikohen aktivitetet kërcënuese, atëherë mund të rrezikohet ndjeshëm.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1. Zhvillimi rezidencial dhe komercial; 2. Bujqësia dhe akuakultura; 5. Përdorimi i burimeve biologjike; 6. Ndërhyrje dhe shqetësime njerëzore; 9. Ndotja.
Kërcënimet kryesore, që e rrezikojnë këtë lloj, kanë të bëjnë me fragmentimin dhe izolimin e habitateve, ndryshimet në regjimin menaxhues të pyjeve gjethegjera dhe tokave bujqësore, humbjen e popullatave të insekteve si rezultat i përdorimit të pesticideve.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Dundarova 2017; Hutson et al. 2007e; Presetnik et al. 2018



Myotis myotis Borkhausen, 1797

Lakuriq nate, veshmiu i madh

Mammalia: Chiroptera: Vespertilionidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Philippe Théou

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj peshon deri në 45 g. Kërkon ushqim përgjatë skajeve të pyjeve gjethegjerë, tokave të hapura brenda pyjeve gjethegjerë dhe kullosave. Ushqehet me artropodë të mëdhenj të tokës si brumbuj, pastaj lloje të ndryshme të Ortoptera-ve dhe merimangave, duke i mbledhur ato nga toka dhe jo duke i kapur përmes ekolokacionit. Në pjesën më të madhe të zonës së tij të distribuimit, strofullon në vende nëntokësore gjatë gjithë vitit, ndërsa në pjesët veriore të gamës së distribuimit përdor edhe ndërtesa (hapësira nënkulmesh) gjatë verës. Herë pas here formon koloni të vogla në pemë. Është një migrant i rastit; lëvizja më e gjatë e regjistruar është 436 km (Hutson et al. 2007d; Simon et al. 2004).

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje, 3. Shkurre, 7. Shpella dhe habitate nëntokësore (joujore), 14. Artificiale tokësore.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Azi.

Përhapja në Kosovë

Lumbardhi i Prizrenit në Prizren, Shpella e Banuar, Shpella e Dushit, Shpella e Radavcit, Mirushë, Ura e Terzive, Shpella e Kusarit, Shpella e Peshterit, Shpella e Kishnarekës (Paunović 2016; Presetnik et al. 2018).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për gjendjen e nënpopullatave të këtij lloji në Kosovë. Trendet e popullatave në nivel europian janë të qëndrueshme.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Gati i Kërcënuar, për shkak të tendencës në rritje të aktiviteteve të cilat mund ta çojnë këtë lloj drejt zhdukjes në Kosovë. Ky lloj, me gjasë, është më i përhapur në Kosovë nga sa dihet tani. Tash për tash, ky lloj nuk kualifikohet për kategoritë e rrezikshmërisë, por në qoftë se intensifikohen aktivitetet kërcënuese, atëherë mund të rrezikohet ndjeshëm.

Kërcënimet

Kërcënimet kryesore, që e rrezikojnë këtë lloj, kanë të bëjnë me fragmentimin dhe izolimin e habitateve, ndryshimet në regjimin menaxhues të pyjeve gjethegjera dhe tokave bujqësore, si dhe humbjen e popullatave të insekteve si rezultat i përdorimit të pesticideve.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Hutson et al. 2007d; Paunović 2016; Presetnik et al. 2018; Simon et al. 2004



Rhinolophus euryale Blasius, 1853

Lakuriq nate, hundëpatkua i Mesdheut

Mammalia: Chiroptera: Rhinolophidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
I Cenuar, VU

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Philippe Théou

Të dhëna të përgjithshme

Koka dhe trupi i këtij lloji zakonisht janë midis 43 dhe 58 mm, bishti ndërmjet 22-30 mm dhe shtrirja e krahëve midis 300 dhe 320 mm. Ushqehet me flutura nate dhe insekte të tjera. Nuk ka informacion të mjaftueshëm për ciklin riprodhues të këtij lloji. Është i njohur më shumë si lloj sedentar me distancën më të gjatë të njohur të udhëtimit prej rreth 130 km (Heymer 1964 në Hutterer et al. 2005). Në dimër hibernon në vende nëntokësore të tilla si shpella (Hutson et al. 2007a).

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje, 3. Shkurre, 4. Kullosa, 7. Shpella dhe habitate nëntokësore (joujore), 14. Artificiale/tokësore.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Afrikë, Azi

Përhapja në Kosovë

Prizren, Grykë e Rugovës, Shpella e Banuar, Shpella e Radavcit, Shpella e Qiriut, Shpella e Peshterit (Paunović 2016; Presetnik et al. 2018).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për trendin e nënpopullatave në Kosovë. Trendi i popullatave në nivel europian është në rënie.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Gati i Kërcënuar, për shkak të trendit të popullatave në nivel europian, si dhe tendencës në rritje të aktiviteteve të cilat mund ta çojnë këtë lloj drejt zhdukjes në Kosovë. Aktualisht, ky lloj nuk kualifikohet për kategoritë e rrezikshmërisë, por në qoftë se intensifikohen aktivitetet kërcënuese, atëherë mund të rrezikohet ndjeshëm.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5. Përdorimi i buri-meve biologjike; 6. Ndërhyrje dhe shqetë-sime njerëzore; 9. Ndotja.
Kërcënimet kryesore, që e rrezikojnë këtë lloj, kanë të bëjnë me fragmentimin dhe izolimin e habitateve, ndryshimet në reg-jimin menaxhues të pyjeve gjethegjera dhe tokave bujqësore, humbjen e popullatave të insekteve si rezultat i përdorimit të pesti-cideve, si dhe prishjen dhe humbjen e habi-tateve nëntokësore dhe nënkulmeve.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Adminis-trativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lo-kalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popul-latës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja even-tuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjen-det.

Referencat

Hutterer et al. 2005; Hutson et al. 2007a; Paunović 2016; Presetnik et al. 2018





Rhinolophus ferrumequinum Schreber, 1774

Lakuriq nate hundëpatkua i madh

Mammalia: Chiroptera: Rhinolophidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Gati i Kërcënuar, NT

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Philippe Théou

Të dhëna të përgjithshme

Ky është lloji më i madh nga lakuriqët hundëpatkua në Europë. Është midis 57-71 mm i gjatë, me një bisht prej 35-43 mm dhe shtrirje krahësh prej 350-400 mm. Ushqehet me flutura nate dhe brumbuj, por edhe me insekte të tjera. Kolonitë mbarështuese verore janë të vendosura në vende të ngrohta natyrore dhe artificiale nëntokësore, kurse në disa vende në nënkulme. Mund të përdorin shpella gjatë gjithë vitit, por në disa zona përdorin ndërtesa për kolonitë verore. Në dimër hibernon në vende të ftohta nëntokësore, kryesisht në shpella (Hutson et al. 2007). Femrat e këtij lloji piqen seksualisht në moshën trevjeçare dhe meshkujt në moshën dyvjeçare. Të rinjtë lindin gjatë periudhës qershor-korrik (Hutson et al. 2007).

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje, 3. Shkurre, 4. Kullosa, 7. Shpella dhe habitate nëntokësore (joujore), 14. Artificiale/tokësore.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Afrikë, Azi

Përhapja në Kosovë

Istog, Novosellë, Lubinje e Epërme, Shpella e Banuar, Shpella e Dushit, Klinë, Shpella e Radavcit; Cërmjan, Shpella e Kusarit, Shpella e Qiriut, Shpella e Peshterit (Budinski et al. 2015; Paunović 2016; Presetnik et al. 2018).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për trendin e nënpopullatave në Kosovë. Trendi i popullatave në nivel europian është në rënie.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Gati i Kërcënuar, për shkak të trendit të popullatave në nivel europian, si dhe tendencës në rritje të aktiviteteve të cilat mund ta çojnë këtë lloj drejt zhdukjes në Kosovë. Tash për tash, ky lloj nuk kualifikohet për kategoritë e rrezikshmërisë, por në qoftë se intensifikohen aktivitetet kërcënuese, atëherë mund të rrezikohet ndjeshëm.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 2. Bujqësia dhe akuakultura; 7. Modifikimet e sistemeve natyrore; 8. Lloje invazive dhe të tjera problematike, gjenet dhe sëmundjet; 9. Ndotja.
Kërcënimet kryesore, që e rrezikojnë këtë lloj, kanë të bëjnë me fragmentimin dhe izolimin e habitateve, ndryshimet në regjimin menaxhues të pyjeve gjethegjera dhe tokave bujqësore, humbjen e popullatave të insekteve si rezultat i përdorimit të pesticideve, si dhe prishjen dhe humbjen e habitateve nëntokësore dhe nënkulmeve.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Budinski et al. 2015; Hutson et al. 2007; Paunović 2016; Presetnik et al. 2018





Rhinolophus hipposideros Bechstein, 1800

Lakuriq nate hundpatkua i vogël

Mammalia: Chiroptera: Rhinolophidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Gati i Kërcënuar, NT

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Philippe Théou

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj është një nga llojet më të vogla të lakuriqëve, peshon 5 deri në 9 g, me një gjerësi krahësh prej 192-254 mm dhe një gjatësi trupi prej 35-45 mm. Lloji i preferuar i presë janë grupe të ndryshme të insekteve, si fluturat e natës dhe Diptera të familjes Tipulidae. (Lino et al. 2014; Zahn et al. 2008). Çiftëzimi ndodh në vjeshtë, kurse femrat lindin gjatë periudhës qershor-korrik. Kolonitë mbarështuese gjenden në vende nëntokësore natyrore dhe artificiale, si dhe në nënkulme dhe ndërtesa. Hibernojnë gjatë dimrit në vende nëntokësore (Taylor 2016).

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje, 3. Shkurre, 4. Kullosa 7. Shpella dhe habitate nëntokësore (joujore), 14. Artificiale/tokësore.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Afrikë, Azi

Përhapja në Kosovë

Disa lokalitete në: Malishevë, Istog, Prizren, Rahovec, Drenas, Pejë, Lipjan (Dundarova 2017; Paunović 2016; Presetnik et al. 2018).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për trendet e nënpopullatave të këtij lloji në Kosovë. Trendi i popullatave në Europë është në rënie.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Gati i Kërcënuar, për shkak të trendit të popullatave në nivel europian, si dhe tendencës në rritje të aktiviteteve të cilat mund ta çojnë këtë lloj drejt zhdukjes në Kosovë. Aktualisht, ky lloj nuk kualifikohet për kategoritë e rrezikshmërisë, por në qoftë se intensifikohen aktivitetet kërcënuese, atëherë mund të rrezikohet ndjeshëm.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 2. Bujqësia dhe akuakultura; 7 Modifikimet e sistemeve natyrore; 8. Specie invazive dhe të tjera problematike, gjenet dhe sëmundjet; 9. Ndotja.
Kërcënimet kryesore, që e rrezikojnë këtë lloj, kanë të bëjnë me fragmentimin dhe izolimin e habitateve, ndryshimet në regjimin menaxhues të pyjeve gjethegjera dhe tokave bujqësore, humbjen e popullatave të insekteve si rezultat i përdorimit të pesticideve, si dhe prishjen dhe humbjen e habitateve nëntokësore dhe nënkulmeve.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Dundarova 2017; Lino et al. 2014; Paunović 2016; Presetnik et al. 2018; Taylor 2016; Zahn et al. 2008





Ursus arctos Linnaeus, 1758

Ariu i murrmë

Mammalia: Carnivora: Ursidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Gati i Kërcënuar, NT

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj

Të dhëna të përgjithshme

Trupin e kanë të mbuluar me gëzof ngjyrë kafe apo të kuqërremtë në të verdhë. Gjatësia dhe dendësia e qimeve ndryshon në stinë të ndryshme dhe në varshmëri nga pozita gjeografike ku jetojnë. Gjatësia trupore sillet prej 1.4 deri në 2.8 m, lartësia trupore rreth 1.5 m, bishti është relativisht i shkurtër 10 – 22 cm, kurse pesha trupore prej 150 – 250 kg, por mund të jetë edhe më e madhe (Jakubiec 1999). Është kafshë aktive edhe ditën edhe natën. Ariu i murrmë në përgjithësi është kafshë josociale, por ndonjëherë edhe mund të hasen në grupe, sidomos kur hasin në burime të mëdha të ushqimit. Jetëgjatësia e këtij lloji është deri në 25 vjet.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje; 3. Shkurre; 4. Kullosa; 5. Vende ujore (kontinentale); 6. Zona shkëmbore (p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore); 14. Artificiale/ tokësore.
Haset në zonat malore të pasura me pyje dhe shkurre, në vende gjysmë të hapura dhe të mbyllura ku vegjetacioni bimor ju mundëson mbrojtje dhe ju siguron ushqim.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Azi, Amerikë, Afrikë.

Përhapja në Kosovë

Kusendin, Svilen, Bjeshkët e Junikut, Debëlldeh, Malet e Jezercit, Stanqiq, Hakanishte, Radishevë, Bjeshkët e Isniqit; Mushtisht, Shtërpcë, Reka e Allagës, Drelaj, Budakovë.

Popullata

Trendi i popullatës: Në rënie
Nënpopullatat e këtij lloji në Kosovë tregojnë rënie të konsiderueshme.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Gati i Kërcënuar, për shkak të tendencës në rritje të aktiviteteve të cilat mund ta çojnë këtë lloj drejt zhdukjes në Kosovë. Aktualisht, ky lloj nuk kualifikohet për kategoritë e rrezikshmërisë, pasi që numri i madh i nënpopullatave siguron qëndrueshmëri, por në qoftë se intensifikohen aktivitetet kërcënuese, atëherë mund të rrezikohet ndjeshëm në të ardhmen.



Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.1 Banimi dhe zonat urbane, 1.2 Hapësirat komerciale dhe industriale 1.3 Zonat turistike dhe rekreative); 2 Bujqësia dhe akuakultura (2.1 Bimët vjetore dhe shumëvjeçare jodrusore, 2.3 Blegtoria dhe fermat); 3 Prodhimi dhe minierat e energjisë (3.1 Eksploatimi i naftës dhe gazit, 3.2 Miniera dhe gurore 3.3 Energjia e ripërtërishme); 4 Korridoret e transportit dhe shërbimit (4.1 Rrugët dhe hekurudhat, 4.2 Linjat e shërbimit dhe shërbimet); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.1 Gjuetia dhe grumbullimi i kafshëve tokësore, 5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrje dhe shqetësime njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative, 6.2 Luftëra, trazira civile dhe stërvitje ushtarake, 6.3 Punë dhe aktivitete të tjera); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.1 Zjarri dhe luftimi i tij, 7.2 Digat dhe menaxhimi/përdorimi i ujit); 9 Ndotja (9.4 Mbeturinat dhe mbetjet e ngurta); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).
Kërcënimet kryesore për këtë lloj janë: gjuetia ilegale, prerja e pyjeve si dhe degradimi i habitatit. Gjithashtu urbanizimi dhe zgjerimi i vendbanimeve njerëzore është një nga rreziqet.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet.

Referencat

Jakubiec 1999



Libri i Kuq i Faunes se Kosoves | 1

LLOJET ME SHQETËSIMIN MË TË VOGËL (LC)

6.1 OLIGOCHAETA

Allolobophora chlorotica Savigny, 1826

Oligochaeta: Opistophora: Lumbricidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Shqetësim më i Vogël, LC

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Lucija Šerić Jelaska

Të dhëna të përgjithshme

Ky është një lloj endogjen, që ushqehet në dhe, ndërsa bën gropime horizontale deri në 20 cm nën sipërfaqe. Është skrrajë me madhësi mesatare, që te të rriturit shkon deri në 50 mm. Të rriturit kanë një unazë të verdhemët afër kokës, që është unike në atë se i ka tri palë disqe në formë ventuzash në segmentet alternuese në pjesën e poshtme të klitelumit (Mršić 1991). Var. kosovensis është përshkruar nga Šapkarev (1975), bazuar në vetëm një ekzemplar nga Kllokoti në afërsi të lumit Morava, në livadhe. Ky varietet dallon nga forma tipike kryesisht nga tubercula pubertatis dhe madhësia e trupit (106 mm, 2.5 mm diametër). Sipas Mršić (1991), klitelumi është pozicionuar në segmentet 1/3 29 deri 37 dhe tuberkula pubertatis në segmentet 31, 32, 33 dhe 35 (disqe të vogla në formë ventuzash).

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (Pyje të klimës mesatare); 4. Kullosa (4.4.Kullosa të klimës mesatare); 14. Artificiale/tokësore (14.1 Toka të punueshme, 14.2 Kullosa).
Ky lloj haset në livadhe të luginave, biotope antropogjene, toka pyjore, toka të kultivuara, livadhe etj. (Šapkarev, 1980).

Përhapja e përgjithshme

Europë, Azi, në veri të ultësirave të Himalajeve, Afrikë veriore dhe në pjesët veriore dhe qendrore të Gadishullit Arabik (Mršić 1991; Rota 2013).

Përhapja në Kosovë

Zhegër, Kllokot, Gërmi, Ferizaj, Pejë, Mitrovicë, Gjakovë.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar si: Shqetësim më i Vogël, për shkak të numrit të konsiderueshëm të lokaliteteve ku gjendet dhe nënpopullatave stabile.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial; 2. Bujqësia dhe akuakultura; 9. Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane, 9.3 Impiante bujqësore dhe pyjore).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Hulumtimi i nevojshëm: 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Për shkak të preferencave të habitatit, rekomandohet ruajtja e livadheve të lagështa dhe mbajtja e disa zonave pyjore me aktivitete pyjore jointensive.

Referencat

Mršić 1991; Rota 2013; Šapkarev 1975; Šapkarev 1980





Aporrectodea caliginosa
Savigny, 1826

Oligochaeta: Opistophora: Lumbricidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Shqetësim më i Vogël, LC

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Lucija Šerić Jelaska

Të dhëna të përgjithshme

Fundi i përparmë i trupit është me ngjyrë me tri hije të dallueshme. Është lloj endogjen dhe të shumtën gjendet në toka të punueshme dhe kullosa me përbërje të ulët të materieve organike, por edhe në dheun e pyjeve. Madhësia tipike e adultit është rreth 6 cm, kur është në qetësi.

Habitati

Lloji i habitatit: 1 Pyje [1.4 Pyje të klimës mesatare]; 4 Kullosa [4.4 Kullosa të klimës mesatare]; 5 Vende ujore [kontinentale] [5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat]]; 14 Artificiale/tokësore [14.1 Toka të punueshme, 14.4 Kopshte rurale, 14.5 Zona urbane].
Jeton në korridore të përkohshme horizontale, në pjesën e epërme të dheut. Është gjetur në dhe të lagësht në livadhe dhe brigje lumenjsh, kurse rrallëherë gjendet në shtresën e gjetheve në tokë.

Përhapja e përgjithshme

Ky lloj është autokton në Palearktik, por si lloj i sjellur gjendet në tërë botën [Csuzdi & Zicsi 2003].

Përhapja në Kosovë

Zhegër, Kllokot, Gërmi, Ferizaj, Rahovec, Suharekë, Deçan, Gjakovë, Mitrovicë [Šapkarev 1975; Mršić 1991]

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj parapëlqen habitatet e lagështa, që mund të jenë nën aktivitete intensive të menaxhimit [bujqësia etj.]. Humbja e habitatit për shkak të urbanizimit, si dhe ndotja industriale mund të jenë kërcënime për këtë lloj në Kosovë. Megjithatë, është vlerësuar si: Shqetësim më i Vogël, për shkak të numrit të konsiderueshëm të lokaliteteve ku është gjetur dhe nënpopullatave të qëndrueshme. Nga Kosova priten edhe më shumë nënpopullata.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 2. Bujqësia dhe akuakultura; 9. Ndotja [9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane, 9.3. Shkarkimet bujqësore dhe pyjore).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Hulumtimi i nevojshëm: 3. Monitorimi [3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit].
Të ruhen tokat e lagështa, të ketë aktivitete jointensive pyjore, të realizohet bujqësi e qëndrueshme, për të reduktuar burimet e ndotjes së tokës dhe ujit

Referencat

Csuzdi & Zicsi; A 2003; Mršić 1991; Šapkarev 1975





6.2 ARACHNIDA

Oxyopes lineatus Latreille, 1806

Merimanga rrëqebull

Oligochaeta: Opistophora: Lumbricidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

Shqetësim më i Vogël, LC

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Lucija Šerić Jelaska

Të dhëna të përgjithshme

Femra ka madhësi 6-8 mm, kurse mashkulli 4-5 mm. Kjo familje nuk ndërton rrjeta për të zënë prenë, mirëpo gjuajnë aktivisht insekte ose kafshë të tjera të imëta (Roberts 1996). Helmi i këtij lloji përmban peptidin toksik oxotoksin.

Habitati

Lloji i habitatit: 4 Kullosa (4.5 Kullosa të thata të ultësirave), 14. Artificiale/tokësore (14.4 Kopshte rurale).

Përhapja e përgjithshme

Austri, Belgjikë, Bullgari, Francë, Gjeorgji, Gjermani, Hungari, Itali, Kosovë, Kroaci, Maqedoni, Portugali, Rumani, Rusi, Serbi, Sllovaki, Sllloveni, Spanjë, Shqipëri, Turqi, Ukrainë, Zvicër, Azi qendrore.

Përhapja në Kosovë

Junik, Istog, Deçan.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Shqetësim më i Vogël, për shkak të qëndrueshmërisë së nënpopullatave në Kosovë dhe pranisë së tij në një numër të madh të lokaliteteve në vendet përreth. Duke pasur parasysh përhapjen e llojit në vendet përreth dhe habitatet e përshtatshme për llojin, mund të supozohet se në Kosovë është më i përhapur nga sa dihet aktualisht.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1. Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.1 Strehimi dhe zonat urbane, 1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.1 Zjarret dhe luftimi i tyre).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Roberts 1996





6.3 INSECTA

Baetis alpinus Pictet, 1843

Insecta: Ephemeroptera: Baetidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Shqetësim më i Vogël, LC

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Agim Gashi, Bardh Xërxa

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 7.5 – 11.5 mm. Larvat janë stenoterme të ftohta. Numri i gjeneratave për vit varet shumë nga temperatura e ujit dhe lartësia mbidetare (Bauernfeind & Soldan 2012).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat], 5.5 Liqene të përhershme të ujërave të ëmbla, 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza). Larvat gjenden kryesisht në zonat burimore dhe në rrjedhat e epërme të lumenjve dhe përroskave malore. Larvat kryesisht parapëlqejnë shpejtësi të madhe ose të paktën mesatare të rrjedhjes së ujit. Shpeshherë mund të gjenden edhe në liqene malore apo në përroska glaciale. Substrati i parapëlqyer është ai guror.

Përhapja e përgjithshme

Pjesa më e madhe e Europës, Turqi, Izrael, Liban.

Përhapja në Kosovë

Lumbardhi i Prizrenit në Reçan, Lumi Nerodime në Nerodine të Epërme të Ferizajit, Prishtinë, Lumi Erenik në Junik, Përroskë në Lugun e Kopilaçës në Viti, Përroskë në Zhegër të Gjilanit, Përroskë në Blinajë, Lumi Drini i Bardhë në Radavc, Lumi Lepenc në Brod, Lumi Morava e Binçës në Binçë.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm
Në të gjitha lokalitetet ku është gjetur në Kosovë, ky lloj karakterizohet me nënpopullata stabile.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Shqetësim më i Vogël, për shkak të numrit relativisht të madh të lokaliteteve ku është gjetur dhe qëndrueshmërisë së nënpopullatave.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrje dhe shqetësime njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)]; 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet]; 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit].

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse. Nënopullata në Blinajë është në kuadër të rezervatit të mbrojtur të gjuetisë.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit].

Referencat

Bauernfeind & Soldan 2012





Habroleptoides confusa Sartori & Jacob, 1986

Insecta: Ephemeroptera: Leptophlebiidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Shqetësim më i Vogël, LC

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Agim Gashi, Bardh Xërxa

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 8 – 12 mm. Periudha e fluturimit është nga marsi deri në korrik edhe pse në disa raste mund të fillojë edhe më herët, për shembull në shkurt apo të zgjatet më vonë përgjatë verës (Bauernfeind & Soldan 2012).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Larvat gjenden kryesisht në zonat burimore deri në rrjedhat e mesme të lumenjve dhe përroskave në lartësi të ndryshme mbidetare prej 200 deri në 1400 m. Larvat parapëlqejnë substratin me zhavorr ku jetojnë midis kokërrzave të rërës.

Përhapja e përgjithshme

Pjesa më e madhe e Europës, Azerbajxhan, Turqi.

Përhapja në Kosovë

Rrjedha e epërme e lumit Erenik, Përroska të ndryshme në komunën e Prishtinës, Ferizaj.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm
Në të gjitha lokalitetet ku është gjetur në Kosovë, ky lloj karakterizohet me nënpopullata stabile.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Shqetësim më i Vogël, për shkak të numrit relativisht të madh të lokaliteteve ku është gjetur dhe qëndrueshmërisë së nënpopullatave.

Kërcënimet

Aktualisht, nuk ka ndonjë kërcënim për popullatat e këtij lloji.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit].

Referencat

Bauernfeind & Soldan 2012





Calopteryx splendens Harris, 1782

Bukuroshja vezulluese

Insecta: Odonata: Calopterygidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

Shqetësim më i Vogël, LC

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi

Të dhëna të përgjithshme

Ky është një lloj i madh i pilivesave me madhësi trupore deri në 48 mm. Stadi larvor zgjat dy vjet zakonisht. Larvat mund të tolerojnë nivel të konsiderueshëm të ndotjes së ujit. Dimrin e kalojnë thellë në substratin e ujit. Periudha e fluturimit të adultëve është prej prillit deri në tetor (Zhushi Etemi 2005).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Jeton në një numër të ndryshëm të habitateve dhe në veçanti në lumenj dhe përroska të hapura.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Azi.

Përhapja në Kosovë

Liqeni i Badovcit, Ligatina e Hencit, Disa lokalitete në Lumin Sitnicë, Lumi Llap në Zhiti, Lumi Drenica në Grabovc, Morava e Binçës në Viti, Mollopolc, Rubovc.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Shqetësim më i Vogël, për shkak të numrit relativisht të madh të lokaliteteve ku është gjetur dhe qëndrueshmërisë së nënpopullatave.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)); 9 Ndotja (9.3 Mbeturinat bujqësore dhe pyjore); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.2 Thatësirat).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Zhushi Etemi 2005





Carabus (Chaetocarabus) intricatus Linnaeus, 1761

Insecta: Coleoptera: Carabidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Gati i Kërcënuar, NT

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

Shqetësim më i Vogël, LC

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Gabor Mesaroš

Të dhëna të përgjithshme

Është lloj me madhësi të konsiderueshme (24-35 mm), me një elitrë të vrazhdë ngjyrë metalike vjollce ose blu. Është lloj nokturn mishngrënës, edhe si larvë edhe si adult, i përshtatur për t'u ushqyer me kërmij falë kokës dhe mandibulave të gjata. Krahët i ka të reduktuar dhe nuk fluturon. I nevojiten dy vjet për të përfunduar ciklin jetësor. Është lloj aktiv gjatë sezonit të vegjetacionit, përveç në një periudhë të zgjatur të thatësirës (kryesisht në gusht).

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare); 4. Kullosa (4.4 Kullosa të klimës mesatare); 6 Zona shkëmbore [p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore]
Të rriturit gjenden nën lëvozhgën e drunjve të vdekur dhe nën gurë. Parapëlqejnë pyjet gjetherënëse në toka gëlqerore, por mund të gjenden edhe në pyjet halore, si dhe në habitate të hapura në lartësi të mëdha mbidetare.

Përhapja e përgjithshme

Kuqishtë, Lumbardhi i Deçanit, Brod, Kullë Rozhajë, Vataj, Prevallë, Luboten, Nebregoste, Prizren.

Përhapja në Kosovë

Runik (Csiki, 1940), Zhleb (Csiki, 1940), Pejë (Csiki, 1940), Gjakovë (Csiki, 1940), Luboten, (Apfelbeck 1907), Brezovicë.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Shqetësim më i Vogël, për shkak të numrit të konsiderueshëm të lokaliteteve ku gjendet dhe qëndrueshmërisë së popullatës. Numri i lokaliteteve të këtij lloji në Kosovë pritet të jetë akoma më i madh pas hulumtimeve të reja.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).





Lucanus cervus Linnaeus, 1758

Kaçadreni

Insecta: Coleoptera: Lucanidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

Shqetësim më i Vogël, LC

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi

Të dhëna të përgjithshme

Është një lloj me madhësi shumë të madhe, që mund të jetë prej 25 deri në 75 mm. Ky lloj karakterizohet me një dimorfizëm të shquar seksual. Meshkujt kanë mandibula më të gjata dhe janë më të mëdhenj se femrat. Edhe pse mandibulat e meshkujve duken të frikshme, ato, megjithatë, janë shumë të dobëta për të qenë të dëmshme. Mandibulat përdoren zakonisht në beteja midis meshkujve gjatë garës për kopulim me femrat. Është një lloj i obligueshëm saproksilik, larvat e të cilit zhvillohen në drunj që kalben të llojeve të ndryshme gjethegjera, dhe veçanërisht të lisit – Quercus. Larvat kalojnë nëpër disa faza dhe iu nevojiten prej 4 deri në 6 vjet për t'u zhvilluar deri në fazën e pupës. Të rriturit, për shkak të modifikimit të mandibulave të tyre, ushqehen duke e lëpirë lëngun që del nga pjesët e lënduara të drunjve të gjallë, para së gjithash të lisit.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare).
Gjendet në pyje gjethegjera me dominim ose prani të llojeve të ndryshme të lisit.

Përhapja e përgjithshme

I përhapur në Europë.

Përhapja në Kosovë

Gërmi, Zhleb, Koprivnik, Pejë, Gjakovë, Brezovicë.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është kategorizuar si: Shqetësim më i Vogël, në Listën e Kuqe të Koleopterëve Saproksilikë të Europës (Nieto and Alexander 2010). Edhe në Kosovë është vlerësuar si: Shqetësim më i Vogël, për shkak të numrit të konsiderueshëm të lokaliteteve dhe nënpopullatave stabile. Me gjasë, lloji është i pranishëm në shumë më tepër lokalitete në vend.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Nieto dhe Alexander 2010





Morimus funereus Mulsant, 1862

Insecta: Coleoptera: Cerambycidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

I Cenuar, VU

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

Shqetësim më i Vogël, LC

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Gabor Mesaroš

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj ka madhësi të ndryshme trupore prej 15 deri 40 mm. Adultët nuk fluturojnë dhe, krahasuar me lloje të tjera, ka aftësi shumë të vogël përhapjeje. Është lloj i obligueshëm saproksilik. Adultët paraqiten nga mesi i majit deri në gusht. Ky lloj bën një jetë sekrete dhe është aktiv kryesisht gjatë muzgut dhe natës. Zhvillimi i larvës ndodh në rrënjë, qafë rrënjësh dhe në pjesët e poshtme të trungjeve të vjetra të drunjve ose atyre që janë dobësuar ose duke vdekur. Larvat janë polifage. Zhvillimi i larvës ndodh në lloje të ndryshme gjethegjera dhe halore. Ky zhvillim në kushte natyrore zgjat tri deri në katër vjet.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare).
Gjendet në pyje gjetherënëse dhe të përziera deri në 1200 m.

Përhapja e përgjithshme

Kryesisht në Europën juglindore, në veri deri në disa pjesë të Europës perëndimore, të mesme dhe lindore, deri në Ukrainën jugperëndimore.

Përhapja në Kosovë

Runik (Csiki, 1940), Zhleb (Csiki, 1940), Pejë (Csiki, 1940), Gjakovë (Csiki, 1940), Luboten, (Apfelbeck 1907), Brezovicë.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar si: Shqetësim më i Vogël, për shkak të numrit të konsiderueshëm të lokaliteteve ku është gjetur dhe nënpopullatave stabile në Kosovë. Lloji me gjasë ka përhapje akoma më të gjerë në Kosovë.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit)

Referencat

Apfelbeck 1907; Csiki 1940





Protaetia (Potosia) fieberi Kraatz, 1880

Insecta: Coleoptera: Lucanidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Shqetësim më i Vogël, LC

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi

Të dhëna të përgjithshme

Është një lloj saproksilik me madhësi mesatare (20-23 mm). Larvat zhvillohen në të çarat e trungjeve dhe cungjeve, që janë duke u kalbur. Të rriturit shihen në grupe gjatë motit të ngrohtë e me diell, më së shumti përreth kurorës gjethore të lisit.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare).
Gjenden në pyje termofile gjetherënëse të dominuara nga gjinia Quercus.

Përhapja e përgjithshme

E përhapur kryesisht në Europën jugore dhe lindore, kurse lokalist në atë qendrore.

Përhapja në Kosovë

Gërmi, Shtërpcë.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Shqetësim më i Vogël, për shkak të nënpopullatave stabile dhe mospranisë së ndonjë kërcënimi direkt për llojin. Ky lloj, me gjasë, është shumë më i përhapur në Kosovë nga se dihet aktualisht.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).



Rhyacophila tristis Pictet, 1834

Insecta: Trichoptera: Rhyacophilidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Shqetësim më i Vogël, LC

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 8 deri në 10 mm. Ngjyra e krahëve është kafe e mbyllët. Në fazën larvore jeton në ujë përgjatë një viti. Larvat ushqehen kryesisht në mënyrë predatore. Faza larvore është treguese e ujërave të pastra. Faza adulte paraqitet prej prillit deri në tetor. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit (Graf et al. 2008; Kumanski 1985).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Gjendet kryesisht në zonat burimore dhe në rrjedhat e epërme të përroskave malore. Substrati i parapëlqyer i larvave të këtij lloji përbëhet nga: zhavorri i trashë, gurët e madhësive të ndryshme dhe shtrati guror i lumit. Mund të haset në lartësi të ndryshme mbidetare.

Përhapja e përgjithshme

Belgjikë, Bosnjë-Hercegovinë, Bullgari, Çeki, Francë, Gjermani, Greqi, Hungari, Itali, Kosovë, Korsikë, Kroaci, Luksemburg, Mali i Zi, Maqedoni, Poloni, Portugali, Rumani, Sllovaki, Slloveni, Spanjë, Zvicër, Serbi, Shqipëri, Turqi.

Përhapja në Kosovë

Gjithandej Kosovës.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Shqetësim më i Vogël, për shkak të numrit relativisht të madh të lokaliteteve ku është gjetur dhe qëndrueshmërisë së nënpopullatave.

Kërcënimet

Aktualisht, nuk ka ndonjë kërcënim të drejtpërdrejtë për popullatën e këtij lloji në Kosovë.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Graf et al. 2008; Kumanski 1985



Carcharodus alceae Esper, 1780

Insecta: Lepidoptera: Hesperiidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Shqetësim më i Vogël, LC

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi, Pajtim Bytyqi.

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj e ka gjerësinë e krahëve prej 28 deri në 32 mm. Adultët fluturojnë nga prilli deri në gusht. Në disa vende ky lloj mund të ketë dy a më shumë gjenerata gjatë një viti.

Habitati

Lloji i habitatit: 6 Zona shkëmbore [p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore]; 14 Artificiale/tokësore [14.1. Toka të punueshme, 14.4. Kopshte rurale].
Ky është një lloj i rëndomtë, që parapëlqen zona gurore të thata dhe të ngrohta. Haset shpesh edhe në zona të ngrohta ruderale dhe kopshte deri në rreth 1100 m.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Azi, Afrikë jugore.

Përhapja në Kosovë

Tri lokalitete në Malishevë, Lloqan, Kalaja e Prizrenit, Brezovicë [Jakšić 2003; Jakšić and Živić 1995-1998].

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm
Ky lloj ka nënpopullata të vogla por stabile në Kosovë.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Shqetësim më i Vogël, për shkak të numrit relativisht të madh të lokaliteteve ku është gjetur dhe qëndrueshmërisë së nënpopullatave. Nga Kosova priten edhe nënpopullata të tjera, duke pasur parasysh habitatet e përshtatshme potenciale për llojin dhe duke e njohur përhapjen nga vendet fqinje.

Kërcënimet

Nuk është konstatuar ndonjë kërcënim për popullatat e këtij lloji në Kosovë.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi [1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia]; 3. Monitorimi [3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit].

Referencat

Jakšić 2003; Jakšić and Živić 1995-1998





Erebia euryale Esper, 1805

Insecta: Lepidoptera: Nymphalidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Shqetësim më i Vogël, LC

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj e ka gjerësinë e krahëve prej 20 deri në 23 mm. Në pjesën e sipërme të krahëve të përparmë dominon ngjyra kafe e errët, me një shirit të ngjyrës së portokalltë në të kuqe. Ky lloj e ka një gjeneratë në vit. Dimëron vitin e parë si vezë dhe pastaj në vitin e dytë si vemje. Adultët shfaqen në periudhën qershor – shtator.

Habitati

Lloji i habitatit: 1 Pyje [1.4. Pyje të klimës mesatare]; 4. Kullosa.
Habitat i parapëlqyer i këtij lloji janë hapësirat e hapura brenda pyjeve, shpatet, kullosat, kullosat e lagështa në lartësi mbidetare prej 500 – 2600 m.

Përhapja e përgjithshme

Alpe, Kantabrie, Pirineje, Karpate, Ballkan, Europë veriore nga Finlanda deri në Urale dhe Alltai.

Përhapja në Kosovë

Bogë, Lloqan, Grykë e Rugovës, Kurvallë, Sharr, Luboten, Istog [Jakšić 2003].

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Shqetësim më i Vogël, për shkak qëndrueshmërisë së nënpopullatave dhe pritshmërisë së prezencës së tij në Kosovë në më shumë lokalitete nga sa dihet aktualisht.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5. Përdorimi i burimeve biologjike [5.3. Prerja dhe vjelja e pyjeve].

Masat ekzistuese mbrojtëse

Habitatet e këtij lloji në parqet kombëtare Bjeshkët e Nemuna dhe Sharri janë të mbrojtura ligjërisht.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi [1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia]; 3. Monitorimi [3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit].

Referencat

Jakšić 2003



Hesperia comma Linnaeus, 1758

Insecta: Lepidoptera: Hesperiidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Shqetësim më i Vogël, LC

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi, Pajtim Bytyqi.

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj e ka gjerësinë e krahëve prej 29 deri në 37 mm. Zakonisht femrat janë më të mëdha se meshkujt. Ky lloj karakterizohet me njolla të dallueshme të bardha në anën e poshtme të krahëve të pasmë, prej nga e ka marrë edhe emrin. Ky lloj e ka një gjeneratë në vit dhe adultët fluturojnë prej qershorit deri në shtator.

Habitati

Lloji i habitatit: 1 Pyje [1.4. Pyje të klimës mesatare]; 14 Artificiale/tokësore [14.2. Kullosa].
Ky lloj jeton kryesisht në zona të hapura të diellzuara, përfshirë zonat e hapura brenda pyjeve, skajet e pyjeve, kullosat etj.

Përhapja e përgjithshme

Holarktik.

Përhapja në Kosovë

Shtërpcë, Brezovicë, Bogë, Qyqavicë, Vushtrri, Pashtrik, Lloqan, Sredskë, Radavc, Luboten [Jakšić 1988; Jakšić 2003; Rebel and Zerny 1931].

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm
Ky lloj ka nënpopullata të vogla por stabile në Kosovë.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Shqetësim më i Vogël, për shkak të numrit relativisht të madh të lokaliteteve ku është gjetur dhe qëndrueshmërisë së nënpopullatave. Nga Kosova priten edhe nënpopullata të tjera, duke pasur parasysh habitatet e përshtatshme potenciale për llojin dhe duke e njohur përhapjen nga vendet fqinje.

Kërcënimet

Nuk është konstatuar ndonjë kërcënim për popullatat e këtij lloji.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Disa nga nënpopullatat e konstatuara janë në kuadër të zonave të mbrojtura.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi [1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia]; 3. Monitorimi [3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit].

Referencat

Jakšić 1988; Jakšić 2003; Rebel and Zerny 1931





Ochlodes sylvanus Esper, 1777

Insecta: Lepidoptera: Hesperiidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Shqetësim më i Vogël, LC

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj e ka gjerësinë e krahëve prej 29 deri në 36 mm. Adultët paraqiten kryesisht në pranverë. Në disa vende në Europë e ka vetëm një gjeneratë në vit, por në disa vende të tjera po në Europë, mund të ketë edhe më shumë gjenerata.

Habitati

Lloji i habitatit: 1 Pyje [1.4. Pyje të klimës mesatare]; 4. Kullosa; 5 Vende ujore [kontinentale] [5.4 Moçale, këneta, moçalishte [përgjithësisht mbi 8ha]].
Ky lloj jeton kryesisht në zonat e diellzuara, në skaje të pyjeve, dhe shumica e habitateve ku haset janë të lagështa dhe shpesh përmbajnë një bollëk të fiernave.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Turqi, pjesa e Azisë deri në Kinë dhe Japoni.

Përhapja në Kosovë

Bollosicë, Nerodime, Samakovë, Bjeshkët e Sharrit, Mali i Shkozës, Stermnicë, Mrasor, Prizren [Jakšić 2003].

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Shqetësim më i Vogël, për shkak të numrit relativisht të madh të lokaliteteve ku është gjetur dhe qëndrueshmërisë së nënpopullatave. Nga Kosova priten edhe nënpopullata të tjera, duke pasur parasysh habitatet e përshtatshme potenciale për llojin dhe duke e njohur përhapjen nga vendet fqinje.

Kërcënimet

Nuk është konstatuar ndonjë kërcënim për popullatat e këtij lloji.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Disa nga nënpopullatat janë në kuadër të zonave të mbrojtura.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi [1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia]; 3. Monitorimi [3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit].

Referencat

Jakšić 2003



Spialia orbifer Hübner, 1823

Insecta: Lepidoptera: Hesperiidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

Shqetësim më i Vogël, LC

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi, Pajtim Bytyqi.

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj e ka gjerësinë e krahëve prej 19 deri në 26 mm. Kanë një fluturim të shpejtë afër tokës. Vezët vendosen mbi lule të vogla të Sanguisorba minor dhe, në Europën lindore, ndoshta edhe në S. officinalis. Ka dy breza në vit dhe hibernon në stadin e vemjes.

Habitati

Lloji i habitatit: 1 Pyje [1.4. Pyje të klimës mesatare]; 4. Kullosa; 14 Artificiale/ tokësore; [14.1. Toka të punueshme].
Ky lloj mund të gjendet në tokat e thata të pasura me lule buzë rrugëve, në skajet e pyjeve, në toka bujqësore të braktisura, në shpatet shkëmbore dhe përgjatë shtretërve të tharë të lumenjve.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Azi.

Përhapja në Kosovë

Llapqevë, Hulaj, Mrasor, Radavc, Bjeshkët e Strellcit, Kalaja e Prizrenit, Gryka e Rugovës, Sredskë.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Shqetësim më i Vogël, për shkak të numrit relativisht të madh të lokaliteteve ku është gjetur dhe qëndrueshmërisë së nënpopullatave. Më shumë nënpopullata të këtij lloji priten nga Kosova, bazuar në praninë e habitateve potenciale dhe në njohuritë nga vendet fqinje.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 2. Bujqësia dhe akuakultura [2.3. Blegtoria dhe fermat: 2.3.2 Kullotja e vogël, fermat apo bujqësia]; 7 Modifikimet e sistemeve natyrore [7.3. Modifikime të tjera të ekosistemit].

Masat ekzistuese mbrojtëse

Disa nga nënpopullatat janë në kuadër të zonave të mbrojtura.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi [1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia]; 3. Monitorimi [3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit].

Referencat

Jakšić and Živić 1995-1998





6.4 ACTINOPTERYGII

Barbus balcanicus Kotlík, Tsigenopoulos, Ráb & Berrebi, 2002

Mrena e Ballkanit

Actinopterygii: Cypriniformes: Cyprinidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

Shqetësim më i Vogël, LC

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Qenan Maxhuni, Linda Grapci Kotori

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj nga ana morfologjike shumë vështirë dallohet nga llojet e tjera të mustakut. Ushqehet kryesisht me makrozoobentos, por edhe me alga. Shumohet nga muaji maj deri në korrik. Ky lloj e arrin madhësinë deri në 17.5 cm (Kottelat and Freyhof 2007).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) {5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat], 5.4 Këneta, moçale, moçalishte, 5.5 Liqene të përhershme të ujërave të ëmbla).

Ky lloj jeton në ujëra rrjedhëse me shpejtësi mesatare ose të shpejtë dhe me substrat ranor. Haset në lumenj të vegjël, por edhe në përroska malore.

Përhapja e përgjithshme

Ballkan dhe disa vende Euoopiane.

Përhapja në Kosovë

Tri lokalitete në Lumin Drenica, Katër lokalitete në Lumin Ibër.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm

Aty ku ndodhet popullatat janë mjaft abundante.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Shqetësim më i Vogël, për shkak të qëndrueshmërisë së popullatave dhe mosekzistimit të ndonjë faktori, që e rrezikon drejtpërsëdrejti këtë lloj apo habitatin e tij në Kosovë. Ky lloj pritet të gjendet edhe në më shumë lokalitete në pellgjet e lumenjve Drenica dhe Ibër.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial {1.1 Zonat për banim dhe komerciale}; 9 Ndotja {9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane, 9.4 Mbeturinat dhe mbetjet e ngurta}; 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.2 Thatësirat).

Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj, kanë të bëjnë me ndotjen nga ujërat e zeza, ndotjen nga mbeturinat e ngurta dhe të tjera, si dhe me thatësirën.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi {1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia}; 3. Monitorimi {3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Kottelat and Freyhof 2007



Scardinius erythrophthalmus Linnaeus, 1758

Lloska pendëkuqe

Actinopterygii: Cypriniformes: Cyprinidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

Shqetësim më i Vogël, LC

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Linda Grapci Kotori

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj ushqehet kryesisht me plankton, insekte që fluturojnë dhe me bimësi. Vezët i lëshon kryesisht në ato vende ku ka bimësi, si për shembull, rrënjë të drunjve etj. Ka aftësi të madhe të adaptimit në ndryshimin e kushteve jetësore. Mund të arrijë gjatësinë deri në 61.7 cm dhe të jetojë deri në 19 vjet (Freyhoff and Kottelat 2008).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) {5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat], 5.4 Këneta, moçale, moçalishte, 5.5 Liqene të përhershme të ujërave të ëmbla).

Ky lloj mund të haset në ujëra të ëmbla bentopelagjike dhe me migrim potamodrom. Paraqitet zakonisht në ujëra të qeta ose me rrjedhje të ngadalshme dhe në ujëra të pasura me vegjetacion bimor.

Përhapja e përgjithshme

Ballkan dhe disa vende Euoopiane.

Përhapja në Kosovë

Tri lokalitete në Lumin Drenica, Katër lokalitete në Lumin Ibër.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm

Aty ku ndodhet popullatat janë mjaft abundante.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Shqetësim më i Vogël, për shkak të qëndrueshmërisë së popullatave dhe mosekzistimit të ndonjë faktori, që e rrezikon drejtpërsëdrejti aktualisht këtë lloj apo habitatin e tij në Kosovë.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 9 Ndotja {9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane, 9.4 Mbeturinat dhe mbetjet e ngurta}; 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.2 Thatësirat).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi {1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia}; 3. Monitorimi {3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Freyhoff and Kottelat 2008



6.5 AMPHIBIA

Bombina variegata Linnaeus, 1758

Barkverdha

Amphibia: Anura: Bombinatoridae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Shqetësim më i Vogël, LC

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Linda Grapci Kotori

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia trupore është 28-56 mm, kurse peshon ndërmjet 2.3 dhe 12 g. Në bazë të kësaj karakteristike, këto bretkosa janë vendosur në mesin e anëtarëve më të vegjël të familjes Bombinatoridae. Në anën shpinore të trupit lëkura ka ngjyrë të murrmë në bojëkafe, shpesh me pika të ndritshme. Femrat prodhojnë deri në 300 vezë në një vit. Pasi që ky lloj i bretkosës nuk ka fshikëza vokale, atëherë gjatë periudhës së shumimit meshkujt lëshojnë një zë të qetë, në mënyrë që t'i joshin femrat për çiftëzim. Për shkak të lëvizjes së shpejtë të formave juvenile, shpesh zgjerohen në hapësira të mëdha.

Habitati

Lloji i habitatit: 1 Pyje [1.1 Pyje boreale, 1.4 Pyje të klimës mesatare]; 3. Shkurre [3.3 Shkurre boreale, 3.4. Shkurre të klimës mesatare]; 4 Kullosa [4.4 Kullosa të klimës mesatare]; 5 Vende ujore [kontinentale] [5.2 Lumenj, përrenj, përroska periodike/të përkohshme/të parregullta, 5.3. Ligatina të dominuara nga shkurret]; 15 Artificiale – ujore [15.3. Basene të akuakulturës, 15.7. Toka të ujitura [përfshirë kanalet ujitëse]].
Zakonisht jetojnë përgjatë lumenjve dhe përroskave ujore, por i gjejmë dhe në gropa argjile dhe zhavorresh. Mund të hasen në mjedise të ndryshme të lartësive mbidetare, prej 100 deri në 2100 m.

Përhapja e përgjithshme

Austri, Bosnjë-Hercegovinë, Bullgari, Çeki, Francë, Gjermani, Greqi, Hungari, Holandë, Itali, Kosovë, Kroaci, Lihtenshtajn, Luksemburg, Maqedoni, Mali i Zi, Poloni, Rumani, Serbi, Sllovaki, Sllloveni, Shqipëri, Zvicër, Ukrainë.

Përhapja në Kosovë

Klinë, Gjakovë, Prizren, Drenas, Prishtinë, Podujevë, Kamenicë, Kaçanik, Viti, Ferizaj.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Shqetësim më i Vogël, për shkak të stabilitetit të nënpopullatave dhe parashikimit se është më i përhapur në Kosovë nga sa dihet tani, bazuar edhe në të dhënat nga vendet fqinje.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial [1.1 Banimi dhe zonat urbane, 1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit]; 5 Përdorimi i burimeve biologjike [5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve: 5.3.1 Përdorimi i qëllimshëm: vjelja për jetesë / në shkallë të vogël [lloji që vlerësohet është i synuar] [vjelja]; 11. Ndryshimet klimatike dhe moti i ashpër.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur [Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura].

Masat e nevojshme mbrojtëse

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi [1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia]; 3. Monitorimi [3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit].



Pelophylax ridibundus Pallas, 1771

Bretkosa e kënetës
Amphibia: Anura: Ranidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Shqetësim më i Vogël, LC

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi[t]

Daut Rexhepaj, Linda Grapci Kotori

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj mund të arrijë një gjatësi maksimale të trupit prej 17 centimetrash, por meshkujt mbeten gjithnjë me trup më të vogël (rreth 12 cm). Koka është proporcionale e madhe dhe këmbët e prapme janë të gjata, e kjo u jep atyre aftësi të shkëlqyera të hedhjes. Ekziston një ndryshim i madh në ngjyrën e trupit, duke filluar nga jeshile e errët deri në bojëkafe ose gri, ndonjëherë me disa vija të lehta të gjelbra. Ushqimi i tyre përbëhet nga pilivesat dhe insekte të tjera, merimangat dhe krimbat e tokës. Bretkosat e rritura ushqehen edhe me brejtës të vegjël dhe nganjëherë me amfibë dhe peshq të vegjël (Pasuljević 1968).

Habitati

Lloji i habitatit: 3. Shkurre (3.3 Shkurre boreale, 3.4. Shkurre të klimës mesatare); 5 Vende ujore (kontinentale) (5.3. Ligatina të dominuara nga shkurret); 7. Shpella dhe habitate nëntokësore (joujore); 14. Artificiale/tokësore (14.4. Kopshte rurale).
Ky lloj kryesisht haset në ujëra të ndenjura.

Përhapja e përgjithshme

Afganistan, Arabi Saudite, Armeni, Austri, Azerbajxhan, Bahrein, Bjellorusi, Bosnjë-Hercegovinë, Bullgari, Çeki, Danimarkë, Francë, Gjeorgji, Gjermani, Greqi, Holandë, Hungari, Iran, Irak, Kazakistan, Kosovë, Kinë, Kroaci, Kirgizistan, Letoni, Lituani, Maqedoni, Moldavi, Mali i Zi, Poloni, Rumani, Rusi, Serbi, Sllovaki, Sllloveni, Taxhikistan, Turqi, Turkmenistan, Ukrainë, Uzbekistan.

Përhapja në Kosovë

Podujevë, Zubin Potok, Skënderaj, Istog, Drenas, Ferizaj, Dragash, Shtërpcë, Kaçanik, Viti, Malishevë, Gjakovë.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Shqetësim më i Vogël, për shkak të qëndrueshmërisë së nënpopullatave dhe mosekzistimit të ndonjë faktori, që e rrezikon drejtpërsëdrejti këtë lloj apo habitatin e tij në Kosovë.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.1 Banimi dhe zonat urbane, 1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve: 5.3.1 Përdorimi i qëllimshëm: vjelja për jetesë/në shkallë të vogël (lloji që vlerësohet është i synuar) [vjelja]; 11. Ndryshimet klimatike dhe moti i ashpër.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloj i mbrojtur në Kosovë (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Pasuljević 1968





Triturus vulgaris Linnaeus, 1758

Tritoni i rëndomtë
Amphibia: Caudata: Salamandridae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Shqetësim më i Vogël, LC

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi[t]

Daut Rexhepaj, Linda Grapci Kotori

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj ka aftësi të mëdha për përshtatje, prandaj edhe gjendet në mjedise të shumta ujore si ligatina, kanale për ujitje etj. Madhësia e trupit është mesatarisht deri në 10 cm. Në periudhën e shumimit meshkujt marrin ngjyrë më të errët sesa femrat (Atlas of Amphibians 1997).

Habitati

Lloji i habitatit: 5 Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat], 5.2 Lumenj, përrenj, përroska periodike/të përkohshme/të parregullta, 5.3. Ligatina të dominuara nga shkurret).
Ky është një lloj i përhapur kryesisht në mjedise ujore. Gjendet në lartësi të ndryshme mbidetare deri në rreth 2150 m.

Përhapja e përgjithshme

Armeni, Austri, Azerbajxhan, Bjellorusi, Belgjikë, Bosnjë-Hercegovinë, Bullgari, Çeki, Danimarkë, Estoni, Finlandë, Francë, Gjeorgji, Gjermani, Greqi, Holandë, Hungari, Irlandë, Itali, Kazakistan, Kosovë, Kroaci, Letoni, Luksemburg, Maqedoni, Mbretëri e Bashkuar, Moldavi, Mali i Zi, Norvegji, Poloni, Rumani, Rusi, Serbi, Sllovaki, Sllloveni, Suedi, Shqipëri, Zvicër, Turqi, Ukrainë.

Përhapja në Kosovë

Velat e Livadhit të Madh në Gjakovë, Lumi Krena në Gjakovë, Disa lokalitete në Prizren, Gurra e Gjatë në Deçan, Gryka e Deçanit.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm
Në nivel europian, gjendja e popullatës së këtij lloji është stabile. Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për gjendjen e nënpopullatave në Kosovë, por bazuar në aftësitë përshtatëse të llojit dhe përhapjen e gjerë, mund të konkludohet se gjendja e popullatës në Kosovë është e qëndrueshme, gjithashtu.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Shqetësim më i Vogël, për shkak të numrit relativisht të madh të lokaliteteve ku është gjetur dhe qëndrueshmërisë së nënpopullatave, si dhe parashikimit se lloji është më i përhapur në Kosovë nga sa dihet tani, bazuar edhe në të dhënat nga vendet përreth.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit); 11. Ndryshimet klimatike dhe moti i ashpër.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloj i mbrojtur në Kosovë (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Atlas of Amphibians 1997



6.6 REPTILA

Algyroides nigropunctatus Duméril & Bibron, 1839

Hardhuca e shkëmbinjve

Reptilia: Squamata: Lacertidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

Shqetësim më i Vogël, LC

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj

Të dhëna të përgjithshme

Gjatësia e trupit është midis 14 dhe 18 cm. Trupin e ka të mbuluar me lëfore në formë rombi dhe të pajisur me nga një trashje gjatësore, kurse lëforet laterale janë shumë më të imta. Ana shpinore e trupit ka ngjyrë hiri në të mbyllët ose të kuqërreme kafe apo edhe tërësisht të zezë te format e reja. Ana barkore dominohet nga ngjyra e kuqërreme. Te femrat ana barkore ka ngjyrë të verdhë ose ulliri. Ushqehet kryesisht me insekte dhe merimanga. Është ovipare. Femra prodhon 2 – 3 vezë, madje jo vetëm në pranverë, por edhe në vjeshtën e hershme (Bressi 2004).

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje; 3. Shkurre; 6. Zona shkëmbore (p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore); 14. Artificiale/tokësore.

Ky lloj mund të haset në vende shkëmbore me klimë të butë mediterane dhe submediterane. Shpeshherë haset në zona me vegjetacion të pakët, por me klimë të butë, pastaj në zona malore të degraduara, shkurre dhe plantacione. Po ashtu, e hasim shpesh pranë luginave të lumenjve, por edhe në lartësi deri mbi 1500 m.

Përhapja e përgjithshme

Bosnjë-Hercegovinë, Greqi, Itali, Kosovë, Kroaci, Maqedoni, Mali i Zi, Serbi, Sllloveni, Shqipëri.

Përhapja në Kosovë

Ana e djathtë e Lumbardhit të Prizrenit në Prizren, Radavc, Ura e Shenjtë, Vërmicë.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm

Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për trendin e popullatave në nivel global. Nënpopullatat e këtij lloji në Kosovë janë të fragmentuara por stabile.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Shqetësim më i Vogël, për shkak të numrit relativisht të madh të lokaliteteve ku është gjetur dhe qëndrueshmërisë së nënpopullatave.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.1 Strehimi dhe zonat urbane): 2 Bujqësia dhe akuakultura (2.1 Bimët vjetore dhe shumëvjeçare jodrusore); 6 Ndërhyrje dhe shqetësime njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.1 Zjarret dhe luftimi i tyre).

Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj, janë: degradimi, fragmentimi dhe humbja e habitateve si rezultat i urbanizimit dhe zhvillimit të infrastrukturës, ndërtimi i objekteve turistike dhe rekreative në zona të lartësive të mëdha, por edhe pranë lumenjve, si dhe zjarrvëniet e qëllimshme të kullosave dhe pyjeve. Ky lloj kërcënohet edhe nga predatorët si gjarpërinjtë, shpendët dhe disa gjitarë.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Bressi 2004



Anguis fragilis Linnaeus, 1758

Kagezogëza

Reptilia: Squamata: Anguidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Shqetësim më i Vogël, LC

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj, nga pamja e jashtme, duket si gjarpër, me trupin cilindrik dhe të zgjatur, të cilit i mungojnë plotësisht gjymtyrët. Gjatë jetës ngjyra e këtij lloji ndryshon, por ajo që dominon është metalike e hirtë ose e argjendtë, me nuanca të shkëlqyeshme, ku anash trupit ka nga një vijë të zezë. Ana barkore e trupit është njëngjyrëshe e ndritshme, e spërkatur me pika të kaltra në të zezë. Në mungesë të gjymtyrëve, lëvizë duke rrëshqitur. Ushqehet me shtazë pasive, si krimbat e shiut, kërmijtë etj. Akvitizohet vonë në pranverë. Është lloj ovovivipar. Femra pas tre muaj fekondimi lind 5 – 26 të vegjël, të cilët kanë ngjyrë ari ose të kuqërremtë dhe një vijë të zezë përgjatë shpinës dhe anash trupit. Jetëgjatësia e këtij lloji është deri 30 vjet.

Habitati

Haset kryesisht në vende të pasura me vegjetacion bimor si livadhe, fusha me shkurre, në ultësira dhe në vise kodrinore-malore, deri në 2400 m lartësi mbidetare.

Përhapja e përgjithshme

Pjesa më e madhe e Europës, Azia e Vogël, Afrikë: Algjeri, Tunizi.

Përhapja në Kosovë

Rapçe, Brezovicë, Kosh, Gërmi, Kukli Beg, Nerodime e Epërme, Zatra.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm
Trendi i popullatave në nivel global është i qëndrueshëm. Në Kosovë, në bazë të të dhënave të deritanishme, trendi i nënpopullatave është i qëndrueshëm, gjithashtu.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Shqetësim më i Vogël, për shkak të qëndrueshmërisë së nënpopullatave dhe parashikimit se do të gjenden më shumë nënpopullata të këtij lloji, bazuar në habitatet potenciale të llojit dhe duke e ditur përhapjen e tij në vendet përreth.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike; 6 Ndërhyrje dhe shqetësime njerëzore; 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.1 Zjarret dhe luftimi i tyre); 11 Ndryshimet klimatike dhe moti i ashpër (11.4 Stuhitë dhe përmbytjet).
Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj, janë të ndërlidhur me intensifikimin e bujqësisë, fragmentimin, izolimin dhe humbjen e habitateve, shkatërrimin e vendeve të hibernimit, si rezultat i ndryshimit të praktikave bujqësore dhe zhvillimit të infrastrukturës urbane. Si ndikim tjetër indirekt kërcënues për këtë lloj është edhe sulmi, që i bëhet nga të rinjtë ose edhe fermerët për shkak të keqinformimit dhe perceptimit të gabueshëm të llojit si gjarpër, pastaj zjarrvëniet, vërshimet etj. Ky lloj është edhe pre e gjitarëve të tjerë, shpendëve, por edhe e kafshëve shtëpiake.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloj i mbrojtur në Kosovë (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).





Lacerta viridis Laurenti, 1768

Hardhuca e gjelbër

Reptilia: Squamata: Lacertidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Shqetësim më i Vogël, LC

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj

Të dhëna të përgjithshme

Është një lloj shumë aktiv, me trup të hollë cilindrik, të gjatë deri në 30 – 40 cm. Ngjyra e trupit zakonisht është e gjelbër, prej nga e ka marrë edhe emrin. Koka ka ngjyrë ulliri të gjelbër të mbyllët, të spërkatur me njolla të verdha. Te femra, ana shpinore e trupit është e pajisur me njolla me pika të errëta ose të zeza dhe me vija gjatësore të verdha e të ndritshme. Ushqehen me insekte, por edhe me të vegjlit e hardhucave të tjera apo gjarpinjve. Është lloj ovipar. Femra në muajin qershor prodhon 13 vezë e rrallëherë deri në 25, të cilat i vendos në një gropë dhe pastaj i mbulon me dhe e gjethe, prej të cilave në muajin gusht dalin format e reja. Pjekuria seksuale arrihet në moshën 2 vjeçare. Jetëgjatësia e këtij lloji mund të arrijë deri në 15 vjet (Arnold et al. 2002).

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje; 3. Shkurre; 4. Kullosa; 14. Artificiale/tokësore.
Ky lloj zakonisht haset në vende të thata dhe të diellosura e të pasura me vegjetacion të ulët bimor, si: fusha dhe shkurre, pyje të hapura, trungje drunjësh, përskaj rrugëve, si dhe në zona me kultura bujqësore.

Përhapja e përgjithshme

Europë jugore, Europë qendrore, nga perëndimi e përfshinë Azinë deri në Persi, nga jugu Gadishullin Ballkanik, Gadishullin Pirinej dhe Apenin.

Përhapja në Kosovë

Gërmi, Badovc, Shën Jovan në Kamenicë, Brezovicë, Llukavc i Thatë, Osojan, Qafë Duhël, Tuneli i Parë, Rapçe, Zabërxhë, Cabër.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm
Trendi i popullatave në nivel global është në rënie e sipër. Në Kosovë, në bazë të të dhënave të deritanishme ky lloj ka nënpopullata stabile.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj, është vlerësuar në kategorinë: Shqetësim më i Vogël, për shkak të qëndrueshmërisë së popullatave dhe parashikimit se në Kosovë do të gjenden nënpopullata të tjera, bazuar në habitatet potenciale të llojit dhe duke e ditur përhapjen e tij në vendet përreth.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 2 Bujqësia dhe akuakultura (2.1 Bimët vjetore dhe shumëvjeçare jodrusore: 2.1.1 Zhvendosja e bujqësisë, 2.1.2 Ferma të vogla); 6 Ndërhyrje dhe shqetësime njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 9 Ndotja.
Kërcënim kryesor i këtij lloji është humbja e habitatit dhe njëherësh rënia e popullatave si rezultat i aktiviteteve intensive bujqësore. Ky lloj, gjithashtu, kërcënohet nga aktivitete të tjera antropogjene, si djegia e arave dhe zonave me vegjetacion të ulët bimor, si dhe përdorimi i pesticideve dhe agrokemikateve në bujqësi dhe blegtori. Ky lloj mund të rrezikohet po ashtu nga aktivitetet rekreative të njeriut në natyrë.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Arnold et al. 2002





Natrix tessellata Laurenti, 1768

Gjarpri i ujit

Reptilia: Squamata: Colubridae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

Shqetësim më i Vogël, LC

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj

Të dhëna të përgjithshme

Ky është një lloj helmues. Te ky lloj mungojnë njollat e verdha ose të bardha në të dy anët, në pjesën e pasme të kokës. Trupi është i mbuluar me lëfore, të cilat në anën shpinore janë të pajisura me nga një të ngritur në formë kreshte, të cilat në regjionin e bishtit janë mjaft të theksuara. Gjatësia e trupit është mesatarisht 1 deri në 1.20 cm, ku bishtit i takon një e pesta e gjatësisë trupore. Femra është më e madhe se mashkulli. Ngjyra e trupit është konstante. Ana shpinore ngjyrë ulliri në të gjelbër ose e murrme e çelët, kurse anash me disa njolla të verdha të spërkatura me pika të mbyllta. Ushqehet kryesisht me peshq, bretkosa, larva insektesh dhe shtazë të tjera të imta të ujit. Femrat kah fundi i qershorit dhe fillimi i korrikut i prodhojnë 5 – 25 vezë në një gropë të cekët ku pas dhjetë javësh dalin format e reja.

Habitati

Lloji i habitatit: 4. Kullosa; 5. Vende ujore (kontinentale)]; 14. Artificiale/tokësore; 15. Artificiale/ujore dhe detare.
Ky lloj jeton pranë ujërave me rrjedhje të shpejtë. Në disa raste haset edhe pranë liqeneve, pellgjet e të cilave janë të pasura me peshq.

Përhapja e përgjithshme

Europë e mesme, Europë jugore, Egjipt, Azi perëndimore.

Përhapja në Kosovë

Sllatinë e Ibrit, Leposaviq, Vërmicë, Pograxhë, Radavc, Dumnicë e Poshtme, Lumi Drenica në Drenas, Krushevë, Jezerc, Viti, Doganaj, Rakovinë, Rahovec, Prizren.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm
Në nivel global trendi i popullatave është në rënie. Në Kosovë, gjithashtu, është vërejtur rënie e lehtë e disa nënpopullatave të këtij lloji, por akoma atojanë të qëndrueshme.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Shqetësim më i Vogël, për shkak të numrit relativisht të madh të lokaliteteve ku është gjetur dhe qëndrueshmërisë së nënpopullatave.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi/përdorimi i ujit: 7.2.11 Digat (madhësia e panjohur), 7.3 Modifikimet e tjera të ekosistemit); 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Ujërat e zeza, 9.1.2 Rrjedhjet).
Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj, janë të ndërlidhur me veprimtaritë të cilat e pengojnë lëshimin e vezëve, dimërimin e llojit, vendin e rrezatimit, gjuetisë, si dhe lëvizjet në kohën e çiftëzimit. Në këtë kontekst, faktorë kryesorë janë: ndërtimet e kanaleve, digave, infrastrukturës, ndotja nga shkarkimet urbane dhe ato bujqësore.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).





Podarcis muralis Laurenti, 1768

Hardhuca e mureve

Reptilia: Squamata: Lacertidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

Shqetësim më i Vogël, LC

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj

Të dhëna të përgjithshme

Gjatësia e trupit të këtij lloji mund të jetë rreth 16 – 18 cm. Bishti është më i gjatë se trupi. Ky lloj aktivizohet herët në pranverë dhe vazhdon aktivitetin deri vonë në vjeshtë, kur pastaj fillon gjumin dimëror. Është lloj insektengrënës. Femra prodhon 5 deri 8 vezë në qershor ose korrik, prej të cilave në muajin gusht dalin format e reja. Jetëgjatësia maksimale e regjistruar është deri në 10 vjet.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje; 3. Shkurre; 4. Kullosa; 6. Zona shkëmbore (p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore); 14. Artificiale/tokësore.
Ky lloj zakonisht mund të haset në terrene të thata shkëmbore kodrinore-malore, pranë rrugëve dhe vendeve të banuara, si dhe shtëpive të braktisura. Përveç ultësirave, mund të haset edhe në lartësi të mëdha mbidetare deri mbi 1500 m.

Përhapja e përgjithshme

Austri, Belgjikë, Bosnjë-Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Çeki, Francë, Gjermani, Greqi, Hungari, Itali, Kosovë, Lihtenshtajn, Luksemburg, Maqedoni, Mali i Zi, Mbretëri e Bashkuar, Rumani, Serbi, Sllovaki, Slloveni, Spanjë, Shqipëri, Zvicër, Turqi.

Përhapja në Kosovë

Gllarevë, Kijevë, Zabërxhë, Mitrovicë, Veriq, Badovc, Leskoc, Suhadoll, Radavc, Carralevë, Jabllanicë, Prizren, Gornje Sello, Prizren, Gërmi, Mirushë, Rapçe, Bishtazhin, Gerqinë, Gjakovë, Letnicë, Drejkoc, Lëbushë.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm
Trendi i popullatave në nivel global është i qëndrueshëm. Në Kosovë, gjithashtu, është vërejtur që ky lloj ka nënpopullata stabile.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Shqetësim më i Vogël, për shkak të numrit relativisht të madh të lokaliteteve ku është gjetur dhe qëndrueshmërisë së nënpopullatave.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.2 Hapësirat komerciale dhe industriale); 8 Llojet invazive dhe të tjera problematike, gjenet dhe sëmundjet (8.1 Speciet jonative invazive / llojet e huaja / sëmundjet); 11 Ndryshimet klimatike dhe moti i ashpër (11.3 Temperatura ekstreme).
Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj, kanë të bëjnë me ndikimin antropogjen në shkatërrimin ose degradimin e habitatit, nëpërmjet veprimtarive nga fusha e agroindustrisë dhe ekonomisë, pastaj ndikimet nga llojet invazive, si dhe efektet natyrore, që vijnë nga temperaturat ekstreme, zjarret dhe përmbytjet.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloj i mbrojtur në Kosovë (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).





Vipera ammodytes Linnaeus, 1758

Nepërka ose hundraku

Reptilia: Squamata: Viperidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Shqetësim më i Vogël, LC

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj dallohet lehtë prej llojeve të tjera të përafërta, për shkak të prezencës së brithit që e ka në buzën e sipërme. Ky brith është i ndërtuar prej lëforeve të imta. Zakonisht e arrin gjatësinë trupore prej 60 deri në 80 cm e ndonjëherë edhe deri në 90 cm (Arnold & Ovenden 2002). Te ky lloj ekziston dimorfizmi seksual. Ngjyra e trupit mund të jetë e ndryshme, si psh., e përhimët apo e murrme në të gjelbër, kurse në anën shpinore e posedojnë një larë zigzage me ngjyrë të mbyllët ose tërësisht të zezë te mashkulli. Ushqehet kryesisht me gjitarë të imët, pastaj hardhuca, shpezë etj. Është lloj ovovivipar. Femra lind kryesisht 4 deri në 20 të vegjël. Mund të jeton deri në 22 vjet.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4 Pyje të klimës mesatare); 3. Shkurre (3.4 Shkurre të klimës mesatare, 3.8 Vegjetacion shkurror i tipit mesdhetar); 6. Zona shkëmbore (p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore); 14. Artificiale/tokësore (14.1 Toka të punueshme, 14.2 Kullosa, 14.3 Plantacione, 14.4 Kopshte rurale).
Haset kryesisht në vende të thata shkëmbore dhe të diellosura, skaj rrugëve, mureve dhe në kodra malore. Haset në lartësi të ndryshme mbidetare, që nga niveli i detit deri në 2500 m.

Përhapja e përgjithshme

Austri, Bosnjë-Hercegovinë, Greqi, Itali, Kaukaz, Kosovë, Kroaci, Maqedoni, Serbi, Siri, Sllloveni, Shqipëri, Turqi.

Përhapja në Kosovë

Bollosicë, Zupç, Çabër, Koshtovë, Klinë, Istog, Skënderaj, Drenas, Prizren, Dragash, Ferizaj, Kaçanik, Viti, Gjakovë, Mirushë, Krilevë, Kamenicë.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm
Në nivel global trendi i popullatave është në rënie (Agasyan et al. 2009) kurse në Kosovë në të gjitha lokalitetet ku është vëzhguar ka nënpopullata të qëndrueshme.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Shqetësim më i Vogël, për shkak të numrit relativisht të madh të lokaliteteve ku është gjetur dhe qëndrueshmërisë së nënpopullatave.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.1 Banimi dhe zonat urbane); 3 Prodhimi dhe minierat e energjisë (3.2 Miniera dhe gurore); 4 Korridoret e transportit dhe shërbimit (4.1 Rrugët dhe hekurudhat); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.1.3 Përndjekja/kontrolli)
Meqenëse në të shumtën e rasteve këtë lloj e hasim në viset kserotorme, atëherë faktorët kryesorë, që e rrezikojnë, kanë të bëjnë me veprime antropogjene si: hapja e rrugëve të reja, kanalizimeve, hapja e guroreve dhe infrastruktura përcjellëse, ndërtimi i objekteve turistike, por në masë më të vogël edhe aktivitetet në sferën agroindustriale. Rreziku vjen edhe nga grabitqarët e tjerë, por edhe nga njeriu, për shkak të qëndrimit armiqësor ndaj këtij lloji si shtazë helmuese.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloj i mbrojtur në Kosovë (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Agasyan et al. 2009; Arnold & Ovenden 2002





Vipera berus Linnaeus, 1758

Nepërka e malit

Reptilia: Squamata: Viperidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Shqetësim më i Vogël, LC

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj

Të dhëna të përgjithshme

Te ky lloj mungon brithi në buzën e sipërme. E ka trupin e trashë e të shtypur. Gjatësia e trupit arrin deri në 60 cm (Arnold & Ovenden 2002). Është aktiv në mbrëmje kur gjuan gjitarë të imët, shpezë të imta, vezë, hardhuca, bretkosa e në disa raste ushqehet edhe me pakurrizorë. Mashkulli zakonisht është më i vogël se femra dhe ngjyra e trupit nga ana shpinore rëndom është e përhimët dhe e spërkatur me nuanca ngjyrë kafe të errët, duke ndërtuar lara me pozitë zigzage, kurse ana barkore e trupit ka ngjyrë të ndritshme në të verdhë. Te ky lloj është e shpeshtë dukuria e melanizmit (Nilson et al. 2005). Ky lloj është vivipar. Femra lind 3 deri në 18 të vegjël, në varshmëri nga mosha, sezoni dhe të ushqyerit. Mashkulli e arrin pjekurinë seksuale në moshën 3 deri në 4 vjet, kurse femra në moshën 4 deri 5 vjet.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4 Pyje të klimës mesatare); 3. Shkurre (3.4 Shkurre të klimës mesatare, 3.8 Shkurre – Vegjetacion shkurror i tipit mesdhetar); 4. Kullosa (4.4. Kullosa të klimës mesatare); 6. Zona shkëmbore (p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore).
Ky lloj e ka një areal heterogjen dhe ndodhet në zona shkëmbore, shkurre, pyje, kullosa dhe vende të lagështa. Mund të haset deri në 3000 m lartësi mbidetare.

Përhapja e përgjithshme

Është i përhapur gati në tërë Europën, duke filluar nga ana perëndimore me Britaninë e Madhe dhe Francën, nga lindja deri në ishujt Sahalin të Azisë e deri te Koreja e Veriut dhe Japonia, dhe nga veriu deri në Greqi, kurse nga ana jugore deri te Koreja.

Përhapja në Kosovë

Dragash, Prevallë, Beroc, Shtërpcë.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm
Në nivel global, por edhe në Ballkan, trendi i popullatave është në rënie. Në Kosovë, gjithashtu, është vërejtur rënie e lehtë e disa nënpopullatave të këtij lloji, por akoma në suaza të qëndrueshmërisë.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Shqetësim më i Vogël, për shkak të numrit relativisht të madh të lokaliteteve ku është gjetur dhe qëndrueshmërisë së nënpopullatave.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.3 Zona turistike dhe rekreative); 2 Bujqësia dhe akuakultura (2.1 Bimët vjetore dhe shumëvjeçare jodrusore: 2.1.1 Zhvendosja e bujqësisë); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.1 Gjuetia dhe mbledhja e kafshëve tokësore: 5.1.3 Persekutimi/kontrolli).
Areali i ngushtë dhe i fragmentuar përfaqëson faktorin kryesor potencial kërcënues për ekzistencën e këtij lloji. Në viset malore është i kërcënuar, para së gjithash, nga faktori njeri nëpërmjet ndërtimit të objekteve hoteliere dhe infrastrukturës përcjellëse turistike, ndërsa në viset e ulëta kërcënohet nga aktivitetet bujqësore si, p.sh., ato në ngritjen e sipërfaqeve të reja, në bashkimin e parcelave, e me këtë rast bëhet shkatërrimi dhe izolimi direkt i vendbanimeve të këtij lloji. Rrezik të konsiderueshëm paraqesin edhe grabitqarët e këtij lloji, por edhe vetë njeriu, për shkak të qëndrimit të tij armiqësor si shtazë helmuese.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloj i mbrojtur në Kosovë (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Arnold & Ovenden 2002; Nilson et al. 2005





Zamenis longissimus Laurenti, 1768

Bolla e shtëpisë

Reptilia: Squamata: Colubridae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

Shqetësim më i Vogël, LC

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj

Të dhëna të përgjithshme

Është gjarpër johelmues, me muskulaturë shumë të fuqishme. Gjatësia e trupit arrin deri në 2 metra. Lëforet kanë shkëlqim metalik. Ngjyra e trupit është e ndryshme, por zakonisht ngjyrë kafe e mbyllët, kurse ana barkore e bardhë në të verdhë, me njolla të errëta. Te ky lloj haset edhe dukuria e albinizmit. Ushqehen me brejtës të imët, hardhuca, shpezë dhe me vezët e tyre, si dhe me artropode të ndryshme. Zakonisht, femra prodhon 5 deri në 10 vezë me formë cilindrike ose të zgjatur, të cilat i vendos në vende ku ndodhë dekompozimi organik. Afërsisht pas 8 javësh, nga vezët dalin format e reja. Ky lloj jeton 25 deri në 30 vjet (Pasuljević 1968).

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje; 3. Shkurre; 4. Kullosa; 6. Zona shkëmbore (p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore); 14. Artificiale/tokësore.

Ky lloj mund të haset në pyje gjetherënëse, zona të pasura me livadhe e kullosa të rrethuara me shkurre, pastaj rreth mureve të shtëpive dhe kasolleve të braktisura, pranë ekonomive bujqësore, por edhe në vise të larta deri në 2000 m.

Përhapja e përgjithshme

Austri, Bosnjë-Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Çeki, Francë, Gjeorgji, Gjermani, Greqi, Hungari, Itali, Kosovë, Mali i Zi, Maqedoni, Moldavi, Rumani, Serbi, Sllovaki, Sllloveni, Spanjë, Shqipëri, Zvicër, Turqi, Ukrainë.

Përhapja në Kosovë

Istog, Zllatar, Gërmi, Sredskë, Banjskë, Brezovicë, Rugovë, Llokvicë, Zubin Potok.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm

Trendi i popullatave në nivel global nuk është mirë i njohur, edhe pse në shumë shtete popullatat e këtij lloji janë të fragmentuara. Në Kosovë gjendja e nënpopullatave është e qëndrueshme.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Shqetësim më i Vogël, për shkak të numrit relativisht të madh të lokaliteteve ku është gjetur dhe qëndrueshmërisë së popullatave. Edhe disa nënpopullata të tjera pritet që të gjenden, duke e konsideruar habitatin potencial për llojin dhe duke e ditur përhapjen e tij në vendet përreth Kosovës.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 2 Bujqësia dhe akuakultura (2.1 Bimët vjetore dhe shumëvjeçare jo drusore: 2.1.1 Zhvendosja e bujqësisë); 4 Korridoret e transportit dhe shërbimit (4.1 Rrugët dhe hekurudhat); 6 Ndërhyrje dhe shqetësime njerëzore (6.3 Punë dhe aktivitete të tjera); 9 Ndotja (9.1 Ujërat e ndotura nga amvisëria dhe urbane: 9.1.1 Ujërat e zeza, 9.1.2 Shkarkimi).

Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj, kanë të bëjnë me degradimin dhe fragmentimin e habitatit që vjen si rezultat i veprimeve antropogjene, si: intensifikimi i bujqësisë, ndërrimi i destinacionit të kulturave bujqësore, hapja e sipërfaqeve të reja, ndërtimi i rrugëve të reja dhe infrastrukturës përcjellëse, pastaj ndotja nga përdorimi i kemikateve në bujqësi, dëmtimi i vezëve dhe formave juvenilie etj. Një faktor, që e rrezikon këtë lloj po ashtu, është sulmi i qëllimshëm apo i paqëllimshëm nga njeriu, veçmas në kohën e çiftëzimit.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Pasuljević 1968





Apodemus flavicollis Melchior, 1834

Miu gushëverdhë

Mammalia: Rodentia: Muridae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

Shqetësim më i Vogël, LC

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj

Të dhëna të përgjithshme

Gjatësia e trupit sillet prej 8.8 – 13 cm dhe ajo e bishtit 9.2 – 13.4 cm, kurse pesha e trupit e meshkujve deri në 50 gr dhe e femrave deri në 44 gr. Ushqehet kryesisht me fara dhe fruta, bimë të gjelbra dhe insekte. Është pre e disa shpendëve grabitqarë, dhelprave, nuselalave dhe karnivorëve të tjerë si dhe reptilëve. Është aktiv kryesisht natën, por mund ta hasim edhe në muzg dhe herët në mëngjes. Është mjaft i shkathët, me lehtësi kërcen dhe ngjitet nëpër drunj ku mund ta hasim deri në 23 m lartësi me ç'rast shfrytëzon foletë e shpendëve dhe zgavrat e drurëve. Gjatë dimrit strehohet edhe në hapësira të mbyllura, stalla, kanale nëntokësore dhe në mure. Jetëgjatësia e këtij lloji është 2 – 4 vjet (Wilson & Reeder 2005).

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje.
Ky lloj i parapëlqen pyjet dhe parqet. Kryesisht mund të haset në pyje gjetherënëse dhe në ato të përziera ku përbërja fitocenologjike siguron një prodhim të lartë të farave dhe frutave për ushqim.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Azi.

Përhapja në Kosovë

Nën Kala, Duhël, Shalë, Lipjan, Korbliq, Rekë, Pouskë, Zhur, Batushë, Ujmir.

Populata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Shqetësim më i Vogël, për shkak të qëndrueshmërisë së nënpopullatave dhe mosekzistimit të ndonjë faktori, që e rrezikon drejtpërsëdrejti këtë lloj apo habitatin e tij në Kosovë. Numri i nënpopullatave në Kosovë me gjasë është më i madh.

Kërcënimet

Faktorët kryesorë, që mund ta rrezikojnë këtë lloj, janë: degradimi dhe humbja e habitateve si dhe përdorimi i kemikateve në bujqësi.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Wilson & Reeder 2005



Apodemus sylvaticus Linnaeus, 1758

Miu bishtgjatë i pyllit

Mammalia: Rodentia: Muridae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

Shqetësim më i Vogël, LC

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj

Të dhëna të përgjithshme

Është një mi i vogël, me vesh e sy të mëdhenj dhe me bisht të gjatë e të hollë. Shqisat e të parit, dëgjuarit dhe nuhatjes, i kanë mjaft mirë të zhvilluara. Trupi është i mbuluar me qime të buta të cilat nga ana shpinore kanë ngjyrë kafe në të verdhë ose të kuqërreme, kurse nga ana barkore kanë ngjyrë të bardhë ose të lehtë hiri. Ushqehet kryesisht me fara, fruta, lëvore druri, bimë dhe insekte. Është aktiv natën e rrallëherë ditën. Është pre e dhelprave, shpendëve, maceve, nuselalave etj. Folenë e përgatit në zgavrat e trungjeve ose në tokë, por i shfrytëzon edhe ato të shpendëve të tjerë. Hap tunele nëntokësore prej 3 cm dhe me thellësi prej afërsisht 20 cm. Nuk migron e as bie në letargji. Jetëgjatësia e këtij lloji është 1 – 2 vjet.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje; 3. Shkurre; 4. Kullosa; 14. Artificiale/tokësore.
Ky lloj haset në habitate të ndryshme, si: pyje, shkurre, kullosa, zona bujqësore të kultivuara apo edhe djerrina dhe zona të banuara.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Afrikë veriore.

Përhapja në Kosovë

Reçan, Dobërdolan, Debëlldeh, Pllanjan, Zhur, Pobergjë, Radishevë, Dersnik, Sinejë.

Populata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Shqetësim më i Vogël, për shkak të qëndrueshmërisë së popullatave dhe mosekzistimit të ndonjë faktori, që e rrezikon drejtpërsëdrejti këtë lloj apo habitatin e tij në Kosovë. Numri i nënpopullatave nga Kosova me gjasë është më i madh.

Kërcënimet

Faktorët kryesorë, që mund ta rrezikojnë këtë lloj janë degradimi dhe humbja e habitateve, si dhe përdorimi i kemikateve në bujqësi.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).





Canis aureus Linnaeus, 1758

Çakalli

Mammalia: Carnivora: Canidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

Shqetësim më i Vogël, LC

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj

Të dhëna të përgjithshme

Është i ngjashëm me ujkun dhe dhelprën. Trupin e ka të mbuluar me qime jo të gjata dhe të trasha ngjyrë hiri, të verdhë të kuqërreme ose gështenje, me njolla të errëta. Ana barkore e trupit ka ngjyrë më të ndritshme. Gjatësia trupore e meshkujve sillet prej 71 – 85 cm dhe e femrave prej 69 – 73 cm, lartësia trupore prej 45 – 50 cm, kurse pesha e trupit prej 6 – 14 kg. Është lloj omnivor dhe ushqehet me kërma, shpendë dhe vezë të tyre, brejtës, reptilë, amfibë, peshq, insekte dhe fruta. Ushqimin e tepërt e deponojnë në gropa, të cilat i mbulojnë me dhe. Lëviz zakonisht natën larg syve të njeriut, por mund ta hasim edhe ditën. Nuk bie në letargji dhe nuk migron. Kryesisht janë kafshë monogame. Maturimi ndodh pas vitit të parë. Jetëgjatësia është rreth 13 vjet, por në disa raste edhe deri në 18 (Jhala & Moelan 2004).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale); 14. Artificiale/tokësore.
Ky lloj kryesisht haset përreth fshatrave dhe zonave të banuara, në zonat kodrinore-malore të pasura me kullosa etj.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Azi, Afrikë.

Përhapja në Kosovë

Gremnik, Berishë, Mushtisht, Debëlldeh, Rapçe, Grykë, Jezerc, Belle, Kotorr, Maxherre, Bajgorë, Uçe, Tunaj.

Populata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm
Trendi i popullatave është në rritje në nivel global. Në Europë dhe në Kosovë popullatat janë të qëndrueshme.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Shqetësim më i Vogël, për shkak të qëndrueshmërisë së popullatave dhe mosekzistimit të ndonjë faktori, që e rrezikon drejtpërsëdrejti këtë lloj apo habitatin e tij në Kosovë.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 2. Bujqësia dhe akuakultura (2.1 Bimët vjetore dhe shumëvjeçare jodrusore: 2.1.3 Bujqësia agroindustriale).
Faktorët kryesorë, që mund ta rrezikojnë këtë lloj, janë: zhvillimi i bujqësisë intensive, industrializimi, urbanizimi dhe infrastruktura.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloj i mbrojtur në Kosovë (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Jhala & Moelan 2004





Canis lupus Linnaeus, 1758

Ujku

Mammalia: Carnivora: Canidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

Shqetësim më i Vogël, LC

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj

Të dhëna të përgjithshme

Ka një gjatësi trupore prej 105 – 160 cm, lartësi prej 80 – 85 cm, bishtin prej 29 – 50 cm dhe peshën trupore prej 12 – 80 kg (Foresman 2012). Te femrat, këto përmasa janë më të vogla. Është kafshë sociale dhe rrallë mund të haset e vetmuar, madje kryesisht gjatë verës. Anëtarët e shoqërisë zakonisht sillen prej 5 deri në 40. Jetojnë në grupe sociale, të udhëhequra nga mashkulli alfa me femrën. Është kafshë e shpejtë dhe mjaft e fuqishme. Zhvillon luftë të ashpër për territor, saqë vdekshmëria e tyre nëpër beteja sillet prej 14 – 65 %. Ushqim kryesor i kanë ungulatet me peshë 20 – 100 kg. Jetëgjatësia arrin deri në 16 vjet.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje; 3. Shkurre; 4. Kullosa; 5. Vende ujore (kontinentale); 6. Zona shkëmbore (p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore); 14. Artificiale/tokësore.
Ky lloj mund të haset në habitate të ndryshme. Gjatë dimrit kryesisht haset në vise të ulëta, por mund të haset edhe në vise të larta malore, fusha të hapura, kullosa etj.

Përhapja e përgjithshme

Lloji më i përhapur në botë i gjitarëve. Haset përgjatë hemisferës veriore në veri të gjatësisë 15° në Amerikën Veriore dhe 12° N në Indi.

Përhapja në Kosovë

Pouska, Bjeshkët e Junikut, Gajre, Nerodime e Ulët, Sedenicë, Sukë, Tunaj, Sukë e Prapë, Novobërdë, Tërpezë, Malishevë, Dërsnik, Klinë, Qyqavicë, Potok, Qabiq, Zijaq, Zhiti, Sinejë, Koritnik, Llanisht.

Populata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm
Nënpopullatat e këtij lloji janë stabile në Kosovë, por edhe në vendet fqinje.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Shqetësim më i Vogël, për shkak të numrit relativisht të madh të lokaliteteve ku është gjetur dhe qëndrueshmërisë së nënpopullatave. Me gjasë, numri i nënpopullatave është më i madh në Kosovë.

Kërcënimet

Aktualisht në Kosovë nuk ka ndonjë kërcënim për këtë lloj.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Foresman 2012





Erinaceus roumanicus Barrett-Hamilton, 1900

Iriqi

Mammalia: Eulipotyphla: Erinaceinae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Shqetësim më i Vogël, LC

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj

Të dhëna të përgjithshme

Trupin e kanë shpatuk, të mbuluar me gjemba, pjesa bazale e të cilëve është me ngjyrë të bardhë, pjesa e mesme ngjyrë kafe e errët, kurse maja e çelët. Dallohet nga iriqi europian për nga ngjyra më e çelët dhe gjoksi me ngjyrë të bardhë qumështi. Është lloj omnivor, i parapëlqen insektet, por ushqehet edhe me kërmij, gjarpërinj, hardhuca, bretkosa, zogj e vezë të shpendëve, brejtës të imët, fruta e fara. Është lloj vetmitar, kurse shoqërohet vetëm gjatë kohës së çiftëzimit. Koha e letargjisë fillon në tetor dhe zgjat deri në prill. Nuk migron dhe shumohet një apo dy herë në vit. Jetojnë deri në 10 vite (Jones et al. 2005).

Habitati

Është lloj i përhapur në habitate të ndryshme, si: pyje të hapura, fusha, shkurre, zona të kultivuara, mjedise periferike të banuara, kopshte, parqe e rrallë herë në zona të lagështa dhe zona të larta të pyjeve halorë.

Përhapja e përgjithshme

Europë juglindore, Azi.

Përhapja në Kosovë

Gllamnik, Qabër, Runikë, Ujmirë, Drenoc, Tërpezë, Nerodime e Ulët, Ostrozub, Reshtan, Kralan, Potok, Strellc, Vataj, Smirë, Grabanicë, Rakovinë, Fortesë, Krushë e Madhe, Berishë, Gremnikë, Turjakë, Veriq, Demjan.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Shqetësim më i Vogël, për shkak të qëndrueshmërisë së nënpopullatave dhe mosekzistimit të ndonjë faktori, që e rrezikon drejtpërsëdrejti këtë lloj apo habitatin e tij në Kosovë.

Kërcënimet

Faktorët kryesorë, që mund t'a rrezikojnë këtë lloj, kanë të bëjnë me transformimin e fushave dhe kullosave në toka bujqësore, përdorimin e kemikateve, të cilat e dëmtojnë prenë e tij, pastaj infrastruktura rrugore, e cila e shkakton fragmentimin e habitatit, rreziqet nga trafiku (sidomos për të vegjlit).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloj i mbrojtur në Kosovë (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Jones et al. 2005





Glis glis Linnaeus, 1766

Gjeri ose Gjumashi i majmë i pyllit

Mammalia: Rodentia: Gliridae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Shqetësim më i Vogël, LC

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj

Të dhëna të përgjithshme

Për nga pamja është i ngjashëm me ketrin për shkak të bishtit xhufkor, me qime të dendura dhe të gjata, por është më i vogël për nga madhësia trupore. Trupin e ka të mbuluar me qime të buta dhe të trasha. Ana shpinore e trupit ka ngjyrë të përhime ose të errët kafe, kurse ana barkore ngjyrë të bardhë. Gjatësia trupore prej 130 – 190 mm, kurse bishti deri në 168 mm. Ushqehet me fara dhe fruta, vezë, zogj të shpendëve, insekte etj. Nuk migron, por bie në letargji prej vjeshtës e deri në pranverë. Gjatë kësaj kohe të hibernimit zgjohen disa herë për të konsumuar ushqimin, që e kanë deponuar më herët. Lëviz kryesisht gjatë natës. Jetojnë deri në 12 vjet (Krystufek 2007).

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje; 3. Shkurre; 14. Artificiale/tokësore.
Është lloj arboreal, i cili banon kryesisht në pyjet gjetherënëse dhe të përziera. Mund të haset edhe në zonat e ulëta, si: kopshte, plantacione, shkurre dhe zona shkëmbore.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Azi.

Përhapja në Kosovë

Hoqë, Mushtisht, Maqitevë, Mjak, Plavë, Voksh.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Shqetësim më i Vogël, për shkak të mosekzistimit të ndonjë faktori që e rrezikon drejtpërsëdrejti këtë lloj apo habitatin e tij në Kosovë. Nga Kosova priten edhe nënpopullata të tjera.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5. Përdorimi i burimeve biologjike (5.1. Gjuetia dhe zënia në kurthe e kafshëve tokësore, 5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve).
Faktorët kryesorë, që mund ta rrezikojnë këtë lloj, kanë të bëjnë me ndryshimin, humbjen dhe fragmentimin e habitatit, pastaj me gjuetinë etj.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Krystufek 2007



Lepus europaeus Pallas, 1778

Lepuri

Mammalia: Lagomorpha: Leporidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

Shqetësim më i Vogël, LC

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj

Të dhëna të përgjithshme

Trupin e kanë të mbuluar me gëzof ngjyrë kafe ose të kuqërremtë nga ana shpinore, kurse nga ana barkore kanë ngjyrë të bardhë. Ngjyrat trupore gjatë stinës së dimrit në përgjithësi janë më të errëta. Kanë gjatësi trupore prej 52 – 68 cm, bisht prej 8 – 12 cm dhe peshë trupore prej 2.5 – 7 kg. Ushqehen me një numër të madh të llojeve barishtore dhe kulturave bujqësore. Kryesisht lëvizin natën, por edhe ditën, mirëpo shkalla e lëvizjes në zona të caktuara është shumë e kufizuar. Nuk migrojnë dhe nuk bien në letargji. Është lloj vetmitar, por mund të grumbullohen në kohë të aktivitetit seksual rreth një partneri ose rreth ushqimit. Është pre e dhelprave, ujkut, çakallit, shpendëve grabitqarë, maces së egër dhe po ashtu i përndjekur nga njeriu.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje; 3. Shkurre; 4. Kullosa; 14. Artificiale/tokësore.
E hasim në një gamë të gjerë habitatesh, duke filluar nga tokat bujqësore, kullosat, zonat malore me vegjetacion të ulët dhe të lartë dhe atë kryesisht në zona të hapura. Mund të takohet edhe në zonat e larta malore deri në 1500 m.

Përhapja e përgjithshme

Palearktik.

Përhapja në Kosovë

Kuçicë, Koshtovë, Zhazhe, Majac, Mramor, Osojan, Pograxhë, Vrellë, Kuzhnin, Bjeshkët e Junikut, Ivajë, Nerodime e Epërme, Stanaj, Prishtinë, Përqevë, Klinë, Zabërxhe, Dërsnik, Turjakë, Zatriq, Glloboqicë, Qyqavicë, Krojmir.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm
Trendi i popullatave në nivel global është në rënie e sipër. Edhe në Europë, në dhjetëvjetëshin e fundit, është vërejtur një rënie. Në Kosovë nënpopullatat e këtij lloji janë të qëndrueshme.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Shqetësim më i Vogël, për shkak të qëndrueshmërisë së nënpopullatave dhe numrit të madh të lokaliteteve ku është gjetur.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.1 Strehimi dhe zonat urbane); 2 Bujqësia dhe akuakultura (2.1 Kulturat vjetore dhe shumëvjeçare jodrusore); 8 Llojet invazive dhe të tjera problematike, gjenet dhe sëmundjet (8.2 Llojet/sëmundjet vendore problematike); 9 Ndotja (9.3. Shkarkimet bujqësore dhe pyjore).
Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj, vijnë si rezultat i intensifikimit të bujqësisë, aplikimit të plehrave kimike, pesticideve dhe mekanizmave bujqësorë si dhe gjuetisë. Një faktor tjetër i rrezikimit të këtij lloji viteve të fundit është i ashtuquajturi sindromi i lepurit europian.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloj i mbrojtur në Kosovë (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).





Martes foina Erxleben, 1777

Shqarthi ose Kunadhja gushëbardhë

Mammalia: Carnivora: Mustelidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

Shqetësim më i Vogël, LC

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj

Të dhëna të përgjithshme

Trupin e ka të mbuluar me qime ngjyrë kafe të errët, kurse te format e reja ngjyrë të çelët të përhime. Gusha ka ngjyrë të bardhë. Gjatësia e trupit sillet prej 4- -55 cm dhe pesha trupore prej 1 – 2.3 kg. Kanë gjymtyrë dhe bisht të gjatë. Është lloj omnivor dhe ushqehet me pakurrizorë dhe kurrizorë të imët dhe të shumëllojshëm, kurse gjatë verës dhe vjeshtës edhe me produkte bimore. Është pre e dhelprës dhe e shpendëve grabitqarë. Kryesisht janë kafshë të vetmuara. Gjatë kohës së çiftëzimit i hasim nëpër drunj e rrallë në tokë. Nuk bie në letargji dhe nuk migron. Jetëgjatësia sillet prej 3 – 8 vjet (Grizimek 1990).

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje; 3. Shkurre; 6. Zona shkëmbore (p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore); 14. Artificiale/tokësore.
Haset kryesisht në pyje gjetherënëse, por edhe në zona kodrinore shkëmbore të hapura dhe në periferi të zonave të banuara.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Azi.

Përhapja në Kosovë

Guri i Hajdarit, Korbiliq, Kërstec, Vllahi, Belle, Ratishë, Llanisht, Drelaj, Lubozhdë, Stanqiq, Pleqe.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Shqetësim më i Vogël, për shkak të qëndrueshmërisë së nënpopullatave dhe numrit relativisht të madh të lokacioneve ku është gjetur. Nga Kosova priten edhe nënpopullata të tjera.

Kërcënimet

Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj, janë persekutimi nga ana e njeriut me metoda të ndryshme për shkak të gëzofit dhe lëkurës së tij si dhe për shkak të bindjes se është dëmtues.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloj i mbrojtur në Kosovë (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Grizimek 1990





Martes martes Linnaeus, 1758

Zardafi ose Kunadhja gushëverdhë

Mammalia: Carnivora: Mustelidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

Shqetësim më i Vogël, LC

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj

Të dhëna të përgjithshme

Trupin e kanë të mbuluar me qime ngjyrë kafe të çelët gjatë verës, kurse në dimër me qime të gjata ngjyrë kafe të mbyllët. Gusha ka ngjyrë të verdhë portokalli. Gjatësia trupore sillet prej 45 – 58 cm, ajo e bishtit 16 – 28 cm, kurse pesha e trupit prej 0.8 – 2.4 kg. Zakonisht meshkujt janë më të mëdhenj se femrat. Ushqehen me brejtës të imët, shpendë dhe vezë të tyre, insekte, këmij, reptile, si dhe me fara dhe frute gjatë stinës së verës. Është pre e dhelprës dhe shpendëve grabitqarë. Nuk bie në letargji dhe nuk migron. Çojnë jetë vetmitare, kurse foletë i ndërtojnë, por edhe mund t'i shfrytëzojnë ato të kafshëve të tjera nëpër drunj. Janë aktive në agim dhe muzg.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje; 3. Shkurre.
Mund të haset kryesisht në pyjet halore ose në ato të përziera, të pasura me drunj të vjetër, si dhe në zona shkëmbore të hapura edhe jashtë pyjeve me vegjetacion të dendur (Overskaug et al.1994).

Përhapja e përgjithshme

Europë, Azi.

Përhapja në Kosovë

Llabjan, Pograxhë, Bjeshkët e Junikut, Nerodime e Epërme, Sukë, Dushkajë, Tunaj, Rahovë, Pleqe, Pllamjan, Mushtisht, Busovat, Guri i Hajdarit.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Shqetësim më i Vogël, për shkak të qëndrueshmërisë së nënpopullatave dhe numrit relativisht të madh të lokacioneve ku është gjetur. Nga Kosova priten edhe nënpopullata të tjera.

Kërcënimet

Kërcënimet kryesore: 5. Përdorimi i burimeve biologjike (5.3. Prerja dhe vjelja e pyjeve); 7. Modifikimet e sistemeve natyrore (7.3 Modifikimet e tjera të ekosistemit).
Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj, janë: përndjekja nga ana e njeriut me metoda të ndryshme për shkak të gëzofit dhe lëkurës, pastaj humbja dhe fragmentimi i habitatit si dhe rritja e dendësisë së grabitqarëve.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloj i mbrojtur në Kosovë (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Overskaug et al.1994





Meles meles Linnaeus, 1758

Vjedulla ose Baldosa

Mammalia: Carnivora: Mustelidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

Shqetësim më i Vogël, LC

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj

Të dhëna të përgjithshme

Trupi i këtij lloji është i mbuluar me qime të gjata me ngjyrë gri ose të argjendtë nga ana shpinore, kurse nga ana barkore qimet janë të shkurtra, të buta dhe të dendura me ngjyrë të bardhë. Gjatësia trupore është prej 56 – 90 cm, bishti prej 12 – 24 cm dhe pesha trupore prej 8 – 17 kg. Ushqim i parapëlqyer i këtij lloji janë: krimbat e tokës, pastaj farat, frutat, zhardhokët, drithërat, arrat, kërpudhat, vezët e shpendëve, iriqët, ketrat, lepujt etj. (Delahay et al. 2008). Nuk kanë grabitqarë të vërtetë natyrorë, përveç njeriut, por, megjithatë, rrëqebulli, ujku, qeni dhe ariu paraqesin rrezik për të. Lëvizë zakonisht në muzg, natën, por, edhe ditën. Vjedullat janë mjaft miqësore, duke jetuar në grupe prej 2 – 23 individësh, por, në mungesë të ushqimit, bëjnë jetë vetmitare. Jetëgjatësia e këtij lloji është deri në 18 vjet.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje; 3. Shkurre; 14. Artificiale/tokësore.
Haset në zona malore gjetherënëse ose gjethembajtëse, me vegjetacion të dendur, por edhe në zona të hapura, kullosa dhe në zona të mbjella me kultura bujqësore, si: drithëra, perime dhe pemishte.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Azi.

Përhapja në Kosovë

Bjeshkët e Junikut, Viti, Jezerc, Bistricë, Dushkajë, Rapçe, Stanaj, Maxherre, Hakanishtë, Kabash, Bjeshkët e Deçanit, Novosellë, Kuqishtë, Mushtisht.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm
Trendi i nënpopullatave është i qëndrueshëm në nivel europian dhe në Kosovë.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Shqetësim më i Vogël, për shkak të qëndrueshmërisë së nënpopullatave dhe mosekzistimit të ndonjë faktori, që e rrezikon drejtpërsëdrejti këtë lloj apo habitatin e tij në Kosovë.

Kërcënimet

Faktorët kryesorë potencialë, që e rrezikojnë këtë lloj, janë ata të lidhur me veprimtaritë antropogjene si reduktimi dhe humbja e habitatit, gjuajtja dhe persekutimi për qëllime komerciale ose veprimtaritë armiqësore për shkak të dëmtimit të kulturave bujqësore, pemishteve dhe drithërave nga ky lloj.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Delahay et al. 2008





Mustela erminea Linnaeus, 1758

Nuselala e borës

Mammalia: Carnivora: Mustelidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Shqetësim më i Vogël, LC

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj ka trup të zgjatur dhe këmbë të shkurtra. Kokën e ka në formë trekëndëshi, qafën e gjatë, sytë të ndritshëm dhe mustaqet e gjata. Nga ana shpinore gëzofi është me ngjyrë të kuqërreme, kurse ana barkore është tërësisht me ngjyrë të bardhë. Bishti i gjatë 4.5 – 10 cm, në majë përfundon me ngjyrë të zezë. Gjatësia trupore sillet prej 17 – 30 cm dhe pesha trupore prej 340 – 400 gr. Meshkujt janë rëndom më të mëdhenj se femrat. Ushqehen me minj, lepuj, pastaj vezë të shpendëve, pakurrizorë, ujëtokësorë, gjarpërinj dhe hardhuca. Janë në gjendje ta mbysin viktimën edhe disa herë më të madhe se vetë dhe ushqimin pastaj e deponojnë në strofull. Janë pre e dhelprave, maceve, shpendëve grabitqarë etj. Nuk bien në letargji dhe nuk migrojnë. Jetëgjatësia e këtij lloji është deri në 7 vjet.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje; 3. Shkurre; 4. Kullosa; 5. Vende ujore (kontinentale); 14. Artificiale/tokësore.
Mund të haset në një gamë të gjerë habitatesh, si: pyje halore dhe të përziera, shkurre, kullosa, buzë rrugëve, brigjeve të lumenjve, pastaj kopshte si dhe në zona të populluara. E hasim në ultësira, por edhe në lartësi deri në mbi 4000.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Azi, Amerikë veriore.

Përhapja në Kosovë

Zhur, Budakovë, Gaçkë, Pozhoran, Përlepnicë, Novobërdë, Vllahi, Koshtovë, Klinë e Epërme, Turiqevc, Shushicë, Maxhunaj, Pobergjë, Osdrim, Krushevë, Zabergjë.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm
Trendi i popullatave është i qëndrueshëm në nivel europian dhe në Kosovë.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Shqetësim më i Vogël, për shkak të qëndrueshmërisë së nënpopullatave dhe numrit relativisht të madh të lokacioneve.

Kërcënimet

Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj, janë: humbja dhe fragmentimi i habitatit si rezultat i intensifikimit të bujqësisë dhe urbanizmit, pastaj djegia e kullosave dhe pyjeve, persekutimi nga ana e njeriut për shkak të gëzofit dhe qëndrimit armiqësor ndaj tij.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloj i mbrojtur në Kosovë (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).



Mustela nivalis Linnaeus, 1766

Nuselala

Mammalia: Carnivora: Mustelidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Shqetësim më i Vogël, LC

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj

Të dhëna të përgjithshme

Trupin e kanë të gjatë dhe të hollë e të mbuluar me gëzof ngjyrë kafe të çeltë nga ana shpinore, kurse nga ana barkore është tërësisht i bardhë. Gjatësia trupore e meshkujve sillet prej 13 – 26 cm, kurse e femrave prej 11 – 20 cm. Pesha trupore e meshkujve është prej 26 – 250 gr, kurse e femrave prej 29 - 117 gr. Është lloj i specializuar në gjuajtjen e brejtësve të vegjël, por, në mungesë të tyre ushqehet me vezë të shpendëve, insekte, hardhuca, gjarpërinj, lepuj të vegjël etj. (King & Powell 2007). Është pre e dhelprave, shpendëve grabitqarë etj. Folenë e ndërtojnë nën tokë, të cilën e shfrytëzojnë për pushim, rritjen e të vegjëlve dhe deponim të ushqimit. Nuk bien në letargji dhe nuk migrojnë. Aktiviteti i tyre është natën dhe ditën. Jetëgjatësia e tyre është 7 – 8 vjet.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje; 3. Shkurre; 4. Kullosa; 14. Artificiale/tokësore.
Mund të haset në habitate të ndryshme si: fusha, pyje të hapura, shkurre, parqe dhe zona të banuara.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Azi, Amerikë veriore, Afrikë veriore, Zelandë e Re, Azor, Kretë, Maltë.

Përhapja në Kosovë

Korbiliq, Kërstec, Celinë, Skivjan, Zabërxhë, Krushevë, Nabërgjan, Llaushë, Bellopojë, Baballoq, Smolicë, Pleshinë, Zhegër, Maxhunaj, Miresh, Busovatë, Novobërdë, Prapashticë.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Trendi i popullatave në nivel europian nuk është i njohur mirë, por edhe në Kosovë nuk ka të dhëna të mjaftueshme për trendin e popullatës.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Shqetësim më i Vogël, për shkak të numrit të madh të nënpopullatave. Me gjasë ky lloj është i përhapur më shumë nga sa dihet tani bazuar në të dhënat e vendeve përreth Kosovës.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5. Përdorimi i burimeve biologjike (5.1 Gjuetia dhe zënia e kafshëve tokësore: 5.1.2 Efektet e paqëllimshme (lloji nuk është i synuar)); 7. Modifikimet e sistemeve natyrore (7.3 Modifikimet e tjera të ekosistemit).
Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj, kanë të bëjnë me aplikimin e kemikateve të ndryshme në bujqësi, transformimin e zonave bujqësore ekstensive në intensive, si dhe me ndryshimin e praktikave bujqësore, të cilat kanë qenë të preferueshme si habitat për këtë lloj. Megjithatë, nuk ka interes për t'u gjuajtur në përgjithësi.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloj i mbrojtur në Kosovë (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

King & Powell 2007



Mustela putorius Linnaeus, 1758

Qelbësi

Mammalia: Carnivora: Mustelidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Shqetësim më i Vogël, LC

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj

Të dhëna të përgjithshme

Ka trup të hollë dhe të zgjatur, kokë të gjerë dhe gjymtyrë të shkurtra. Meshkujt janë më të mëdhenj se femrat. Gjatësia trupore e meshkujve sillet prej 35 – 46 dhe e bishtit prej 11.5 – 17 cm, kurse e femrave 29 – 40 dhe e bishtit prej 8.4 – 15 cm. Pesha trupore është midis 1 – 2.5 kg. Gjah i parapëlqyer i këtij lloji janë: brejtësit, shpendët, vezët dhe zogjtë e tyre, lepujt, amfibet, insektet, skrrajat e shiut etj. Qelbësi është pre e dhelprave, qenit, maceve të egra dhe atyre shtëpiake. Janë kafshë të vetmuara dhe janë aktive natën ose herët në agim. Territorin e mbrojnë edhe nga individët e të njëjtës gjini duke e markuar me një aromë shumë të rëndë të sekretuar nga gjëndrat anale. Nuk migron dhe nuk bie në letargji. Jeton deri në 6 vjet.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje; 3. Shkurre; 4. Kullosa; 5. Vende ujore (kontinentale); 14. Artificiale/tokësore.
Mund të haset kryesisht në zona të ulëta pyjore, kullosa, sipërfaqe me kultura bujqësore, zona të banuara dhe përreth tyre, por edhe pranë brigjeve të lumenjve dhe kënetave.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Azi perëndimore.

Përhapja në Kosovë

Korbiliq, Nerodime e Epërme, Kqiq i Madh, Çabër, Uçe, Veriq, Dobrushë, Strellc, Patok, Demjan, Zabërxhë, Turjakë, Studençan, Krojmir, Tërstenik, Vërban, Firajë, Pograxhë, Rahovë, Tërpezë, Përqevë.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm
Trendi global i popullatave është në rënie. Në bazë të vrojtimeve në Kosovë, vlerësohet se nënpopullatat e këtij lloji janë të qëndrueshme.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Shqetësim më i Vogël, për shkak të qëndrueshmërisë së popullatave dhe numrit relativisht të madh të lokacioneve ku është gjetur.

Kërcënimet

Kërcënimet kryesore: 5. Përdorimi i resurseve biologjike (5.1 Gjuetia dhe zënia e kafshëve tokësore: 5.1.2 Efektet e paqëllimshme (lloji nuk është i synuar)); 8. Specie, gjene dhe sëmundje invazive dhe të tjera problematike (8.1 Llojet e paidentifikuara/speciet e huaja/llojet e huaja: 8.1.2 Speciet e emërtuara, 8.2 Llojet/sëmundjet vendase problematike: 8.2.1 Lloje të paspecifikuara).
Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj, janë: modifikimi dhe shkatërrimi i habitatit, aplikimi i bujqësisë intensive dhe përdorimi i kemikateve në bujqësi, zhvillimi i infrastrukturës afër vendeve të banuara, si dhe persekutimi nga njeriu, për shkak të ndjenjës armiqësore ose edhe për qëllime komerciale.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloj i mbrojtur në Kosovë (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).



Sciurus vulgaris Linnaeus, 1758

Ketri

Mammalia: Carnivora: Mustelidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Shqetësim më i Vogël, LC

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj

Të dhëna të përgjithshme

Janë kafshë të shkathëta dhe vigjilente. Ngjyra e trupit varion në stinë të ndryshme, gjatë verës gëzofi është i kuqërremtë, gri ose kafe, kurse gjatë dimrit dominojnë ngjyrat e errëta. Ana barkore ka ngjyrë të bardhë. Gjatësia e trupit është prej 18 – 24 cm, bishti prej 14 – 20 cm, kurse pesha trupore prej 220 – 435 gr. Ushqehen kryesisht me fara dhe fruta drunjsh, si dhe me kërpudha, por ndonjëherë edhe me vezë shpendësh. Janë aktivë gjatë ditës, herët në agim dhe në muzg. Kohën më të madhe qëndrojnë në drunj. Jetojnë mesatarisht prej 2 – 7 vjet (Gumell & Wanters 1999).

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje; 14. Artificiale/tokësore.
Haset në zonat malore të përziera dhe halore por edhe në zonat periferike të kopshteve dhe parqeve.

Përhapja e përgjithshme

Palearktik.

Përhapja në Kosovë

Svilen, Korbiliq, Nerodime e Epërme, Hakanisht, Kozmaq, Bjeshkët e Sharrit, Shkrel, Shtupeq i Vogël, Zhazhe, Qyqavicë, Shtërpcë, Mushtisht, Isniq.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm
Trendi i popullatave në nivel global është në rritje. Edhe në Kosovë trendi i nënpopullatave të këtij lloji është stabil.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Shqetësim më i Vogël, për shkak të qëndrueshmërisë së nënpopullatave dhe numrit relativisht të madh të lokacioneve. Numri i nënpopullatave nga Kosova është, me gjasë, më i madh nga sa dihet tani.

Kërcënimet

Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj, janë: shkatërrimi dhe degradimi i habitateve, sëmundjet virusale dhe konkurrenca ndërllojore. Në disa raste, edhe gjuetia mund të jetë faktor rrezikues.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloj i mbrojtur në Kosovë (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Gumell & Wanters 1999





Sus scrofa Linnaeus, 1758

Derri i egër

Mammalia: Artiodactyla: Suidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

Shqetësim më i Vogël, LC

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj

Të dhëna të përgjithshme

Trupin e kanë të mbuluar me qime të trasha me ngjyrë të zezë, kuqërreme ose të hirtë në të bardhë, me një kreshtë përgjatë shpinës. Gjatësia trupore është prej 153 – 240 cm, lartësia deri në 0.9 m, kurse pesha trupore prej 66 – 350 kg. Meshkujt janë zakonisht më të mëdhenj se femrat. Ushqehen me fara, fruta, zhardhokë bimësh, insekte dhe kurrizorë të imët, si: reptilë, shpendë dhe gjitarë. Është pre e ujqve dhe rrëqebullit në vendin tonë, kurse në vende të tjera edhe e luanit, leopardit, krokodilit, pitonit etj. Lëviz kryesisht natën dhe herët në agim, por edhe gjatë ditës. Jetojnë në grupe prej 6 – 20 individësh ose edhe më shumë. Për të vegjlit përkujdesen vetëm femrat. Jetojnë deri në 20 vjet (Graves 1984).

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje; 3. Shkurre; 14. Artificiale/tokësore.
Gjendet në një gamë të gjerë habitatesh, si zona pyjore të ulëta dhe të larta të cilat nuk përballen me temperatura ekstreme dhe të cilat janë të pasura me vegjetacion të dendur dhe shkurre. Gjithashtu, haset në toka bujqësore të mbjella me drithëra.

Përhapja e përgjithshme

Në të gjitha kontinentet, me përjashtim të Antarktikut.

Përhapja në Kosovë

Papaz, Svilen, Bjeshkët e Junikut, Stane Du, Prroni i Azemit, Kërstec, Stanaj, Duhël, Debëlldeh, Gremnik, Berishë, Koshutan, Radishevë, Strellc, Bjeshkët e Isniqit, Mushtisht, Uglare.

Popullata

Trendi i popullatës: Në rritje
Trendi i popullatave është i qëndrueshëm dhe në rritje, në nivel europian dhe në Kosovë.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Shqetësim më i Vogël, për shkak të qëndrueshmërisë së popullatave dhe numrit relativisht të madh të lokaliteteve ku është gjetur.

Kërcënimet

Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj, janë: degradimi dhe shkatërrimi i habitateve, persekutimi nga ana e njeriut për qëllime komerciale, pastaj konkurrenca ndërllojore si dhe sëmundjet virale, të cilat me lehtësi barten te njeriu dhe kafshët e tjera.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Graves 1984





Talpa caeca Savi, 1822

Urithi i verbër

Mammalia: Eulipotyphla: Talpidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

Shqetësim më i Vogël, LC

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj

Të dhëna të përgjithshme

Trupin e kanë të mbuluar me qime të buta, të dendura dhe me shkëlqim. Trupi i tyre ka ngjyrë gri të errët në të zezë, kurse shputat e kuqërreme. Është i ngjashëm me urithët e tjerë, vetëm se te ky lloj sytë janë të mbuluar me një membranë të përhershme, që bën që kafsha të jetë plotësisht e verbër. Gjymtyrët i ka të fuqishme, të cilat përfundojnë me kthetra të përshtatshme për rrëmihje. Ushqehet kryesisht me pakurrizorë, si: krimba të tokës të cilët e përbëjnë rreth 90 % të menysë, pastaj me larva të insekteve, kërmij etj. Jetëgjatësia është rreth 5 vjet.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje; 4. Kullosa; 14. Artificiale/tokësore.
Ky lloj mund të haset në livadhe, kullosa, kopshte, pastaj në zona kodrinore-malore e më rrallë në zona subalpine dhe alpine deri në 2000 m.

Përhapja e përgjithshme

Lloj endemik i Europës, por është hasur edhe në Turqi.

Përhapja në Kosovë

Zabërxhë, Bubavec, Peçan, Poslisht, Demjan, Strellc, Veriq, Plemetin, Llapushnik, Koshare, Biçec, Smirë, Cërnicë, Hogosht, Gllamnik, Bellopojë, Mramor, Kllodernicë.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm
Trendi i nënpopullatave të këtij lloji është i qëndrueshëm, edhe pse në disa lokalitete pamjaftueshëm i njohur.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Shqetësim më i Vogël, për shkak të qëndrueshmërisë së popullatave dhe numrit relativisht të madh të lokaliteteve.

Kërcënimet

Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj, kanë të bëjnë me luftimin që i bëhet këtij lloji në tokat bujqësore, duke përdorur kurthe apo helme të ndryshme, edhe pse supozohet se kjo nuk përfaqëson kërcënim serioz për popullatën.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).





Vulpes vulpes Linnaeus, 1758

Dhelpra

Mammalia: Carnivora: Canidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

Shqetësim më i Vogël, LC

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj karakterizohet me trup të zgjatur, bisht të gjatë dhe gjymtyrë të shkurtra. Trupi është i mbuluar me gëzof prej qimeve të buta dhe të dendura. Ngjyra e trupit është e kuqërreme, kafe ose në të verdhë, ndërsa maja e bishtit dhe pjesa ventrale e kokës dhe qafës janë me ngjyrë të bardhë, kurse gjymtyrët, putrat dhe pjesët e jashtme të veshëve kanë ngjyrë të zezë. Gjatësia trupore është prej 50 – 90 cm, bishti prej 30 – 60 cm dhe pesha trupore prej 3 – 14 kg. Zakonisht, meshkujt janë më të mëdhenj se femrat. Janë omnivorë dhe ushqehen me brejtës, lepuj, insekte dhe fruta. Është lloj i specializuar në gjuajtjen e minjve. Jetëgjatësia e këtij lloji është deri në 10 vjet (Jones & Theberge 1982; Mc Donald 2001; Mc Donald & Reynolds 2005).

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje; 3. Shkurre; 4. Kullosa; 5. Vende ujore (kontinentale); 14. Artificiale/tokësore.

Haset në mjedise të ndryshme si pyje, shkurre, zona bujqësore, afër vendeve të banuara etj.

Përhapja e përgjithshme

Është i përfaqësuar me një numër të madh të nënllojeve dhe haset në Europë, Afrikë veriore, Azi, Amerikë veriore, Australi, Kanada, Meksikë etj.

Përhapja në Kosovë

Bjeshkët e Sharrit, Malishevë, Qabiq, Dollc, Vllahi, Rahovë, Qyqavicë, Debëllde, Svilen, Pouska, Bjeshkët e Junikut, Stanedub, Nerodime e Poshtme, Shushicë, Dushkajë, Nishevc.

Popullata

Trendi i popullatës: I qëndrueshëm

Nënpopullatat e këtij lloji janë stabile në Kosovë, por edhe në vendet fqinje.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Shqetësim më i Vogël, për shkak të numrit relativisht të madh të lokaliteteve ku është gjetur dhe qëndrueshmërisë së popullatave.

Kërcënimet

Aktualisht në Kosovë nuk ka ndonjë kërcënim për këtë lloj.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloj i mbrojtur në Kosovë (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Jones & Theberge 1982; Mc Donald 2001; Mc Donald & Reynolds 2005





Libri i Kuq i Faunes se Kosoves | 1

LLOJET ME TË DHËNA TË PAMJAFTUESHME (DD)

7.1 OLIGOCHAETA

Allolobophora leoni Michaelsen, 1891

Oligochaeta: Opistophora: Lumbricidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi[t]

Lucija Šerić Jelaska

Të dhëna të përgjithshme

Ky është një lloj me përhapje trans-egjeike. Trupi përbëhet nga 149 deri 180 segmente, kurse gjatësia nga 88 deri në 149 mm. Prostomiumi është proepilob. Apertura mashkullore me një atrium të vogël gjëndëror gjendet në segmentin e 15-të. Klitelumi shtrihet nga segmenti i 26-të deri te ai i 34-të; turberkulat janë në segmentet 30 – 32, me dy palë të xhungave në formë pllakash (Csuzdi & Zicsi 2003; Mršić 1991).

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4 Pyje të klimës mesatare); 4. Kullosa; 14 Artificiale/tokësore (14.1 Toka punuese, 14.5 Zona urbane).
Gjendet në pyje të ahut dhe të lisit, si dhe në livadhe të lagështa (Stojanović et al. 2018).

Përhapja e përgjithshme

Bosnjë-Hercegovinë, Bullgari, Hungari, Itali, Kosovë, Kroaci, Maqedoni, Moldavi, Rumani, Sllovaki (Rota 2013).

Përhapja në Kosovë

Ferizaj, Prishtinë (Šapkarev 1975).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Duke qenë se të dhënat për këtë lloj janë nga livadhe të lagështa në zonat urbane dhe preferencat e llojit për habitatin janë të lidhura me pyje të ahut e lisit, si dhe me livadhe të lagështa që mund të jenë nën aktivitetet e menaxhimit, humbja e habitateve për shkak të urbanizimit, menaxhimi intensiv i pyjeve, ndotja industriale dhe ngrohja globale, mund të paraqesin kërcënime ndaj këtij llloji në Kosovë. Për shkak të mungesës së të dhënave për vlerësim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë për Kosovën, ne sugjerojmë studime të mëtejshme dhe e klasifikojmë llojin në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1. Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.1 Strehimi dhe zonat urbane, 1.2. Hapësirat komerciale dhe industriale); 5. Përdorimi i burimeve biologjike (5.3. Prerja dhe vjelja e pyjeve).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Mirëmbajtja e livadheve të lagështa; aktivitete jo intensive pyjore.

Referencat

Csuzdi & Zicsi 2003; Mršić 1991; Rota 2013; Šapkarev 1975; Stojanović et al. 2018





Aporrectodea georgii Michaelsen, 1890

Oligochaeta: Opistophora: Lumbricidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Lucija Šerić Jelaska

Të dhëna të përgjithshme

Është lloj atlanto-mesdhetar, endogjen, që gjendet në shtresën minerale të dheut, i banon pyjet e ahut dhe lisit, livadhet e ultësirave në dhera të lagështa dhe brigjet e lumenjve (Csuzdi & Zicsi 2003). Trupi ka ngjyrë të zbehtë, të papigmentuar, me gjatësi 38 deri në 80 mm, diametri 2 – 4 mm dhe përbëhet nga 98 deri 150 segmente. Klitelumi shtrihet prej segmentit të 28-të dhe 29-të deri në atë të 35-të, ½ e atij të 36-të, kurse dy palë turberkula në formë ventuzash janë të pranishme në segmentet 31 dhe 33 (Mršić 1991).

Habitati

Lloji i habitatit: 1 Pyje (1.4 Pyje të klimës mesatare); 4 Kullosa (4.4 Kullosa të klimës mesatare); 5 Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat]); 14 Artificiale/tokësore (14.1 Toka të punueshme, 14.2 Kullosa, 14.4 Kopshte Rurale, 14.5 Zona urbane); 7. Shpella dhe habitate nëntokësore (joujore).
Ky lloj haset në kullosa, shpella, pyje ahu dhe lisi, dhera të kultivuara dhe livadhe (Šapkarev 1980; Stojanović et al. 2018).

Përhapja e përgjithshme

Europë (përveç Europës veriore), Siri, Palestinë.

Përhapja në Kosovë

Prishtinë (Šapkarev 1975).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Për shkak të mungesës së të dhënave për vlerësim direkt apo indirekt (përhapja dhe dendësia, të dhënat e vjetra për praninë e saj në mjediset urbane në Prishtinë, qytet ky që është nën presion të vazhdueshëm antropogjen (ndërtimet, turizmi etj.)), këtë lloj e klasifikojmë në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme. Për shkak të statusit të këtij lloji si: I Cenuar, në Serbinë fqinje, sugjerojmë studime të mëtejme.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.2 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi komercial), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)); 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Ujërat e zeza).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës, 1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve). 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Csuzdi & Zicsi 2003; Mršić 1991; Šapkarev 1975; Šapkarev 1980; Stojanović et al. 2018)





Aporrectodea jassyensis Michaelsen, 1891

Oligochaeta: Opistophora: Lumbricidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Lucija Šerić Jelaska

Të dhëna të përgjithshme

Ky është një lloj transegjeik. Është skrrajë endogjene, që jeton dhe ushqehet në shtresën minerale të dheut. Trupi është i zbehtë pa pigmentim, 60 – 100 mm i gjatë, 2 – 4 mm në diametër, i përbërë nga 100 – 140 segmente. Koka është epilobe. Klitelumi është në formë të shalës dhe shtrihet në segmentet: 28, 29-35. Tuberkula pubertatis është në formë të një shiriti në segmentet 31, 32 – 34 dhe 35. Pori mashkullor gjendet në segmentin e 15-të me një papillë të madhe gjëndërore, që i mbulon pjesërisht edhe segmentet fqinje (Mršić 1991).

Habitati

Lloji i habitatit: 1 Pyje (1.4 Pyje të klimës mesatare); 4 Kullosa (4.4 Kullosa të klimës mesatare); 5 Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat]); 14 Artificiale/tokësore.

Përhapja e përgjithshme

Transegjeik (nga Zvicra drejt Europës juglindore dhe Lindjes së Mesme) (Rota 2013).

Përhapja në Kosovë

Prishtinë, Prizren, Suharekë (Mršić 1991; Šapkarev 1975, 1972; Zicsi 1968).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Për shkak të mungesës së të dhënave dhe vjetërsisë së regjistrimeve ekzistuese (disa nga to në zona urbane dhe përgjatë brigjeve të lumenjve, që të dy këto habitate nën ndikim të madh antropogjen), sugjerojmë studime të mëtejme, kurse tash për tash e klasifikojmë këtë lloj në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.2 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi komercial), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)); 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Ujërat e zeza).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës, 1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve). 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Të ruhen tokat e lagështa, të ketë aktivitete jointensive pyjore, të realizohet bujqësi e qëndrueshme, për të reduktuar burimet e ndotjes së tokës dhe ujit

Referencat

Mršić 1991; Rota 2013; Šapkarev 1972; Šapkarev 1975; Zicsi 1968





Dendrobaena serbica Karaman, 1973

Oligochaeta: Opistophora: Lumbricidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Lucija Šerić Jelaska

Të dhëna të përgjithshme

Trupi i këtij lloji ka ngjyrë vjollce të mbyllët, i gjatë prej 12 deri në 21 mm, i përbërë nga 58 deri 81 segmente. Prostomiumi është prolob. Klitelumi shtrihet nga segmentet 29 deri 33, 34, kurse tuberkula pubertatis mungon (Mršić 1991).

Habitati

Lloji i habitatit: 4 Kullosa (4.4 Kullosa të klimës mesatare); 14 Artificiale/tokësore (14.2 Kullosa).
Haset në livadhe dhe kullosa (Karaman 1973; Šapkarev 1980; Stojanović et al. 2018; Trakić et al. 2016).

Përhapja e përgjithshme

Kosovë, Serbi.

Përhapja në Kosovë

Çakorr (Karaman 1973; Mršić 1991).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky është një lloj endemik i Ballkanit. Nuk ka të dhëna të mjaftueshme rreth përhapjes apo trendit të popullatës për të bërë vlerësim të caktuar për kategoritë përkatëse të rrezikshmërisë. Prandaj, e kemi klasifikuar në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 2. Bujqësia dhe akuakultura (2.3 Blegtoria dhe Fermat); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 11. Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lokaliteti ku është gjetur ky lloj është në kuadër të zonës së mbrojtur.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës, 1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve). 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Karaman 1973; Mršić 1991; Šapkarev 1980; Stojanović et al. 2018; Trakić et al 2016



Dendrobaena zicsi Karaman, 1973

Oligochaeta: Opistophora: Lumbricidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Lucija Šerić Jelaska

Të dhëna të përgjithshme

Ky është një lloj me gjatësi prej 130 – 160 mm dhe diametër prej 6-7 mm me ngjyrë hiri të çelët kah e kafta. Është lloj endemik i Ballkanit me përhapje të kufizuar dhe i njohur vetëm nga lokaliteti tipor.

Habitati

Lloji i habitatit: 4 Kullosa (4.4 Kullosa të klimës mesatare); 14 Artificiale/tokësore (14.2 Kullosa).
Është regjistruar në kullosa në pyje (Karaman 1973).

Përhapja e përgjithshme

Kosovo.

Përhapja në Kosovë

Rahovec, Çakorr (Kerovec & Mršić 1981; Šapkarev 1975).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky është një lloj endemik me përhapje të kufizuar. Edhe pse zona e pranisë ZP është më e vogël se 20 km2, të dhënat për përhapjen e llojit dhe trendin e popullatës janë të pamjaftueshme për të bërë një vlerësim për kategorinë e kërcënueshmërisë. Prandaj, tash për tash lloji klasifikohet në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 11. Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Njëra nga nënpopullatat është në kuadër të zonës së mbrojtur.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës, 1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve). 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës); 3 Monitorimi (3.1. Menaxhimi ex-situ).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Karaman 1973; Kerovec & Mršić 1981; Šapkarev 1975



Eisenia lucens Waga, 1857

Oligochaeta: Opistophora: Lumbricidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Lucija Šerić Jelaska

Të dhëna të përgjithshme

Është lloj i Europës qendrore. Është lloj epigjeik me ngjyrë të errët vjollce, me shirita alternues të segmenteve të errëta, me zona të verdha ndërsegmentore. Koka është epilobe. Gjendet kryesisht në pyje ahu, ku mund të gjendet nën lëvozhgën e cungjeve të dekompozuara ose nën gjethet e rëna, në pyje të lartësive të mëdha mbidetare. Kur irritohet e gjuan lëngun celomik bioluminishent me ngjyrë të gjelbër nëpërmjet poreve në murin e trupit. Gjatësia trupore është 45 – 180 mm, diametri 4 – 6 mm dhe i ka 60 – 130 segmente. Klitelumi është në formë të shalës dhe shtrihet në segmentet (24), 25, 26, 27–33, 34. Tuberkulat janë zakonisht në segmentet 28, 29–31, 1/2 32, 33 (Mršić 1991).

Habitati

Lloji i habitatit: 1 Pyje (1.4 Pyje të klimës mesatare).
Gjendet në pyje gjetherënëse dhe jeton kryesisht në shtresën organike të dheut të drunjve që janë duke u dekompozuar.

Përhapja e përgjithshme

Europë.

Përhapja në Kosovë

Luboten (Šapkarev 1975).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky është një lloj me përhapje të kufizuar. Edhe pse zona e pranisë ZP është më e vogël se 20 km2, të dhënat për përhapjen e llojit dhe trendin e popullatës janë të pamjaftueshme për të bërë një vlerësim për kategorinë e kërcënueshmërisë. Prandaj, tash për tash lloji klasifikohet në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.3 Zona turistike dhe rekreative); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 11. Ndryshimet klimatike dhe moti i ashpër (11.2 Thatësirat, 11.3 Ekstremet e temperaturës).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës, 1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve). 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Është i nevojshëm konservimi i pyjeve nëpërmjet menaxhimit të orientuar të pyjeve, duke siguruar drunj të vdekur, si dhe konservimi i përrenjve dhe liqeneve malore të cilat e mirëmbajnë lagështinë e dheut.

Referencat

Mršić 1991; Šapkarev 1975



Proctodrilus tuberculatus Černosvitov, 1935

Oligochaeta: Opistophora: Lumbricidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Lucija Šerić Jelaska

Të dhëna të përgjithshme

Është lloj i Europës qendrore. I takon grupit endogjen, që jeton dhe ushqehet në shtresën minerale të dheut. Parapëlqen dhera të lagështa, por toleranca e këtij lloji ndaj thatësisë është më e madhe sesa te lloji P. antipai. Gjatësia e trupit është 45 deri 60 mm, me diametër 1-2.5 mm dhe 89 – 130 segmente me ngjyrë të zbehtë pa pigmentim. Klitelumi shtrihet përgjatë segmenteve 25 (26) - 33. Dy palë të tuberkulave në formë ventuze janë ndërsegmentale, në segmentet 30/31 dhe 31/32. Poret mashkullore janë në segmentin e 15-të dhe i mbulojnë edhe segmentet fqinje (Mršić 1991).

Habitati

Lloji i habitatit: 4 Kullosa (4.4 Kullosa të klimës mesatare); 14 Artificiale/tokësore (14.1 Toka të punueshme).
Ky lloj haset në kullosa dhe toka të kultivuara.

Përhapja e përgjithshme

Europë.

Përhapja në Kosovë

Mitrovicë, Prishtinë (Šapkarev 1975).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është klasifikuar në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme, për shkak të informatave ekzistuese joadekuate, që e pamundësojnë vlerësimin për kategoritë e rrezikshmërisë bazuar në përhapjen dhe statusin e popullatës. Ka nevojë për më shumë informata për këtë lloj sa i përket përhapjes dhe trendit të popullatës në Kosovë për të përcaktuar saktësisht statusin e kërcënueshmërisë.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 2. Bujqësia dhe akuakultura (2.3 Blegtoria dhe fermat).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës, 1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve). 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Mršić 1991; Šapkarev 1975



7.2 CLITELLATA

Dina prokletijaca
Grosser & Pešić 2016

Ushunjëza e Bjeshkëve të Nemuna

Clitellata: Arhynchobdellida: Erpobdellidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi, Astrit Bilalli

Të dhëna të përgjithshme

Gjatësia e trupit të këtij lloji është 23 mm, kurse gjerësia 4,5 mm. Ana barkore është e ndritshme, me dy gjurmë të errëta gjatësore. Jetojnë në pjesët burimore të rrjedhave ujore, kryesisht në zona pyjore të dominuara nga ahu (Fagus sylvatica L.) (Grosser et al. 2016).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat]), 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Ky lloj gjendet në zonat burimore në lartësi mbidetare nga 659 m deri 1599 m mbi nivelin e detit.

Përhapja e përgjithshme

Kosovë.

Përhapja në Kosovë

Bjeshkët e Nemuna.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Përhapja e këtij lloji nuk është mirë e njohur. Trendi i popullatës është i panjohur. Për shkak të mungesës së të dhënave, ky lloj klasifikohet në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)]; 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Grosser et al. 2016





Glossiphonia balcanica Grosser & Pešić 2016

Ushunjëza ballkanike

Clitellata: Rhynchobdellida: Glossiphoniidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Astrit Bilalli

Të dhëna të përgjithshme

Gjatësia e trupit është deri në 10 mm, kurse gjerësia deri në 8 mm. Trupi në anën shpinoro-barkore është i rrafshët, forma është ovale dhe koka në formë të bulbit. Sipërfaqja barkore në ekzemplarët e gjallë është ngjyrë kafe e ndritshme (ngjyrë qelibari) (Grosser et al. 2016).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat), 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Ky lloj gjendet në ujëra të niveleve të ndryshme (të vogla, të mesme dhe të mëdha) (Utevsky et al. 2013).

Përhapja e përgjithshme

Endemik i Ballkanit. Aktualisht, i njohur vetëm nga Kosova dhe Mali i Zi.

Përhapja në Kosovë

Deçan.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Përhapja e njohur e këtij lloji është e shkëputur, por, me gjasë kjo vjen si rezultat i njohurive të pamjaftueshme. Trendi i popullatës është i panjohur. Për shkak të mungesës së të dhënave, ky lloj klasifikohet në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)); 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Grosser et al. 2016; Utevsky et al. 2013





Asagena meridionalis Kulczyński, 1894

Arachnida: Araneae: Theridiidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Donard Geci

Të dhëna të përgjithshme

Mashkulli ka madhësi 4-6 mm, kurse femra 4.9-5.6 mm. Pedipalpet tek mashkulli janë me një zgjatim të embolusit. Prozoma me ngjyrë të zezë të theksuar. Këmbët me ngjyrë të shndritshme. Mashkulli haset në pranverë dhe vjeshtë (Nentwig et al. 2018).

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4 Pyje të klimës mesatare)
Pyje të hapura të bungut dhe të pishës.

Përhapja e përgjithshme

Bullgari, Çeki, Greqi, Gjeorgji, Hungari, Kosovë, Mali i Zi, Maqedoni, Serbi, Sllovaki, Ukrainë.

Përhapja në Kosovë

Parku Karagaç.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Përhapja e këtij lloji nuk është e njohur mirë për shkak të hulumtimeve të pamjaftueshme. Trendi i popullatës është i panjohur. Për shkak të mungesës së të dhënave, lloji vlerësohet në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1. Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.1 Strehimi dhe zonat urbane 1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.1 Zjarret dhe luftimi i tyre).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Nentwig et al. 2018



Callilepis cretica Roewer, 1928

Arachnida: Araneae: Gnaphosidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Donard Geci

Të dhëna të përgjithshme

Mashkulli ka prozomë me ngjyrë gështenje me qime të bardha. Prozoma ka madhësi 1.4 mm. Sternumi është ngjyrë kafe. Këmbët janë me ngjyrë të zezë si kafe, përveç tarzusit, i cili ka ngjyrë të verdhë në të kuqe. Opistozoma e zezë. Femra është e ngjashme me mashkullin (Nentwig et al. 2018).

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4 Pyje të klimës mesatare).
Habitat i parapëlqyer i këtij lloji janë pyjet e bungut edhe të pishës.

Përhapja e përgjithshme

Algjeri, Bullgari, Greqi, Kosovë, Maqedoni, Turqi.

Përhapja në Kosovë

Gërmi.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Përhapja e këtij lloji nuk është e njohur mirë për shkak të hulumtimeve të pamjaftueshme. Trendi i popullatës është i panjohur. Për shkak të mungesës së të dhënave, lloji vlerësohet në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1. Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.1 Strehimi dhe zonat urbane 1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.1 Zjarret dhe luftimi i tyre).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Nentwig et al. 2018



Lycosa tarantula Linnaeus, 1758

Tarantulla

Arachnida: Araneae: Theridiidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Donard Geci

Të dhëna të përgjithshme

Është lloji më i madh i familjes Lycosidae. Femra ka madhësi rreth 30 mm, ndërsa mashkulli 25 mm. Ngjyra bazike te mashkulli është e bardhë në të hirtë, ndërsa te femra e verdhë ose portokalli. Ky lloj nuk ndërton rrjeta për të gjuajtur prenë, sikurse bëjnë shumica e përfaqësuesve të kësaj familjeje, por tunele në tokë. Sikurse edhe te llojet e tjera të kësaj familjeje, numri i vezëve në mbështjellësin e tyre sillet rreth 100. Femrat jetojnë 4 ose më shumë vite, ndërsa meshkujt më pak, e njëra nga arsyet është kanibalizmi nga femrat. Dimrin e kalojnë në gjumë në tunelet e hapura gjatë verës (Bellmann 2016).

Habitati

Lloji i habitatit: 4. Kullosa (4.4 Kullosa të klimës mesatare); 6. Zona shkëmbore (p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore].
Gjendet kryesisht në vende shkëmbore të ekspozuara me diell.

Përhapja e përgjithshme

Bosnjë-Hercegovinë, Itali, Kosovë, Kroaci, Maqedoni, Turqi.

Përhapja në Kosovë

Krevenikë.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Përhapja e këtij lloji nuk është e njohur mirë për shkak të hulumtimeve të pamjaftueshme. Trendi i popullatës është i panjohur. Për shkak të mungesës së të dhënave, lloji vlerësohet në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1. Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.1 Strehimi dhe zonat urbane, 1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.1 Zjarret dhe luftimi i tyre).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Bellmann 2016





Nemesia pannonica Herman, 1879

Arachnida: Araneae: Nemesidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Donard Geci

Të dhëna të përgjithshme

Te mashkulli prozoma ka gjatësi 5 mm. Opistozoma është ngjyrë kafe dhe me struktura të parregullta. Te femra prozoma është ngjyrë kafe në të kuqe, me gjatësi 6.2 mm, kurse opistozma ngjyrë kafe. Ky lloj ndërton tunele të thella deri në 30 cm (Nentwig et al. 2018). Mashkulli dhe femra paraqiten nga marsi deri në maj. Janë organizma nokturnë.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4 Pyje të klimës mesatare); 3.Shkurre (3.4 Shkurre të klimës mesatare).

Përhapja e përgjithshme

Algjeri, Bullgari, Greqi, Kosovë, Maqedoni, Turqi.

Përhapja në Kosovë

Gërmi.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Përhapja e këtij lloji nuk është e njohur mirë për shkak të hulumtimeve të pamjaftueshme. Trendi i popullatës është i panjohur. Për shkak të mungesës së të dhënave, lloji vlerësohet në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1. Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.1 Strehimi dhe zonat urbane, 1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.1 Zjarret dhe luftimi i tyre).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Nentwig et al. 2018





Steatoda paykulliana Walckenaer, 1806

Arachnida: Araneae: Theridiidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Donard Geci

Të dhëna të përgjithshme

Mashkulli ka prozomë ngjyrë kafe të mbylltë deri në të zezë. Këmbët janë me ngjyrë të verdhë në të kaftë. Madhësia e trupit 4.5-8.4 mm. Te femra prozoma është ngjyrë kafe në të zezë, kurse sternumi është i kaftë i mbylltë. Këmbët janë po ashtu të kafta. Madhësia është nga 8-13 mm (Nentwig et al. 2018).

Habitati

Lloji i habitatit: 6. Zona shkëmbore [p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore].

Përhapja e përgjithshme

Austri, Azerbejxhan, Belgjikë, Bosnjë-Hercegovinë, Bullgari, Francë, Gjeorgji, Gjermani, Greqi, Hungari, Itali, Kosovë, Kroaci, Maqedoni, Portugali, Rumani, Rusi, Serbi, Slloveni, Spanjë, Shqipëri, Turqi, Zvicër.

Përhapja në Kosovë

Livadhi i Madh në Junik, Prilep.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Përhapja e këtij lloji nuk është e njohur mirë për shkak të hulumtimeve të pamjaftueshme. Trendi i popullatës është i panjohur. Për shkak të mungesës së të dhënave, lloji vlerësohet në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1. Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.1 Strehimi dhe zonat urbane 1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit); 7. Modifikimet e sistemeve natyrore (7.1 Zjarret dhe luftimi i tyre).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Nentwig et al. 2018





Uroctea durandi Latreille, 1809

Arachnida: Araneae: Oecobiidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)

Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)

Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Donard Geci

Të dhëna të përgjithshme

Te femra prozoma është e zezë ose e kuqe si ngjyrë kafe, mirëpo e errët. Prozoma ka madhësi 4.1 mm. Sytë e mesëm të përparmë janë shumë të mëdhenj, kurse ata të mesëm të pasmë janë më të larguar nga njëri-tjetri. Opistozoma ka ngjyrë të zezë me 5 pika të verdha. Madhësia e trupit: 15 mm. Mashkulli është i ngjashëm me femrën por më i vogël, 6-10 mm. Sa i përket fenologjisë, femra mund të shihet gjatë gjithë vitit, ndërsa mashkulli vetëm në pranverë, vjeshtë dhe dimër (Nentwig et al. 2018).

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare); 6. Zona shkëmbore [p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore].

Përhapja e përgjithshme

Austri, Bullgari, Francë, Hungari, Itali, Kosovë, Kroaci, Maqedoni, Portugali, Spanjë, Shqipëri, Turqi.

Përhapja në Kosovë

Krevenikë.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Përhapja e këtij lloji nuk është e njohur mirë, për shkak të hulumtimeve të pamjaftueshme. Trendi i popullatës është i panjohur. Për shkak të mungesës së të dhënave, lloji vlerësohet në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1. Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.1 Strehimi dhe zonat urbane 1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.1 Zjarret dhe luftimi i tyre).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Nentwig et al. 2018





Zygiella keyserlingi Ausserer, 1871

Arachnida: Araneae: Araneidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Donard Geci

Të dhëna të përgjithshme

Femra ka madhësi 6-8 mm. Prozoma ka ngjyrë kafe të çelët. Opistozoma ka ngjyrë të argjendtë me nuanca ngjyrë kafe, në anën barkore me nga një vijë në secilin skaj. Këmbët kanë ngjyrë të njëjtë. Mashkulli ka ngjyrë të njëjtë sikurse femra, mirëpo është më i vogël, rreth 6 mm (Nentwig et al. 2018).

Habitati

Lloji i habitatit: 4.Kullosa (4.4 Kullosa të klimës mesatare).

Përhapja e përgjithshme

Bosnjë-Hercegovinë, Bullgari, Greqi, Hungari, Itali, Kosovë, Kroaci, Mali i Zi, Maqedoni, Portugali, Serbi, Sllloveni, Turqi, Ukrainë.

Përhapja në Kosovë

Junik, Pejë (gjetja në Pejë duhet konfirmuar (Deltshev et al. 2003)).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Përhapja e këtij lloji nuk është e njohur mirë për shkak të hulumtimeve të pamjaftueshme. Trendi i popullatës është i panjohur. Për shkak të mungesës së të dhënave, lloji vlerësohet në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1. Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.1 Strehimi dhe zonat urbane, 1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.1 Zjarret dhe luftimi i tyre).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Deltshev et al. 2003; Nentwiget al. 2018





Zercon kosovina Kontschán 2006

Arachnida: Mesostigmata: Zerconidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Donard Geci

Të dhëna të përgjithshme

Lloj endemik, lokaliteti tipor i të cilit gjendet në Kosovë. Femra është e gjatë 410–415 µm dhe e gjerë 365–370 µm (n = 3) (Kontschán 2006).

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare).
Gjendet në pyje të ahut, kryesisht në shtresën e detritusit.

Përhapja e përgjithshme

Kosovë

Përhapja në Kosovë

Bjelluhë, Çakorr (Kontschán 2006).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme, për arsye se të dhënat e tanishme janë joadekuate për të vlerësuar drejtpërsëdrejti apo tërthorazi rrezikun e zhdukjes së llojit, bazuar në përhapjen e tij dhe/apo statusin e popullatës.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5. Përdorimi i burimeve biologjike (5.3. Prerja dhe vjelja e pyjeve); 11. Ndryshimet klimatike dhe moti i ashpër (11.2 Thatësirat, 11.3 Ekstremet e temperaturës).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lokaliteti ku është gjetur ky lloj është në kuadër të zonës së mbrojtur (Parku Kombëtar i Bjeshkëve të Nemuna), ku janë në funksion disa masa mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës). 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Kontschán 2006



7.4 MALACOSTRACA

Microcharon profundalis Karaman, 1940

Malacostraca: Isopoda: Microparasellidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Lucija Šerić Jelaska

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj gjendet kryesisht në habitatet nëntokësore të lagështa dhe mund të gjendet nëpër bunarë. Në Kosovë është i pranishëm nënlloji Microcharon profundalis kosovensis Karaman, 1940. Nënlloji karakterizohet me formë të dallueshme të majës së pleopodit të parë të mashkullit. Stanko Karaman (1940) e ka emërtuar këtë lloj në bazë të fushës së Kosovës, si nënlloj kosovensis (Karaman 1940).

Habitati

Gjendet në habitate nëntokësore të lagështa (puse).

Përhapja e përgjithshme

Kosovë, Mali i Zi, Maqedoni (Boxshall 2013).

Përhapja në Kosovë

Mitrovicë (Karaman 1940).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme, për arsye se të dhënat e tanishme janë joadekuate për të vlerësuar drejtpërsëdrejti apo tërthorazi rrezikun e zhdukjes së llojit, bazuar në përhapjen e tij dhe/apo statusin e popullatës.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.1 Strehimi dhe zonat urbane, 1.2. Hapësirat komerciale dhe industriale); 7. Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2. Digat dhe menaxhimi/përdorimi i ujit: 7.2.2 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi komercial), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)]; 9. Ndotja (9.1 Ujërat shtëpiake dhe urbane, 9.2. Efluentët industrialë dhe ushtarakë, 9.3 Shkarkimet bujqësore dhe pyjore, 9.4 Mbeturinat dhe mbetjet e ngurta).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës). 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Boxshall 2013; Karaman 1940



7.5 DIPLOPODA

Dyocerasoma drimicum Mrsic, 1985

Diplopoda: Chordeumatida: Craspedosomatidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Lucija Šerić Jelaska

Të dhëna të përgjithshme

Trupi i këtij lloji është ngjyrë kafe, rreth 15 mm i gjatë. Trupi përbëhet nga 30 segmente. Koka e rrafshët, lehtas e lakuar. Sytë në formë trekëndëshi. Përshkrimi i detajuar është dhënë nga Mršić (1985). Lloji është i njohur vetëm nga lokaliteti tipor nga Drini i Bardhë në Kosovë (Makarov et al. 2004).

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare).
Ky lloj kryesisht ndodhet në pyje, në afërsi të burimeve.

Përhapja e përgjithshme

Kosovë.

Përhapja në Kosovë

Drini i Bardhë (Mršić 1985).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme, për arsye se të dhënat e tanishme janë joadekuate për të vlerësuar drejtpërsëdrejti apo tërthorazi rrezikun e zhdukjes së llojit, bazuar në përhapjen e tij dhe/apo statusin e popullatës.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5. Përdorimi i burimeve biologjike (5.3. Prerja dhe vjelja e pyjeve); 7. Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi/përdorimi i ujit: 7.2.3 Eksploatimi i ujërave sipërfaqësore (përdorimi komercial).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës, 1.2. Mbrojtja e burimeve dhe habitatit). 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Aktivitete jointensive pyjore.

Referencat

Makarov et al. 2004; Mršić 1985



Leptoiulus macedonicus Attems, 1927

Diplopoda: Julida: Julidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Lucija Šerić Jelaska

Të dhëna të përgjithshme

Ky është një lloj endemik i Ballkanit, që parapëlqen lartësi të mëdha mbidetare (Beron 2008; Makarov et al. 2004).

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare).
Ky lloj ndodhet kryesisht në pyjet alpine, kryesisht të ahut, në shtresën e detritusit apo nën gurë (Attems 1929; Kime & Enghoff 2017).

Përhapja e përgjithshme

Greqi, Kosovë, Maqedoni, Shqipëri.

Përhapja në Kosovë

Luboten (Attems 1929; Makarov et al. 2004; Mršić 1987, 1988).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme, për arsye se të dhënat e tanishme janë joadekuate për të vlerësuar drejtpërsëdrejti apo tërthorazi rrezikun e zhdukjes së llojit, bazuar në përhapjen e tij dhe/apo statusin e popullatës.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5. Përdorimi i burimeve biologjike (5.3. Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lokaliteti ku është gjetur ky lloj është në kuadër të zonës së mbrojtur (Parku Kombëtar i Bjeshkëve të Sharrit), ku janë në funksion disa masa mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës, 1.2. Mbrojtja e burimeve dhe habitatit). 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Aktivitete jointensive pyjore.

Referencat

Attems 1929; Beron 2008; Kime and Enghoff 2017; Makarov et al. 2004; Mršić 1987, 1988





Megaphyllum crassum Attems, 1929

Diplopoda: Julida: Julidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Lucija Šerić Jelaska

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj i takon gjinisë Megaphyllum Verhoeff, 1894, që është gjini euro-ponto-mediterane dhe një nga gjinitë më të llojllojshme dhe taksonomikisht më komplekse të familjes Julidae (Lazányi et al. 2017).

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare).
Ky lloj ndodhet kryesisht në zona pyjore.

Përhapja e përgjithshme

Kosovë, Maqedoni.

Përhapja në Kosovë

Luboten, Kaçanik (Attems 1929; Kime & Enghoff 2017; Makarov et al. 2004; Strasser 1971).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme, për arsye se të dhënat e tanishme janë joadekuate për të vlerësuar drejtpërsëdrejti apo tërthorazi rrezikun e zhdukjes së llojit, bazuar në përhapjen e tij dhe/apo statusin e popullatës.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5. Përdorimi i burimeve biologjike (5.3. Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Disa gjetje të këtij lloji janë në kuadër të zonës së mbrojtur (Parku Kombëtar i Bjeshkëve të Sharrit), ku janë në funksion disa masa mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës, 1.2. Mbrojtja e burimeve dhe habitatit). 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Aktivitete jointensive pyjore.

Referencat

Attems 1929; Kime and Enghoff 2017; Lazanyi et al. 2012; Makarov et al. 2004; Strasser 1971



Onychoglomeris herzogowinensis Verhoeff, 1898

Diplopoda: Glomerida: Glomeridae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Lucija Šerić Jelaska

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e trupit të këtij lloji sillet prej 13-24 mm, kurse gjerësia prej 7-11 mm. Femrat janë rëndom më të mëdha se meshkujt. Tergitet trupore janë të zeza, me skaje anësore dhe kaudale më të zbehta, vetëm rrallëherë me ngjyrë të zbehtë të kuqe-verdhemtë-kafe (Attems 1929).

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare).
Ky lloj epigjeik ndodhet kryesisht në pyje, kryesisht në detritus apo nën gurë (Mauries et al. 1997).

Përhapja e përgjithshme

Bosnjë-Hercegovinë, Greqi, Kosovë, Kroaci, Mali i Zi, Shqipëri.

Përhapja në Kosovë

Deçan (Čurčić et al. 1999 në Makarov et al. 2004).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme, për arsye se të dhënat e tanishme janë joadekuate për të vlerësuar drejtpërsëdrejti apo tërthorazi rrezikun e zhdukjes së llojit, bazuar në përhapjen e tij dhe/apo statusin e popullatës.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5. Përdorimi i burimeve biologjike (5.3. Prerja dhe vjelja e pyjeve).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Disa gjetje të këtij lloji janë në kuadër të zonës së mbrojtur (Parku Kombëtar i Bjeshkëve të Nemuna), ku janë në funksion disa masa mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës, 1.2. Mbrojtja e burimeve dhe habitatit). 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Aktivitete jointensive pyjore.

Referencat

Attems 1929; Makarov et al. 2004; Mauries et al. 1997



Typhloglomeris ljubetensis Attems, 1929

Diplopoda: Glomerida: Glomeridae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Lucija Šerić Jelaska

Të dhëna të përgjithshme

Ky është një lloj epigjeik me ngjyra të ndryshme. Guaska e kokës e ka bazën ngjyrë kafe të mbyllët, me nuanca kah e verdha e çelët (Attems 1929).

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare).
Ndodhet kryesisht në pyje (zakonisht të ahut), në detritus apo nën gurë (Attems 1929).

Përhapja e përgjithshme

Kosovë, Maqedoni.

Përhapja në Kosovë

Luboten (Attems 1929; Makarov et al. 2004; Strasser 1971).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme, për arsye se të dhënat e tanishme janë joadekuate për të vlerësuar drejtpërsëdrejti apo tërthorazi rrezikun e zhdukjes së llojit, bazuar në përhapjen e tij dhe/apo statusin e popullatës.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5. Përdorimi i burimeve biologjike (5.3. Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6. Ndërhyrje dhe shqetësime njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lokaliteti ku është gjetur ky lloj është në kuadër të zonës së mbrojtur.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës, 1.2. Mbrojtja e burimeve dhe habitatit). 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Aktivitete jointensive pyjore.

Referencat

Attems 1929; Makarov et al. 2004; Strasser 1971





Typhloiulus albanicus Attems, 1929

Diplopoda: Julida: Julidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Lucija Šerić Jelaska

Të dhëna të përgjithshme

Ky është një lloj kavernikol, që jeton mbi tokë. Labrumi është i përbërë nga një rend prej 16 setash. Këmbët e mashkullit në pjesën e përparme të trupit e kanë një jastëk ngjitës të vogël, por shumë të theksuar në tibia; ky jastëk mungon në femur (Vagalinski et al. 2015).

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare); 7. Shpella dhe habitate nëntokësore (joujore) (7.1 Shpella, 7.2. Habitatet të tjera nëntokësore).
Ky lloj ndodhet kryesisht në pyje ahu dhe në shpella e habitate të tjera nëntokësore (Attems 1929).

Përhapja e përgjithshme

Kosovë, Maqedoni.

Përhapja në Kosovë

Luboten, Kaçanik (Attems 1929; Makarov et al. 2004).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme, për arsye se të dhënat e tanishme janë joadekuate për të vlerësuar drejtpërsëdrejti apo tërthorazi rrezikun e zhdukjes së llojit, bazuar në përhapjen e tij dhe/apo statusin e popullatës.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5. Përdorimi i burimeve biologjike (5.3. Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Disa gjetje të këtij lloji janë në kuadër të zonës së mbrojtur (Parku Kombëtar i Bjeshkëve të Sharrit) ku janë në funksion disa masa mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës, 1.2. Mbrojtja e burimeve dhe habitatit). 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Aktivitete jointensive pyjore.

Referencat

Attems 1929; Makarov et al. 2004; Vagalinski et al. 2015





Baetis nexus
Navàs, 1918

Insecta: Ephemeroptera: Baetidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Agim Gashi, Bardh Xërxa

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 8 – 11.6 mm. Është lloj bivoltin dimëror. Periudha e fluturimit të adultëve është nga maji deri në gusht (Bauernfeind & Soldan 2012; Sartori 2006).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza); 15 Artificiale - ujore (15.9 Kanale dhe drenazha, gropa).
Larvat gjenden zakonisht në ekosisteme ujore të lartësive të ulëta mbidetare, kryesisht në lumenj, por mund të hasen edhe në kanale artificiale ujore me shpejtësi shumë të ulët të ujit. Parapëlqejnë vendet me vegjetacion të zhytur ujor.

Përhapja e përgjithshme

Pjesa më e madhe e Europës, Turqi.

Përhapja në Kosovë

Përroskë në Slivovë.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Përhapja e njohur e këtij lloji në Kosovë është e panjohur si rezultat i njohurive të pamjaftueshme. Trendi i popullatës është i panjohur. Për shkak të mungesës së të dhënave, ky lloj vlerësohet në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme, sepse nuk ka pasur mundësi të vlerësohet për kategoritë e tjera.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)); 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Bauernfeind & Soldan 2012; Sartori 2006



Habrophlebia eldae
Jacob & Sartori, 1984

Insecta: Ephemeroptera: Leptophlebiidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Agim Gashi, Bardh Xërxa

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 5.5 deri 8 mm. Aspektet biologjike dhe ekologjike të këtij lloji akoma nuk janë të njohura mirë. Periudha e fluturimit është nga maji deri në korrik. Ky lloj e ka një gjeneratë në vit dhe gjatë dimrit i nënshtrohet diapauzës në formë larve (Bauernfeind & Soldan 2012).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Larvat parapëlqejnë lumenj dhe përroska me substrat me gurë, zhavorr dhe rërë. Ky lloj mund të gjendet në lartësi të ndryshme mbidetare, prej 20 deri në 1200 m.

Përhapja e përgjithshme

Bullgari, Greqi, Francë, Itali, Kosovë, Spanjë.

Përhapja në Kosovë

Përroskë në Blinajë.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Përhapja e këtij lloji është e panjohur si rezultat i njohurive të pamjaftueshme. Trendi i popullatës është i panjohur. Për shkak të mungesës së të dhënave, ky lloj klasifikohet në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme, sepse nuk ka pasur mundësi të vlerësohet për kategoritë e tjera.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)); 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Bauernfeind & Soldan 2012





Caliaeschna microstigma Schneider,1845

Insecta: Odonata: Aeshnidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Gati i Kërcënuar, NT

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj është një përfaqësues i vogël i familjes Aeshnidae, me madhësi totale të trupit prej 50 – 60 mm.

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) [5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat]).
Larvat e këtij lloji jetojnë në përroska me rrjedhje të shpejtë, që janë pjesërisht të hijezuara.

Përhapja e përgjithshme

Lloj mediterano-lindor, që shtrihet nga Ballkani deri në Azinë e Vogël, Levant dhe Iran, Turkmenistan.

Përhapja në Kosovë

Përroskë në afërsi të Liqenit të Vërmicës, Lumi Mirusha.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme, sepse nuk ka të dhëna të mjaftueshme për përhapjen e këtij lloji në Kosovë apo për trendin e popullatave të tij.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 7 Modifikimet e sistemeve natyrore [7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor [përdorimi në bujqësi]]; 9 Ndotja [9.3 Mbeturinat bujqësore dhe pyjore].

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur [Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit [1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës]; 5. Ligji dhe politikat [5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit].
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi [1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi [3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit].





Coenagrion ornatum Selys,1850

Insecta: Odonata: Coenagrionidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Gati i Kërcënuar, NT

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj ka madhësi tipike të trupit prej 30-31 mm. Periudha e fluturimit është prej majit deri në gusht.

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) [5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Ky lloj është i lidhur me burime të vogla, shpeshherë të diellëzuara mirë, pastaj përroska me fund me baltë dhe materie organike, si dhe me vegjetacion të dendur higrofil barishtor.

Përhapja e përgjithshme

Ky lloj është i përhapur nga Europa perëndimore, veriperëndimore dhe qendrore, deri në Europën lindore dhe juglindore, si dhe deri në Azinë e vogël dhe vendet e Kaukazit.

Përhapja në Kosovë

Përroskë në afërsi të Liqenit të Badovcit.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për popullatat e këtij lloji. Është gjetur me vetëm tre individë në një lokalitet të vetëm (Zhushi Etemi 2005).

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme, sepse nuk ka të dhëna të mjaftueshme për përhapjen e këtij lloji në Kosovë apo për trendin e popullatave të tij.

Kërcënimet

Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për kërcënimet ndaj këtij lloji.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur [Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit [1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës]; 5. Ligji dhe politikat [5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit].
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi [1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi [3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit].

Referencat

Zhushi Etemi 2005



Erythromma viridulum Charpentier, 1840

Insecta: Odonata: Coenagrionidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi

Të dhëna të përgjithshme

Ky është një lloj i madh i pilivesave me madhësi trupore deri në 29 mm. Stadi larvor zgjat një vit. Periudha e fluturimit të adultëve është prej majit deri në shtator.

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore [kontinentale] [5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat], 5.4. Këneta, moçale, moçalishte, 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza]; 15 Artificiale - ujore [15.9 Kanale dhe drenazha, kanale, gropa].
Jeton në një numër të konsiderueshëm të habitateve, si këneta, moçale, kanale apo lumenj me substrat të mjaftueshëm balte.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Azi, Afrikë.

Përhapja në Kosovë

Lumi Sitnica në Vragoli.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për popullatat e këtij lloji. Është gjetur me numër të vogël individësh [Zhushi Etemi 2005].

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme, sepse nuk ka të dhëna të mjaftueshme për përhapjen e këtij lloji në Kosovë apo për trendin e popullatave të tij.

Kërcënimet

Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për kërcënimet ndaj këtij lloji.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit [1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës]; 5. Ligji dhe politikat [5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit].
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi [1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia]; 3. Monitorimi [3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit].

Referencat

Zhushi Etemi 2005





Orthetrum brunneum Fonscolombe, 1837

Insecta: Odonata: Libellulidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e adultëve mbërrin deri në 45 mm dhe paraqiten nga qershori deri në gusht. Larvat e këtij lloji janë predatore. Përmbushja e ciklit jetësor zgjat dy deri në tre vjet.

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore [kontinentale] [5.1 Lumenj, përrenj, përroska të përhershme [përfshirë ujëvarat]]; 15 Artificiale - ujore [15.9 Kanale dhe drenazha, kanale, gropa].
Ky lloj parapëlqen përrenj të vegjël dhe kanale me ujë të ngrohtë dhe të shpejtë.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Azi, Afrikë Veriore.

Përhapja në Kosovë

Ligatina e Hencit.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme, sepse nuk ka të dhëna të mjaftueshme për përhapjen e këtij lloji në Kosovë apo për trendin e popullatave të tij.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 2 Bujqësia dhe akuakultura [2.1 Kulturat vjetore dhe shumëvjeçare jodrusore]; 9 Ndotja [9.3 Shkarkimet bujqësore dhe pyjore: 9.3.1 Ngarkesat me nutrientë].
Ky lloj është vëzhguar se ndikohet nga përdorimi i plehrave.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit [1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës]; 5. Ligji dhe politikat [5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit].
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi [1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia]; 3. Monitorimi [3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit].





Pyrrhosoma nymphula Sulzer, 1776

Insecta: Odonata: Coenagrionidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi

Të dhëna të përgjithshme

Ky është një lloj i madh i pilivesave me madhësi trupore deri në 36 mm. Stadi larvor zgjat dy vjet. Periudha e fluturimit të adultëve është prej prillit deri në shtator dhe zakonisht është ndër llojet e para të pilivesave që paraqitet herët në pranverë.

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) [5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat], 5.4 Këneta, moçale, moçalishte).
Jeton në moçale dhe këneta të vogla dhe në disa raste edhe në lumenj me rrjedhje të ngadaltë. Zakonisht, nuk gjenden në ujëra me rrjedhje të shpejtë.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Azi, Afrikë.

Përhapja në Kosovë

Lumi Sitnica në Vragoli.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për popullatat e këtij lloji. Është gjetur me numër të vogël të individëve (Zhushi Etemi 2005).

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme, sepse nuk ka të dhëna të mjaftueshme për përhapjen e këtij lloji në Kosovë apo për trendin e popullatave të tij.

Kërcënimet

Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për kërcënimet ndaj këtij lloji.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Zhushi Etemi 2005





Somatochlora meridionalis Nielsen, 1935

Insecta: Odonata: Corduliidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi

Të dhëna të përgjithshme

Gjatësia e trupit të këtij lloji është 50 deri 55 cm. Adultët paraqiten nga qershori deri në gusht.

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) [5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Larvat e këtij lloji jetojnë kryesisht në përroska të hijezuara mirë, edhe pse në disa ekosisteme ujore të lartësive më të mëdha mbidetare jeton edhe në zona të hapura me diell.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Turqi.

Përhapja në Kosovë

Blinajë.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme, sepse nuk ka të dhëna të mjaftueshme për përhapjen e këtij lloji në Kosovë apo për trendin e popullatave të tij.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër [11.2 Thatësirat].

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lokaliteti ku është gjetur ky I lloj është në kuadër të rezervatit të mbrojtur të gjuetisë.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).





Sympetrum depressiusculum Selys, 1841

Insecta: Odonata: Libellulidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
I Cenuar, VU

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi

Të dhëna të përgjithshme

Ky është ndër llojet më të lokalizuara dhe me aftësinë më të vogël të përhapjes nga gjinia Sympetrum. Madhësia e trupit është prej 29-34 mm. Periudha e fluturimit është nga maji deri në gusht.

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) [5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat]]; 15 Artificiale - ujore [15.9 Kanale dhe drenazha, gropa].
Ky lloj kryesisht gjendet në ujëra të cekëta dhe të ngrohta që nuk janë të hijezuara.

Përhapja e përgjithshme

Nga Europa deri në brigjet e Pacifikut në Azi.

Përhapja në Kosovë

Drini i Bardhë te Ura e Shenjtë.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Popullata e këtij lloji është e vogël.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme, sepse nuk ka të dhëna të mjaftueshme për përhapjen e këtij lloji në Kosovë apo për trendin e popullatave të tij. Me gjasë, ky lloj është i përhapur më shumë nga sa dihet tani, bazuar në të dhënat e vendeve përreth Kosovës.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial [1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit]; 7. Modifikimet e sistemeve natyrore [ndryshimet në menaxhimin e ujit]; 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër [11.1 Ndryshimi dhe modifikimi i habitatit].

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur [Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës / ujit [1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës]; 5. Ligji dhe politikat [5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit].
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi [1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia]; 3. Monitorimi [3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit].





Ampedus (Ampedus) aethiops Lacordaire, 1835

Insecta: Coleoptera: Elateridae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Gabor Mesaroš

Të dhëna të përgjithshme

Është një lloj saproksilik me madhësi mesatare (9.5-11.5 mm). Ky lloj biologjikisht është i lidhur me drunj të vdekur halorë. Larvat mund të gjenden në trungje dhe degë të rëna në tokë, kryesisht bredh, dhe më rrallë në pisha, duke u ushqyer me drurin e vdekur. Gjenerata zgjat 3-4 vjet. Adultët paraqiten prej gjysmës së majit deri në korrik. Zakonisht, mund të gjenden nën lëvozhgë, në çarjet e drunjve të kalbur ose në degët e poshtme të drunjve halorë, kurse gjatë fluturimit në skajet e pyjeve dhe mes të pyjeve.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje [1.4. Pyje të klimës mesatare].
Gjendet kryesisht në mjedise të ftohta dhe të lagështa të pyjeve halore.

Përhapja e përgjithshme

Europa qendrore, Europa juglindore, Turqi.

Përhapja në Kosovë

Koprivnik (Csiki 1940).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Prezenca e llojit në Kosovë është e bazuar në të dhëna historike nga viti 1917. Nevojiten të dhëna të mëtejme për vlerësim të llojit. Për shkak të mungesës së të dhënave, ky lloj vlerësohet në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial [1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit]; 5 Përdorimi i burimeve biologjike [5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lokaliteti ku është gjetur ky lloj është në kuadër të zonës së mbrojtur.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit [1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve); 2. Menaxhimi i tokës/ujit [2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi [1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia]; 3. Monitorimi [3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Promovimi i përdorimit të praktikave menaxhuese në pyje të orientuara kah konservimi, me reduktim të praktikës së prerjeve të tërësishme dhe sigurim të pranisë së drunjve të vdekur.

Referencat

Csiki 1940



Ampedus (Ampedus) nigroflavus Goeze, 1777

Insecta: Coleoptera: Elateridae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Gabor Mesaroš

Të dhëna të përgjithshme

Është një lloj saproksilik me madhësi mesatare të trupit (9-13 mm). Larvat ushqehen me pjesë të kalbura me ngjyrë të bardhë, të verdhë ose kafe të drunjve të gjallë (por më rrallë në pjesë të vdekura të trungjeve të rrëzuara) të gjinive: Populus, Salix, Tila, Ulmus, Betula, Alnus, Fagus, Quercus, Carpinus dhe Prunus.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare).
Gjendet në pyje të ndryshme gjetherënëse.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Afrikë Veriore, Azi.

Përhapja në Kosovë

Deçan (Csiki 1940).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është përfshirë në Listën e Kuqe të Koleopterave Saproksilike të Europës në kategorinë: Shqetësim më i Vogël. Prezenca e llojit në Kosovë është e bazuar në të dhëna historike nga viti 1917. Të dhëna të mëtejme janë të domosdoshme për të vlerësuar llojin. Për shkak të mungesës së të dhënave, lloji vlerësohet në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve); 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Promovimi i përdorimit të praktikave menaxhuese në pyje të orientuara kah konservimi, me reduktim të praktikës së prerjeve të tërësishme dhe sigurim të pranisë së drunjve të vdekur.

Referencat

Csiki 1940



Ampedus (Ampedus) aethiops Lacordaire, 1835

Insecta: Coleoptera: Elateridae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Gabor Mesaroš

Të dhëna të përgjithshme

Është një lloj saproksilik me madhësi mesatare (9.5-11.5 mm). Ky lloj biologjikisht është i lidhur me drunj të vdekur halorë. Larvat mund të gjenden në trungje dhe degë të rëna në tokë, kryesisht bredh, dhe më rrallë në pisha, duke u ushqyer me drurin e vdekur. Gjenerata zgjat 3-4 vjet. Adultët paraqiten prej gjysmës së majit deri në korrik. Zakonisht, mund të gjenden nën lëvozhgë, në çarjet e drunjve të kalbur ose në degët e poshtme të drunjve halorë, kurse gjatë fluturimit në skajet e pyjeve dhe mes të pyjeve.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare).
Gjendet kryesisht në mjedise të ftohta dhe të lagështa të pyjeve halore.

Përhapja e përgjithshme

Europa qendrore, Europa juglindore, Turqi.

Përhapja në Kosovë

Koprivnik (Csiki 1940).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Prezenca e llojit në Kosovë është e bazuar në të dhëna historike nga viti 1917. Nevojiten të dhëna të mëtejme për vlerësim të llojit. Për shkak të mungesës së të dhënave, ky lloj vlerësohet në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lokaliteti ku është gjetur ky lloj është në kuadër të zonës së mbrojtur.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve); 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Promovimi i përdorimit të praktikave menaxhuese në pyje të orientuara kah konservimi, me reduktim të praktikës së prerjeve të tërësishme dhe sigurim të pranisë së drunjve të vdekur.

Referencat

Csiki 1940



Ampedus (Ampedus) nigroflavus Goeze, 1777

Insecta: Coleoptera: Elateridae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Gabor Mesaroš

Të dhëna të përgjithshme

Është një lloj saproksilik me madhësi mesatare të trupit (9-13 mm). Larvat ushqehen me pjesë të kalbura me ngjyrë të bardhë, të verdhë ose kafe të drunjve të gjallë (por më rrallë në pjesë të vdekura të trungjeve të rrëzuara) të gjinive: Populus, Salix, Tila, Ulmus, Betula, Alnus, Fagus, Quercus, Carpinus dhe Prunus.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare).
Gjendet në pyje të ndryshme gjetherënëse.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Afrikë Veriore, Azi.

Përhapja në Kosovë

Deçan (Csiki 1940).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është përfshirë në Listën e Kuqe të Koleopterave Saproksilike të Europës në kategorinë: Shqetësim më i Vogël. Prezenca e llojit në Kosovë është e bazuar në të dhëna historike nga viti 1917. Të dhëna të mëtejme janë të domosdoshme për të vlerësuar llojin. Për shkak të mungesës së të dhënave, lloji vlerësohet në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve); 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Promovimi i përdorimit të praktikave menaxhuese në pyje të orientuara kah konservimi, me reduktim të praktikës së prerjeve të tërësishme dhe sigurim të pranisë së drunjve të vdekur.

Referencat

Csiki 1940



Ampedus (Ampedus) sanguineus Linnaeus, 1758

Insecta: Coleoptera: Elateridae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Gabor Mesaroš

Të dhëna të përgjithshme

Është lloj me madhësi mesatare (13-17.5 mm), me elitra me ngjyrë të kuqe të çelët. Larvat gjenden në trungje të drunjve të prerë apo të rënë nga të gjitha llojet e halorëve, veçanërisht në cungjet që gjenden në vende me diell. Femrat i lëshojnë vezët në korridore dhe tunele të koleopterëve saproksilikë, ku larva jeton si predatore dhe saprofage. Gjenerata në kushte të favorshme zgjat deri në 4 apo edhe deri në 5-6 vjet.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare).
Ky lloj gjendet në zonat malore të pyjeve halorë.

Përhapja e përgjithshme

Palearktik.

Përhapja në Kosovë

Kuqishtë.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është i përfshirë në Listën e Kuqe të Koleopterave Saproksilike të Europës në kategorinë: Shqetësim më i Vogël. Prezenca e llojit në Kosovë bazohet në vetëm një gjetje në vitin 2018. Të dhëna të mëtejme janë të nevojshme për vlerësim të llojit. Për shkak të mungesës së të dhënave, lloji vlerësohet në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lokaliteti ku është gjetur ky lloj është në kuadër të zonës së mbrojtur.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve); 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Promovimi i përdorimit të praktikave menaxhuese në pyje të orientuara kah konservimi, me reduktim të praktikës së prerjeve të tërësishme dhe sigurim të pranisë së drunjve të vdekur.



Ampedus (Ampedus) sanguinolentus Schrank, 1776

Insecta: Coleoptera: Elateridae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Gabor Mesaroš

Të dhëna të përgjithshme

Është një lloj saproksilik me madhësi mesatare (9-11.5 mm), me elitra me ngjyrë të kuqe të çelët, me dekorime karakteristike longitudinale të zeza në mes. Larvat jetojnë në pjesë të buta të drurit, në trungje të drunjve në kalbje e sipër, trupa të rënë dhe rrënjë të vdekura të drunjve gjetherënës. Kohëzgjatja e gjeneratës ndryshon dhe zgjat afërsisht deri në 4 vjet.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare).
Gjendet në lloje të ndryshme gjethegjera të pyjeve gjetherënëse.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Azi.

Përhapja në Kosovë

Runik (Csiki 1940).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është përfshirë në Listën e Kuqe të Koleopterave Saproksilike të Europës në kategorinë: Shqetësim më i Vogël. Prezenca e këtij lloji në Kosovë është e bazuar në të dhëna historike nga viti 1917 (Csiki 1940). Të dhëna të mëtejme janë të dosdoshme për vlerësim të llojit, prandaj vlerësohet në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve); 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Promovimi i përdorimit të praktikave menaxhuese në pyje të orientuara kah konservimi, me reduktim të praktikës së prerjeve të tërësishme dhe sigurim të pranisë së drunjve të vdekur.

Referencat

Csiki 1940



Cerambyx (Cerambyx) miles Bonelli, 1823

Insecta: Coleoptera: Cerambycidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Gati i Kërcënuar, NT

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Gabor Mesaroš

Të dhëna të përgjithshme

Ky është një lloj me madhësi të madhe trupore (41 – 55 mm), shumë i ngjashëm me llojin Cerambyx cerdo, me të cilin edhe haset shpesh së bashku dhe nga i cili dallon vetëm në pak karakteristika. Është shumë më i rrallë se ai. Zhvillimi i larvës ndodh në drunj të gjallë të pyjeve gjethegjera, me preferencë për ato të gjinisë Quercus, por gjithashtu edhe Amygdalus, Prunus, Malus, Pyrus, Crataegus, Carpinus dhe Vitis. Zhvillimi i tërësishëm i larvës zgjat përgjatë 3 – 5 vjetësh dhe kjo varet nga pozita, kushtet klimatike dhe cilësia e drurit.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare).
Gjendet kryesisht në kodra të pyllëzuara në lartësi të ulëta mbidetare, të shumtën në pyje lisi.

Përhapja e përgjithshme

Azerbejxhan, Armeni, Bosnjë-Hercegovinë, Bullgari, Francë, Greqi, Gjeorgji, Hungari, Itali, Kosovë, Kroaci, Maqedoni, Poloni, Rumani, Serbi, Sllovaki, Slloveni, Shqipëri, Zvicër, Turqi, Ukrainë.

Përhapja në Kosovë

Skivjan (Csiki 1940).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Prania e këtij lloji në Kosovë bazohet në të dhëna historike nga viti 1917. Hulumtime të mëtejme janë të nevojshme për të bërë vlerësimin adekuat të këtij lloji dhe prandaj, lloji vlerësohet në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Kontrolli i zhvillimit dhe ndërtimit të infrastrukturës turistike.

Referencat

Csiki 1940



Isorhipis melasoides Laporte, 1835

Insecta: Coleoptera: Eucnemidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Gabor Mesaroš

Të dhëna të përgjithshme

Është lloj saproksilik me madhësi mesatare të trupit (6.5-11 mm). Larvat ushqehen në pjesët e forta të drunjve në vendet e dëmtuara të trungjeve të drunjve të gjallë apo të atyre që sapo janë rrëzuar, të shumtën në ah, shkozë, bli e më pak në lis. Kulmi i aktivitetit të fazës së rritur është në periudhën qershor – korrik, kur mund të shihet në degë ose shkurre në afërsi të drunjve amvisë.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare).
Gjendet në lloje të ndryshme të pyjeve gjetherënëse.

Përhapja e përgjithshme

Austri, Bosnjë-Hercegovinë, Bullgari, Çeki, Francë, Gjermani, Hungari, Itali, Kosovë, Kroaci, Poloni, Rumani, Serbi, Sllovaki, Suedi, Turqi.

Përhapja në Kosovë

Gërmi.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është i përfshirë në Listën e Kuqe të Koleopterave Saproksilike të Europës në kategorinë: Shqetësim më i Vogël. Prezenca e llojit në Kosovë është e bazuar në një gjetje të vetme të vitit 2018. Të dhëna të mëtejme janë të domosdoshme për të vlerësuar llojin. Në mungesë të të dhënave, lloji vlerësohet në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve); 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Promovimi i përdorimit të praktikave menaxhuese në pyje të orientuara kah konservimi, me reduktim të praktikës së prerjeve të tërësishme dhe sigurim të pranisë së drunjve të vdekur.



Lichenophanes varius Illiger, 1801

Insecta: Coleoptera: Bostrichidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Gati i Kërcënuar, NT

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Gabor Mesaroš

Të dhëna të përgjithshme

Është një lloj me madhësi mesatare 8-12 mm. Imagot shfaqen në maj dhe qershor dhe mbajnë një mënyrë të fshehtë të jetës gjatë ditës, duke u fshehur në çarje të pemëve, nën lëvoren e drunjve ose në kanalet e koleopterëve të tjerë. Larvat e tyre saproksilofage zhvillohen në drunj të vdekur të llojeve të ndryshme. Femrat vendosin vezët në çarjet e drunjve të vdekur, kryesisht të pyjeve gjethembajtëse. Larvat ushqehen në dru të fortë dhe të kalbur, duke shpuar kanale në drejtime të ndryshme, deri në një thellësi prej rreth 2 cm. Pas dimërimit, ato pupojnë në fund të prillit dhe në maj. Faza e pupës zgjat dy javë.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4 Pyje të klimës mesatare).
Jetojnë në pyje gjethegjera të vjetra ose të paktën të mbrojtura mirë.

Përhapja e përgjithshme

I përhapur në pjesën më të madhe të Europës, Afrikë veriore, Azi.

Përhapja në Kosovë

Gjakovë (Csiki 1940).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj vlerësohet në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme, për shkak të mungesës së të dhënave për përhapjen në Kosovë apo trendin e popullatës. Ekziston vetëm një regjistrim i vjetër nga afërsia e Gjakovës në bazë të materialit të mbledhur gjatë vitit 1917, kurse nuk është gjetur viteve të fundit.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.3 Zona turistike dhe rekreative) 5 Përdorimi i resurseve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve); 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës).
Promovimi i përdorimit të praktikave menaxhuese në pyje të orientuara kah konservimi, me reduktim të praktikës së prerjeve të tërësishme dhe sigurim të pranisë së drunjve të vdekur.

Referencat

Csiki 1940



Molorchus (Molorchus) kiesenwetteri Mulsant & Rey, 1861

Insecta: Coleoptera: Cerambycidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Gabor Mesaroš

Të dhëna të përgjithshme

Është lloj me madhësi të vogël (5-7 mm). Është lloj saproksilik, larvat e të cilit zhvillohen në degë të holla. Adultët janë aktivë nga maji deri në korrik në degë të pyjeve gjetherënëse dhe halore por gjithashtu edhe në lulet e Umbelliferae-ve.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare).
Gjendet brenda pyjeve gjetherënëse dhe halore prej ultësirave deri në 1800 m.

Përhapja e përgjithshme

Europa qendrore, Europa juglindore, në lindje deri në Uralet jugore dhe Azia qendrore.

Përhapja në Kosovë

Mitrovicë (Csiki 1940).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Lloji përfshihet në Listën e Kuqe të Koleopterave Saproksilike të Europës nën kategorinë Të Dhëna të Pamjaftueshme (Nieto dhe Alexander 2010). Prania në Kosovë bazohet në të dhënat historike të vitit 1917. Nevojiten të dhëna të mëtejshme për vlerësimin e këtij lloji, prandaj klasifikohet në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve); 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Promovimi i përdorimit të praktikave menaxhuese në pyje të orientuara kah konservimi, me reduktim të praktikës së prerjeve të tërësishme dhe sigurim të pranisë së drunjve të vdekur.

Referencat

Csiki 1940; Nieto and Alexander 2010



Mycetophagus (Ulolendus) atomarius Fabricius, 1787

Insecta: Coleoptera: Bostrichidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Gabor Mesaroš

Të dhëna të përgjithshme

Është një lloj me madhësi të vogël (4-4.5 mm). Imagot mund të gjenden në pjesën frutore të kërpudhave arboreale (Daldinia concentrica, Kretzschmaria deusta, Ganoderma applanatum, Pluteus cervinus etj.), të cilat rriten në trungje të vdekura apo cungje të drunjve gjetherënës ose halorë.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare).
Banon zonat malore të pyjeve gjetherënëse dhe halore.

Përhapja e përgjithshme

Europë; Turqi.

Përhapja në Kosovë

Zhleb (Csiki 1940).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është përfshirë në Listën e Kuqe të Koleopterave Saproksilike në kategorinë: Shqetësim më i Vogël. Ky lloj vlerësohet në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme, pasi që prezenca e llojit në Kosovë është e bazuar në të dhëna historike nga viti 1917. Të dhëna të mëtejme janë të domosdoshme për vlerësim të llojit.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve); 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Promovimi i përdorimit të praktikave menaxhuese në pyje të orientuara kah konservimi, me reduktim të praktikës së prerjeve të tërësishme dhe sigurim të pranisë së drunjve të vdekur.

Referencat

Csiki 1940



Osmoderma barnabita Motschulsky, 1845

Insecta: Coleoptera: Cerambycidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Gabor Mesaroš

Të dhëna të përgjithshme

Është një lloj relativisht i madh (28-32 mm), i detyrueshëm saproksilik. Prania e tij është e kufizuar në pjesën e brendshme të drunjve, që janë duke u shpërbërë, te llojet e ndryshme gjetherënëse (nga gjinitë Quercus, Salix, Fagus, Malus, Prunus Pyrus, dhe Tilia) dhe në vende pyjore të hapura me drunj të vjetër, por edhe në peizazhe tradicionale kulturore. Ky lloj ka një kapacitet të përhapjes shumë të vogël, duke qenë edhe fluturues i dobët, prandaj veçoritë lineare të habitatit janë të rëndësishme për të mbajtur ndërlidhjen dhe vijimësinë e popullatave. Larvat zhvillohen përgjatë një periudhe deri në dy vjet ose edhe më gjatë, kur kushtet nuk janë optimale për zhvillim.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare).
Gjendet në drunjtë e vjetër të llojeve gjetherënëse të cilat kanë zona boshe brenda tyre, kryesisht në pyje ahu.

Përhapja e përgjithshme

E përhapur gjithandej në Europë.

Përhapja në Kosovë

Pejë (Mikšič 1955).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky vlerësim është i bazuar në vetëm një gjetje nga viti 1950. Gjatë hulumtimit në teren në vitin 2018, nuk është gjetur, por janë vëzhguar disa drunj me zona boshe brenda tyre në Bjeshkët e Nemuna dhe Sharr. Ky lloj i habitatit në Kosovë është nën presion, prandaj është e nevojshme që në të ardhmen ti kushtohet rëndësi këtij llloji. Për shkak të mungesës së të dhënave, lloji vlerësohet në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve); 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Promovimi i përdorimit të praktikave menaxhuese në pyje të orientuara kah konservimi, me reduktim të praktikës së prerjeve të tërësishme dhe sigurim të pranisë së drunjve të vdekur.

Referencat

Mikšič 1955





Peltis grossa Linnaeus, 1758

Insecta: Coleoptera: Trogossitidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Gabor Mesaroš

Të dhëna të përgjithshme

Është një lloj i madh (11-19 mm), me ngjyrë kafe të errët drejt të zezës. Larvat jetojnë në pjesën e butë, në kalbje e sipër të drunjve gjetherënës apo halorë, të infektuar me kërpudha, si p.sh., në pjesët e poshtme të drunjve të vjetër apo në cungjet e tyre. Zhvillimi i këtij lloji zgjat 2-3 vjet.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare).
Gjendet në habitate të ndryshme të pyjeve (gjetherënëse, të përziera dhe halore), të cilat kanë numër të madh të drunjve që kalben.

Përhapja e përgjithshme

Lloj europian i përhapur prej Spanjës deri në Siberinë perëndimore dhe nga Skandinavia deri në Turqi dhe Transkaukazi.

Përhapja në Kosovë

Luboten (Procházka et al. 2017).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Prezenca e këtij lloji në Kosovë bazohet në të dhëna historike nga viti 1930. Të dhëna të mëtejme janë të domosdoshme për të vlerësuar llojin, prandaj klasifikohet në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve); 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Promovimi i përdorimit të praktikave menaxhuese në pyje të orientuara kah konservimi, me reduktim të praktikës së prerjeve të tërësishme dhe sigurim të pranisë së drunjve të vdekur.

Referencat

Procházka et al. 2017



Penichroa fasciata Stephens, 1831

Insecta: Coleoptera: Cerambycidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Gabor Mesaroš

Të dhëna të përgjithshme

Është lloj me madhësi të vogël të trupit (6-15 mm). Është lloj saproksilik. Larvat zhvillohen në degët e një numri të madh të llojeve gjetherënëse (Juglans, Ficus, Populus, Prunus, Castanea, Ceratonia, Quercus). Gjenerata zgjat 2 deri në 3 vjet.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare).
Kryesisht gjendet në pyjet gjetherënëse dhe të përziera termofile.

Përhapja e përgjithshme

I përhapur gjerësisht në Palearktikun perëndimor.

Përhapja në Kosovë

Pejë (Csiki 1940).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është përfshirë në Listën e Kuqe të Koleopterave Saproksilike të Europës, në kategorinë: Shqetësim më i Vogël. Prezenca në Kosovë është e bazuar në të dhëna historike nga viti 1917. Të dhëna të tjera janë të nevojshme për vlerësim adekuat të llojit, prandaj klasifikohet në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve); 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Promovimi i përdorimit të praktikave menaxhuese në pyje të orientuara kah konservimi, me reduktim të praktikës së prerjeve të tërësishme dhe sigurim të pranisë së drunjve të vdekur.

Referencat

Csiki 1940



Protamaurops serbicus Karaman, 1961

Insecta: Coleoptera: Staphylinidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Gabor Mesaroš

Të dhëna të përgjithshme

Është një lloj shumë i vogël (krejt pak më shumë se 2 mm). Aspektet ekologjike të llojit nuk janë të njohura.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare).
Jeton në shtresën në shpërbërje e sipër të gjetheve në pyjet e ahut.

Përhapja e përgjithshme

Kosovë.

Përhapja në Kosovë

Kaçanik (Karaman 1961).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është gjetur dhe zbuluar në grykën e Kaçanikut në vitin 1961 dhe më nuk është gjetur asnjëherë. Në katalogë trajtohet si lloj stenoendemik i Kosovës. Nevojiten të dhëna të tjera për të vlerësuar këtë lloj. Për shkak të mungesës së të dhënave, lloji vlerësohet në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Karaman 1961



Rosalia (Rosalia) alpina Linnaeus, 1758

Insecta: Coleoptera: Cerambycidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
I Cenuar, VU

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Gabor Mesaroš

Të dhëna të përgjithshme

Është një lloj i madh (18-38 mm), me ngjyra të bukura dhe haset kryesisht në pyje të vjetra të ahut. Është lloj i detyrueshëm saproksilik. Është shumë i përhapur, por i rrallë dhe me dendësi të vogël. Cikli i zhvillimit të larvës, që ndodh në drunj të vdekur dhe pjesë të kalbura të drunjve të vjetër ose të gjallë të gjinisë Fagus, zgjat të paktën tre vjet. Të rriturit shfaqen në mot të ngrohtë dhe me diell, nga mesi i Qershorit dhe deri në fillim të Shtatorit, me intensitetin më të lartë në Korrik dhe Gusht, kur ato mund të shihen gjatë fluturimit. Larvat ushqehen në drunj të vdekur në shpërbërje e sipër.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare).
Haset në pyje ahu në lartësi deri në 1500 m.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Afrikë Veriore, Azi.

Përhapja në Kosovë

Koprivnik, Brezovicë.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ka disa të dhëna të viteve të fundit nga Kosova për këtë lloj, por janë të nevojshme të dhëna më të shumta për një vlerësim adekuat, prandaj tash për tash vlerësohet në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës / ujit (1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve); 2. Menaxhimi i tokës / ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit / zonës)
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit)
Promovimi i përdorimit të praktikave menaxhuese në pyje të orientuara kah konservimi, me reduktim të praktikës së prerjeve të tërësishme dhe sigurim të pranisë së drunjve të vdekur.





Triplax aenea Schaller, 1783

Insecta: Coleoptera: Erotylidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Gabor Mesaroš

Të dhëna të përgjithshme

Është një lloj me madhësi të vogël (3.3-4.3 mm). Format larvore, por edhe ato të rritura, jetojnë në kërpudha (p.sh., Pleurotus corticatus, Fomes fomentarius), të cilat zhvillohen në lëvozhgën e trungjeve dhe në degët e disa drunjve. Nganjëherë gjenden edhe në kërpudha, të cilat i sulmojnë pyjet halore.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare).
Ky lloj gjendet në zonat malore të pyjeve gjetherënëse dhe të përziera.

Përhapja e përgjithshme

Palearktik.

Përhapja në Kosovë

Zhleb (Csiki 1940).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është përfshirë në Listën e Kuqe të Koleopterave Saproksilike të Europës në kategorinë: Shqetësim më i Vogël. Prezenca e këtij lloji në Kosovë bazohet në të dhëna historike nga viti 1917. Të dhëna të mëtejme janë të domosdoshme për vlerësim të llojit, prandaj klasifikohet në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve); 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Promovimi i përdorimit të praktikave menaxhuese në pyje të orientuara kah konservimi, me reduktim të praktikës së prerjeve të tërësishme dhe sigurim të pranisë së drunjve të vdekur.

Referencat

Csiki 1940



Triplax scutellaris Charpentier, 1825

Insecta: Coleoptera: Erotylidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Gabor Mesaroš

Të dhëna të përgjithshme

Është një lloj me madhësi të vogël (4.5-5.5 mm). Gjendet në trupin e kërpudhave parazite, të cilat rriten në drunj të vjetër të ahut, panjës dhe thuprës.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare).
Haset në pyje të ndryshme gjetherënëse të llojeve gjethegjera.

Përhapja e përgjithshme

Palearktik.

Përhapja në Kosovë

Gërmi.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është përfshirë në Listën e Kuqe të Koleopterave Saproksilike të Europës në kategorinë: Shqetësim më i Vogël. Prezenca e llojit në Kosovë është e bazuar në një gjetje të vetme në vitin 2018. Të dhëna të mëtejme janë të nevojshme për të bërë vlerësimin e llojit. Për shkak të mungesës së të dhënave, lloji vlerësohet në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve); 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Promovimi i përdorimit të praktikave menaxhuese në pyje të orientuara kah konservimi, me reduktim të praktikës së prerjeve të tërësishme dhe sigurim të pranisë së drunjve të vdekur.



Xylotrechus (Xylotrechus) arvicola Olivier, 1795

Insecta: Coleoptera: Cerambycidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Gabor Mesaroš

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e formave të rritura varet shumë nga kushtet e zhvillimit të larvës dhe mund të jetë prej 8 – 20 mm. Është lloj saproksilik. Larvat zhvillohen në trungje dhe degë të dëmtuara ose drunj me sëmundje. Si drunj amvisë mund të jenë ata të gjinive: Quercus, Fagus, Ulmus, Tilia, Populus, Carpinus, Pirus, Castanea dhe Crataegus. Gjenerata zgjat 2 vjet.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare).
Gjendet në pyje të ndryshme gjetherënëse.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Turqi, Afrikë veriore.

Përhapja në Kosovë

Koprivnik (Csiki 1940).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është përfshirë në Listën e Kuqe të Koleopterave Saproksilike të Europës si: Shqetësim më i Vogël. Prezenca në Kosovë është e bazuar në të dhëna historike nga viti 1917. Të dhëna të mëtejme janë të domosdoshme për të bërë vlerësimin e llojit, prandaj vlerësohet në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lokaliteti ku është gjetur ky lloj është në kuadër të zonës së mbrojtur.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve); 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Promovimi i përdorimit të praktikave menaxhuese në pyje të orientuara kah konservimi, me reduktim të praktikës së prerjeve të tërësishme dhe sigurim të pranisë së drunjve të vdekur.

Referencat

Csiki 1940



Boreus westwoodi Hagen, 1866

Insecta: Mecoptera: Boreidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi, Astrit Bilalli

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj i takon familjes së vogël të Mecoptera-ve, që shquhen për aktivitetin e tyre gjatë muajve të dimrit në lartësi të mëdha mbidetare në hemisferën veriore. Krahët i kanë të vegjël ose mungojnë. Ushqehen me myshqe gjatë fazës larvore dhe adulte (Ibrahimi et al. 2016).

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare).

Përhapja e përgjithshme

Bosnjë-Hercegovinë, Çeki, Finlandë, Gjermani, Itali, Lituani, Rusi, Kosovë, Kroaci, Norvegji, Poloni, Sllovaki, Sllloveni, Suedi.

Përhapja në Kosovë

Brezovicë.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Në Kosovë është konstatuar në vetëm 1 lokalitet me 2 individë.

Arsyetimi i vlerësimit

Përhapja e këtij lloji nuk është e njohur mirë. Trendi i popullatës është i panjohur. Për shkak të mungesës së të dhënave, ky lloj klasifikohet në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Ibrahimi et al. 2016





Rhypholophus bifurcatus Goetghebuer, 1920

Insecta: Diptera: Limoniidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Agim Gashi, Astrit Bilalli, Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Larvat zhvillohen në drunj të kalbur, në tokë me lagështi përgjatë rrjedhave ujore dhe nën mbeturina të gjetheve. Format adulte hasen nga fundi i verës dhe përgjatë vjeshtës, në vegjetacion përgjatë rrjedhave ujore. Nuk ka të dhëna të mjaftueshme rreth biologjisë së tyre. Është lloj i rrallë dhe ka përhapje të kufizuar (Oosterbroek & Dek 2013).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).

Përhapja e përgjithshme

Austri, Belgjikë, Britani, Bullgari, Çeki, Francë, Greqi, Gjermani, Hungari, Holandë, Itali, Kosovë, Lituani, Rusi, Sllovaki, Zvicër, Ukrainë.

Përhapja në Kosovë

Përroskë në Stanqiq, Gajre.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Në Kosovë është konstatuar në vetëm disa lokalitete me numër të vogël të individëve.

Arsyetimi i vlerësimit

Përhapja e njohur e këtij lloji është e shkëputur, por, me gjasë kjo vjen si rezultat i njohurive të pamjaftueshme. Trendi i popullatës është i panjohur. Për shkak të mungesës së të dhënave, ky lloj klasifikohet në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme. Me gjasë, ky lloj është i përhapur në Kosovë më shumë se sa dihet tani.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)); 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Oosterbroek & Dek 2013



Tipula (Savtshenkia) benesignata Mannheims, 1954

Insecta: Diptera: Tipulidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Agim Gashi, Astrit Bilalli, Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj ka krahë me ngjyrë ari dhe me ekstremitete të gjata. Ngjyra e trupit është kafe e çelët. Format larvore ushqehen me myshqe, që jetojnë nën mbulesën e pyllit, ndërsa format adulte jetojnë në pyje me lagështi (Savchenko 1964).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Gjendet kryesisht në zona pyjore me lagështi dhe vegjetacion përgjatë rrjedhave ujore.

Përhapja e përgjithshme

Austri, Belgjikë, Çeki, Finlandë, Francë, Kroaci, Greqi, Gjermani, Hungari, Itali, Kosovë, Luksemburg, Norvegji, Mali i Zi, Rumani, Rusi, Sllovaki, Slloveni, Serbi, Suedi, Zvicër, Ukrainë.

Përhapja në Kosovë

Përroskë në Dërmjak, Përroskë në Gajre.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Në Kosovë është konstatuar në vetëm disa lokalitete me një numër të vogël të individëve.

Arsyetimi i vlerësimit

Përhapja e njohur e këtij lloji është e shkëputur, por, me gjasë kjo vjen si rezultat i njohurive të pamjaftueshme. Trendi i popullatës është i panjohur. Për shkak të mungesës së të dhënave. ky lloj klasifikohet në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme. Me gjasë, ky lloj është i përhapur në Kosovë më shumë se sa dihet tani.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)]; 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet]; 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Savchenko 1964



Agrypnia varia Fabricius, 1793

Insecta: Trichoptera: Phrygaenidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 12 deri në 19 mm. Është ndër llojet me madhësinë më të madhe nga llojet e Trichopterave në Ballkan. Në fazën larvore jeton në ujë përgjatë një viti. Ka valencë të gjerë ekologjike. Ushqehet si gërryes, copëtues dhe predator. Faza adulte paraqitet në periudhën pranverore. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë, në afërsi të brigjeve të ujit (Graf et al. 2008; Kumanski 1985). Është lloji i vetëm i familjes Phrygaenidae, që gjendet në Kosovë.

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Është limnobiont dhe haset në ujëra të rrjedhshme dhe të ndenjura. Substrat i preferuar i larvave të këtij lloji është zhavorri i madhësive të ndryshme, balta, grimcat e materieve organike etj.

Përhapja e përgjithshme

Austri, Belgjikë, Bullgari, Bosnjë-Hercegovinë, Britani e Madhe, Rusi, Çeki, Danimarkë, Estoni, Francë, Gjermani, Greqi, Hungari, Irlandë, Itali, Iran, Kosovë, Kroaci, Letoni, Lihtenshtajn, Lituani, Luksemburg, Maqedoni, Moldavi, Norvegji Poloni, Portugali, Rumani, Sllovaki, Slloveni, Spanjë, Suedi, Holandë, Serbi, Turqi, Zvicër.

Përhapja në Kosovë

Lumi Ibër në Koshtovë.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Përhapja e këtij lloji nuk është mjaft e njohur. Trendi i popullatës është i panjohur. Për shkak të mungesës së të dhënave, ky lloj vlerësohet në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme. Me gjasë, ky lloj është i përhapur në Kosovë më shumë se sa dihet tani, bazuar edhe në të dhënat nga vendet përreth.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve); 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)]; 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet]; 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit).
Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj, janë: humbja dhe degradimi i habitateve, shpyllëzimi, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Graf et al. 2008; Kumanski 1985





Beraea pullata Curtis, 1834

Insecta: Trichoptera: Beraeidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Ky lloj nuk është vlerësuar nga IUCN.

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Halil Ibrahimi

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e krahëve të përparmë të këtij lloji është prej 5 deri në 6 mm. Në fazën larvore jeton në ujë përgjatë një viti. Në aspektin e të ushqyerit, larvat e këtij lloji kryesisht ushqehen si gërryes. Faza adulte paraqitet në periudhën maj - gusht. Si adult jeton për disa ditë deri në disa javë, në afërsi të brigjeve të përroskës apo lumit (Graf et al. 2008; Kumanski 1988).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza).
Gjendet kryesisht në përroska të vogla malore. Substrat i preferuar i larvave të këtij lloji janë skajet e trupave ujorë dhe mjediset e lagështa afër tyre. Zakonisht gjendet në lartësi të mëdha mbidetare.

Përhapja e përgjithshme

Austri, Bullgari, Bjellorusi, Belgjikë, Bosnjë-Hercegovinë, Kroaci, Çeki, Danimarkë, Estoni, Finlandë, Francë, Gjermani, Greqi, Hungari, Irlandë, Itali, Kosovë, Mali i Zi, Holandë, Letoni, Lituani, Luksemburg, Poloni, Portugali, Rusi, Norvegji, Rumani, Sllovaki, Slloveni, Spanjë, Suedi, Shqipëri, Zvicër.

Përhapja në Kosovë

Përroskë në Bjeshkën e Lloqanit

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Në Kosovë është konstatuar në vetëm 1 lokalitet me një numër të vogël të individëve.

Arsyetimi i vlerësimit

Përhapja e këtij lloji nuk është e njohur, por me gjasë ky është rezultat i hulumtimeve të pamjaftueshme. Trendi i popullatës është i panjohur. Si rezultat i mungesës së të dhënave, ky lloj vlerësohet në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme. Me gjasë, lloji është i përhapur në Kosovë më shumë nga sa dihet deri tani, bazuar edhe në të dhënat e vendeve përreth Kosovës.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi i ujit/përdorimi: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri), 7.2.3 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në bujqësi)]; 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane: 9.1.1 Kanalizimet]; 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit]. Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj, janë: humbja dhe degradimi i habitateve, ndotja e ujërave dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i tyre, aktivitetet rekreative dhe turistike të menaxhuara në mënyrë të paqëndrueshme, si dhe përhapja e kufizuar dhe densiteti i ulët.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Graf et al. 2008; Kumanski 1988



Brenthis ino Rottemburg, 1775

Insecta: Lepidoptera: Nymphalidae

Flatrargjenda vjollce

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj bën pjesë në grupin e llojeve me madhësi mesatare. E ka gjerësinë e krahëve prej 34 deri në 42 mm. Pjesa e sipërme e krahëve të përparmë është e dominuar nga ngjyra e portokalltë. Ky lloj e ka një gjeneratë në vit. Adultët fluturojnë në periudhën qershor-korrik. Larvat ushqehen me bimët që u takojnë gjinive: Filipendula, Rubus, Aruncus dhe Sanguisorba.

Habitati

Lloji i habitatit: 1 Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare); 4. Kullosa; 5 Vende ujore (kontinentale) (5.4 Moçale, këneta, moçalishte (përgjithësisht mbi 8ha)].
Ky lloj mund të haset në lartësi të ndryshme mbidetare, prej nivelit të detit e deri në mbi 2000 metra. Në Kosovë haset në vende të hijezuara në prani të lumenjve.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Azi.

Përhapja në Kosovë

Bogë.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për popullatat e këtij lloji.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme, sepse nuk ka të dhëna të bollshme për përhapjen e tij në Kosovë apo për trendin e popullatave të tij. Me gjasë, ky lloj është i përhapur më shumë nga sa dihet tani, bazuar në të dhënat e vendeve përreth Kosovës.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 2. Bujqësia dhe akuakultura; Modifikimet e sistemeve natyrore (7.3 Modifikimet e tjera të ekosistemit); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Modifikimi dhe ndryshimi i habitatit).
Ky lloj është vëzhguar të jetë i ndjeshëm ndaj braktisjes së tokave bujqësore dhe fragmentimit të habitatit.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Habitatet e këtij lloji në Bjeshkët e Nemuna janë të mbrojtura ligjërisht.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).



Limenitis populi Linnaeus, 1758

Insecta: Lepidoptera: Nymphalidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi

Të dhëna të përgjithshme

Është një flutur relativisht e madhe. E ka gjerësinë e krahëve prej 57 deri në 90 mm. Sikur shumica e llojeve të gjinisë Limenitis, edhe ky lloj i ka krahët e përparmë me ngjyrë të zezë dhe me njolla të bardha. Ky lloj e ka një gjeneratë në vit. Adultët fluturojnë prej majit deri në qershor. Larvat ushqehen me bimët që i takojnë gjinisë Populus. Larvat dimërojnë në hibernukulum.

Habitati

Lloji i habitatit: 1 Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare).

Përhapja e përgjithshme

Europë, pjesërisht Azi.

Përhapja në Kosovë

Grykë e Kaçanikut, Milishevc (Jakšić 1998; Jakšić 2003).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për popullatat e këtij lloji.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme, sepse nuk ka të dhëna të mjaftueshme për përhapjen e këtij lloji në Kosovë apo për trendin e popullatave të tij. Me gjasë, ky lloj është i përhapur më shumë nga sa dihet deri tani, bazuar në të dhënat e vendeve përreth Kosovës.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 2. Bujqësia dhe akuakultura (2.3. Blegtoria dhe fermat: 2.3.2 Kullotja e vogël, fermat apo bujqësia); 5. Përdorimi i burimeve biologjike (5.3. Prerja dhe vjelja e pyjeve); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.1 Modifikimi dhe ndryshimi i habitatit, 11.2 Thatësirat).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura). Habitatet e këtij lloji janë të mbrojtura në parqet kombëtare Bjeshkët e Nemuna dhe Sharri.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4.2 Niveli kombëtar).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Jakšić 1998; Jakšić 2003



Melitaea aurelia Nickerl, 1850

Insecta: Lepidoptera: Nymphalidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Gati i Kërcënuar, NT

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi

Të dhëna të përgjithshme

Gjatësia e krahëve të meshkujve nga baza deri në maje është 14 deri në 16 mm. Pjesa e sipërme e krahëve të përparmë është ngjyrë kafe e errët, me nuanca të zeza dhe të bardha. Ky lloj e ka një gjeneratë në vit. Adultët paraqiten në periudhën qershor-korrik. Bimë ushqyese e larvave të këtij lloji është Plantago lanceolata.

Habitati

Lloji i habitatit: 3. Shkurre; 4. Kullosa.
Në Kosovë haset shpesh në lëndina të hapura dhe të pasura me lule.

Përhapja e përgjithshme

Europë qendrore dhe lindore, Turqi, Transkaukaz, Urale jugore, Kazakistan verior, Siberi perëndimore deri në Tian Shan.

Përhapja në Kosovë

Mirushë, Gërmi (Jakšić 1998; Jakšić 2003; Zhushi et al. 2017).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Është hasur në nënpopullata me kampionë individualë.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme, sepse nuk ka të dhëna të mjaftueshme për përhapjen e këtij lloji në Kosovë. Me gjasë, ky lloj është i përhapur më shumë nga sa dihet tani, bazuar në të dhënat e vendeve përreth Kosovës.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 2 Bujqësia dhe akuakultura (2.3 Blegtoria dhe fermat: 2.3.2 Kullotja e shkallës së vogël, fermat ose bujqësia); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.3 Modifikimet e tjera të ekosistemit).
Ky lloj është vëzhguar të jetë i ndikuar nga praktika e braktisjes së tokave dhe kositja.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Jakšić 1998; Jakšić 2003; Zhushi et al. 2017



Neptis sappho Pallas, 1771

Insecta: Lepidoptera: Nymphalidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj e ka gjerësinë e krahëve prej 44 deri në 48 mm. Ky lloj ka midis 2 dhe 4 gjenerata për vit. Zhvillimi ndodh shumë shpejt gjatë verës. Të rriturit paraqiten në periudhën prill – shtator.

Habitati

Lloji i habitatit: 1 Pyje [1.4. Pyje të klimës mesatare].
Në Kosovë është hasur shpesh në zona me pyje gjetherënëse, sidomos kur janë në afërsi të ekosistemeve të ujërave të ëmbla.

Përhapja e përgjithshme

Europë lindore: nga Italia verilindore dhe jugu i Austrisë në lindje deri në Rumani dhe lokalisht në jug të Ballkanit dhe veri të Greqisë.

Përhapja në Kosovë

Malet e Drenicës, Grykë e Rugovës.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për popullatat e këtij lloji.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme, sepse nuk ka të dhëna të bollshme për përhapjen e tij në Kosovë. Me gjasë, ky lloj është i përhapur më shumë nga sa dihet deri tani, bazuar në të dhënat e vendeve përreth Kosovës.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5. Përdorimi i burimeve biologjike [5.3. Prerja dhe vjelja e pyjeve]; 6. Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore [6.1 Aktivitetet rekreative]; 7 Modifikimet e sistemeve natyrore [7.1 Zjarrfikësit dhe zjarrfikësit]; 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër [11.1 Modifikimi dhe ndryshimi i habitatit].

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit [1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës]; 5. Ligji dhe politikat [5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit].
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi [1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia]; 3. Monitorimi [3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit].



7.7 ACTINOPTERYGII

Gobio bulgaricus Drensky, 1926

Actinopterygii: Cypriniformes: Cyprinidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Linda Grapci Kotori

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj është zbuluar fillimisht nga Bullgaria, prej nga e ka marrë edhe emrin. Më vonë është konstatuar edhe në mjedise të tjera në kontinentin europian dhe më gjerë. Rritet deri ne 9 cm (Freyhoff and Kottelat 2008).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat)).
Ky lloj haset kryesisht në ujëra me rrjedhje të ngadaltë dhe me substrat ranor.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Turqi.

Përhapja në Kosovë

Lumi Nerodime tek bifurkacioni.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Përhapja e njohur e këtij lloji është e pakompletuar si rezultat i hulumtimeve të pamjaftueshme. Trendi i popullatës është i panjohur. Për shkak të mungesës së të dhënave, këtë lloj e klasifikojmë në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane, 9.4 Mbeturinat dhe mbetjet e ngurta); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.2 Thatësirat).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Freyhoff and Kottelat 2008



Leucaspius delineatus Heckel, 1843

Actinopterygii: Cypriniformes: Cyprinidae

Gjuca

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Ferdije Zhushi Etemi

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj ka trup të zgjatur dhe pak të shtypur dorzoventralisht. Buzët i ka karakteristike sepse janë mjaft të fryra. Ka ngjyrë të argjendtë të trupit dhe rritet deri në 12 cm. Ushqehet me material me origjinë bimore, por edhe me larva të insekteve dhe gaforrëza. Është relativisht tolerant ndaj ndryshimeve të temperaturës dhe mungesës së oksigjenit. Shumohet gjatë muajve qershor dhe korrik. Jeton deri në 2 vjet (Kottelat and Freyhof 2007).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat), 5.4 Këneta, moçale, moçalishte, 5.5 Liqene të përhershme të ujërave të ëmbla).
Gjendet kryesisht në rrjedhat e poshtme të lumenjve dhe në ujërat liqenore aty ku ka mjaft vegjetacion bimor. Është i shpeshtë në këneta, liqene të pjerrëta dhe trupa të vogla ujore, që nuk janë të lidhura me lumenj.

Përhapja e përgjithshme

Europë.

Përhapja në Kosovë

Lumi Drenica në Drenas, Lumi Drenica në Çikatovë, Lumi Drenica në Grabovc, Lumi Drenica në Vragoli, Liqeni i Badovcit, Liqeni i Batllavës, Liqeni i Radoniqit, Lumi Llap në Murgull, Lumi Llap në Bajqinë, Lumi Llap në Lupq, Lumi Llap në Barilevë, Lumi Llap në Milloshevë, Lumi Llap në Lummadh.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Popullata e këtij lloji është e madhe. Megjithatë, nuk ka të dhëna të mjaftueshme për trendet kohore të nënpopullatave apo për gjerësinë e shtrirjes së tyre.

Arsyetimi i vlerësimit

Përhapja e ditur e këtij lloji është e pakompletuar si rezultat i hulumtimeve të pamjaftueshme. Trendi i popullatës është i panjohur. Për shkak të mungesës së të dhënave, këtë lloj e klasifikojmë në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.1 Zonat për banim dhe komerciale); 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane, 9.4 Mbeturinat dhe mbetjet e ngurta); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.2 Thatësirat).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Kottelat and Freyhof 2007





Rhodeus meridionalis Karaman, 1924

Actinopterygii: Cypriniformes: Cyprinidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Linda Grapci Kotori

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj është karakteristik për ujëra të ëmbla dhe haset kryesisht në lumenj të mëdhenj ose mesatarë. Është lloj relativisht konfuz pasi që karakteristikat morfologjike janë shumë të përafërta me R. amarus dhe R. seratus, dhe për këtë arsye ka nevojë që të bëhen analiza gjenetike. Dallohet nga lloji R. amarus sepse e ka kapakun rostral të dhëmbit terminal, i cili e mbulon pjesën e epërme të buzëve të epërme. Madhësia e adultit deri në 9.5 cm (Freyhoff and Kottelat 2008).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat], 5.4 Moçale, kënetа, moçalishte, 5.5 Liqene të përhershme të ujërave të ëmbla).
Ky lloj gjendet kryesisht në lumenj të madhësive të ndryshme, prej atyre të mëdhenj deri në mesatare, por mund të haset edhe në ujëra të ndenjura, si: liqene, kënetа, moçale dhe kanale. Në lumenj i parapëlqen ato pjesë me rrjedhje të ngadalshme. Mund të gjendet shpesh herë në ato ujëra ku jetojnë edhe llojet e guacave të gjinisë Anadonta dhe Unio.

Përhapja e përgjithshme

Lloj endemik i Ballkanit.

Përhapja në Kosovë

Lumi Erenik në Gjakovë (Wanke 2018).

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Në Kosovë është konstatuar në vetëm 1 lokalitet, por të dhënat për përhapjen e tij dhe trendet e nënpopullatave janë akoma të pamjaftueshme.

Arsyetimi i vlerësimit

Përhapja e ditur e këtij lloji është e pakompletuar, si rezultat i hulumtimeve të pamjaftueshme. Trendi i popullatës është i panjohur. Për shkak të mungesës së të dhënave, këtë lloj e klasifikojmë në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane, 9.4 Mbeturinat dhe mbetjet e ngurta); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.2 Thatësirat).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Freyhoff and Kottelat 2008; Wanke 2018



Sabanejewia balcanica Karaman, 1922

Actinopterygii: Cypriniformes: Cobitidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Linda Grapci Kotori.

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj shumohet në pranverë. Adultët shpeshherë mund të vërehen gjatë ditës, duke gërmuar në rërë apo edhe në substratin me guralecë në përroskat e pjerrëta kodrinore dhe duke bërë kështu strofulla. Distribuimi i tij dhe veçoritë ekologjike në Ballkan akoma nuk janë të njohura mirë. Adultët mund të arrijnë gjatësinë deri në 9 cm. Është lloj mjaft i ndjeshëm ndaj ndryshimit të habitatit (Freyhoff and Kottelat 2008).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat]).
Ky lloj i parapëlqen ujërat me temperaturë konstante dhe të pastra kodrinore. Mund të haset edhe ujëra me rrjedhje më të ngadaltë me pak bimë, në thellësi uji prej 1.5 m. Janë vëzhguar edhe në lumenj të mëdhenj.

Përhapja e përgjithshme

Europë.

Përhapja në Kosovë

Lumi Drenica në Drenas, Lumi Drenica në Çikatovë, Lumi Drenica në Grabovc, Lumi Drenica në Vragoli, Liqeni i Badovcit, Liqeni i Batllavës, Liqeni i Radoniqit, Lumi Llap në Murgull, Lumi Llap në Bajqinë, Lumi Llap në Lupq, Lumi Llap në Barilevë, Lumi Llap në Milloshevë, Lumi Llap në Lummadh.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Përhapja e njohur e këtij lloji është e pakompletuar si rezultat i hulumtimeve të pamjaftueshme. Trendi i popullatës është i panjohur. Për shkak të mungesës së të dhënave, këtë lloj e klasifikojmë në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.1 Zonat për banim dhe komerciale); 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane, 9.4 Mbeturinat dhe mbetjet e ngurta); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.2 Thatësirat).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Freyhoff and Kottelat 2008; Wanke 2018





Salmo macedonicus Karaman, 1924

Actinopterygii: Salmoniformes: Salmonidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Linda Grapci Kotori

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj mund të arrijë gjatësinë deri në 40 cm. Nuk ka të dhëna të mjaftueshme rreth aspekteve ekologjike për këtë lloj (Maric et al. 2010).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat)).
Ky lloj i parapëlqen ujërat e ëmbla me rrjedhje të shpejtë, sidomos segmentet ku krijohen ujëvara të vogla.

Përhapja e përgjithshme

Kosovë, Maqedoni.

Përhapja në Kosovë

Lumi Lepenc.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Përhapja e njohur e këtij lloji është e pakompletuar si rezultat i hulumtimeve të pamjaftueshme. Trendi i popullatës është i panjohur. Për shkak të mungesës së të dhënave, këtë lloj e klasifikojmë në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.1 Zonat për banim dhe komerciale); 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane, 9.4 Mbeturinat dhe mbetjet e ngurta); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.2 Thatësirat).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Maric et al. 2010



7.8 AMPHIBIA

Bufo bufo
Linnaeus, 1758

Thithëlopa

Amphibia: Anura: Bufonidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj, Linda Grapci Kotori

Të dhëna të përgjithshme

Është lloj që përshtatet lehtë në mjedise të ndryshme. Madhësia e trupit është deri në 15 cm. Zakonisht e gjejmë në zonat e lagështa me biměsi të dendur, kurse në përgjithësi u shmangen hapësirave të mëdha dhe zonave të hapura. Zakonisht, qëndrojnë të fshehura gjatë ditës dhe bëhen aktive në muzg dhe gjatë natës, kur edhe fillojnë të gjuajnë invertebrorë të ndryshëm me të cilët ushqehen. Ky lloj bën jetë vetmitare, kurse në sezonin e shumimit një numër i madh i individëve kalojnë në pellgje të caktuara ujore, ku meshkujt i joshin femrat për fekondim. Zhvillimi është kryesisht me metamorfozë. Pas disa muajve të rritjes dhe zhvillimit, të miturit dalin nga uji dhe mbeten kryesisht organizma tokësorë për pjesën tjetër të jetës së tyre.

Habitati

Lloji i habitatit: 1 Pyje [1.4 Pyje të klimës mesatare]; 3. Shkurre [3.3 Shkurre boreale, 3.4. Shkurre të klimës mesatare]; 4 Kullosa [4.4 Kullosa të klimës mesatare]; 5 Vende ujore [kontinentale] [5.2 Lumenj, përrenj, përroska periodike / të përkohshme / të parregullta, 5.3. Ligatina të dominuara nga shkurret]; 14 Artificiale/ tokësore [14.4 Kopshte rurale, 14.5 Zona urbane].

Përhapja e përgjithshme

Algjeri, Andorrë, Austri, Bjellorusi, Belgjikë, Bosnjë-Hercegovinë, Bullgari, Çeki, Danimarkë, Estoni, Finlandë, Francë, Gjermani, Gibraltar, Greqi, Hungari, Italí, Kazakistan, Kosovë, Kroaci, Letoni, Liban, Lihtenshtajn, Lituani, Luksemburg, Maqedoni, Mbretëri e Bashkuar, Moldavi, Monako, Mali i Zi, Marok, Holandë, Norvegji, Poloni, Portugali, Rumani, Rusi, San Marino, Serbi, Sllovaki, Slloveni, Spanjë, Suedi, Zvicër, Siri, Tunizi, Turqi, Ukrainë.

Përhapja në Kosovë

Liqeni i Badovcit, Liqeni i Batllavës, Krojmir, Komoran, Lumi Erenik në Gjakovë, Gllaviçicë, Grabanicë.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Përhapja e njohur e këtij lloji është e shkëputur, por, me gjasë, kjo është si rezultat i të dhënave të pamjaftueshme. Trendi i nënpopullatave është i panjohur. Për shkak të mungesës së të dhënave, lloji vlerësohet në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme. Me gjasë, lloji është më i përhapur në Kosovë nga sa dihet tani, bazuar edhe në të dhënat nga vendet përreth.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial [1.1 Banimi dhe zonat urbane, 1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit]; 5 Përdorimi i burimeve biologjike [5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve: 5.3.1 Përdorimi i qëllimshëm: vjelja për jetesë/në shkallë të vogël [lloji që vlerësohet është i synuar] [vjelja]; 11. Ndryshimet klimatike dhe moti i ashpër.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloj i mbrojtur në Kosovë [Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura].

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit [1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës]; 5. Ligji dhe politikat [5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit].
Hulumtimi i nevojshë**m:** 1. Hulumtimi [1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia]; 3. Monitorimi [3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit].





Bufotes viridis
Laurenti, 1768

Bretkosa e gjelbër

Amphibia: Anura: Bufonidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj, Linda Grapci Kotori.

Të dhëna të përgjithshme

Ka madhësi të trupit nga 4.5 deri në 12 cm. Karakteristikë e veçantë e këtij lloji është se i ka gjëndrat parotide-pasveshore shumë të theksuara, të vendosura menjëherë pas syve. Lëkura e trupit nga ana dorzale është e pajisur me gungëza gjëndërorë ngjyrë të gjelbër ulliri, si dhe disa pika të kuqërremta në pjesët anësore të ekstremiteteve. Ana ventrale e trupit ka ngjyrë të hirit të ndritshme. Gjatë periudhës së shumimit, femrat marrin ngjyrë të gjelbër më të theksuar. Sa i përket përhapjes, konsiderohet si lloj me përhapje shumë të gjerë që nga lartësitë e mëdha mbidetare e deri te pjesët me të ulëta.

Habitati

Lloji i habitatit: 1 Pyje [1.4 Pyje të klimës mesatare]; 3. Shkurre [3.3 Shkurre boreale, 3.4. Shkurre të klimës mesatare]; 4 Kullosa [4.4 Kullosa të klimës mesatare]; 5 Vende ujore [kontinentale] [5.3. Ligatina të dominuara nga shkurret]; 14 Artificiale/ tokësore [14.4 Kopshte rurale, 14.5 Zona urbane]; 15 Artificiale Ujore [15.3. Basene të akuakulturës].
Ky lloj mund të jetojë në pyje, stepa pyjore, stepa, gjysmëshkretëtira dhe shkretëtira. Mund të gjendet edhe në vende të lagështa, por edhe në vende të thata.

Përhapja e përgjithshme

Austri, Bjellorusi, Bosnjë-Hercegovinë, Bullgari, Çeki, Estonia, Francë, Gjermani, Greqi, Hungari, Italí, Kazakistan, Kosovë, Kroaci, Letoni, Lituani, Moldavi, Mali i Zi, Poloni, Rumani, Rusi, Serbi, Sllovaki, Slloveni, Spanjë, Shqipëri, Zvicër, Ukrainë.

Përhapja në Kosovë

Podujevë, Pejë, Klinë, Prizren, Gjakovë, Istog, Ferizaj, Deçan.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Përhapja e njohur e këtij lloji është e shkëputur, por, me gjasë, kjo është si rezultat i të dhënave të pamjaftueshme. Trendi i nënpopullatave është i panjohur. Për shkak të mungesës së të dhënave, lloji vlerësohet në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial [1.1 Banimi dhe zonat urbane, 1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit]; 5 Përdorimi i burimeve biologjike [5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve: 5.3.1 Përdorimi i qëllimshëm: vjelja për jetesë/në shkallë të vogël [lloji që vlerësohet është i synuar] [vjelja]; 11. Ndryshimet klimatike dhe moti i ashpër.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit [1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës]; 5. Ligji dhe politikat [5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit].
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi [1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia]; 3. Monitorimi [3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit].





Hyla arborea Linnaeus, 1758

Bretkosa e pemëve

Amphibia: Anura: Hylidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj, Linda Grapci Kotori

Të dhëna të përgjithshme

Është lloj me madhësi relativisht të vogël trupore. Te meshkujt madhësia trupore sillet midis 3 dhe 4 cm, ndërsa te femrat, 4 deri në 5 cm. Kanë trup të hollë dhe këmbë të gjata. Në anën shpinore të trupit kanë lëkurë të butë, ndërsa në anën barkore ajo është më e vrazhdë. Ngjyra e lëkurës nga ana shpinore mund të jetë e gjelbër ose hirtë, varësisht nga temperatura e mjedisit dhe sasia e lagështisë, ndërsa nga ana barkore lëkura ka ngjyrë të bardhë. Në maje të gishtave kane disqe të veçanta me ane të të cilave ngjiten në pemë dhe drunj të ndryshëm (Pasuljevič 1968).

Habitati

Lloji i habitatit: 1 Pyje (1.4 Pyje të klimës mesatare); 3. Shkurre (3.3 Shkurre boreale, 3.4. Shkurre të klimës mesatare); 4 Kullosa (4.4 Kullosa të klimës mesatare); 5 Vende ujore (kontinentale) (5.3. Ligatina të dominuara nga shkurret); 14 Artificiale/ tokësore (14.4 Kopshte rurale, 14.5 Zona urbane); 15 Artificiale ujore (15.3. Basene të akuakulturës).
Është lloj kryesisht i lartësive të vogla mbidetare, edhe pse është hasur edhe deri në 2300 m. Ky lloj shoqërohet përgjithësisht me pyje, shkurre, livadhe, kopshte, vreshta, pemishte, parqe, liqene dhe vegjetacion të ulët bregor të hapur, të ndriçuar mirë. Pyjet e errëta dhe të dendura shmangen. Mund të tolerojnë periudhat e thatësisë dhe mund të hasen edhe në habitate të thata.

Përhapja e përgjithshme

Armeni, Austri, Azerbajxhan, Bjellorusi, Belgjikë, Bosnjë-Hercegovinë, Bullgari, Çeki, Danimarkë, Francë, Gjeorgji, Gjermani, Greqi, Holandë, Hungari, Itali, Kosovë, Kroaci, Lihtenshtajn, Lituani, Luksemburg, Maqedoni, Mali i Zi, Moldavi, Poloni, Portugali, Rumani, Rusi, Serbi, Sllovaki, Sllloveni, Spanjë, Suedi, Shqipëri, Zvicër, Turqi, Ukrainë.

Përhapja në Kosovë

Radavc, Gërmi.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur
Në shumë vende europiane popullatat e këtij lloji janë të fragmentuara dhe në rënie. Nga Kosova nuk ka të dhëna të mjaftueshme për trendin e popullatave të këtij lloji.

Arsyetimi i vlerësimit

Përhapja e njohur e këtij lloji është e shkëputur, por, me gjasë, kjo është si rezultat i të dhënave të pamjaftueshme. Trendi i nënpopullatave është i panjohur. Për shkak të mungesës së të dhënave, lloji vlerësohet në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme. Me gjasë, lloji është më i përhapur në Kosovë nga se dihet tani, bazuar edhe në të dhënat nga vendet përreth.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit); 11. Ndryshimet klimatike dhe moti ekstrem.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Pasuljevič 1968



Rana dalmatina Bonaparte, 1840

Bretkosa e shkathtë

Amphibia: Anura: Ranidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj, Linda Grapci Kotori.

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj karakterizohet me trup të hollë dhe me ekstremitete të gjata. Në kokë ka një lloj feçke të butë. Meshkujt arrijnë madhësi të trupit deri në 6.5 cm, ndërsa femrat deri në 8 cm. Ngjyra e trupit është kryesisht kafe ose kafe në të kuqërremtë në anën shpinore, kurse në anën barkore më e ndritshme dhe pa njolla të dukshme. Këmbët e pasme janë jashtëzakonisht të gjata, të cilat i mundësojnë që të kërcejë më shumë se bretkosa të tjera të ngjashme – është e njohur se ato mund të hidhen në largësi deri në dy metra. Periudha e shumimit është në 20 ditët e muajit mars por ajo mund të vonohet varësisht nga kushtet klimatike (Kaya et al. 2009).

Habitati

Lloji i habitatit: 1 Pyje (1.4 Pyje të klimës mesatare); 4 Kullosa (4.4 Kullosa të klimës mesatare); 5 Vende ujore (kontinentale) (5.3. Ligatina të dominuara nga shkurret, 5.11. Vende ujore alpine [përfshirë ujërat e përkohshme nga shkrirja e borës); 15 Artificiale Ujore (15.3. Basene të akuakulturës).
Mund të haset deri në 1700 m lartësi mbidetare. Ky lloj haset në pyje me gjethe, kryesisht prej lisi dhe / ose ahu, shkoze, etj. Këto pyje shpesh përmbajnë një shtresë të trashë të mbeturinave të gjetheve.

Përhapja e përgjithshme

Austri, Belgjikë, Bosnjë-Hercegovinë, Bullgari, Çeki, Danimarkë, Francë, Gjermani, Greqi, Hungari, Itali, Kroaci, Kosovë, Luksemburg, Maqedoni, Mali i Zi, Mbretëria e Bashkuar, Rumani, Serbi, Sllovaki, Sllloveni, Spanjë, Suedi, Shqipëri, Zvicër, Turqi, Ukrainë.

Përhapja në Kosovë

Patok, Lëbush, Badovc.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Përhapja e njohur e këtij lloji është e shkëputur, por, me gjasë, kjo është si rezultat i të dhënave të pamjaftueshme. Trendi i nënpopullatave është i panjohur. Për shkak të mungesës së të dhënave, lloji vlerësohet në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme. Me gjasë, lloji, është më i përhapur në Kosovë nga sa dihet tani, bazuar edhe në të dhënat nga vendet përreth.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.1. Banimi dhe zonat urbane, 1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve: 5.3.1 Përdorimi i qëllimshëm: vjelja për jetesë/në shkallë të vogël [lloji që vlerësohet është i synuar) [vjelja]; 11. Ndryshimet klimatike dhe moti i ashpër.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Kaya et al. 2009



Rana graeca Boulenger, 1891

Bretkosa greke

Amphibia: Anura: Ranidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj, Linda Grapci Kotori

Të dhëna të përgjithshme

Bretkosa greke është një bretkosë me ngjyre kafe dhe ka një madhësi të trupit prej 5 deri në 8 cm. Këmbët i ka të gjata dhe ka një hundë të shkurtër. Pjesa shpinore e trupit është e lëmuar dhe ka ngjyrë kafe. Nuk ka njolla në trup, por shpesh mund të shfaqen disa pika të ndritshme të ngjashme me mykun. Pjesa barkore është e ndritshme, ndërsa në regjionin e fytit ngjyra bëhet më e murrme. Meshkujt kane xhepa te brendshëm vokalë dhe gjatë periudhës së shumimit lëshojnë zë. Riprodhimi bëhet nga shkurti deri në prill, duke depozituar në shtratin guror të ujërave të rrjedhshme grumbuj xhelatinozë prej 200-2000 vezësh.

Habitati

Lloji i habitatit: 1 Pyje [1.4 Pyje të klimës mesatare]; 4 Kullosa [4.4 Kullosa të klimës mesatare]; 5 Vende ujore [kontinentale] [5.1. Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat], 5.11. Vende ujore alpine [përfshirë ujërat e përkohshme nga shkrirja e borës]; 14 Artificiale/tokësore.
Në të shumtën e rasteve është i lidhur për habitate të lumenjve të vegjël dhe të ftohtë. Gjithashtu, shpesh gjendet edhe përreth përroskave dhe burimeve, të cilat gjenden në pyje të përziera. Po ashtu, është hasur përreth liqeneve glaciale.

Përhapja e përgjithshme

Bosnjë-Hercegovinë, Bullgari, Greqi, Kosovë, Mali i Zi, Maqedoni, Serbi, Shqipëri.

Përhapja në Kosovë

Burimi i Lumbardhit të Prizrenit, Prizren, Brod, Gryka e Deçanit, Prelep.

Habitati

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Përhapja e njohur e këtij lloji është e shkëputur, por, me gjasë, kjo është si rezultat i të dhënave të pamjaftueshme. Trendi i nënpopullatave është i panjohur. Për shkak të mungesës së të dhënave, lloji vlerësohet në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme. Me gjasë, lloji është më i përhapur në Kosovë nga sa dihet tani, bazuar edhe në të dhënat nga vendet përreth.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial [1.1 Banimi dhe zonat urbane, 1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit]; 5 Përdorimi i burimeve biologjike [5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve: 5.3.1 Përdorimi i qëllimshëm: vjelja për jetesë/në shkallë të vogël [lloji që vlerësohet është i synuar] [vjelja]; 11. Ndryshimet klimatike dhe moti i ashpër.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Të paktën një nga nënpopullatat është në kuadër të zonës së mbrojtur.

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit [1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës]; 5. Ligji dhe politikat [5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi [1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia]; 3. Monitorimi [3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit].





Rana temporaria Linnaeus, 1758

Bretkosa e zakonshme

Amphibia: Anura: Ranidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj, Linda Grapci Kotori.

Të dhëna të përgjithshme

Është lloj me madhësi mesatare të trupit prej 6 deri në 9 cm. Regjioni shpinor dhe ai i ekstremiteteve ka ngjyrë të gjelbër ulliri, mirëpo tonet e ngjyrës mund të ndryshojnë, varësisht nga mjedisi se ku ndodhen. Nga përfaqësuesit e këtij lloji ka edhe forma albino. Gjatë periudhës së shumimit, bretkosa e gjinisë mashkullore ka tendencë të kthejë ngjyrën e trupit në të errët-blu. Kanë këmbë të pasme të gjata që iu mundësojnë mënyrën e lëvizjes me kërcim. Këto shtazë janë aktive gjatë gjithë vitit. Shumohen kryesisht në ujëra të cekëta dhe të pastra, ku periudhën e shumimit e kanë që nga muaji mars e deri në fund të qershorit.

Habitati

Lloji i habitatit: 1 Pyje [1.4 Pyje të klimës mesatare]; 3. Shkurre [3.3 Shkurre boreale, 3.4. Shkurre të klimës mesatare]; 4 Kullosa [4.4 Kullosa të klimës mesatare]; 5 Vende ujore [kontinentale] [5.3. Ligatina të dominuara nga shkurret, 5.11. Vende ujore alpine [përfshirë ujërat e përkohshme nga shkrirja e borës]; 14 Artificiale/tokësore [14.4 Kopshte Rurale, 14.5 Zona urbane]; 15 Artificiale Ujore [15.3. Basene të akuakulturës].
Mund të haset në lartësi të ndryshme mbidetare, deri në 2700 m. Ky lloj haset në habitate të ndryshme, si pyje gjetherënëse, halore dhe të përziera, ku mund të jetojë në zona të thata por edhe të lagështa.

Përhapja e përgjithshme

Austri, Bjellorusi, Belgjikë, Bullgari, Çeki, Danimarkë, Estoni, Finlandë, France, Gjermani, Hungari, Irlandë, Itali, Kosovë, Letoni, Lihtenshtajn, Lituani, Luksemburg, Maqedoni, Mbretëri e Bashkuar, Mali i Zi, Holandë, Norvegji, Poloni, Rumani, Rusi, Serbi, Sllovaki, Slloveni, Spanjë, Suedi, Zvicër, Ukrainë.

Përhapja në Kosovë

Liqeni i Leqinatit, Brod, Prevallë, Gurra e Gjatë, Gryka e Deçanit, Liqeni i Shutmanit, Liqeni i Badovcit.

Popullata

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Përhapja e njohur e këtij lloji është e shkëputur, por, me gjasë, kjo është si rezultat i të dhënave të pamjaftueshme. Trendi i nënpopullatave është i panjohur. Për shkak të mungesës së të dhënave, lloji vlerësohet në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme. Me gjasë, lloji është më i përhapur në Kosovë nga sa dihet tani, bazuar edhe në të dhënat nga vendet përreth.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial [1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit]; 5 Përdorimi i burimeve biologjike [5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve: 5.3.1 Përdorimi i qëllimshëm: vjelja për jetesë/në shkallë të vogël [lloji që vlerësohet është i synuar] [vjelja]; 11. Ndryshimet klimatike dhe moti i ashpër.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur [Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura].

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit [1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës]; 5. Ligji dhe politikat [5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi [1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia]; 3. Monitorimi [3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit].





Salamandra salamandra Linnaeus, 1758

E bukura e dheut

Amphibia: Caudata: Salamandridae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj, Linda Grapci Kotori

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj është mjaft i përhapur. Madhësia e trupit arrin nga 250 deri 300 mm. Femrat janë zakonisht më të mëdha se meshkujt, por karakterizohen me ekstremitete më të shkurtra. Karakterizohet me prezencën e bishtit, që është më i shkurtër se trupi. Në anën shpinore dhe në pjesët anësore të trupit ka ngjyrë të zezë, me njolla të verdha. Ana barkore ka kryesisht ngjyrë të zezë. Ka aftësi të përshtatet në ndryshimet e mjedisit jetësor (Gasc et al. 1997).

Habitati

Lloji i habitatit: 1 Pyje (1.1 Pyje boreale, 1.4 Pyje të klimës mesatare); 4 Kullosa (4.4 Kullosa të klimës mesatare); 5 Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat], 5.2 Lumenj, përrenj, përroska periodike/të përkohshme/të parregullta, 5.3. Ligatina të dominuara nga shkurret).
Jeton kryesisht në mjedise ligatinore dhe pyje. Mund të gjendet gjithashtu në lëndina, lumenj dhe liqene. Ky lloj parapëlqen mikrohabitate të mbuluara me gjethe të dendura dhe myshk. Mund të haset prej nivelit të detit deri në 2500 m.

Përhapja e përgjithshme

Andorrë, Austri, Belgjikë, Bosnjë-Hercegovinë, Bullgari, Çeki, Francë, Gjermani, Greqi Holandë,, Hungari, Itali, Lihtenshtajn, Luksemburg, Kosovë, Kroaci, Mali i Zi, Maqedoni, Poloni, Portugali, Rumani, San-Marino, Serbi, Sllovaki, Slloveni, Spanjë, Shqipëri, Zvicër, Ukrainë

Përhapja në Kosovë

Deçan, Bjeshkët e Sharrit, Zupç, Koshtovë, Këpuz, Gurrat e Bardha, Dubovë, Bjeshkët e Nemuna.

Habitati

Trendi i popullatës: I panjohur
Deri vonë popullatat e këtij lloji kanë qenë të qëndrueshme, por në vitet e fundit, për shkak të degradimit të pyjeve dhe erozionit të rrjedhës së lumenjve, është vërejtur një rënie e lehtë në madhësinë e popullatës. Ekziston nevoja për një hulumtim më të hollësishëm për të përcaktuar prirjen e kësaj rënieje.

Arsyetimi i vlerësimit

Përhapja e njohur e këtij lloji është e shkëputur, por, me gjasë, kjo vjen si rezultat i njohurive të pamjaftueshme. Trendi i popullatës është i panjohur. Për shkak të mungesës së të dhënave ky lloj vlerësohet në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.1 Banimi dhe zonat urbane, 1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve: 5.3.1 Përdorimi i qëllimshëm: vjelja për jetesë/në shkallë të vogël (lloji që vlerësohet është i synuar) [vjelja]; 11. Ndryshimet klimatike dhe moti i ashpër.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloj i mbrojtur në Kosovë (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Gasc et al. 1997



7.9 REPTILIA

Dolichophis caspius Gmelin, 1789

Reptilia: Squamata: Colubridae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj

Të dhëna të përgjithshme

Është gjarpër johelmues, tokësor dhe mjaft i fuqishëm, i shpejtë dhe agresiv. Ka një gjatësi trupore deri në 2.5 m. Trupi është i mbuluar me lëfore të mëdha dhe të lëmuara, renditja e të cilave nuk u përngjan tjegullave në pullaz. Ana shpinore e trupit është e murrme, kah ngjyra e hirit ose tërësisht e murrme, ndërsa ana barkore e ndritshme, e verdhë në të portokalltë. Mashkulli është më i madh se femra. Ushqehet me kurrizorë të imët si gjitarë, shpezë e reptile (Kreiner 2007). Gjatë lëvizjes është shumë i shpejtë, e mban kokën lart mbi substrat, e kjo shkakton panik të madh. Është lloj ovipar. Kah gjysma e qershorit dhe fillimi i korrikut femra prodhon 6 deri në 18 vezë, prej të cilave dalin format e reja në fillim të shtatorit. Jetëgjatësia e këtij lloji është deri në 10 vjet.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje; 3. Shkurre; 4. Kullosa; 6. Zona shkëmbore (p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore); 14. Artificiale/tokësore.
E hasim në viset kodrinore-malore të pasura me bar dhe shkurre, pastaj pranë vendeve të banuara, rrugëve, kopshteve dhe sipërfaqeve të mbjella me kultura bujqësore. Ky lloj mund të haset edhe në rajonet me bimë të përziera në lartësi mbi detare deri në 1000 m.

Përhapja e përgjithshme

Bullgari, Greqi, Gjeorgji, Hungari, Kazakistan, Kosovë, Kroaci, Maqedoni, Moldavi, Mali i Zi, Rumani, Rusi, Serbi, Shqipëri, Turqi, Ukrainë.

Përhapja në Kosovë

Bardhaniq, Gërnqar, Leposaviq, Vërbicë, Zhur, Banjskë, Berivojcë.

Habitati

Trendi i popullatës: I panjohur
Trendi i popullatave në Europë për shumë vende është stabil, me përjashtim të vendeve veriperëndimore, të cilat karakterizohen me popullata të fragmentuara dhe trend negativ.

Në vendin tonë sipas të dhënave të deritanishme është lloj mjaft i rrallë, por nuk ka të dhëna të mjaftueshme për qëndrueshmërinë e popullatave.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme, sepse nuk ka të dhëna të mjaftueshme për përhapjen e këtij lloji në Kosovë apo për trendin e nënpopullatave të tij. Me gjasë, ky lloj është i përhapur më shumë nga sa dihet tani, bazuar në të dhënat e vendeve përreth Kosovës.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.1 Banimi dhe zonat urbane, 1.2 Hapësirat komerciale dhe industriale); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.1 Gjuetia dhe mbledhja e kafshëve tokësore: 5.1.3 Persekutimi/kontrolli); 6 Ndërhyrje dhe shqetësime njerëzore.
Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj, kanë të bëjnë me humbjen dhe degradimin e habitatit, para së gjithash, nëpërmjet ndërrimit të destinimit të kulturave bujqësore dhe kalimi nga ato ekstensive në ato intensive, pastaj zhvillimi i industrisë, urbanizimi, infrastruktura etj. Shpeshherë, ky lloj është cak i sulmit nga njeriu, për shkak të lëvizjes së tij të shpejtë, duke shkaktuar kështu panik.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Kreiner 2007



Lacerta agilis Linnaeus, 1758

Hardhuca e shpejtë

Reptilia: Squamata: Lacertidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj është një hardhucë jashtëzakonisht pasive, kështu që lehtë mund të kapet edhe me dorë. Ka gjymtyrë të shkurtra dhe bisht të gjatë sa 1.5 herë gjatësia e trupit. Te mashkulli ana shpinore ka ngjyrë të gjelbër të spërkatur me pika të bardha, kurse te femra ngjyrë hiri të mbyllët dhe me njolla të errëta. Ana barkore e trupit te mashkulli ka ngjyrë të gjelbër në të portokalltë, kurse te femra ngjyra është më e ndritshme. Intensiteti i ngjyrave është shumë më i shprehur gjatë aktivitetit seksual. Ushqehet me pakurrizorë të llojllojshëm, duke përfshirë insektet, merimangat dhe karkalecat. Fekondimi ndodh kah gjysma e prillit dhe fillimi i majit, ku meshkujt shquhen me një agresivitet të madh. Në qershor ose në fillim të korrikut femra prodhon 4 – 14 vezë, prej të cilave në gusht dalin format e reja. Jetëgjatësia e këtij lloji është deri në 12 vjet.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje; 3. Shkurre; 4. Kullosa; 14. Artificiale/tokësore.
E hasim në vendet kodrinore-malore të thata, në toka poroze, livadhe, lugina të lumenjve me vegjetacion të pasur bimor (Nemes et al. 2006).

Përhapja e përgjithshme

Europë, Siberi, Azi e mesme.

Përhapja në Kosovë

Gjakovë, Prizren.

Habitati

Trendi i popullatës: I panjohur
Trendi i popullatave në nivel global është në rënie e sipër. Në Kosovë nuk është vëzhguar viteve të fundit prandaj, nuk ka të dhëna të mjaftueshme për trendet e popullatës. Nevojiten hulumtime më të detajuara për këtë lloj.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme, sepse nuk ka të dhëna të mjaftueshme për përhapjen e këtij lloji në Kosovë apo për trendin e popullatave të tij. Me gjasë, ky lloj është i përhapur më shumë nga sa dihet tani, bazuar në të

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.1 Banimi dhe zonat urbane); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5. 1 Gjuetia dhe mbledhja e kafshëve tokësore: 5.1.3 Përndjekja / kontrolli); 6 Ndërhyrje dhe shqetësime njerëzore; 9 Ndotja (9.4 Mbeturinat dhe mbetjet e ngurta).
Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj, kanë të bëjnë me degradimin e habitatit nëpërmjet urbanizimit, pastaj ndotja dhe grumbullimi i mbeturinave, lëvizja e njerëzve dhe kafshëve në vendbanimet e llojit, fragmentimi i habitatit nëpërmjet ndërtimit të rrugëve dhe kanaleve, të cilat bëhen barrierë efektive në shpërndarjen dhe komunikimin e llojit, intensifikimi i bujqësisë, hapja e plantacioneve të reja, zhvillimi i qendrave turistike dhe rekreative.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Nemes et al. 2006



Podarcis erhardii
Bedriaga, 1876

Hardhuca e gurëve

Reptilia: Squamata: Lacertidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2017

Vlerësuesi(t)

Daut Rexhepaj

Të dhëna të përgjithshme

Gjatësia totale e trupit të këtij lloji arrin deri në 20 cm. Ngjyra e trupit nga ana shpinore është e përhime në të gjelbër dhe e përshkuar nga dy shirita me njolla të zeza, ku përgjatë vijës mediale shtrihet një zonë e ndritshme dhe në të dy anët e trupit nën këtë shirit të zi po ashtu shtrihet zona e ndritshme. Ana barkore e trupit është njëngjyrëshe dhe mund të jetë e bardhë, e verdhë ose portokalli. Është lloj ovipar. Femra prodhon 1 -5 vezë, prej të cilave nga mesi i korrikut dhe i shtatorit dalin format e reja. Pjekurinë seksuale e arrijnë në moshën 1.5 deri 2 vjeçare. Ushqehen kryesisht me insekte. Jetëgjatësia e tyre arrin deri në 5 vjet (Arnold & Oveden 2002; Valakos 1990).

Habitati

Lloji i habitatit: 3. Shkurre; 6. Zona shkëmbore (p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore); 14. Artificiale/tokësore.
Ky lloj haset kryesisht në vende të thata gurore dhe ranore të pasura me vegjetacion të ulët bimor, përskaj rrugëve dhe mureve të vendbanimeve.

Përhapja e përgjithshme

Bullgari, Greqi, Maqedoni, Kosovë, Serbi.

Përhapja në Kosovë

Mirushë, Gërmi, Blinajë.

Habitati

Trendi i popullatës: I panjohur
Trendi i popullatave në nivel global është stabil. Në Kosovë nuk ka të dhëna të mjaftueshme për nënpopullatat e këtij lloji.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme, sepse nuk ka të dhëna të mjaftueshme për përhapjen e këtij lloji në Kosovë apo për trendin e popullatave të tij. Me gjasë, ky lloj është i përhapur më shumë nga sa dihet tani, bazuar në të dhënat e vendeve përreth Kosovës.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial; 6 Ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër.
Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj, kanë të bëjnë me degradimin, fragmentimin dhe shkatërrimin e habitateve nga veprimtaritë antropogjene, si: urbanizimi, infrastruktura, turizmi dhe rekreacioni. Ky lloj është po ashtu shumë i ndjeshëm ndaj ndryshimeve klimatike. Një faktor kufizues për llojin është dhe prodhimi i numrit të vogël të vezëve.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloj i mbrojtur në Kosovë (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Arnold & Ovenden 2002; Valakos 1990





Aquila fasciata Vieillot, 1822

Shqiponja bishtvizuar

Aves: Accipitriformes: Accipitridae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Taulant Bino

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e këtij lloji është 55–67 cm, mashkulli peshon 1 400–2 240 g, femra 2 100–3 025 g, kurse hapja e krahëve është 143–176 cm. Të rriturit janë zakonisht rezidentë, kurse të vegjlit shtegtojnë në distanca jo fort të largëta. Ushqehen me shpendë, gjitarë, reptile, insekte etj. (BirdLife International 2016g).

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare); 4. Kullosa (4.4 Kullosa të klimës mesatare); 5. Vende ujore (kontinentale) (5.4 Moçale, këneta, moçalishte, 5.5 Liqenet e përhershme të ujërave të ëmbla (mbi 8ha)); 6 Zona shkëmbore (p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore)
Ky lloj gjendet në habitate pyjore, shkëmbore, të thata deri në gjysmë të lagështa, nga niveli i detit deri në 1500 m, por edhe deri në 3000 m në Afrikë dhe 3750 m në kodrinat e Himalajeve. Përgjithësisht gjendet në zona të hapura, por edhe në pyje. Të vegjlit shpesh mund të hasen në afërsi të trupave të mëdhenj ujorë.

Përhapja e përgjithshme

Veriperëndim i Afrikës dhe Gadishulli Iberik në lindje nëpërmjet Mesdheut, Lindjes së Afërt deri në Afganistan, Pakistan dhe Indi dhe pastaj nëpërmjet Indokinës veriore deri në Kinën juglindore; vizitor dimri i Afrikës veriperëndimore dhe jugore deri në Senegalin verior.

Përhapja në Kosovë

Junik, Dragash.

Habitati

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme, për shkak të mungesës së informatave rreth përhapjes dhe trendit të popullatës.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 2 Bujqësia dhe akuakultura (2.2 Plantacionet e drurit dhe pulpës); 3 Prodhimi dhe minierat energjetike (3.3 Energjia e ripërtërishme); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.1 Gjuetia dhe grumbullimi i kafshëve tokësore: 5.1.1 Përdorimi i qëllimshëm (lloji që vlerësohet është i synuar), 5.1.3 Persekutimi/kontrolli, 5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve: 5.3.3 Efektet e paqëllimta: vjelja për jetesë/në shkallë të vogël (lloji që vlerësohet nuk është i synuar); 12 Opsione të tjera (12.1 Kërcënim tjetër (helmim)).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur në Kosovë (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura)

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës, 1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve). 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës); 4 Edukimi dhe ndërgjegjësimi; 5 Ligji dhe politika (5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Parandalimi dhe kontrolli i përpjekjeve helmuese. Shtyllat e rrezikshme të energjisë elektrike duhet të modifikohen ose të futen nën dhe. Kulturat e bimëve duhet të përdoren për të rritur popullsitë e gjahut për këtë lloj, duhet të mirëmbahet bujqësia e gjerë baritore dhe të mbrohen gardhet/kufizimet e fushave. Organizimi i fushatave të edukimit, me përfshirjen aktive të shoqatave të gjuetisë dhe vazhdimi i kërkimit dhe monitorimit, do të ndihmonte në ruajtjen e këtij lloji.

Referencat

BirdLife International 2016g





Buteo rufinus Cretzschmar, 1827

Huta bishtbardhë

Aves: Accipitriformes: Accipitridae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Taulant Bino, Qenan Maxhuni

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e këtij lloji është 43–62 cm, mashkulli peshon 590–1 281 g, femra 945–1 760 g, dhe hapja e krahëve është 112–160 cm. Në Afrikë janë rezidentë, kurse në Eurazi shtegtojnë. Ushqehen kryesisht me gjitarë të vegjël (BirdLife International 2017e).

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare); 3. Shkurre (3.8. Vegjetacion shkurror i tipit mesdhetar); 4. Kullosa (4.4 Kullosa të klimës mesatare); 14. Artificiale/tokësore (14.1. Tokë e punueshme).
Ky lloj parapëlqen kryesisht zonat e hapura, veçanërisht stepat dhe gjysmë-shkretëtirat dhe është regjistruar deri në 3500 m (BirdLife International 2017e).

Përhapja e përgjithshme

Europë juglindore, Turqi dhe Izrael lindor, Transkaukaz, Iran, Afganistan dhe Azi qendrore deri në Kinën veriperëndimore, dhe Pakistanin jugor dhe verior dhe Indinë veriperëndimore; dimëron në Afrikën veriilindore, Lindjen e Afërt, Pakistan dhe në Indinë veriore deri në Bangladesh.

Përhapja në Kosovë

Prizren.

Habitati

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është shumë i rrallë në Kosovë, edhe pse brenda hapësirës së tij të përhapjes. E kemi vlerësuar në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme, sepse akoma nuk ka njohuri të mjaftueshme për përhapjen apo trendin e popullatës.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 2 Bujqësia dhe akuakultura (2.1 Bimët vjetore dhe shumëvjeçare jodrusore: 2.1.3 Bujqësia agroindustriale; 2.3.2 Kullotja e përmasave të vogla, fermat apo bujqësia; 2.2 Plantacionet e drurit dhe pulpës: 2.2.2 Plantacionet agroindustriale; 3 Prodhimi dhe minierat energjetike (3.2 Miniera dhe gurore, 3.3 Energjia e ripërtërishme); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve - Efektet e paqëllimta: vjelja për jetesë/në shkallë të vogël (lloji që vlerësohet nuk është i synuar).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Ky lloj është i mbrojtur në Kosovë (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës, 1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve). 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës); 5 Ligji dhe politika (5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

BirdLife International 2017e





Ciconia nigra Linnaeus, 1758

Lejleku i zi

Aves: Ciconiiformes: Ciconiidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Taulant Bino, Qenan Maxhuni

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e këtij lloji është 95–100 cm, peshon mesatarisht 3 kg kurse hapja e krahëve është 144–155 cm. Mashkulli është mesatarisht më i madh. Është kryesisht lloj shtegtar, që shkon përgjatë rrugëve mirë të përcaktuara. Ushqehet kryesisht me peshq, por edhe me insekte, amfibë, gaforre, reptilë e edhe me shpendë të tjerë (BirdLife International 2017b).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vendet ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat), 5.4 Moçale, këneta, moçalishte, 5.7 Moçale/basene të përhershme të ujërave të ëmbla (nën 8ha)).
Lloji jeton në pyje të vjetra të hapura dhe të pashqetësuara, nga niveli i detit deri në rajonet malore (p.sh., 2.000-2.500 m në lartësi). Kërkojnë ushqimin në rrjedha të cekëta, pellgje, këneta, moçalishte, livadhe të lagështa, fusha të përmbytura, pishina në shtretërit e thatë të lumenjve dhe herë pas here në kullosa, sidomos aty ku ka kallamishte apo bar të gjatë. Në përgjithësi, lloji shmang trupat e mëdhenj ujorë dhe pyjet e dendura.

Përhapja e përgjithshme

Folezon përgjatë Palearktikut, të shumtën në gjerësitë 40°–60° N; gjithashtu në nënpopullata të shkapërderdhura gjendet prej Malavit dhe Namibisë deri në Afrikën veriore. Dimëron në verilindje, nën-Sahara dhe jug të Afrikës si dhe prej perëndimit të Indisë, në lindje nëpërmjet veriut të Indisë dhe veriut të Indkinës drejt Kinës juglindore dhe lindore, Tajvanit, Koresë Jugore; disa individë (disa qindra) janë rezidentë në Spanjën jugperëndimore.

Përhapja në Kosovë

Koretinë.

Habitati

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Është një lloj i fshehtë. Habitatet e folezimit janë nën presion antropogjen. Tash për tash, ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme, sepse nuk ka informata të sakta rreth përhapjes apo madhësisë së nënpopullatave në Kosovë.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 5 Përdorimi i resurseve biologjike (5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve: 5.3.3 Efektet e paqëllimshme: vjelje për jetesë/në shkallë të vogël (lloji që vlerësohet nuk është i synuar)]; 6 Ndërhyrje dhe shqetësime njerëzore (6.3 Punë dhe aktivitete të tjera]; 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi/përdorimi i ujit: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri)].

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloj i mbrojtur në Kosovë (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës, 1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve). 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës); 5 Ligji dhe politika (5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Monitorim i folezimit, shtegtimit, përbërjes moshore dhe ndryshimeve ekologjike në vendet kyçe. Menaxhim i qëndrueshëm i lumenjve dhe përrenjve të vegjël. Vendosja e zonave të mosndërhyrjes përreth lokaliteteve folezuese. Mbrojtja e drunjve folezues (gjithashtu në plantacione) dhe shkëmbinj. Futja nën dhe e kabllove të rrymës ose zëvendësimi i tyre me të tjera më të dukshme. Parandalimi i gjuetisë ilegale dhe mbipërdorimit të peshqve.

Referencat

BirdLife International 2017b





Falco cherrug Gray, 1834

Skifteri i gjuetisë

Aves: Falconiformes: Falconidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
I Rrezikuar, EN

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Taulant Bino

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e këtij lloji është 45–57 cm, mashkulli peshon 730–990 g, femra 970–1 300 g, dhe hapja e krahëve është 97–126 cm. Në varshmëri nga prania e ushqimit, mund të jenë sedentar, ose pjesërisht apo tërësisht shtegtar. Gjuajnë kryesisht brejtës tokësorë të madhësisë mesatare (BirdLife International 2017f).

Habitati

Lloji i habitatit: 4. Kullosa (4.4 Kullosa të klimës mesatare); 14. Artificiale/tokësore (14.1. Tokat e punueshme, 14.2. Kullosat).
Ky lloj parapëlqen peizazhe të hapura me bar, të tilla si skaj shkretëtirash, gjysmë-shkretëtirash, stepa, zona bujqësore dhe zona të thata malore.

Përhapja e përgjithshme

Europa qendrore dhe lindore nëpërmjet Ukrainës dhe Rusisë jugperëndimore deri në Siberinë jugqendrore, Kazakistani verior, Azia e Vogël dhe Irani; dimëron prej Europës jugore deri në Afrikën veriore dhe lindore e deri në Azinë jugperëndimore.

Përhapja në Kosovë

Krushevë.

Habitati

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme, për shkak të mungesës së informatave rreth përhapjes së llojit dhe trendit të popullatës së tij.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 2 Bujqësia dhe akuakultura (2.1 Bimët vjetore dhe shumëvjeçare jodrusore: 2.1.1 Zhvendosja e bujqësisë; 2. 2 Plantacione druri dhe pulpë: 2.2.2 Plantacionet agroindustriale); 3 Prodhimi dhe minierat e energjisë; (3.3 Energjia e ripërtërishme); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.1 Gjuetia dhe grumbullimi i kafshëve tokësore: 5.1.1 Përdorimi i qëllimshëm (lloji që vlerësohet është i synuar)]; 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.3 Modifikimet e tjera të ekosistemit).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Ky lloj është i mbrojtur në Kosovë (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës, 1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve). 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës]; 5 Ligji dhe politika (5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Shtyllat elektrike të jenë të sigurta për llojin. Ngritja e vetëdijes midis palëve të interesit rreth rreziqeve nga shtyllat elektrike.

Referencat

BirdLife International 2017f





Hieraaetus pennatus Gmelin, 1788

Shqiponja e vogël

Aves: Accipitriformes: Accipitridae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Taulant Bino

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e këtij lloji është 42–51 cm, mashkulli peshon 510–770 g, femra 840–1 250 g, kurse hapja e krahëve është 113–138 cm. Ky është një lloj kryesisht shtegtar. Ushqehet të shumtën me shpendë të vegjël (BirdLife International 2016h).

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje (1.4. Pyje të klimës mesatare).
Është lloj që parapëlqen zona të hapura pyjore sidomos të kombinuara me zona pyjore dhe mund të gjendet deri në 3000 m.

Përhapja e përgjithshme

Jugperëndim i Europës dhe veriperëndim i Afrikës nëpërmjet Europës lindore, Azisë së Vogël dhe Kaukazit deri në Azinë qendrore, në verilindje të Mongolisë, Liqenit Bajkall dhe Transbajkalisë (ndoshta në lindje të Kinës verilindore), dhe juglindje drejt veriut dhe Perëndimit të Pakistanit, Indisë veriore dhe Nepalit; gjithashtu jugu i Afrikës Jugore (Western Cape dhe Eastern Cape) dhe veriu i Namibisë. Dimëron kryesisht në Afrikë në jug të Saharasë dhe në jug të Azisë, kryesisht në nënkontinentin Indian.

Përhapja në Kosovë

Junik, Dragash.

Habitati

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme, për shkak të mungesës së informatave që kanë të bëjnë me përhapjen e llojit dhe trendin e popullatës.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 2 Bujqësia dhe akuakultura (2.2 Plantacionet e drurit dhe pulpës); 3 Prodhimi dhe minierat energjetike (3.3 Energjia e ripërtërishme); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.1 Gjuetia dhe grumbullimi i kafshëve tokësore: 5.1.1 Përdorimi i qëllimshëm (lloji që vlerësohet është i synuar), 5.1.3 Persekutimi/kontrolli, 5.3 Prerja dhe vjelja e pyjeve: 5.3.3 Efektet e paqëllimta: vjelja për jetesë/në shkallë të vogël (lloji që vlerësohet nuk është i synuar)); 12 Opsione të tjera (12.1 Kërcënim tjetër (helmimi)).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Ky lloj është i mbrojtur në Kosovë (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës, 1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve). 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës); 4 Edukimi dhe ndërgjegjësimi; 5 Ligji dhe politika (5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Parandalimi dhe kontrolli i përpjekjeve helmuese. Shtyllat e rrezikshme të energjisë elektrike duhet të modifikohen ose të futen nën dhe. Kulturat e bimëve duhet të përdoren për të rritur popullsitë e gjahut për këtë lloj, duhet të mirëmbahet bujqësia e gjerë baritore dhe të mbrohen gardhet/kufizimet e fushave. Organizimi i fushatave të edukimit, me përfshirjen aktive të shoqatave të gjuetisë dhe vazhdimi i kërkimit dhe monitorimit do të ndihmonte në ruajtjen e këtij lloji.

Referencat

BirdLife International 2017b





Monticola saxatilis Linnaeus, 1766

Tusha bishtkuqe

Aves: Passeriformes: Muscicapidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Taulant Bino, Qenan Maxhuni

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e këtij lloji është 16–19 cm, kurse pesha 40–65 g. Ky lloj ushqehet kryesisht me insekte dhe fruta. Është lloj shtegtar (BirdLife International 2017g).

Habitati

Lloji i habitatit: 6. Zonat shkëmbore (p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore)
Ky lloj folezon në zonat malore shkëmbore dhe kodra të larta me shkurre të shpërndara dhe mbulesë sporadike të barit, skajet e gjera gëlqerore, rrjedhat e lavës, kanjonet e eroduara, shtigjet e lumenjve të hapur, grykat e shkurtra të lumenjve, livadhet alpine shkëmbore etj. (BirdLife International 2017g).

Përhapja e përgjithshme

Malet prej Europës jugore dhe qendrore dhe Afrikës veriperëndimore dhe Lindore deri në Azinë jugperëndimore dhe qendrore (në Lindje deri në Liqenin Baikall, Mongolinë e brendshme dhe Kinën qendrore); dimëron në Afrikën nënsahariane.

Përhapja në Kosovë

Prizren, Bajgorë.

Habitati

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme, për shkak të përhapjes së kufizuar në Kosovë edhe pse ka mungesë të madhe të informatave ornitologjike.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.3 Zona turistike dhe rekreative); 2 Bujqësia dhe akuakultura (2.3 Blegtoria dhe fermat: 2.3.2 Kullotja e shkallës së vogël, fermat apo bujqësia) 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.3 Modifikimet e tjera të ekosistemit).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloj i mbrojtur në Kosovë (Udhëzim Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura). Pjesë të hapësirës së përhapjes në Kosovë janë të caktuara si Zonë e Mbrojtur

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës, 1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve). 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës); 5 Ligji dhe politika (5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

BirdLife International 2017g





Panurus biarmicus Linnaeus, 1758

Trishtili me mustaqe

Aves: Passeriformes: Acrocephalidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Taulant Bino

Të dhëna të përgjithshme

Madhësia e këtij lloji është 14·5–17 cm, kurse pesha 11–20·8 g. Popullatat në Europë janë kryesisht sedentare, por, gjatë dimrit nganjëherë me lëvizje. Ushqehen kryesisht me parruazorë dhe me perime gjatë dimrit (BirdLife International 2016l).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (koninentale) (5.1. Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme (përfshirë ujëvarat), 5.4. Moçale, këneta, moçalishte (mbi 8ha)).
Ky lloj gjendet në zona me Phragmites dhe shoqërohet me vegjetacion drunor në dhe, përreth ujërave të ëmbla dhe të njelmëta, ose menjëherë ngjitur me këneta dhe moçale. Folezon në kallame, shqira apo vegjetacion tjetër të kënetave.

Përhapja e përgjithshme

Lokalisht nga Britania e Madhe, Franca dhe Spanja jugore dhe lindore në lindje deri në Norvegjinë jugore, Danimarkë, Suedi jugore, Finlandë jugore, Rusi jugperëndimore, Ballkan, Turqi perëndimore dhe jugore dhe mbase Azerbejxhan.

Përhapja në Kosovë

Henc.

Habitati

Trendi i popullatës: I panjohur

Arsyetimi i vlerësimit

Lloji është vlerësuar në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme, për shkak të mungesës së njohurive rreth përhapjes dhe trendit të popullatës.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 2 Bujqësia dhe akuakultura (2.1 Kulturat vjetore dhe shumëvjeçare jodrusore); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.1 Gjuetia dhe grumbullimi i kafshëve tokësore: 5.1.1 Përdorimi i qëllimshëm (lloji që vlerësohet është i synuar)); 7 Modifikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi/përdorimi i ujit: 7.2.1 Eksploatimi i ujit sipërfaqësor (përdorimi në amvisëri).

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloj i mbrojtur në Kosovë (Udhëzim Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës, 1.2 Mbrojtja e resurseve dhe habitateve). 2. Menaxhimi i tokës/ujit (2.1 Menaxhimi i lokalitetit/zonës); 5 Ligji dhe politika (5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).
Monitorim më i mirë dhe ruajtje e kallamishteve. Ky lloj përdor edhe kutitë fole, në rastet kur ka mungesë të vendeve për fole. Mirëmbajtja e kallamishteve të madhësisë së mjaftueshme, që lejon mirëmbajtjen e popullatave të këtij lloji, është e domosdoshme. Në raste të caktuara, duhet të krijohen kallamishte të reja.

Referencat

BirdLife International 2016l





Myotis capaccinii Bonaparte, 1837

Lakuriq nate gishtgjatë

Mammalia: Chiroptera: Vespertilionidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
ICenuar, VU

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Philippe Théou

Të dhëna të përgjithshme

Gjatësia e këtij lloji është nga 47-53 mm dhe pesha deri në 7-13 gr. Këmbët e pasme mund të jenë midis 10-13 mm të gjata. Ushqehet me insekte, kryesisht insekte ujore, por edhe me peshq. Ky lloj varet nga habitatet ujore. Strofullat i bëjnë përgjithësisht në habitatet e nëndheshme. Në Ballkan është i kufizuar në zonat karstike. Lëvizjet midis kolonive verore dhe dimërore janë kryesisht brenda një distance prej 50 km dhe maksimum prej 140 km (Hutterer et al. 2005; Paunović 2016a).

Habitati

Lloji i habitatit: 5. Vende ujore (kontinentale); 3. Shkurre; 7. Shpella dhe habitate nëntokësore (joujore).

Përhapja e përgjithshme

Europë, Afrikë, Azi.

Përhapja në Kosovë

Shpella e Dushit, Shpella e Radavcit, Mirushë (Dundarova 2017; Paunović 2016).

Habitati

Trendi i popullatës: I panjohur
Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për gjendjen e popullatave të këtij lloji në Kosovë. Trendi i popullatave në nivel europian është në rënie.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme, sepse nuk ka të dhëna të mjaftueshme për përhapjen në Kosovë apo për trendin e popullatave të tij. Me gjasë, ky lloj është i përhapur më shumë nga sa dihet tani, bazuar në të dhënat e vendeve përreth Kosovës.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 1. Zhvillimi rezidencial dhe komercial; 7 Modifikimet e sistemieve natyrore; 9. Ndotja.
Kërcënimet kryesore, që e rrezikojnë këtë lloj, kanë të bëjnë me fragmentimin dhe izolimin e habitateve, ndryshimet në regjimin menaxhues të pyjeve gjethegjera dhe tokave bujqësore, humbjen e popullatave të insekteve si rezultat i përdorimit të pesticideve, prishjen dhe humbjen e habitateve nëntokësore, si dhe nënkulmeve.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Dundarova 2017; Hutterer et al. 2005; Paunović 2016; Paunović 2016a





Myotis daubentonii Kuhl, 1817

Lakuriq nate i Daubenton-it

Mammalia: Chiroptera: Vespertilionidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Philippe Théou

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj është midis 45 dhe 55 mm i gjatë, me gjerësi krahësh prej 240 deri 275 mm dhe peshë ndërmjet 7 dhe 15 g. Ushqehet me insekte ujore, pastaj Lepidoptera, Diptera dhe Hemiptera. E kërkon ushqimin në trupat ujorë, natyrorë dhe artificialë (duke përfshirë fjordet), nganjëherë në pyje ose mjedise me vegjetacion të pakët. Dimëron në një gamë të gjerë të habitateve të nëndheshme. Distanca më e gjatë e regjistruar e lëvizjes gjatë lëvizjeve sezonale është 257 km. (Hutterer et al. 2005). Çiftëzimi ndodh gjatë vjeshtës dhe fekondimi bëhet në pranverën e ardhshme (Hutson et al. 2007b).

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje, 3. Shkurre; 5. Vende ujore (kontinentale); 6. Zona shkëmbore (p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore), 7. Shpella dhe habitate nëntokësore (joujore), 14. Artificiale/tokësore; 15. Artificiale/ujore & Detare; 9. Detare neritike.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Azi.

Përhapja në Kosovë

Sharr, Shpella e Radavcit, Lumbardhi i Pejës në Pejë; Mirushë (Paunović 2016).

Habitati

Trendi i popullatës: I panjohur
Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për gjendjen e popullatave të këtij lloji në Kosovë. Trendi i popullatave në nivel europian është në rritje.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme, sepse nuk ka të dhëna të mjaftueshme për përhapjen në Kosovë apo për trendin e nënpopullatave të tij. Me gjasë, ky lloj është i përhapur më shumë nga sa dihet tani, bazuar në të dhënat e vendeve përreth Kosovës.

Kërcënimet

Kërcënimet kryesore, që e rrezikojnë këtë lloj, kanë të bëjnë me fragmentimin dhe izolimin e habitateve, ndryshimet në regjimin menaxhues të pyjeve gjethegjera dhe tokave bujqësore, humbjen e popullatave të insekteve si rezultat i përdorimit të pesticideve, prishjen dhe humbjen e habitateve nëntokësore, si dhe nënkulmeve.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Hutterer et al. 2005; Hutson et al. 2007b; Paunović 2016





Myotis mystacinus Kuhl, 1817

Lakuriq nate me mustaqe

Mammalia: Chiroptera: Vespertilionidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Philippe Théou

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj është i zakonshëm në parqe, kopshte dhe fshatra. Është një migrant i kohëpaskohshëm. Strofullon në koloni, duke jetuar në pemë, midis shkëmbinjve dhe në rrethoja blegtorale, por gjithashtu dihet që strofullon edhe në shpella, duke jetuar atje kryesisht gjatë gjithë vitit dhe duke u kthyer aty për të hibernuar gjatë dimrit (Dulamtseren et al.1989) Kolonitë verore janë zakonisht të vendosura në pemë, në ndërtesa, dhe kuti të dedikuara për shpendë dhe lakuriqë. Hibernon në grupe të vogla në vende nëntokësore (shpella, miniera dhe bodrume). Është një lloj nate që del për të gjuajtur për ushqim në perëndim të diellit, por herë pas here është parë ta bëjë këtë edhe gjatë orëve të ditës. Këtë e bën ekskluzivisht pranë trupave ujore por ushqen me insektet fluturuese joujore, të tilla si mushkonja. Të rinjtë lindin në qershor/korrik (Hutson et al. 2007c).

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje; 3. Shkurre; 4. Kullosa; 7. Shpella dhe habitate nëntokësore (joujore); 14. Artificiale/tokësore; 8. Shkretëtira.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Azi.

Përhapja në Kosovë

Pejë (Paunović 2016).

Habitati

Trendi i popullatës: I panjohur
Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për gjendjen e popullatave të këtij lloji në Kosovë. Trendi i popullatave në nivel europian gjithashtu nuk është mjaft i njohur.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme, sepse nuk ka të dhëna të mjaftueshme për përhapjen në Kosovë apo për trendin e nënpopullatave të tij.

Kërcënimet

Kërcënimet kryesore, që e rrezikojnë këtë lloj, kanë të bëjnë me fragmentimin dhe izolimin e habitateve, ndryshimet në regjimin menaxhues të pyjeve gjethegjera dhe tokave bujqësore, humbjen e popullatave të insekteve si rezultat i përdorimit të pesticideve, prishjen dhe humbjen e habitateve nëntokësore, si dhe nënkulmeve.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Dulamtseren et al. 1989; Hutson et al. 2007c; Paunović 2016



Myotis nattereri Kuhl, 1817

Lakuriq nate i Natterer-it

Mammalia: Chiroptera: Vespertilionidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Philippe Théou

Të dhëna të përgjithshme

Ky është një lloj me madhësi mesatare dhe mbërrin një gjatësi të trupit prej 44 deri në 51 mm. Është lloj sedentar dhe insektivor. Kërkon ushqim në pyje (duke përfshirë pyjet mesdhetare të pishës dhe lisit: Amr 2000), shkurre dhe parqe, ndonjëherë mbi ujë, kullosa dhe pemë rruge. Gjendet në zona të lagështa, kurse në zona të thata varet nga trupat e ujit. Strofujt verorë janë në pemë të zbrazëta, ndërtesa, herë pas here edhe vende nëntokësore. Hibernon në habitatet nëntokësore.

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje, 3. Shkurre, 4. Kullosa, 5. Vende ujore (kontinentale), 7. Shpella dhe habitate nëntokësore (joujore); 14. Artificiale/tokësore.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Azi.

Përhapja në Kosovë

Prizren, Shpella e Banuar (Presetnik et al. 2018).

Habitati

Trendi i popullatës: I panjohur
Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për gjendjen e nënpopullatave të këtij lloji në Kosovë. Janë vëzhguar vetëm disa individë. Trendi i popullatave në nivel europian është në rritje.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme, sepse nuk ka të dhëna të mjaftueshme për përhapjen në Kosovë apo për trendin e nënpopullatave të tij. Me gjasë, ky lloj është i përhapur më shumë nga sa dihet tani, bazuar në të dhënat e vendeve përreth Kosovës.

Kërcënimet

Kërcënimet kryesore, që e rrezikojnë këtë lloj, kanë të bëjnë me fragmentimin dhe izolimin e habitateve, ndryshimet në regjimin menaxhues të pyjeve gjethegjera dhe tokave bujqësore, si dhe humbjen e popullatave të insekteve si rezultat i përdorimit të pesticideve.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Amr 2000; Hutson et al. 2008; Presetnik et al. 2018



Pipistrellus pipistrellus Schreber, 1774

Pipistrel i zakonshëm

Mammalia: Chiroptera: Vespertilionidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Philippe Théou

Të dhëna të përgjithshme

Ky është një lloj relativisht i vogël, vetëm 3,5-5,2 cm i gjatë në diametrin midis kokës dhe trupit dhe me bishtin 2,3-3,6 cm. Masa e trupit është midis 3.5 dhe 8.5 gr. E kërkon ushqimin në zona të hapura pyjore dhe skaje pyjesh, shkurre mesdhetare, gjysmëshkretëtira, ferma bujqësore, kopshte rurale dhe në zona urbane. Zakonisht, ushqehet me insekte të vogla, kryesisht me flutura nate. Strofujt e verës gjenden kryesisht në ndërtesa dhe pemë. Shumica e strofujve të dimrit janë të vendosur në rrënojat e ndërtesave, edhe pse mund të përdoren edhe çarje në shkëmbinj dhe shpella dhe gropat potenciale në pemë. Zakonisht, nuk është lloj migrator (Hutson et al. 2007f).

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyll; 3. Shkurre; 14. Artificiale/tokësore.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Afrikë, Azi.

Përhapja në Kosovë

Kuqishtë, Lumbardhi i Pejës, Prizren (Paunović 2016). §

Habitati

Trendi i popullatës: I panjohur
Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për gjendjen e nënpopullatave të këtij lloji në Kosovë. Janë vëzhguar vetëm disa individë. Trendi i popullatave në nivel europian po ashtu nuk është mjaftueshëm i njohur.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme, sepse nuk ka të dhëna të mjaftueshme për përhapjen në Kosovë apo për trendin e nënpopullatave të tij.

Kërcënimet

Kërcënimet kryesore, që e rrezikojnë këtë lloj, kanë të bëjnë me fragmentimin dhe izolimin e habitateve, ndryshimet në regjimin menaxhues të pyjeve gjethegjera dhe tokave bujqësore, humbjen e popullatave të insekteve si rezultat i përdorimit të pesticideve, si dhe shqetësimin dhe humbjen e strofujve.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Hutson et al. 2007f; Paunović 2016



Pipistrellus pygmaeus Leach, 1825

Pipistrel xhuxh

Mammalia: Chiroptera: Vespertilionidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Philippe Théou

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj është ndarë taksonomikisht nga lloji Pipistrellus pipistrellus para disa vitesh, bazuar në thirrjet e ekolokacionit të frekuencave të ndryshme, por edhe në bazë të ndryshimeve morfologjike. E kërkon ushqimin përreth zonave pyjore dhe tokave të lagështa dhe është më shumë i lidhur me ujin sesa lloji P. pipistrellus. Ushqehet me insekte, kryesisht me Diptera të ujit. Kolonitë e lindjes gjenden në hapësira drunjsh, zgavra shkëmbinjsh dhe ndërtesa. Nuk ka të dhëna specifike për vendet e strofullimit dimëror të këtij lloji, por, me gjasë, ato janë të ngjashme me ato të përdorura nga P. pipistrellus (Hutson et al. 2007g).

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje; 5. Vende ujore (kontinentale), 14. Artificiale / tokësore.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Turqi, Iran.

Përhapja në Kosovë

Shpella e Radavcit, Deçan.

Habitati

Trendi i popullatës: I panjohur
Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për gjendjen e nënpopullatave të këtij lloji në Kosovë. Janë vëzhguar vetëm disa individë. Trendi i popullatave në nivel europian po ashtu nuk është mjaftueshëm i njohur.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme, sepse nuk ka të dhëna të mjaftueshme për përhapjen e tij në Kosovë apo për trendin e nënpopullatave. Me gjasë, ky lloj është i përhapur më shumë nga sa dihet tani, bazuar në të dhënat e vendeve përreth Kosovës.

Kërcënimet

Kërcënimet kryesore, që e rrezikojnë këtë lloj, kanë të bëjnë me fragmentimin dhe izolimin e habitateve, ndryshimet në regjimin menaxhues të pyjeve gjethegjera dhe tokave bujqësore, humbjen e popullatave të insekteve si rezultat i përdorimit të pesticideve, si dhe shqetësimin dhe humbjen e strofujve.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Hutson et al. 2007g



Pipistrellus pipistrellus Schreber, 1774

Pipistrel i zakonshëm

Mammalia: Chiroptera: Vespertilionidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Philippe Théou

Të dhëna të përgjithshme

Ky është një lloj relativisht i vogël, vetëm 3,5-5,2 cm i gjatë në diametrin midis kokës dhe trupit dhe me bishtin 2,3-3,6 cm. Masa e trupit është midis 3.5 dhe 8.5 gr. E kërkon ushqimin në zona të hapura pyjore dhe skaje pyjesh, shkurre mesdhetare, gjysmëshkretëtira, ferma bujqësore, kopshte rurale dhe në zona urbane. Zakonisht, ushqehet me insekte të vogla, kryesisht me flutura nate. Strofujt e verës gjenden kryesisht në ndërtesa dhe pemë. Shumica e strofujve të dimrit janë të vendosur në rrënojat e ndërtesave, edhe pse mund të përdoren edhe çarje në shkëmbinj dhe shpella dhe gropat potenciale në pemë. Zakonisht, nuk është lloj migrator (Hutson et al. 2007f).

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyll; 3. Shkurre; 14. Artificiale/tokësore.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Afrikë, Azi.

Përhapja në Kosovë

Kuqishtë, Lumbardhi i Pejës, Prizren (Paunović 2016). §

Habitati

Trendi i popullatës: I panjohur
Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për gjendjen e nënpopullatave të këtij lloji në Kosovë. Janë vëzhguar vetëm disa individë. Trendi i popullatave në nivel europian po ashtu nuk është mjaftueshëm i njohur.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme, sepse nuk ka të dhëna të mjaftueshme për përhapjen në Kosovë apo për trendin e nënpopullatave të tij.

Kërcënimet

Kërcënimet kryesore, që e rrezikojnë këtë lloj, kanë të bëjnë me fragmentimin dhe izolimin e habitateve, ndryshimet në regjimin menaxhues të pyjeve gjethegjera dhe tokave bujqësore, humbjen e popullatave të insekteve si rezultat i përdorimit të pesticideve, si dhe shqetësimin dhe humbjen e strofujve.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Hutson et al. 2007f; Paunović 2016



Pipistrellus pygmaeus Leach, 1825

Pipistrel xhuxh

Mammalia: Chiroptera: Vespertilionidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Philippe Théou

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj është ndarë taksonomikisht nga lloji Pipistrellus pipistrellus para disa vitesh, bazuar në thirrjet e ekolokacionit të frekuencave të ndryshme, por edhe në bazë të ndryshimeve morfologjike. E kërkon ushqimin përreth zonave pyjore dhe tokave të lagështa dhe është më shumë i lidhur me ujin sesa lloji P. pipistrellus. Ushqehet me insekte, kryesisht me Diptera të ujit. Kolonitë e lindjes gjenden në hapësira drunjsh, zgavra shkëmbinjsh dhe ndërtesa. Nuk ka të dhëna specifike për vendet e strofullimit dimëror të këtij lloji, por, me gjasë, ato janë të ngjashme me ato të përdorura nga P. pipistrellus (Hutson et al. 2007g).

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje; 5. Vende ujore (kontinentale), 14. Artificiale / tokësore.

Përhapja e përgjithshme

Europë, Turqi, Iran.

Përhapja në Kosovë

Shpella e Radavcit, Deçan.

Habitati

Trendi i popullatës: I panjohur
Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për gjendjen e nënpopullatave të këtij lloji në Kosovë. Janë vëzhguar vetëm disa individë. Trendi i popullatave në nivel europian po ashtu nuk është mjaftueshëm i njohur.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme, sepse nuk ka të dhëna të mjaftueshme për përhapjen e tij në Kosovë apo për trendin e nënpopullatave. Me gjasë, ky lloj është i përhapur më shumë nga sa dihet tani, bazuar në të dhënat e vendeve përreth Kosovës.

Kërcënimet

Kërcënimet kryesore, që e rrezikojnë këtë lloj, kanë të bëjnë me fragmentimin dhe izolimin e habitateve, ndryshimet në regjimin menaxhues të pyjeve gjethegjera dhe tokave bujqësore, humbjen e popullatave të insekteve si rezultat i përdorimit të pesticideve, si dhe shqetësimin dhe humbjen e strofujve.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Hutson et al. 2007g



Plecotus austriacus Fischer, 1829

Lakuriq nate veshgjate i hirtë

Mammalia: Chiroptera: Vespertilionidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Shqetësim më i Vogël, LC

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Philippe Théou

Të dhëna të përgjithshme

Ky është një lloj relativisht i madh i lakuriqëve. E kërkon ushqimin në lugina dhe toka të hapura bujqësore, por edhe në habitate të tjera. Kryesisht ushqehet me flutura nate. Gjatë verës kryesisht strofullon në ndërtesa (nënkulme, zgavra, hapësira, ndërtesa të vjetra), edhe pse individët e vetmuar mund të strofullojnë në vende nëntokësore. Gjatë dimrit hibernon në ndërtesa, miniera dhe shpella. Kryesisht është një lloj sedentar (Juste et al. 2008).

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje 3. Shkurre, 4. Kullosa 5. Vende ujore (kontinentale), 7. Shpella dhe habitatet nëntokësore (jo ujore), 8. Shkretëtira; 14. Artificiale/tokësore.

Përhapja e përgjithshme

Europë.

Përhapja në Kosovë

Lumbardhi i Prizrenit në Prizren (Presetnik et al. 2018).

Habitati

Trendi i popullatës: I panjohur
Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për gjendjen e nënpopullatave të këtij lloji në Kosovë. Janë vëzhguar vetëm disa individë. Trendi i popullatave në nivel europian po ashtu nuk është mjaftueshëm i njohur.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme, sepse nuk ka të dhëna të mjaftueshme për përhapjen e këtij lloji në Kosovë apo për trendin e nënpopullatave të tij.

Kërcënimet

Lista e kërcënimeve: 2. Bujqësia dhe akuakultura; 11. Ndryshimet klimatike dhe moti i ashpër.
Kërcënimet kryesore, që e rrezikojnë këtë lloj, kanë të bëjnë me ndryshimet në regjimin menaxhues të pyjeve gjethegjera dhe tokave bujqësore, humbjen e popullatave të insekteve si rezultat i përdorimit të pesticideve, si dhe shqetësimin dhe humbjen e strofujve.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Juste et al. 2008; Presetnik et al. 2018



Vespertilio murinus Linnaeus, 1758

Lakuriq nate dyngjyrësh

Mammalia: Chiroptera: Vespertilionidae

Statusi i kërcënueshmërisë në Europë (sipas IUCN)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Statusi i kërcënueshmërisë në Kosovë (sipas kritereve të IUCN-së)
Të Dhëna të Pamjaftueshme, DD

Viti i vlerësimit

2018

Vlerësuesi(t)

Philippe Théou

Të dhëna të përgjithshme

Ky lloj ka një madhësi trupore prej 4.8-6.4 cm, gjerësi krahësh prej 26-33 cm dhe një peshë prej 11-24 g. Emri i llojit vjen nga gëzofi i cili ka dy ngjyra. Ana shpinore është e kuqe në të kaftë, me qime të bardha me nuancë të argjendtë, kurse ana barkore është e bardhë ose gri. Zakonisht, ushqehet me flutura nate dhe insekte të tjera, të tilla si brumbuj. Është kryesisht lloj sedentar, por në disa raste janë regjistruar migracione. Ky lloj nate shfaqet vonë në mbrëmje, duke fjetur në të çara të ngushta gjatë ditës. Jeton në koloni të vogla dhe shpesh mund të vrojtohen edhe individët e vetmuar. Hibernon gjatë gjithë dimrit. Të rinjtë lindin në qershor/korrik (Coroiou 2016).

Habitati

Lloji i habitatit: 1. Pyje; 2. Shkurre; 4. Kullosa; 6. Zona shkëmbore (p.sh., shkëmbinj kontinentalë, maja malore); 7. Shpella dhe habitate nëntokësore (joujore), 8. Shkretëtira; 14. Artificiale/tokësore.

Përhapja e përgjithshme

Shpella e Radavcit.

Përhapja në Kosovë

Shpella e Radavcit, Deçan.

Habitati

Trendi i popullatës: I panjohur
Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për gjendjen e nënpopullatave të këtij lloji në Kosovë. Janë vëzhguar vetëm disa individë. Trendi i popullatave në nivel europian po ashtu nuk është mjaftueshëm i njohur.

Arsyetimi i vlerësimit

Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Të Dhëna të Pamjaftueshme, sepse nuk ka të dhëna të mjaftueshme për përhapjen e këtij lloji në Kosovë apo për trendin e nënpopullatave të tij.

Kërcënimet

Kërcënimet kryesore, që e rrezikojnë këtë lloj, kanë të bëjnë me fragmentimin dhe izolimin e habitateve, ndryshimet në regjimin menaxhues të pyjeve gjethegjera dhe tokave bujqësore, humbjen e popullatave të insekteve si rezultat i përdorimit të pesticideve, si dhe shqetësimin dhe humbjen e strofujve.

Masat ekzistuese mbrojtëse

Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).

Masat e nevojshme mbrojtëse

Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit).
Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit).

Referencat

Coroiou 2016



REFERENCAT

[1] Agasyan A., Avci A., Tuniyev B., Crnobrnja Isailovic J., Lymberakys P., Orlov N., Podloucky R., Tuniyev S., Kaya U., Sindaco R., Bohme W., Ajtic R., Tok V., Ugyrtas I. H., Sevinc M., Tomovic L., Crochet P. A., Haxhiu I., Joger U., Sterijovski B., Nilson G. & Jelic D. 2009. Vipera ammodytes. In: IUCN Red List of Threatened Species. Version 2013.2.

[2] Akçakaya H. R. & Ferson S. 2001. RAMAS® Red List: Threatened Species Classifications under Uncertainty. Version 2.0. Applied Biomathematics, New York.

[3] Amr Z. S. 2000. Mammals of Jordan. United Nations Environment Programme, Amman.

[4] Antić D. Ž., Ćurčić B. P. M., Mitić B. M., Tomić V. T., Lučić L. R., Dudić B. D., Stojanović D. Z. & Makarov S. E. 2013. A new cave diplopod of the genus Brachydesmus Heller, 1858 from southwest Serbia (Diplopoda: Polydesmida: Polydesmidae). Archives of Biological Sciences 65 (2): 745-750.

[5] Apfelbeck V. 1907. Bericht über die im Jahre 1906 durchgeführte zoologische Reise nach Ost-Albanien in das Gebiet des Schar Dagh. Jahresbericht des naturwissenschaftlichen Orient-Vereines in Wien 12: 31-36.

[6] Arnold E. N. & Ovenden D. 2002. A field guide to the Reptiles and Amphibians of Britain and Europe. Collins, London, pp. 288.

[7] Arntzen J. W., Denoël M., Kuzmin S., Ishchenko V., Beja P., Andreone F., Jehle R., Nyström P., Miaud C., Anthony B., Schmidt B., Ogrodowczyk A., Ogielska M., Bosch J., Vogrin M. & Tejedo M. 2009. Ichthyosaura alpestris (Alpine Newt). The IUCN Red List of Endangered Species. International Union for Conservation of Nature and Natural Resources. Retrieved 27 February 2017.

[8] Attems C. M. T. Graf von. 1929. Die Myriopodenfauna von Albanien und Jugoslavien. Zoologische Jahrbücher, Abteilung für Systematik, Ökologie und Geographie der Tiere 56: 269-356.

[9] Bauernfeind E. & Soldán T. 2012. The mayflies of Europe (Ephemeroptera), Denmark: Apollo Books, Ollerup, pp.781.

[10] Bellmann H. 2016. Der Kosmos Spinnenfuehrer. Stutgard: Franck-KosmHos Verlags- Gmb., pp. 180-181.

[11] Beron P. 2008. High Altitude Isopoda, Arachnida and Myriapoda in the Old World. Pensoft & National Museum of Natural History, Sofia–Moscow: pp.556.

[12] Bertolero A., Chelyan A. M., Hailey A., Livoreil B. & Willemsen R. E. 2011. Testudo hermanii Gmelin, 1789-Hermanns tortoise. In: Rhodin A. G. J., Pritchard, P. C. H., Saumure R. A., Buhlmann K.A., Iverson J. B., Mittermeier R. A. Conversation Biology of freshwater Turtles and Tortoises.

[13] BirdLife International 2016d. Ardea cinerea. The IUCN Red List of Threatened Species 2016: Downloaded on 25 November 2018.

[14] BirdLife International 2016g. Aquila fasciata. The IUCN Red List of Threatened Species 2016: Downloaded on 25 November 2018.

[15] BirdLife International 2016l. Panurus biarmicus. The IUCN Red List of Threatened Species 2016: Downloaded on 25 November 2018.

[16] BirdLife International 2016m. Acrocephalus palustris. The IUCN Red List of Threatened Species 2016: Downloaded on 25 November 2018.

[17] BirdLife International 2017. Aythya ferina (amended version of 2016 assessment). The IUCN Red List of Threatened Species 2017: Downloaded on 25 November 2018.

[18] BirdLife International 2017a. Aythya nyroca. The IUCN Red List of Threatened Species 2017: Downloaded on 25 November 2018.

[19] BirdLife International 2017b. Ciconia nigra (amended version of 2016 assessment). The IUCN Red List of Threatened Species 2017: Downloaded on 25 November 2018.

[20] BirdLife International 2017c. Vanellus vanellus (amended version of 2016 assessment). The IUCN Red List of Threatened Species 2017: Downloaded on 25 November 2018.

[21] BirdLife International 2017d. Gyps fulvus (amended version of 2016 assessment). The IUCN Red List of Threatened Species 2017: Downloaded on 25 November 2018.

[22] BirdLife International 2017e. Buteo rufinus (amended version of 2017 assessment). The IUCN Red List of Threatened Species 2017: Downloaded on 25 November 2018.

[23] BirdLife International 2017f. Falco cherrug (amended version of 2016 assessment). The IUCN Red List of Threatened Species 2017: Downloaded on 25 November 2018.

[24] BirdLife International 2017g. Monticola saxatilis (amended version of 2016 assessment). The IUCN Red List of Threatened Species 2017: Downloaded on 25 November 2018.

[25] BirdLife International 2018. Alectoris graeca. The IUCN Red List of Threatened Species 2018: e.T22678684A131902869. Downloaded on 25 November 2018.

[26] BirdLife International 2018a. Accipiter brevipes. The IUCN Red List of Threatened Species 2018: e.T22695499A131936047. Downloaded on 25 November 2018.

[27] BirdLife International 2018b. Tichodroma muraria. The IUCN Red List of Threatened Species 2018: e.T22711234A132095740. Downloaded on 25 November 2018.

[28] BirdLife International 2016. Tetrao urogallus. The IUCN Red List of Threatened Species 2016: Downloaded on 25 November 2018.

[29] BirdLife International 2016b. Anas crecca. The IUCN Red List of Threatened Species 2016: Downloaded on 25 November 2018.

[30] BirdLife International 2016c. Botaurus stellaris. The IUCN Red List of Threatened Species 2016: Downloaded on 25 November 2018.

[31] BirdLife International 2016e. Himantopus himantopus. The IUCN Red List of Threatened Species 2016: Downloaded on 25 November 2018.

[32] BirdLife International 2016f. Aquila chrysaetos. The IUCN Red List of Threatened Species 2016: Downloaded on 25 November 2018.

[33] BirdLife International 2016h. Hieraaetus pennatus. The IUCN Red List of Threatened Species 2016: Downloaded on 25 November 2018.

[34] BirdLife International 2016i. Alcedo atthis. The IUCN Red List of Threatened Species 2016: Downloaded on 25 November 2018.

[35] BirdLife International 2016j. Picoides tridactylus. The IUCN Red List of Threatened Species 2016: Downloaded on 25 November 2018.

[36] BirdLife International 2016k. Falco biarmicus. The IUCN Red List of Threatened Species 2016: Downloaded on 25 November 2018.

[37] Bohme W., Lymberakis P., Ajtic R., Tok V., Ugurtas I. H., Sevinc M., Crochet P., Haxhiu I., Sterijovski B., Krecsak L., Crnobrnja-Isailovic J., Kaska Y., Avzi A. & Jelic D. 2009. Ablepharus kitaibelii IUCN Red List of Threatened Species. Version 2009. 2.

[38] Boxshall G. 2013. Fauna Europaea: Isopoda. Fauna Europaea version 2017.06, https://fauna-eu.org (assesed 29_11_2018).

[39] Breitenmoser Wursten C. & Obexer Ruff G. 2003. Population Genetic of two reintroduced Lynx (Lynx lynx) populations in Switzerland: A molecular evaluation 25 years after translocation. Progress report. Kora Bericht. Bern.

[40] Bressi N. 2004. Algyroides nigropunctatus nigropunctatus in Italy: notes on ecology, habitat selection and conversation (Reptilia, Lacertidae). Italian Journal of Zoology 71: 113-116.

[41] Budinski I., Jojić V., Jovanović V. M., Bjelić Cabrilo O., Paunović M. & Vujošević M. 2015. Cranial variation of the greater horseshoe bat Rhinolophus ferrumequinum (Chiroptera: Rhinolophidae) from the central Balkans. Zoologischer Anzeiger 254: 8–14.

[42] Chivian E. & Bernstein A. (eds.) 2008. Sustaining life: How human health depends on biodiversity. Center for Health and the Global